

Përgatiti:  
Dibran Fylli  
Naim Kelmendi

**FLORI BRUQI KONTI I LETRAVE SHQIPE**  
(Intervista, vështrime, recensione)

AKADEMIA SHQIPTARO-AMERIKANE  
E SHKENCAVE DHE ARTEVE



THE ALBANIAN AMERICAN ACADEMY  
OF SCIENCE AND ARTS



NEW YORK, PRISHTINË, TIRANË, SHKUP

Shtëpia botuese  
“Press Liberty”

Për botuesin  
Asllan Qyqalla

Redaktor gjuhësor  
Naim Kelmendi

Recensent  
Zef Pergega

Kopertina-dizajni  
Dibran Fylli

Radhitja kompjuterike dhe faqosja  
uniART Creative

© të gjitha të drejtat (f.b)

**Dibran Fylli**  
**Naim Kelmendi**


# **FLORI BRUQI**

## **KONTI I LETRAVE SHQIPE**

(Intervista, vështrime, recensione)



**PRESS LIBERTY**  
Prishtinë 2021



**Shkrime kritike nga:**

*Zef Pergega, Eshref Ymeri, Namik Shehu, Naim Kelmendi, Kujtim Mateli, Rushit Ramabaja, Reshat Sahitaj, Fatmir Terziu, Mehmet Kajtazi, Iljaz Prokshi, Lumturie Haxhijaj, Dibran Fylli, Rustem Geci, Kristaq Shabani, Faik Xhani, Rasim Bebo, Rexhep Shahu, Nijazi Halili, Adem Avdia, Bajame Hoxha...*

---



PIKËPAMJE PËR KRJIMTARINË LETRARE, KRITIKËN  
DHE KRIZËN E IDENTITETIT

*Intervistë e gjatë me shkrimtarin Flori Bruqi*

**Nga Akademik Prof.dr. Zef Përgega**

Atë që nuk e bëri shteti e bëri njeriu, Flori Bruqi, Konti i kulturës dhe letrave shqipe. Leksikoni pikë së pari është një leksion për Akademitë e Shkencave të Shqipërisë, Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare. Flori Bruqi u ka ngritur njerëzve një permendore të derdhur ne shkronja, i ka vlerësuar në motivin më të lartë që kurrë nuk do ta përjetonin nga shteti, të cilit i shërbyen me devocion, ashtu siç bënë çdo gjë për kombin e tyre. Gjëja më e keqe dhe e rëndomtë tek shqiptari është mungesa e kujtesës dhe e ndëritit, që prej tyre vjen bashkimi, ndërsa ato i mbajnë sytë e lumturohen në gardhin e lartë të ndarjes mes nesh, që po me paratë e popullit ndërton muret e ndarjes. Flori Bruqi është një etalon i paparë, një shpirt i madh që nuk kërkon lavd. Një njeri që çdo ditë e vë një gurë të latuar në këndin e kulturës kombëtare. Ai i ka dhënë një frymë të re Akademisë së shkencave dhe arteve në Nev-York. Flori Bruqi është një tra i fortë dhe i rreshkur si guri i xeherorit, me anë të cilin mbahet kulmi i kulturës që të mos shembet. Ai ecën me vuajtjen dhe heroizmin e popullit të vet, pa kërkuar merita dhe pa u dukur. Qetë ecin para, parmenda u shkon mbrapa, e më pas plisi mbulon dheun që të mbijë fara. Kështu mund ta përkufizoj kontributin e Flori Bruqit në këto rreshta spontane siç m'i tha shpirti e siç m'i tha fjala. Kam qenë në promovimin e librit të akademik z. Fylli dhe e pashë respektin që kishin njerëzit më të lartë të kulturës në Kosovë

për Flori Bruqin që nuk bën ndarje as krahinore dhe as fetare. Ai në Leksikon ka përfshirë shenjtoeren Nana Terezë, një nga Papaet e Romës, me origjinë shqiptare dhe disa krijues, shkrimtare e personalitete katolike, e kjo e bën veprën e Flori Bruqit që t'i kapërcejë përmasat kombëtare sa vetë Vatikani, është shprehur me konsideratë për këtë njeri. I dashur, udha e Flori Bruqit nuk ka pengesa, nuk ka urrejtje, nuk ka vesë, por ajo është shtruar me mjaltin e shpirtit të tij, ku pranvera i mbush me lulet e Blinit. Më ka mahnitur pritja dhe nderimi i tij ndaj dy vetave që kishin shkuar në takimin e promovimit të librit të Dibrani Fyllit, bashkë me Preg Pjetri Babon nga Italia. Salla ishte mbushr plot. Ishte salla e Bibliotekës Kombëtare, ku tavolina e nderit ishte poshtë dhe shkencëtarët apo pjesëmarrësit lart. Kjo kishte një domethënie... Gruri i mban kokën ulur, egjrat kërkojnë të ngrihen mbi kallin e tyre të thatë. Krijimtaria e Flori Bruqit është një blegërimë në jehonën e letrave shqipe... jehonë që merr me vete njeriun e mirë...

Flori Bruqi shkrimtar, poet i afirmuar, studiues i letërsisë, shkencëtar i Kineziologjisë Sportive, autor i 56 librave, zhanresh letrare dhe shkencore.

Vepra letrare-poetike dhe studimore e tij,në një mënyrë ose tjetër,me kohë ka zgjuar interesim te lexuesit dhe studiuesit,veçanërisht te kritika e mirëfillët letrare dhe shkencore. Kështu ajo, si ndërthurje estetike vitale, shqiptare dhe evropiane,ka qenë mjaft shpesh pikë e fortë referimi, objekt observimi dhe analize nga studiues të shumtë të profileve akademike.

Libri më i ri publicistik i shkrimtarit tashmë të mirënjohur, Flori Bruqi, na vjen si një sihariq i mirë letrar. 38 librat e tij

për Flori Bruqin që nuk bën ndarje as krahinore dhe as fetare. Ai në Leksikon ka përfshirë shenjtoren Nana Terezë, një nga Papaet e Romës, me origjinë shqiptare dhe disa krijues, shkrimtare e personalitete katolike, e kjo e bën veprën e Flori Bruqit që t'i kapërcejë përmasat kombëtare sa vetë Vatikani, është shprehur me konsideratë për këtë njeri. I dashur, udha e Flori Bruqit nuk ka pengesa, nuk ka urrejtje, nuk ka vesë, por ajo është shtruar me mjaltin e shpirtit të tij, ku pranvera i mbush me lulet e Blinit. Më ka mahnitur pritja dhe nderimi i tij ndaj dy vetave që kishin shkuar në takimin e promovimit të librit të Dibrani Fyllit, bashkë me Preg Pjetri Babon nga Italia. Salla ishte mbushr plot. Ishte salla e Bibliotekës Kombëtare, ku tavolina e nderit ishte poshtë dhe shkencëtarët apo pjesëmarrësit lart. Kjo kishte një domethënie... Gruri i mban kokën ulur, egjrat kërkojnë të ngrihen mbi kallin e tyre të thatë. Krijimtaria e Flori Bruqit është një blegërimë në jehonën e letrave shqipe... jehonë që merr me vete njeriun e mirë...

Flori Bruqi shkrimtar, poet i afirmuar, studiues i letërsisë, shkencëtar i Kineziologjisë Sportive, autor i 56 librave, zhanresh letrare dhe shkencore.

Vepra letrare-poetike dhe studimore e tij, në një mënyrë ose tjetër, me kohë ka zgjuar interesim të lexuesit dhe studiuesit, veçanërisht të kritika e mirëfillët letrare dhe shkencore. Kështu ajo, si ndërthurje estetike vitale, shqiptare dhe evropiane, ka qenë mjaft shpesh pikë e fortë referimi, objekt observimi dhe analize nga studiues të shumtë të profileve akademike.

Libri më i ri publicistik i shkrimtarit tashmë të mirënjohur, Flori Bruqi, na vjen si një sihariq i mirë letrar. 38 librat e tij

përmbajnë një lëndë të pasur në shumë aspekte letrare dhe shkencore. Studiuesi Bruqi i ka sistemuar këto shkrime, që përbëjnë një sërë vlerësimesh të çmueshme letrare dhe shkencore për krijimtarinë e tij të ndryshme, poetike, publicistike dhe shkencore, për ato botime të fushës profesionale. Flori Bruqi (1952) përveç kolanës letrare dhe shkencore mbajnë firmën e tij 21 fejtone publicistiko-shkencore në gazetën “Rilindja” të Prishtinës, në periudhën 1974-1982, si dhe qindra -mijëra punime në shumë veb faqe interneti (2003-2016). Është editor i Agjencionit “Floripress”, si dhe bashkëpunëtor i dhjetëra veb faqeve në internet. Bashkëpunoi me shtypin e përditshëm e periodik të vendit dhe të jashtëm, që nga viti 1974 e deri me tash (“Bota e re” - Prishtinë, “Rilindja” - Prishtinë, “Danas” - Zagreb, “Dello” - Lubjanë, “Dnevnik” - Lubjanë, “Vequer” - Maribor, “Le Mond”, “Corriera della Sera” etj).

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2000). Menaxher i kompanisë “Flomed” nga Prishtina dhe menaxher gjeneral për Kosovë në distribucion e preparateve farmaceutiko-kimike të fabrikave “Schülke-Mayr-”it të Gjermanisë dhe “Borer Chemie AG” të Zvicrës.

Personalisht kam një bashkëpunim 14 vjeçar me Florin, duke botuar dhjetëra artikuj kryesisht me temë ngjarjet në Kosovë.

*-Flori Bruqi, ju njohim si shkrimtar, kritik letrar dhe publicist. Si vrojtues i zhvillimeve shoqërore, a mund të na thoni, ku është kombi shqiptar sot?*

**F.Bruqi:** Para 60 vjetëve në Vienë, një grup intelektualësh në mërgimin e detyruar nga komunizmi, shqiptar, shkruan librin “Nga do ia mbajnë shqiptarët”? Në libër thuhet, se kombi

kombi shqiptar ndodhet në një udhëkryq mes ngërçit të trashëgimisë turke dhe orientale dhe ecjes drejt Perëndimit, drejt familjes europiane, së cilës duam që të besojmë se i përkasim. Unë do të thosha: inercinë, atë aftësi tragjike që kemi ne për të qëndruar vendnumëro, atë aftësi të çuditshme që kemi për t'i injoruar shenjat dhe për të mbyllur veshët kur kambanat bien. Pas gjithë këtyre viteve do të shtroja edhe një herë po atë pyetje: nga do t'ia mbash?-Nga Perëndimi apo nga Lindja?

*-Ka një kohë të gjatë, që debatet për identitetin shqiptar nuk pushojnë. Sipas jush, kanë shqiptarët identitet unik? Për më tepër, a mund të flitet për një kulturë homogjene brenda kombit shqiptar?*

**F.Bruqi:** Mendoj se problemi kryesor i ne shqiptarëve është kriza e identitetit. Tek ne flitet për identitet, për histori, për lashtësi kombëtare, pa arritur të kuptohet se çfarë është në të vërtetë identiteti kombëtar. Historianët dhe akademikët që duhej të ishin të parët në debatin për identitetin kombëtar janë të parët që e shtojnë konfuzionin dhe keqkuptimin. Na pëlqen të flasim për historinë në një kohë që jemi nxënësit më të këqij të historisë; na pëlqen të flasim për lashtësinë, dhe nuk mbajmë mend ato ngjarje që kanë ndodhur para 30-40 viteve, na pëlqen të flasim për identitet në një kohë që jemi të gatshëm t'i nënvleftësojmë vlerat tona të kulturës dhe simbolet tona të kombit. Ju më pyesni nëse ka një kulturë homogjene brenda kombit shqiptar. Nuk besoj aq shumë te homogjiniteti, i cili mbart brenda vetes rrezikun e armikut më të madh të kulturës, uniformitetin. Besoj te paradoksi se sa më e larmishme të jetë kultura e një vendi, aq më e bashkuar dhe e njëjtë është ajo. Gjergj Fishta, Fan S. Noli, Lasgush Poradeci, janë shkrimtarët më të pangjashëm mes tyre.

Dhe janë shkrimtarë të bashkuar si shkrimtarët më përfaqësues të kombit.

*-Meqë jemi tek identiteti. Vitin e kaluar, para dy vitesh u festua 100 vjetori i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ndërkaq, në anën tjetër, kemi një përpjekje të vazhdueshme për afrim me Turqinë. Në këtë aspekt, ndodh që qeveritë shqiptare të shfaqin një "vëllazëri" me politikanë turq. Si i vlerësoni ju këto marrëdhënie dhe si shpjegoni marrëdhëniet e turko-shqiptare të viteve të fundit?*

**F.Bruqi:** 100 vjetori i Pavarësisë, ishte ndër ngjarjet më të mëdha të historisë kombëtare, por e festuar në mënyrën tonë. Me një eufori skenike dhe pompoze.

Mendoj se 100 vjetori i Pavarësisë, duhej të ishte që një çast reflektimi kombëtar. Reflektimi se si ca burra të shquar të kombit shpallën Pavarësinë kombëtare, duke na lënë pasurinë më të rrallë e më të çmuar në bankën e ndërgjegjes tonë.

Çfarë kemi bërë ne me këtë pasuri të trashëguar, me këtë llogari bankare të lënë 100 vite më parë?

Si e kemi shpenzuar, manexhuar këtë pasuri të lënë me aq amanete?

Mendoj se e kemi manexhuar dhe vazhdojmë ta manexhojmë shumë keq. Eshtrat e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Bogdanit, Budit, Marin Barletit, Naim Frashërit, Atë Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Fan S.Nolit do të ktheheshin përmbys në varret e tyre po të dëgjonin deklaratat e kryeministrit turk dhe të kryeministrave shqiptarë për vëllazërinë e gjakut, për fshehjen e bustit të Gjergj Kastriot Skënderbeut në zyrat e presidencës shqiptare dhe në zyrat e kryeministrisë e të Ministrisë së Jashtme saherë që një delegacion i lartë turk vjen e

viziton vendin tonë. Kohët e fundit ndoqa në kanalet televizive angleze një intervistë të gjatë me presidentin turk, Rexhep Erdogan.

Ai tha se, "ndjen një kënaqësi të rrallë sa herë që viziton vende myslimane, si Egjipti, Kosova, Bosnja dhe Shqipëria"

Se si ndjehem, si në shtëpinë time, tha ai. Se ne myslimanët kemi diçka që vendet e krishtera nuk e kanë, vëllazërimin mysliman, solidaritetin, miqësinë dhe mikpritjen!.,

Po qe se ndonjë kryeministër anglez a gjerman a francez, do guxonte të thoshte se ndjejnë kënaqësi kur vizitojnë vende të krishtera, deklaratë e tyre do të konsiderohej një skandal i "political correctness" dhe një shovinizëm i krishterë. Që kur kryeministri turk Ahmet Davoutoglu shpalli në Sarajevë ambicien e Turqisë moderne për të krijuar një shtet protektorat për popujt myslimanë të Ballkanit e të Kaukazit, do të qe një naivitet për të mos parë përpjekjet ambicioze të Turqisë për t'u bërë një Super-Pover. Turqia nuk është e sigurt për anëtarësimin në Bashkësinë Evropiane. Asaj i duhet një kartë rezervë, dhe kjo kartë rezervë e saj është rikrijimi në format moderne i shtetit perandorak osman. Marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë janë marrëdhëniet e dy vendeve anëtare të Nato-s. Shqipëria ka dhe duhet të ketë marrëdhënie normale me shtetin turk. Por në të njëjtën kohë duke reaguar me forcë dhe dinjitet ndaj çdo reference mohuese të kombit shqiptar. P.sh., kur Dovuglu, duke folur për multi-kulturalizmin në Ballkanin turk, dhe kur ai thotë se shqiptarët dhe turqit "janë një komb" nuk ke se si të mos shohësh këtu shtrembërimin me dashje të historisë. Kjo pikëpamje e shtetarëve të Turqisë moderne nuk është gjë tjetër veç një ferexhe që fsheh

dëshirën për të krijuar komunitetin islamik të perandorisë osmane (milletin Otoman apo Umna-në islamike) si një mjet për të zëvendësuar identitetin modern kombëtar. Sipas konceptit të kombit, Turqit dhe shqiptarët nuk mund të jenë një komb. Koncepti i presidenti turk Erdoganit është koncepti i Perandorisë turke, sipas të cilit banorët e Perandorisë nuk ndahen e as nuk bashkohen nga etniciteti, por nga feja. muslimanë shqiptarë, myslimanë çeçenë, arabë, boshnjakë, kirkizianë, egjiptianë, sirianë, janë një etnicitet, ngaqë i përkasin etnicitetit musliman. Ndërsa shqiptarët e krishterë u përkasin një etniciteti tjetër, atij millet - rom dhe latin, së bashku me grekët, serbët, bullgarët, hungarezët...

Unë nuk di një tezë më përçarëse dhe më rrënimtare se kjo për ne shqiptarët.

*-Po tendencën për ndryshimin e historisë, që vjen nga presioni i shtetit turk, sidomos i pjesëve ku bëhet fjalë për pushtimin e perandorisë osmane në tokat shqiptare?*

**F.Bruqi:** Historiani Luan Malltezi. Drejtor i Muzeumit Kombëtar, Drejtor i atij institucioni kombëtar që kujdeset për ruajtjen e kujtesës kolektive të shqiptarëve, pat thënë se zyrtarët turq janë të pakënaqur me librat e historiografisë shqiptare, kësaj duhet ta rishkruajmë historinë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Turqinë. Problemi nuk është nëse duhet a nuk duhet rishkruar historia, por çfarë kuptojmë me rishkrim të historisë. Argumentimi teorik i rishkrimit të historisë reduktohet që në fillim në “rishikimin e historisë së Shqipërisë nën Perandorinë Osmane”, - siç shkruan Malltezi. Pozita e historianit nuk është në vartësi të qëndrimit të hënës apo të gjysmë hënës subjektive të historianit si individ.



Aq më tepër nuk është një përpjekje për të kënaqur politikanët e ditës. Është një detyrim në radhë të parë ndaj së vërtetës historike. Historiografia si pjesë dhe koncept i kulturës perëndimore në tërësi, mbetet një mishërim i vetë identifikimit të popujve, i kujtesës së kolektivitetit etik, kombëtar, fetar, politik, dhe shoqëror të tyre. Kësisoj historia duhet të rishkruhet me kriteret më rigorozë të shkencës historike, pa u impresionuar apo, aq më pak, pa u ndikuar nga politikanët e ditës, qofshin këta ministra turq a kryeministra shqiptar.

Sipas historianëve tanë: “shqiptarë të shumtë kaluan me kohë në besimin osman me qëllim që të ishin të lirë të bënin karrierë ushtarake. Gjenerali Ballaban Pasha që luftoi më Skënderbeun ishte një shqiptar i talentuar ushtarak i kohës. Gjer më sot shqiptarët i kanë dhënë 23 kryeministra (sadriazemë) Perandorisë Osmane, pa numëruar këtu njerëz të tjerë të mëdhenj të administratës së lartë që ishin të shumtë Perandorisë. Në kohën kur Perandoria ra dhe i ishte afruar greminës, një dorë shqiptare si Mehmet Pashë Qypriliu nga fshatrat e Beratit e ngriti dhe i dha jep një fuqi të re. I biri i Mehmet Pashës, Fazil Pasha i shpuri ushtritë e perandorisë deri në Austri dhe Rusi, një shqiptar tjetër Sinan Pashai, shpuri armët e perandorisë Osmane në Jemen dhe në shkretëtirën e Arabisë. Këtu çdo njeri me mendje të kthjellët duhet të ndalet e të pyes: Ballaban Pasha me të vërtetë mund të ketë qenë një gjeni ushtarak i kohës - i talentuar - thotë Malltezi (do të isha kurioz të dija burimin historik të këtij epiteti për Pashain që luftoi kundër vendit të vet, veç ndonjë defteri turk, që nuk ka se si të merret si dokument i besueshëm kur lavdëron një gjeneral të ushtrisë së Sulltanit), por a e

shpëton atë gjenia e tij ushtarake për të mos qenë një renegat që luftoi kundër vendit të vet?

Nuk jam i sigurt për ministrat turq, por jam i sigurt se asnjë mendje e kthjelltë nuk do ta pranonte se kuislingu që një kryeministër i talentuar norvegjez, e se Qeveria e Vishisë kishte ministra të talentuar e të virtytshëm! Është e çuditshme kur lexon pohime të tilla të artikuluara, jo në klubin e Mamurrasit, por në sallën e Muzeut Kombëtar, madje në zyrën e drejtorit të saj. Nuk do të çuditeshim po që se ndonjë ditë mund të shohim një portret të Ballaban Pashës në sallat e Muzeut Kombëtar. Sa për përmendjen e atyre pashallarëve që paskan shkuar “për të shpurë armët e Perandorisë Osmane deri në Austri dhe Rusi”, - do thonim “good for them”.

Karriera ushtarake është një çështje personale e tyre dhe nuk kuptohet se çfarë lidhje ka karriera e tyre në dyert e Austrisë e të Rusisë me historinë e Shqipërisë. Nuk besoj se historiani Malltezi ka të njëjtin mendim me Gjorgjeviqin që thotë se, “shqiptarët janë një popull renegat dhe mercenarë që kanë luftuar kundër lirisë së popujve të tjerë”, dhe kjo shpjegon përse Historia e Shqipërisë ka prodhuar veç tradhtarë të kombit të vet. Të gjithë këta shqiptarë që paskan shkuar “deri në Jemen dhe në shkretëtirën e Arabisë” - së bashku me këta 37 kryeministra shqiptarë të Perandorisë Osmane, çfarë i dhanë vendit të vet kur ai ishte në Orën e nevojës më të madhe - siç e kish zakon të thoshte Vilson Çurçill!

Ndihma që ata i paskan dhënë Perandorisë turke duke e shpëtuar atë nga rrënimi, shkon kundër famës së tyre. A nuk do të kishte qenë mijëra herë më mirë që të mos e kishin ndihmuar perandorinë turke me gjeninë e tyre, që duke mos

pasur gjeninë e tyre shëruese dhe shpëtuese, perandoria turke të qe shembur, e kësisoj të ishte bërë e mundur që Shqipëria të qe bërë shtet i pavarur dy shekuj më parë se 1912? Apo duhet rishkruar dhe riparë dhe vetë pavarësia e Shqipërisë, si një ide e gabuar që vinte nga Perëndimi? Madje, Naim Frashëri duhet t'i rishohë ato vargjet e veta tek shkruan se “Dielli lind nga Perëndimi”. Një publicist i njohur dhe i respektuar britanik, Jeremy Paxman, para ca vitesh botoi një libër me 300 faqe me titull “The English”, duke u përpjekur të kuptojë se çfarë do të thotë të jesh anglez. Pas treqind faqesh të shkruara me elokuencë, duke sjellë me qindra referenca historike, Paxman thotë se përpjekja për të përcaktuar se çdo të thotë të jesh anglez është një përpjekje absurde. Të njëjtën gjë do thoja dhe për përpjekjen për të përcaktuar se çfarë do të thotë të jesh shqiptar. Po qe se do t'ia bënit këtë pyetje 5 milionë shqiptarëve, jam i bindur se kishit për të marrë 5 milionë përgjigje krejt të ndryshme nga njëra-tjetra.

*-Çfarë do të thotë sot të jesh shqiptar dhe a është përgjigja në këtë pyetje homogjene për gjithë shqiptarët? Meqë kjo intervistë iu dedikohet më shumë lexuesve nga Kosova, si e shihni ju rrugëtimin e Kosovës në këto vite, nga liria, pavarësia deri tek përpjekjet për integrim në BE dhe NATO?*

**F.Bruqi:** Si çdo shqiptar normalë që interesohet për zhvillimet e kombit të vet, nuk kam se si të mos ndjehem i lumtur për rrugëtimin e Kosovës drejt BE-së dhe Nato-s. Mos të harrojmë se 21 vite më parë Kosova ishte një vend i pushtuar, dhe më pas, i masakruar. Mos të harrojmë se në Kosovë u bënë krime ndër më monstruozet. Mos të harrojmë ndihmën e jashtëzakonshme të SHBA-së dhe të vendeve europiane për

të arritur atë pavarësi që dukej një utopi e paarritshme. Më duket se ndonjëherë amnistia shqiptare, aftësia jonë për të harruar, prodhon një lloj mosmirënjohje të paqytetërueshme. Nuk duhet harruar për asnjë çast se ishte Nënë Tereza, që ndërhyri energjikisht te presidenti Klinton kundër barbarive të presidentit serb Slobodan Millosheviçit (shih librin autobiografik të B. Klinton).

*-Ju jetoni në Prishtinë, dhe nga Kosova, si e shihni letërsinë shqipe sot dhe trendet e zhvillimit të saj?*

**F.Bruqi:** Nuk mund të them se e njoh deri në fund zhvillimin e sotëm të letërsisë shqipe. Me aq sa e njoh, mendoj se është e emancipuar, se ka vepra dhe autorë me dinjitet artistik, se ka individualitet të spikatur krijues. Mendoj se ne ende vuajmë nga komplekse inferioriteti kur vjen puna për të artikuluar vlerat e letërsisë tonë.

*-Në këtë kontekst, sipas jush, në çfarë gjendje është kritika letrare?*

**F.Bruqi:** Sot ata që merren kinse me kritikë në fakt nuk zhvillojnë studime kritike, por thurin ritet, bëjnë cilësime në superlativ të vlerave të larta të akëcilit krijues, sa po të mos e njohësh nivelin e tanishëm të letërsisë, do të mund të mendoje se Jorge Luis Borges (24 gusht 1899-14 qershor 1986), Federico Garcia Lorca (5 qershor 1898-19 gusht 1936), Pablo Neruda (12 qershor 1905-23 shtator 1973) etj., janë shqiptarë dhe të Kosovës madje...

Kritika letrare shqipe në Kosovë vazhdon të përballet me vështirësi të ndryshme. Që nga koha kur kjo gjini letrare arriti të konsolidohet, dy dekadat e fundit kanë qenë mjaft të vështira, duke e lënë këtë gjini në duart e pak kritikëve.

Kushtet aspak të mira që përballen sot studiuesit tanë, dhe që kërkohen për zhvillimin e kritikës, ka bërë që pak emra të rinj t'i përkushtohen kësaj gjinie letrare, mjaft të rëndësishme, e cila lehtëson komunikimin mes lexuesit dhe një vepre letrare. Interesimi i paktë dhe në disa raste edhe jo sinqeriteti i publikimeve kritike kanë sjellë kritikë letrare drejt shuarjes. Megjithatë, edhe përkundër vështirësive, sipas disa studiuesve, vitet e fundit po lindin kritikë të rinj, të cilët me shkrimet e tyre shënjojnë dialogun e çliruar me letërsinë, duke rikthyer përherë argumentimin dhe vetëdijen kah teksti letrar.

Pavarësisht vlerësimeve të dhënë nga studiuesit tanë, nevoja për pasjen e një kritike të fuqishme dhe numër sa më të madh të kritikëve dhe shkrimeve në shtyp dhe me mediet audiovizive shihet si një mundësi mjaft e mirë për të rikthyer kritikën letrare në nivelin e viteve të arta të saj, asaj të para të 90-tave të shekullit të kaluar, pse jo edhe për zhvillim të mëtejshëm. Me një kritikë të fortë, sipas studiuesve, do të kishte edhe një krijimtari letrare më cilësore dhe më reprezentative, përkthim më të madh të letërsisë shqipe dhe para së gjithash një lexueshmëri më të madhe.

“Ndikimet e kritikës janë shumë të mëdha në zhvillimin e letërsisë së mirëfilltë të një kombi. Përveçse ndihmon në eliminimin e keqit dhe shundit, një kritikë e fuqishme ndikon në lexueshmëri më të madhe dhe zgjon interesimin për letërsinë”. Do dëshiroja të isha i gabuar nëse them se më duket pothuajse inekzistente. Po të isha cinik, do ju pyesja: Kritika letrare, çfarë do të thotë kjo?!

Origjina e kritikës letrare shqiptare ashtu si në botën romane (italo-hispanike), në historinë e letrave shqiptare vija

në mes «kritikës letrare» dhe «shkencës së letërsisë» është pothuaj e padukshme. Teoriku është kritik dhe anasjelltas. Ose më sinqerisht thënë, deri sot ende nuk është zhvilluar një diskutim konkret qoftë shkencor a medial rreth kësaj çështjeje, prandaj edhe nuk ekziston - përveç ca skicave e fragmenteve studimore aludojnë një njërën apo tjetrën shkollë – një pozicionim i qartë i studuesve shqiptarë rreth asaj se cili, bazuar në traditën dhe të tashmen autoktone, është dallimi ndërmjet këtyre nocioneve e as që janë hedhur deritani parimet «institucionale» se si duhet definuar njërën, tjetrën apo të dyja bashkë.

«Kritika letrare» ose «teoria e letërsisë» (le ta quajmë si të duam) ka ecur dhe ende ecën sipas binarëve pozicionues të instituteve të huaja, studimet e të cilave kemi mundur t'i përkthejmë në gjuhën shqipe. Në Shqipëri modeli i kritikës letrare është huazuar nga rusët, ndërsa në Kosovë nga gjuha serbokroate (e cila ka qenë një mish-mash i instituteve të Moskës-Pragës-Parisit) e pjesërisht të shkollave frankofone. Kjo është «historia», ndërsa fakti se dhjetë vjetëve të fundit janë përkthyer edhe teori tjera nga gjuhë angleze, gjermane etj. nuk është relavant, për arsye se nga njëra anë ndikimi i tyre nuk duket ende në horizont dhe nga ana tjetër praktika na tregon se në përgjithësi ende (dhe atë me bensikëri) punohet sipas modeleve tashmë të adaptuara. Po ky «huazim» shumëburimor e bën situatën edhe më konfuze sa i përket identifikimit, orientimit e para së gjithash konceptimit të kritikës letrare si të tillë dhe pengon në formulimin e saktë dhe të drejtë të kësaj fushe, në përcaktimin se do t'i dallojmë ato ose do të vazhdojmë kështu si deri më tani!

Faik Konica

Se kush mund të jetë shqiptari i parë që ka praktikuar formën konkrete të tekstit kritik gjatë kohës kur është shkruar latinisht e greqisht nuk dihet. Ose vetëm mund të supozohet. Studimi i parë që ka të bëjë tërësisht me letërsinë shqipe është ai i Alberto Stratico-s «Manuale di literatura albanese» (Milano 1896, shqip: Doracak i letërsisë shqipe) i cili megjithatë ka më shumë nivelin prezentues se sa atë vlerësues, ndërsa tekstet e para vërtet kritike (recensionet) shiptare e bartin firmën e Faik Konicës. Tekstet si «Baba Tomori» (1902) për poezinë e Çajupit, «Rreze dielli» (1904) për Asdrenin etj. janë recensionet e para konkrete në gjuhën shqipe. Arsyen e kësaj «vonese» e shpjegon Konica në diskursin e tij «Letërsia shqiptare» (1897) ku thotë: «E gjithë letërsia shqiptare mund të përmblihet në pesë apo gjashtë vëllime mjaftë të holla». Përveç praktikimit të drejtëpërdrejtë të recensionit si formë interpretimi të veprës letrare, Konica në shkrimin e tij «Kohëtore e letrave shqipe» (1906) e bën një minimanifest për kritikën letrare shqiptare. Në këtë manifest të Konicës vërejmë nga njëra anë «amshueshmërinë» e dilemës rreth përcaktimit ose ndarjes së shkencës së letërsisë nga kritika letrare dhe në anën tjetër përballimi me realitetin e hidhur se në këtë drejtim, edhe sot i kemi po të njëjtat probleme si në vitin 1906, ngase edhe 98 vjet më vonë vërejtja e Konicës «Kur del një njeri e më thotë se akësh libër është «fort i bukur», mund të ketë të drejtë, por nuk jam i shtrnguar t'i zë besë fjalës së tija. Edhe një çau sh a një dragat mund të presë me hanxharë gjykime të atilla. Kritika është një punë tjetër, dhe ca më e vështirë. Kur më pëlqen e kur më çpëlqen

një vepër, nuk arrin të këcej a të fryj: duhet të shfaqë përsetë e pëlqimit a të çpëlqimit tim...» nuk ka humbur hiçgjë nga aktualiteti i saj.

Padyshim se Konica nuk është zbuluesi i tezave që tenton të «imponojë» nëpërmjet diskursit a manifestit të tij, por vetëm përçues nga gjuhët tjera. Kryesisht nga gjuha frënge, mirëpo me argumentimet që bën duke ftuar shembuj nga letërsia angleze shihet edhe ndikimi nga ana tjetër. Andaj edhe pozicionimi konfuz «kritika letrare është subjektive» e jo «shkencë ku çdo e thënë mund të provohet me «dy e dy bëjnë katër», e cila bie ndesh me atë që Konica kërkon në në citatin lartë «...duhet të shfaqë përsetë e pëlqimit apo çpëlqimit...». Pse na qenkan të nevojshme përsetë kur çdonjëri mundëka ta ndjejë si të dojë e të shprehë po ashtu si të dojë ndjenjat e përfituara gjatë leximit? E mbi të gjitha cila është ajo metodë që do ta detyronte Konicën të jetë objektiv e mos ta merrte në qafë ndonjë autor a vepër edhe në ditën kur ai do të ishte ters, me ndjenja të trazuara a me disponim të keq? Pikërisht ato rregullat shkencore, të ftohta e të definuara që nuk dallojnë shumë nga ai kalkulimi «dy dhe dy bëjnë katër» apo? Këto pyetje bërë Konicës pa hamendje mund t'i parash-trojmë edhe sot, thjeshtë për shkak se përgjigja ende nuk ka filluar të kërkohet si duhet. Konica është i pari që bën kërkesën pragmatike për një kritikë letrare shqiptare. Se a mund të merret ai (ose rregullat e përkthyer nga frëngjishtja e anglishtja) si themelues (në plotë kuptimin e fjalës) i saj, siç aludon studiuesi Sabri Hamiti, mbetet çështje diskutabile. Ndërsa fakti se Konica është nismëtari i kësaj fushe është i pakontestueshëm.



### Retrospektiva

Nonda Bulka, Justin Rota, Eqrem Çabej, Namik Resuli dhe Karl Gurakuqi janë emrat që bëjnë vlerësimet e para mbi letërsinë si të tërrë dhe veprat e veçanta letrare. Edhe pse tek shumica e këtyre emrave, kritika, vlerësimi, gjykimi dhe interpretimi konkret luan rol sekondar e qëllimi kryesor i tyre është prezentimi pozitiv i vlerave të letërsisë shqiptare, studimet dhe vështrimet (ose pjesë të tyre) mundën pa dilemë të kualifikohen si kritikë letrare. Disa prej tyre, të shkolluar e formuar nëpër qendra të rëndësishme universitare disponojnë me njohuritë më aktuale rreth vlerësimit dhe gjykit të artit të të shkruarit. Në këtë kontekst veçohet intelektuali universal e i doktoruar në Vjenë, Eqrem Çabej. Vështrimi i Çabejit «Mbi poezinë e Lasgush Poradecit» (Gazeta e re, 22 shkurt 1929, f.3) dëshmon jo sall për qenien e kritikës (së mirëfilltë) letrare në botën e letrave shqipe, por edhe për integritetin e pavarrur të bartësve të saj. Ata nuk imitojnë parimet e shkollave të njohura mondane vetëm sa për t'i sjellë kulturës shqiptare «diç të re nga perëndimi», përkundrazi, nëse analizojmë dhe krahasojmë shkrimet, studimet dhe tezat e tyre vërejmë se jorrallë përvoja e përvetësuar në katedrat universitare tejkalohet dukshëm.

Synimi është formimi i një kritike letrare që do të përputhej me tipicitetin dhe specifikat e letërsisë së deriatëhershme shqiptare. Parakushtet për të krijuar institucionin e kritikës letrare shqiptare ishin po aq të volitshme si ato që kishin gjermanët, austriakët, italianët etj.

Mirëpo ashtu siç e do «fati i gjorë i të vegjëlve»; sa herë që bëhen gati të festojnë iu ndodhë ndonjë tragjedi. Në krahasim

me letërsinë artistike, e cila vazhdonte hovin e saj, kritika letrare do ngec. Ose ajo bën jetë sporadike. Çabej – shpresa më e madhe - i përkushtohet ekskluzivisht gjuhësisë dhe kulturologjisë, intelektualët tjerë që njihnin thellë shkencën e letërsisë dhe letërsinë vetë si Lasgush Poradeci e të ngajshëm u tërhoqën krejtësisht nga skena. Pseja: ardhja e komunizmit edhe në hapësirat shqiptare. Ashtu si për sferat tjera të jetës shqiptare edhe për letërsinë e kritikën letrare nis një jetë tjetër, ndryshe nga ajo siç e kishin projektuar bartësit e saj.

#### Kritika pseudomarksiste

Gjersa letërsia, duke u lakuar dhe përshtatur sipas situatës e motit nuk ul intensitetin e saj, kritika letrare vazhdon të jetojë hajdutërisht deri në fillim të viteve të 60-ta. Paskëtaj, në Shqipëri fillon kritika ideologjike. Nis proletarizimi i artit. Kritikë që formulohej në këtë mënyrë: «... Letërsia e realizmit socialist ka edhe një mbështetje ideologjike të caktuar. Ajo mbështetet në botëkuptimin revolucionar të klasës punëtore: në marksizëm leninizëm! Duke pasur në themel të saj këtë botëkuptim, del e qartë vetvetiu se edhe letërsia e re ndeshet me tërë ato rryma, metoda ose shkolla letrare që kanë në thelb të tyre botëkuptimet idealiste dhe reaksionare të klasave të përmbysura. Këtë ndeshje të vazhdueshme me këto klasa e këto ideogji e vëmë re edhe në rrugën e lindjes dhe të zhvillimit të letërsisë sonë të re». (Historia e letërsisë shqiptare, 1977) E qartë: Çdo rrymë tjetër letrare - e me këtë dhe çdo kritikë letrare që koketonte me ndonjë model analizimi jashtë oborrit - përpos asaj që bazohet në doktrinën marksiste-leniniste duhej të asgjësohej. Që këtej çdo prodhim letrar do të intepretohet nga këndi ideologjik

marksist - leninist. E kjo nuk ishte çorbë e gatuar vetëm nga shqiptarët, por i njejti qëndrim ku më pak e ku më shumë u mor në të gjitha vendet ku orgjitë e cenzorëve fillonin me himin e internacionales.

Madje edhe në Rusi e të mos flasim më për vendet tjera si Çekosllovakia, Hungaria, më vonë pjesë të caktuara të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia) etj. qarqet letrare e sidomos kritika gjenin mundësitë, që aq sa mundnin të shpëtonin artin nga vënia e tij totale në shërbim të politikës, sistemit, respektivisht diktatorit. Nga ajo luftë e sipër prej modelit primitiv të vlerësimit në baza të doktrinës politike (duke përjashtuar çdo instrument tjetër si jorelevant) të artit u kalua në metodën shkencore materialiste - marksiste, në të ashtuquajturën «Teoria e reflektimit» të realitetit e themeluar nga György Lukács. Mund të debatojmë se sa objektive e dëmshme, degjeneruese a fitimprurëse mund të jetë kjo teori, mirëpo nuk mund t'ia injorojmë kualitetet që përmban ajo në segmente të caktuara të vlerësimit. Ajo si metodë është poashtu një formë vlerësimi si të tjerat: privilegjon këndvështrimin socrealist gjatë vlerësimit, por megjithatë pa përjashtuar procesin empirik! Në Shqipëri nuk ecej me kohën. As me kohën e bllokut që i përkiste e lere më me atë jashtë saj. Kritika letrare shërbente klasën politike më me besnikëri se sa «qeni t'zotin». Saherë që ndonjë interpret të humbëte rrugën jashtë oborrit dhe hapaqorras të bënte ndonjë kritikë pa përmendur mëmë partinë dhe burrin e saj deplacohej në logore. Kur analizojmë «teoritë», «historitë», «recensionet», «studimet» e periudhës 48-90 të nënshkruara nga Dalan Shaplllo, Koçe Bihiku, Dhimitër Shuteriqi, Klara Kodra,

Jorgo Bulo, Razi Brahimi, Jakup Mato e shumë të tjerë nuk përballemi vetëm me një soldateskë ideologjike e të përbetuar (ndryshe ndoshta as që kanë e mundur, përveç se të përfundonin në logore), por edhe me një «elitë» sharllatane, shamatetke, pa fije energjie së paku (nëse jo tjetër) për të arrirë të bëjë një kritikë kualitative sipas metodës ortodokse marksiste. Domethënë një kritikë letrare ndryshe nga ajo që kanë bërë; pa fije strukture, rregulla që u përngjajnë interpretimeve të atyre falltoreve (duke përjashtuar zotësinë e parashikimit që e kanë pasur) të kohës së Faraonit.

Se kritika letrare e asaj kohë s'ka poseduar fije kualiteti shihet kur po të njëjtët kritikë, edhe pse kanë pastruar fjalorin e tyre nga partishmëria, heronjtë pozitivë dhe nuk e kanë koken më nën kamxhikun e diktaturës shkruajnë tekste: ato nuk janë asgjë tjetër përveç se mozaiqe përsëritjesh, riprodhime fjalësh të autorit pa guximin për të konkluduar apo vlerësuar argumentativisht. Atyre u mungon metoda, ngase atë që ata kanë ushtruar pesëdhjetë vjet s'ka qenë e bazuar në ndonjë shkollë me liçensë shkencore, por ka lindur si model për keqpërdorimin e artit në favor të sistemit dhe diktatorit të saj. Fillimisht edhe në Prishtinë, përkundër se kërkesat e sistemit ndaj kritikës letrare nuk kanë qenë aq të egra si në RPSSH, bëhet vetëm ajo lloj kritike si në Tiranë. Model që, edhe pse më vonë kritikët letrarë të Prishtinës do të marrin udhë të tjera, ka pasur dhe ka ithtarët e vetë. Ndoshta me një masë më të modifikuar dhe përparuar por me thelb të ngjajshëm. Emrat e rëndësishëm të kësaj fryme në Kosovë janë: Ali Jasiqi, Gani Luboteni, dhe më intensiv i Ali Aliu e të tjerë. Ky i fundit edhe pse vepër pas vepre zhvillohet (sidomos me përkthimin e

studimeve nga serbokroatishtja) në kuintesencë nuk largohet nga formula që ia bën vetes në shkrimin e tij themelor «Angazhimi» (1969). Citat: «...letrari e ka fare të qartë se e vetmja rrugë shpëtimi nga kjo gjendje ...drejt një ardhmërie të lumtur; mandej se shansa ma reale dhe e vetmja për të realizuar këtë besim dhe ideal është doktrina marksiste» dhe ai letrar që bën ndryshe nga ajo që sugjeron Aliu është «...i papjekur dhe nganjëherë edhe menatlitet i sëmurë dhe mikroborgjez». Edhe sot kur mund të spekulohet se kritikë Aliu ka pësuar transformim dhe ka braktisur këtë metodë vlerësimi, nga tekstet e tij nuk mund ta vërejmë këtë gjë, ose po, atë që e vërejmë tek kritikët e tjerë të kësaj «shkolle»: tekstet e tij nuk janë vlerësime, interpretime që zbërthejnë veprat e përgojuara, të pajisura me vlerësime, konkluzione dhe informacion, por më shumë ato kanë karakter autist – biseda me vetveten mbi patosin e autorit.

Rexhep Qosja

Historiani, studiuesi dhe romancieri Rexhep Qosja është ai që e krijon kritikën letrare shqiptare dhe ia jep asaj përmasat e «institutit» serioz, të bazuar në parimet universale të vlerësimit. Librat «Kritika letrare», «Episode letrare», «Dialogje me shkrimtarët» etj. janë veprat kryesore ku hidhen themelet e kritikës së angazhuar, pra shembujt e parë se si duhej të dukej kritika letrare.

Qosja dallon nga kritikët dhe teoricientët e tjerë të bllokut socrealist, sidomos sa i përket konceptit teorik të estetikës reflektive që kishte marksizmi ortodoks. Ky nuk e sheh artin thjeshtë vetëm si refleksion të rrethanave shoqërore, përkundrazi, studimet e tija historike, kritika praktike letrare

e zhanre tjera të letërsisë ku ai angazhohet, janë një Antithesis e asaj që mbizotëronte ose kërkohet. Më saktë formuluar: kritika e tij aludon në racionalitetin autonom e vetjak të artit e jo në kushtëzimin e paskajshëm të tij me racionalitetin e përvojës shoqërore. Kjo troç dhe shqip do të thotë: Qosja funksionon kundër synimit të idologjisë për të vënë artin në shërbim total të saj dhe atë pa deformuar metodën e analizës dialektiko-marksiste, por duke e hapur këtë metodë (së paku në botën shqiptare) edhe ndaj modernës deriatëherë të refuzuar. Metoda se si vepron Qosja në vitet e gjashtëdhjeta, dhe kjo është interesante, do të «legalizohet» veç më vonë edhe në hapësirat tjera përreth e më gjërë.

Para spekulimit, se Qosja mund të ketë qenë i ndikuar nga neomarksistët apo teoria dialektike kritike e «Shkollës së Frankfurtit» dhe kryevepra së saj «Dialektik der Aufklärung» (1944-47) që ka për autorë Max Horkheimer dhe Theodor Adornon, më bindëse është teza se qëndrimi i tij mund të ketë rezultuar nga përgjegjësia intelektuale që ka ndier ndaj artit e sidomos ndaj etnisë që i takon (të mendojmë në romanin «Vdekja më vjen prej syve të tillë»). Edhe diçka tjetër shkon në favor të këtij konstatimi: estetët e analizës së tekstit sipas metodës ortodokse marksiste refuzojnë kategorikisht artin abstrakt dhe «absurd» modern dhe kapen fortë për realizmit të shekullit 19-të, filozofët dhe sociologët e shkollës së Frankfurtit përqëndrohen më shumë në modernë dhe nuk i përfillin gjithaq teoritë e realizmit. Qosja, ndryshe nga shkollat e përmendura, trajton e analizon në mënyrë të barabartë dhe pa nënvleftësuar ose mohuar (me përjashtime të diktuar nga ideologjia - shih «...Romantizmi») konceptet

e realizimit dhe të modernës.

Rexhep Qosja është themeluesi i institucionit «kritikë letrare shqiptare» dhe njëkohësisht bartësi i teorisë neomarksiste e të ashtuquajtur «metoda dialektiko-kritike» në letrat shqipe.

Kritika letrare e Qoses megjithatë nuk do marr përmasat e shkollës. Dhe atë për dy arsye: 1. Ajo nuk përfillet atëbotë nga Tirana dhe 2. Asnjëri nga studentët dhe pasardhësit e tij në Prishtinë e gjetiu nuk arrin t'i afrohet profilit të «profesorit». Ca madje spekulojnë se Qosja ka ndërmarrë gjithçka për të penguar shfaqjen eventuale të ndonjë konkurrence, me qëllim që të jetë i pazëvendësueshëm. Nëse shikojmë përtej murreve të këtij spekulimi vërtet habit fakti se ata që kanë ndjekur gjurmët e Qosjes dhe teorisë së tij ose kanë përfunduar në epigonë të zbehtë të tij (me Agim Vincën në krye) ose janë avulluar. Kryesorja; prej tyre nuk ka dalur ndonjë format kritiku me rëndësi relevante.

Ibrahim Rugova dhe Sabri Hamiti

Dy kritikët Ibrahim Rugova dhe Sabri Hamiti (vitet e 70) nuk i bashkangjiten synimit për të përparuar metodën ortodokse marksiste në favor të lirisë dhe autonomisë të artit. Ata e injorojnë atë komplet. Dhe praktikojnë teori tjera moderne të letërsisë.

Ibrahim Rugova në fillim të veprimit të tij si kritik letrar e deri tek studimi i shkëlqyeshëm «Vepra e Bogdanit - Cuneus Prophetarum» (1982) përdor (jo vetëm, por theksueshëm) metodën hermeneutike. Model që parasëgjithash bazohet në «teorinë e të kuptuarit» të tekstit e që bazën e ka në interpretimet e teksteve të Bilblës që i bëri reformatori gjerman Martin

Luter (.....): mënyrë interpretimi që më vonë do të definohet si «interpretimi i botës» nëpërmjet objektit në analizim e sipër (Gadamer: për të kuptuar një tekst, paraprakisht duhet pasur një parafytyrim se ç'është ai tekst, në cilën kohë është e situuar, kush është autori i saj e kështu me rradhë). Në filozofi kjo metodë për pionerë ka filiozofët Wilhelm Dilthey dhe Martin Heidegger.

Robert Elsie në librin e tij «Historia e letërsisë shqiptare» për Sabri Hamitin thotë «si kritik ai ka sjellë nocione dhe koncepte të reja në studimin e letërsisë shqiptare, duke këmbëngulur në një intepretim të pavarur nga proceset jashtë-letrare» E njëjta gjë, pra, para mund të thuhet për Rugovën ose për të dy bashkë dhe më shumë: Rugova dhe Hamiti janë themeluesit e Hermeneutikës dhe Strukturalizmit në letrat shqipe - për shkak të krijimit (zbulimit) të formulave interpretese pa të cilat do të përjashtoheshin tipiciteti dhe natyra e karakteristike e letërsisë shqiptare, nëse këto teori do të merreshin një për një, dy studiuesit e përmendur nuk mund të konsiderohen thjeshtë vetëm si përçues të këtyre metodave nga gjuhët e huaja, siç aludojnë indirekt dhe me gjysëmzë ca kritikë.

Rugova dhe Hamiti, për dallim nga kritikët ideologjikë të Tiranës, të cilët analizën e mbështetshin në luftën e klasave dhe neomarksistët e Prishtinës, të cilët përpiqen të zbulojnë formulën e fekundimit apo ç'fekundimit të reales me imagjinaren dhe anasjelltas - «nuk çajnë kokën» me faktorët jashtë-letrarë siç bënin neomarksistët ose nuk vërdallen pa cak e qëllim siç bënin teoricientë të ndryshëm në planin universal për t'i dhënë primatin njëres nga metodat e shumta



interpretuese (hermeneutike, biografike, psikanalitike etj), por në këtë aspekt ata bëjnë ashtu siç bënë formalistët rusë dhe përqëndrohen ekskluzivisht në tekstin letrar, të ashtuquajturit «fakt letrar». Themeli i kësaj lloj analize qëndron në pyetjen: Çka e bën një vepër artistike të tillë?

Mëtej metoda e tyre interpretuese shihet se për bazë ka teorinë strukturaliste të Claude Lévi Strauss, Roland Barthes, Claude Bremond, Gérard Genette etj, e të iniciuar nga gjuhëtari gjenevas Ferdinand de Saussure (...) sidomos me «Cours de linguistique générale» (në shqip «Kursi i Gjuhësisë së Përgjithshme», përkthyer nga prof. Rexhep Ismajli, Prishtinë 1977).

Strukturalizmi niset nga parimi themelor se fenomenet nuk shfaqen të izoluara, por në lidhshmëri me fenomenet tjera. Detyra kryesore e metodës është që të zbulohet kjo lidhshmëri: Fenomenet gjatë shfaqjes së tyre krijojnë një lidhshmëri të strukturuar. Në këtë e sipër struktura konstruohet nga vëzhguesi (interpretuesi) në model. Sipas kësaj teorie, struktura nuk ekziston në nivel të realitetit, por vetëm në nivel të modelit vetë.

Epiqendra e strukturalizmit shkencor është analiza e shemës formale të renditjes së figurave, analiza e kompozicionit rrëfyes dhe domethënive retorike e figurative në tekst e parasëgjithash - siç u cek më lartë - hulumtimi i letraricitetit specifik në tekstet estetike dhe dallimi nga tekstet e natyrave të tjera.

Duo-ja prishtinase përveç se është shkaktarja e thyerjes së monopolit të kritikës marksiste e neomarksiste (dialektikës materialiste) dhe sjellësja e dy metodave të elaboruara më

lartë, ajo siç shihet fut edhe pluralizmin si mundësi të re studimi në «pallatin e institutit të kritikës letrare».

#### Ramadan Musliu

Si kritik i rëndësishëm me stil të vetin, pas këtyre dyve, dalllohet Ramadan Musliu me recensionet e botuara viteve të tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta (pjesërisht të përmbeldhura në librin: «Konfiguracione narrative», Prishtinë 1996) për romanin shqiptar. Analizat diskursive të Musliut janë shembulli tipik se si mund të harmonizohen metodat e ndryshme të interpretimit në një katalog unik vlerësimi.

Interpretimet e Musliut varrësisht nga tema, lënda dhe autori i referohen herë njëjës e herë tjetrës metodë vlerësimi e gjykimi. Është kjo mënyrë vlerësimi rezultat i formimit universal të autorit apo aksion i qëllimshëm i tij për të krijuar një «metodë personale vlerësimi» duke përzier suksesshëm elementet e shumë shkollave në një, nuk ka fare rëndësi. I rëndësishëm në këtë plan është efekti i kësaj mënyre interpretimi. Që në kritikën shqiptare shfaqet për herë të parë si e tillë.

Këtë metodë, që tek shumëkush ka dështuar në fazën e eksperimentimit, Musliu (me tekstet e përmbledhura në librin «Konfiguracione narrative») e finalizon dhe «legalizon» si sistem të suksesshëm vlerësimi. Pikërisht për këtë, që nga zanafillat e saja, nëpër baltën e banalitetit ideologjik, në institucionalizimin dhe pluralitetin e saj-metoda e Musliut, që akumulon dhe përbashkon shkollat në favor të një sistemi specifik për vlerësimin e një letërsie poashtu specifike, është me rëndësi shumë të madhe për qenien, zhvillimin dhe studimin e kritikës letrare shqiptare.

### Të tjerët:

Natyrisht se kritikët që përmendëm më lartë nuk janë të vetëm. Numri i autorëve që janë marur dhe po meren me vlerësimin dhe interpretimin e letërsisë është gati po aq i madh sa edhe numri i autorëve të gjinisë më të përhapur ndër shqiptarë, ai i vjershëtarëve! Përveç brigadës së sporadikëve ekziston edhe ajo e atyre që janë marë ekskluzivisht me këtë «zanat» të përvetësuar nga mjeshtër të ndryshëm, por pa lënë gjurmë të dukshme, pa sjellë ndonjë praktikë të veçantë studimi e analizimi të arteve.

Tashmë të përballur me këtë aksiomë, me këto informacione ne nuk mund të shesim poza duke mohuar ekzistencën e institucionit të kritikës letrare, por mund të debatojmë për zhvillimin e saj qëkëndeje e tutje, pozitën, gjendjen dhe rëndësinë saj aktuale. Me rëndësi kapitale në këtë kontekst është që të dijmë se cilat janë funksionet qenësore të kritikës letrare në kushtet e së sotmes. Çka e arsyeton ekzistencën e saj? A luan si duhet kritika letrare shqiptare rolin që ka? Assesi! Pse?...

Pas viteve të nëntëdhjeta, që atëherë kur de fakto u hoq cenzura ideologjike, filloi një prodhim i pakontrollueshëm dhe masiv i veprave «letrare». Erdhi koha e «të shtypurve»?! Si pasojë e kësaj çdo autor, magazinier e parelinj ngriti një ndër marrje botuese, fillimisht më shumë për të botuar shkirmet e veta e pastaj edhe për të luajtur rolin e botuesit. Pas një heshtjeje jo edhe të shkurtë me reagimet e tyre u shfaqën të privilegjuarit e hierarkisë së vjetër kundër vërshimit të kësaj, shundit që për lau bibliotekat gjysmë të rrënuara shqiptare. Alarmet autorësh dhe të tjerëve në lidhje me rreziqet që sjellte

që sjellte akulturimi u morën si «britmë e fundit e kalit para se të ngordhë». Në realitet reagimi i tyre ishte me vend edhe pse shumica e tyre do t'i kishin bërë vetes më mirë të mbanin gojën mbyllur, sidomos ata që në të kaluarën kanë qenë tepër aktiv si «redaktorë e recensent» në vijë të proletariatit e partisë. Kjo gjendje orteku i përsheshti edhe ato pak kritikë të specializuar që ishin. Nga njëra anë për arsye të prodhimit masiv e nga ana tjetër për shkak të kushteve të reja sociale e ekonomike me të cilat u ndeshën krijuesit pas deformimit të shoqërisë, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.

Kritika letrare si shumë segmente tjera të jetës kulturore u vu në pozitën stand by. Edhe sot pas pesmbëdhjetë viteve gjendja ka mbetur pothuaj e njëjtë.

a) Edhe sot kritika letrare ende nuk ka arritur të luaj rolin e saj informues e orientues duke dhënë një pasqyrë mjaftueshme mbi botimet e reja. Edhe poqëse ky qëllim të ekzistonte ajo një gjë të tillë do ta kishte të pamundshme si për shkak mungesës së medimeve të specializuara ashtu për shkak të mungesës së një sistemi koordinues ndërmjet botuesve e mediave.

b) Si pasojë e së parës ajo nuk mund të luajë rolin e seleksionimit, duke veçuar e zgjedhur vepra që meritojnë të recensohen, vlerësohen e t'iu ofrohen lexuesve potencial si literaturë e vyeshme që duhet blerë e pasur në bibliotekë. Ato pakë kritikë të specializuar pa pasur shteg tjetër i janë përshtatur ligjit të xhunglës dhe janë detyruar për shkaqe ekzistence të shlirojnë nervat dhe të vlerësojnë sipas «vendit e kuvendit», kështu duke përjashtuar çdo parim serioz profesional.

c) Funkcionin e saj didaktiko-ndërmjetësues kritika letrare e ushtron (!) vetëm nëpër shkolla, institute e fakultete. Publikut më të gjërë një mundësi e tillë i është uzurpuar qëmoti nga rrethanat mbizotëruese. Opinioni, pra masa e lexuesve jashtë katedrave, nuk do e marrë vesh kurrë (nëse vazhdohet kështu) se ç'risishë vijnë në letrat shqipe, cilët autorë e autore trajtojnë një problem të përgjithshëm që duhet njohur e ditur e që është me rëndësi për çdo qytetar apo për shtresa të caktuara të shoqërisë. Lexuesit nuk i bëhet e qartë se cili autor është vërtet «gjeni i lindur», e cili imitator i pararendësve dhe shkrimin bukur e trajton si zeje. Masa nuk merr shpjegime nga kritika se si duhet kuptuar veprat e reja dhe ato të retushuara të Kadaresë; ç'na sjell të re Dërvishi me dramën e tij ekcesive; si duhet kuptuar famën e madhe të Ardian Kristian Kyçyikut në Rumani e gati mospërfilljen e tij në atdheun e tij; pse është interesant për t'u përkthyer romani «Shkëlqimi i huaj» i shkrimtarit Beqë Cufaj në gjermanishte e jo i shumë autorëve tjerë që shqiptarët i konsiderojnë elitore, e shumë, shumë çështje të tjera.

d) As në rolin e saj didaktiko-sanksionues që për prodhuesit e letërsisë (autorët dhe botuesit) është e një rëndësie të madhe kritika letrare nuk luan asnjë rol. Kritikët nuk merren parasysh si referencë që do të ndihmonin në dallimin e prodhimit kualitativ letrar dhe atij të pavlerë dhe të pasuksesshëm në treg, gjë që do të ndihmonte dukshëm në përmirësimin e kualitetit të botimeve të reja. Janë të rralla ato shtëpi botuese që në redaksinë e tyre kanë lektorë profesional ose recensentë që do të bënin vlerësimin dhe gjykimin e veprës para se të vendosej botimi apo mosbotimi i saj.

Shumica e shtëpive botuese përbehen vetëm nga pronari i saj e në të shumtën e rasteve nga një staf redaktorësh që vallëzojnë sipas xhepit të pronarit e jo sipas kriterieve të vlerësimit profesional.

Këto janë vetëm disa nga kushtet që duhej t'i plotësonte kritika letrare për tu pranuar si institucion koherent dhe serioz si dhe për të arritur që të stimulojë masat për më shumë lexim dhe të rikthejë imazhin e humbut të letërsisë artistike.

### **Sferat e angazhimit të kritikës**

Për të përfituar nga kritika - në favor të përmirësimit të kualitetit të letërsisë si dhe popullarizimit të letërsisë në masë - duhet që asaj t'i mundësohet pjesmarrja në institucionet e prodhimit letrar si dhe mbikqyrja në procesine punës së këtyre institucioneve. Kritiku duhet të jetë pjesë vitale dhe e pashmangshme e institucioneve të prodhimit letrar: ai është i vetmi kompetent që mund të vlerësojë autorin konkurrues dhe t'ia oforojë botuesit, i cili pastaj e drejton për në shtypshkronjë dhe kujdeset që produkti i tij të plasohet e trajtohet si e sa duhet në mediat masive.

Prezenca e kritikës në zgjedhjen, botimin dhe vlerësimin publik të një vepre letrare ndikon edhe në punën e institucioneve të distribuimit: libraritë informohen për prodhimet e reja dhe vihen në kërkim të mallit për konsumatorët e vetë. E njëjta gjë vlen edhe për stendat trotuareve e nën shi si dhe për bibliotekat.

Një vepër që ka sukses në këto dy faza dhe që kritika e vlerëson si pozitive dhe të rëndësishme domosdo se zgjon interesin edhe të institucioneve të përpunimit si; teatri, filmi, televizioni e radioja, punën e të cilave e ndjek kritika në çdo

faze dhe formë të prezentimit të veprës. Është detyrë e kritikës që të luajë rolin primar në institucionet e zhvillimit siç janë konkurset, shpërblimet e bursat e jo e autorët vetë dhe kryesitë e shoqatave siç ndodhë aktualisht. Sidomos aty ku synohet legalizimi dhe popullarizimi i një çmimi ose ruajtja e seriozitet që ka një çmim tradicional. Edhe në institucionet e komunikimit si univerziteti, shkollat e larta dhe institutet tjera kritika letrare ligjërohet pa sistem, në mënyrë konfuze dhe e papërcaktuar, për të mos thënë edhe më troç se janë pikërisht këto institucione që nuk kanë arritur ose nuk arrijnë të kualifikojnë kuadro të përgatitura që do të ndikonin në zhvillimin e kritikës letrare shqiptare. Teoritë që ligjerohen aty nuk kanë ndonjë sistem që do të mund të formonin kritikun e shkolluar, shkencor dhe praktik. Prej aty dalin do melezë (në kuptimin profesional) që nuk e dijnë se për ç'janë formuar saktësisht për teorikë, gjuhëtarë apo për mësues të letërsisë nëpër shkollat e mesme, kështu që më në fund përfundojnë në vjershëtarë ose komentatorë politikë. Ato pak emra që dallohen si kritikë të specializuar nuk janë të tillë për shkak të fakultetit që kanë kryer, por më shumë falë angazhimit të tyre personal e autodidakt. Një arsye tjetër që ka sjellë në këtë gjendje institucionet e komunikimit është edhe mungesa e metakritikës. Të krijohet përhstypja sikur asnjëri nga kritikët (me përjashtime) nuk merr guximin të vë nën dioptri punën e kolegëve të tij. (Kjo është e rëndësishme, sepse roli dhe funksioni i kritikës nuk është vetëm intepretimi dhe vlerësimi i prodhimit të letërsisë artistike, por edhe i vetë kritikës letrare si të tillë: si shkruhen recensionet? Nga cila pozitë gjykojnë kritikët e veçantë dhe ata të angazhuar në media etj. etj.)

### **Teoria dhe praktika sot**

Studiuesit e sotëm të letërsisë shqiptare – ata që ligjërojnë ose punojnë në universitete - luajnë poaq rolin e kritikut praktik sa edhe gazetarët dhe fejtunistët nëpër media. Po tu bëjmë një analizë punimeve të të dyja grupeve do të konstatojmë se dallimet janë minimale. Si studiuesi ashtu dhe gazetari, fejtunisti pretendojnë ta ekspozojnë veten me të dyja funksionet; atë të shkenctarit që di të bëjë kritikë praktike dhe atë të gazetarit të pajisur me dijen shkencore. Në të dyja rastet rezultatet janë maksimalisht modeste e në të shumtën e rasteve servohet një sallatë mendimesh që më shumë eksponon snobizmin e autorit sesa vlerësime rreth objektit në trajtim e sipër. Për të qenë kritik letrar natyrisht se nuk nevojitet vetëm një dije elementare nga shkencat e letërsisë, por edhe një specializim në metodat e vlerësimit si dhe njohje të llojeve të shumta të intepertimeve. Pikërisht mungesa e këtij vetëdijësimi, sistemi dhe mungesa e diskurseve që do të qartësonin kompetencat e roleve ndërmjet shkencës edhe kritikës letrare praktike e zmadhojnë konfuzitetin dhe nuk lënë zhvillimin e asnjërës prej këtyre dyjave në nivel të nevojshëm. Ndoshta këtu duhet kërkuar arsyen se pse kritika shkencore letrare ka mbetur vetëm në nivelin e eseistikës historike mbi epokat, mbi stilet e rrymat apo në nivel të reportazhit monografik për shkrimtarë të caktuar të historisë së letërsisë së arteve. Natyra eseistike, monografike e reportazheske e trajtimit të letërsisë nuk lejon që të bësh fjalë për kritikë shkencore, por maksimalisht për diskurse hipotetike mbi sfera, çështje dhe personalitete të caktuara të letërsisë shqiptare. Kështu siç edhe e kemi. Në emër të kritikës shkencore, teorike pra bën jetë stili



fejtonistik i (para)grykimit, (mbi ose nën)vlerësimit dhe (gjoja)interpretimit e në vend të kritikës praktike vepron anarackia e hobi-interpretëve, gazetarëve pa fije përvojë teorike, që ta shpifin cilindro libër që përgojnë - edhe pse duken si «akte subjektive» të një lexuesi të sinqertë ato tekste s'përbajnë asnjë argument të vetëm, përpos emrit dhe mbiemrit të autorit me pasionin për t'u bërë publik.

Ngushëllimi i ca prej teorikëve dhe altoparalantëve të tyre se «le të bëhet letërsi e mirë atëherë do të ketë edhe kritikë të mirëfilltë» është infantil dhe poashtu një përpjekje për të gjetur një «fajtor kujdestar» për paaftësinë personale, të cilin edhe e gjejnë qysh në stacionin e parë: shkrimtarët (vetja) se kush tjetër! Kritikët me talent që mund të bëjnë e bëjnë analiza objektive dhe kualitative nuk mungojnë. Ajo që mungon është procesi i konceptimit të kritikës letrare brenda zhanrit, dallueshmërisë ndërmjet të të ashtuqujturës kritikë praktike (recensionit, fejtioni, eseut, polemikës etj) dhe asaj shkencore (studimore, teorike). Këtu, si duket ekziston një keqkuptim që edhe ka rezultuar në një degradim ku mungon ose dyshemeja ose kulmi.

### **Format e vlerësimit: Recensionit**

Kritika letrare nëpër media (ose praktike) shërbehet me tipe të ndryshme tekstesh që synojnë interpretimin dhe vlerësimin e veprave, epokave, problemeve letrare, autorëve e të ngjajshëm. Gjersa portretet, letrat e hapura, intervistat, esetë, dialogjet e imagjinuara janë raritete dhe sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit kanë marrë statusin e «species» në vdekje e sipër, recensionit dhe «vitrina e librit» (përshkrimet e shkurtëra për veprat e sapobotuara që i praktikojnë shumica e

gazetave të përditshme shqiptare) vazhdojnë të mbijetojnë. Ato bëjnë jetë të hendikepuar, ama megjithatë po mbahen. Recensionet që i lexojmë në të përditshmet shqiptare si «Shekulli», «Koha jonë», «Koha ditore», «Zëri i ditës» si dhe në revista e website të «specializuara» për letërsi në përgjithësi lënë shumë për të dëshiruar. Tekstet që vijnë të mbitulluara si recensione ose që sugjerohen si të tilla nuk përmbajnë në vete elementet themelore që duhet të kenë. Të rrallë janë ata autorë që marrin mundin për të përfshirë të gjitha segmentet e nevojshme që kërkon recensionin për të qenë i kompletuar, si:

1. Të dhënat biografike për autorin (ky segment mund të lihet anash vetëm në rastin e autorëve shumë të popullarizuar, mirëpo përsëritja e biografisë është prapsepapë me rëndësi për shkak se biografitë ndryshojnë).

-Informata në lidhje me veprat e mëpërparshme të autorit si dhe krahasimi i asaj të fundit me më të hershmet.

-Analizimi i vlerësimeve kritike mbi autorin, vërtetimi, modifikimi apo kundërshtimi i tyre.

-Krahasimi i veprës së autorit me vepra të autorëve tjerë aktual.

-Informata mbi temën, përmbajtjen, strukturën, gjuhën, intencionin dhe përgatitjen teknike të librit.

### **Vlerësimi i tekstit dhe konkluzionet vlerësuese mbi librin**

Nëqoftëse intepretuesi nuk punon sipas këtij katalogu parimor, themelor dhe teksti i tij nuk përmban në vete informatat e sipërradhitura (pavarrësisht renditjes së tyre) ai asnjëherë nuk mund të jetë i bindshëm se di të shkruajë recension, ai nuk do të mund të jetë i besueshëm se ka lexuar, analizuar dhe njeh tekstin që trajton.

analizuar dhe njeh tekstin që trajton.

Recensioni sipas katalogut që shtrouam mungon. Në vend të tij bëjnë jetë interpretimet që mund të emërohen si gjithçka tjetër, por jo si recensione. Për çdo ditë na bie të hasim ndonjë tekst të mbititulluar si «recension». Lexuesi i privuar nga e drejta e ndërhyrjes, i cili luan vetëm rolin e konsumatorit të fjalës publike, është i detyruar të pranojë atë si të tillë. Me një mbititull të tillë paralajmërohet publikimi i ndonjë vepre të re. Autorët e teksteve të tilla, harrojnë përgjegjësinë që kanë ndaj lexuesit dhe japin konstatime nga më të çuditshmet pa qenë koshient për të arsyetuar mendimin e vetë. Ata thjeshtë shkruajnë; „ky është më i miri“ ose „ai është më i keqi“ pa ndier nevojën për të treguar konkretisht shkaku!

Në fund të një shkrimi, po ashtu të mbititulluar si «recension», lexojmë konstatimin; «X është poeti më i mirë i (flan) gjeneratës së shkrimtarëve shqiptarë». Autori i atij shkrimi pompoz që nga shkronja e pare e tekstit e deri në fund shihet se është një injorant i kategorisë së asaj sorte që me shumicë i gjen nëpër mediat shqipe. Për të demonstruar sa më ashpër «dashurinë» ndaj poezisë (ose lirikut vetë), autori kishte rishkruar (besojmë me dorë të vetë) vargjet dhe i kishte futur ndërmjet fjalëve të veta, kështu që më në fund, pas një llogaritjeje të thjeshtë dilte se ai nuk kishte thënë më shumë se sa nja dhjetë fjali të fshehura ndër citatet që përmbushnin pothuaj gati një faqe gazete të formatit klasik. Ato dhjetë fjali, që të gjitha, rrotulloheshin rreth të njejtës gjë; «X. është poeti më i mirë, gjenial, kolosal...». Nëpër sallone apo në kafene edhe po të kërkoi dikush llogari për ndonjë konstatim të përshpejtuar, mund të refuzosh që të pijsh më tej me të në

tavolinë dhe të çohesh e të ikësh, ndërsa fjala e thënë publike të nënshtron përpara një obligimi, përgjegjësie më të madhe, për arsye se çdo konstatim duhet të jetë i argumentuar, i «dokumentuar», përndryshe ai mund të konsiderohet si shpifje. Keqpërdorim i lexuesit dhe mediumit ku plason mendimet. Autori i konstatimit të lartëshënuar pa fije turpi donte t' i imponojë lexuesit të sinqertë mendimin e tij, pa ndier nevojë që t' i sqarojë atij; përse – sipas mendimit të tij – poeti X është më i miri! Ata që kanë mundësinë ta sigurojnë librin do të shohin se autori i «recensionit» ose është gjetur ngushtë gjatë hulumtimit të vlerave, të cilat ai do t' i bënte shtyllë të tekstit të tij ose nuk e ka lexuar fare librin dhe gjithë frymëzimi i tij fillonte dhe mbaronte në kopertinat e librit në fjalë. Kjo e dyta është më e sigurtë, sepse librat, për të cilat flasin «kritikët» e tillë jorrallë përmbajnë vlera që mund të përfliten, mirëpo me parakushtin që ata, pra «kritikët» së pari duhet t' i bëjnë nervat tok e t' i lexojnë si duhet e mos të flasin përmendsh. Domethënë kriteriet themelore të vlerësimit nuk janë ato që kërkohen mëlartë por: Lavdërimi i tepruar ose sharrja deri në asht. Për të mos rënë në pozitën e «recensentit» të përshkruar më lartë kritiku serioz duhet të manovrojë së paku me mjetet themelore të vlerësimit që analiza e tekstit i vë si parakusht. Kritiku i angazhuar dhe serioz asnjëherë nuk e nis intepretimimin e tij për një vepër pa përshkruar së pari katalogun e pyetjeve themelore që kërkon analiza e tekstit. Katalog që në sipërfaqe duket skolastik, porqë jo vetëm se është i pashmangshëm por bashkë me çelësat personal interpretues (shih formularin mëposhtë) edhe përcakton nivelin e njohjes së objektit në studime e sipër dhe ajo më

kryesorja dëshmon për punën, seriozitetin dhe besueshmërinë e vlerësuesit.

### **Kritika letrare dhe mediat**

Në masmedia mungojnë rubrikat e rregullta, emrat e rregullt që do të përfolnin librat në mënyrë objektive dhe duke iu përmbajtur parimeve të formës së shkrimit (recensionit) dhe kondicioneve profesionale të printmediave, artikuj edhepse me një gjërësi e natyrë gjuhësore ndryshe nga shkrimet publicistike, por megjithatë të ngritura në bazë të atyre pesë a gjashtë E-ve të famshme gazetareske.

Shkrimet «kritike» që botohen nëpër rubrikat apo shtojcat e kulturës nëpër media, dëshmojnë se faji kyresor prapëseprapë nuk është i përgjegjësve të këtyre medimeve por vërtet stagnuese shfaqet paaftësia e autorëve që përpiqen të merren me kritikë letrare e s'dijnë t'iu përshtaten as rregullave të profesionit që mëtojnë ta ushtrojnë e as atij të gazetarisë.

Sidomos gazetat e përditshme (ato që kanë për synim profesionalitetin sipas standardeve) janë të detyruara të tregohen refuzuese ndaj idesë për krijimin e një rubrike të rregullt ku do të përfolej vepra artsitike. Nga ana tjetër askush nuk beson se këto media nuk mund të sigurojnë për redaksitë e tyre nga dy a tre kritikë letrarë që në mënyrë të rregullt do ta ndjeknin (ama edhe do ta lexonin) librin, pikturën etj. e do ta diskutonin atë publikisht. Le ta marrin shembullin e mediave të huaja: nuk e koston asnjë gazetë as e përditshme as periodike në përfundim pa kritikun e vetë të rregullt letrar, pa rubrikën e vetë të rregullt për librin.

Natyrisht se, për të qenë mediumet më kualitative duhet të sigurojnë kuadro të përgatitura mirë profesionalisht. Nuk

mungon as përshtypja se problemet apo të arriturat kulturore, sipas mediave që kemi në duar, përdoren vetëm si mjet elozhi, vetkënaqësie dhe onanie personash ambicioz që kanë fatin të jenë afër medimeve, kështu duke zmadhuar fatkeqësinë e kulturës e në veçanti atë të letërsisë shqiptare. Për këtë një përgjegjësi të pamohueshme mbajnë përgjegjësit e medimeve. Ata duhet të krijojnë ca rregulla që do të parandalonte vërshimin e sojit të pseudokomentatorëve, që manifestohen me gjithë makinacionet e mundshme të akulturimit. Ndonjë vëzhgues i proceseve letrare dhe punës së mediave në këtë drejtim do të thoshte se gjithë kjo tragjedi ka ardhur nga mungesa e «institucionit» të kritikës si dhe vazhdimit të sistemit të trashëguar socrealist. Mirëpo e vërteta qëndron edhe diku tjetër. Një segment të dukshëm përbën edhe tipi i mentalitetit anadollak i disa shkruesve shqiptarë, të cilët në vend që të punësohen si ofiqarë në ndonjë administratë, aq sa e kanë edhe aftësinë, atyre nuk u vjen fare turp për t'u marrë me kritikë të letërsisë, duke shkruar «recension» që s'janë gjë tjetër se sa përdhunim i pashembullt i lexuesve, pra aventurierë të tipit siç është shembulli më lartë. Kritiku - si është dhe si duhej të ishte.

*-U tha: sot kemi shumë pak kritikë të mirëfilltë letrare, pse është kështu?*

**F.Bruqi:** Shkollë speciale për kritikë letrar nuk ka. Nuk dihet nëse ndonjëri nga univerzitetet shqiptare ofron ndonjë seminar apo kurs praktik në lidhje me Metodën e Vlerësimit të Teksit, nëse po atëherë ato seminare apo kurse duhet të jenë aq të këqija sa që s'kanë mundur të nxjerin hiç më shumë se disa veta që mund të numurohen në gishta si profesionistë.

Shumica e gazetarëve që merren me kritikë letrare kanë të mbaruar fakultetin e letërsisë ose janë vetë autorë (shkrimtarë, poetë etj.). Fakultetet e letërsisë janë patjetër baza ku pretendentët e këtij profesioni aftësohen me njohuritë në shkencat e letërsisë, mirëpo kjo nuk do të thotë saora specializim edhe si kritik letrar.

Në krahasim me fushën ku ajo angazhohet, dmth me artet e bukura si vepër e gjenive dhe që nuk mësohet por është e lindur (I. Kant), kritika letrare është një aftësi praktike, zotësi që rrjedh nga dija. Diçka që duhet të mësohet. Përveç njohjes së letërsisë, historinë e saj, teorive mbi të, aktualitetin dhe tregun kritiku letrar, siç dihet, duhet të njohë mirë edhe gazetarinë për të qenë i aftë që të publikojë refleksionet e tij. Institutet ekzistuese, pra njohës të kompletuar të shkencës, arteve të bukura dhe gazetarisë, tash për tash nuk janë gjendje të nxjerin kritikë të këtij formati. Ndërsa nga përvoja kemi parë se kritikët e këtij kalibri, ata të kompletuarit, në këtë nivel kanë mbërritur falë angazhimit personal në këto fusha të ndryshme, si dhe vetiniciativës.

Ky realitet e hedh në erë bindjen infantile të shumëkujt se për të qenë kritikë letrar mjafton fakulteti i letërsisë dhe aftësia për të stilizuar e bërë llafe mbi artet e bukura pa studimin rigoroz të tyre dhe përkuljen para një disiplinë të rreptë e të mundimshme pune.

Si u vjen kritikëve serioz të cilët harxhojnë energji, mund e dije për ta lexuar e interpretuar një vepër arti me përkushtim kur konfrontohen me prezencën e vërshuar të sharlatanëve, të cilët nuk kanë asnjë fije respekti ndaj të bukurës dhe muzës së gjenit?

Numri i atyre kritikëve që për afërsisht plotësojnë kushtet e shtruarra më lart, në letrat shqipe, është më se minimal. Shkaqet që kanë çuar në këtë gjendje janë të njohura ose pjesërisht janë trajtuar edhe në këtë ese.

### **Morali dhe etika profesionale e kritikut**

Përpos këtij defeciti ekzistojnë edhe një mori pengesash tjera që profesionin e kritikut e bëjnë joatraktiv ose edhe të pamundshëm: Asnjëri medium, madje as edhe shtëpitë botuese në hapësirën shqiptare nuk punësojnë dikë si kritik letrar. Personi i specializuar si kritik duhet së pari të bëjë punën e gazetarit, lektorit, korrektorit gjuhësor, redaktorit e punë të tjera për të siguruar ekzistencën e pastaj nëse i mbetet kohë mund të kontribuojë diçka për profesionin dhe pasionin e tij. Nuk mjaftojnë vetëm aftësitë për të siguruar një vend në ndonjë medium që të ushtrosh «zanatin» e kritikut. Përveç përgatitjes profesionale duhet t'i takosh ndonjë klani a grupacioni (letrar, rajonal, gjinor e së fundi edhe fetar) që mban nën kontroll institucionin e caktuar. Me sigurimin e kësaj lidhjeje kritiku automatikisht humb pavarrësinë intelektuale dhe ndeshet me pengesa tjera që ia bëjnë të mundimshme punën: klani ose personat që e kanë ndihmuar kërkojnë (edhe nëse nuk e thonë drejtëpërdrejtë, për mentalitetin shqiptar kjo është gjë e natyrshme) mirënjohje në vepër. Me humbjen e kësaj mvetësie kritiku letrar fillon të shkruajë nga pozitat e mikut, avokatit, shërbyesit të grupit apo autorit ( e ka ndihmuar të ngjitet shkallëve) dhe gjykatësit të njeanshëm, «edukatorit» joobjektiv kur bëhet fjalë për vepra autorësh që u përkojnë klaneve konkurente ose në luftë me atë, të cilit i takon (me dashje ose padashje) kritiku letrar.



Ata që veprojnë jashtë këtyre rretheve e grupacioneve duhet të bëjnë luftë të ashpër për të mbetur gjallë publikisht. Se ç'morali dhe etike profesionale duhet të ketë kritiku letrar në këtë rast e përcakton shoqëria me gjithë mekanizmat e saj. Nëse gjendemi në një shoqëri të korruptuar edhe kritiku do të jetë patjetër i tillë, nëse funksionojmë në një shoqëri ku klanet, fiset dhe grupacionet e kanë fjalën kryesore edhe kritiku – se si do të mbijetojë ndryshe – do të jetë altoparlanti ose falltori i oborrit të njërit nga këto formacione. Me këtë kritiku e ka të kufizuar veprimin e vetë dhe nuk mund të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjitha letërsitë e mundshme, por mbetet si kritik special i literaturës primare (të lauruar nga klani si elitore) ose i asaj sekundare ose i asaj margjinale ose i pop-letërsisë ose i asaj literature që prodhon vetëm shefi i taborrit.

Nëse një kritik vendos që të bëjë luftë jashtë sistemit me qëllim të ruajtjes së integritetit personal, etikës profesionale dhe njerzore ai do të injorohet, izolohet deri sa ta gjejë një profesion tjetër ose të heq dorë fare edhe nga publikimi i studimeve të tija.

### **Kritika letrare sot**

Kështu duket sot kritika letrare në pasqyrën e saj të grimcuar. E bërë pikepesë dhe në atë shkallë saqë mund t'i thurrim lemente deri në pakufi. Megjithkëtë, mund të jetë edhe ndryshe. Shpresat nuk janë djegur të tërra. Dhe atë për dy arsye: E para, se edhe mëtutje mund të shpresojmë në aktivizimin dhe angazhimin e atyre kritikëve letrarë që për një apo shumë arsye kanë kërkuar hije nën pyllin e profesioneve tjera dhe ia kanë kthyer shpinën pikërisht asaj

që më së shumti ka nevojë për ta. Dhe e dyta arsye, ajo që më së shumti ushqen shpresat, është se në letrat shqipe kanë hyrë dinjitetshëm (përveç brigadave të hobiinterpretëve) edhe specialistë të shkëlqyeshëm të teorive letrare si Agron Tufa, i cili njëkohësisht është edhe eksperti më i spikatur i formalizmit dhe strukturalizmit. Pastaj dy Kujtimët (Shala dhe Rrahmani) nga Prishtina, Ndue Ukaj, Vehbi Miftari e ndonjë tjetër. Ndërsa në fushën e kritikës letrare praktike mund pa hamendje të përmendim Ragip Sylajn, Sali Bytyçin, Gilmana Bushatin e ca të tjerë.

Natyrisht se edhe këta studies e autorë kanë pengesat e tyre gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Edhe kur ata konsiderohen të atillë siç i përshkruam në fillim të kësaj eseje ata përpiqen që të mos i nënshtrohen diktatit social, ekonomik dhe mos bien nën kurthin e ndonjë klase të caktuar politike ose ndonjë sektit fetar që botën di ta shohë vetëm nga perspektiva e ngushtë e religjionit (® interpretesit e autorëve ekskluzivisht katolikë ose ata që me çdo kusht privilegjojnë shkrimtarët turkofilë islamikë). Janë këta emra që jo vetëm se dëshmojnë se kritika letrare shqiptare megjithatë ekziston, porse edhe do të mbijetojë duke u ristabilizuar (si para viteve të nëntëdhjeta) dhe duke kthyer imazhin dhe formën e saj institucionale. Nihilstët, (veçanarisht) gjenitë e hutuar të letrave shqipe le të mos brengosen se pas shkuarjes në atë botën tjetër askush nuk do të merret me artin e tyre, përkundrazi kritika do të merret edhe me ata që sa kanë qenë gjallë nuk kanë lënë gurrë pa ia hedhur asaj në kokë. Ky është vetëm njëri nga ato mallkimet me të cilin duhet të jetojë kritiku objektiv.

*-Si analist i botës së fjalës si i vlerësoni marrëdhëniet ndër-fetare ndër shqiptarë?*

**F.Bruqi:** Shpresoj të jenë ashtu siç kanë qenë gjithmonë ndër ne shqiptarët: tolerante dhe bashkëvepruese.

*-Si është statusi i shkrimtarit sot?*

**F.Bruqi:** Jorge Francisco Isidoro Luis Borges do t'i mjaftonte vetëm një fjali për ta dhënë mrekullisht thelbin e dinjitetit: “Individi dinjitoz është ai që ia del të jetë në paqe me veten dhe me të tjerët”. Thënia e njohur e Immanuel Kantit se “Individi pa dinjitet s'mund të prodhojë vepra dinjitoze”, duket që u përket atyre postulateve që s'vjetrohen kurrë, pavarësisht konotacioneve që mund të fitojë fjala “dinjitet” në kohërat moderne apo postmoderne. Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, përmes një shprehje fare pak dinjitoze, jepen dy shpjegime të fjalës “dinjitet”: 1. Tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish (nderi, krenaria etj.); vetëdija që ka njeriu a një grup njerëzish për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi i tij për vetveten; shfaqja e jashtme e kësaj vetëdije dhe e këtij nderimi.

Dinjiteti kombëtar. Dinjiteti i njeriut (i familjes, i ndërmarrrjes, i institutit). Me (pa, plot) dinjitet. Ngre (ul, fyen, merr nëpër këmbë) dinjitetin. S'ka pikë dinjiteti. Flet (sillet) me dinjitet. 2. Cilësia e mirë a vlera e lartë e diçkaje që e bën atë të çmohet. Me dinjitet artistik. Vepër plot dinjitet.

*-A ka dinjitet shkrimtari i sotëm shqiptar?*

**F.Bruqi:** Jo pa dhimbje, derisa flas edhe për veten më duhet të përgjigjem (zë-ulët): “Jo”. Si për ta ngushëlluar veten dhe kolegët e mi, po shtoj se problematika në fjalë, domethënë “dinjiteti i humbur i shkrimtarit” duket së është një shqetësim

mbarë-kombëtar çka lidhet, me siguri, me “dinjitetin e humbur” të vetë letërsisë. Sipas studiuesit Ridvan Dibra ”Konsu-  
mizmi i shfrenuar, triumfi i imazhit, realitetet elektronikë,  
ekspansioni i medias etj. duket se vërtet ia kanë lëkundur  
letërsisë dinjitetin e dikurshëm”.(Në parantezë, gjithherë e  
kam fjalën për autorë dhe letërsi serioze, që rreken t’u  
rezistojnë kohërave dhe ndërrimit të përvitshëm të modave).  
Amerikani, Joseph H Bloom njëri ndër emrat më të lavdishëm  
të kritikës letrare bashkëkohore, shprehet plot dhimbje:  
“Talentet e mëdha janë shurdhuar një herë e mirë nga realiteti  
i medias amerikane.

*-Kush mund t’i rivalizojë me parodi lajmet e televizorit,  
gazetës dhe fjalimet e qeveritarëve?*

**F.Bruqi:** Realiteti amerikan është më grotesk dhe më  
qesharak se cilado parodi, sado e mirë qoftë...”. (Kur realiteti  
amerikan paraqitet i tillë, imagjinojeni tonin, të dashur miq).  
Të dënuar të përballen e të jenë pjesë e një realiteti të tillë, disa  
prej shkrimtarëve shqiptarë bashkëkohorë (post-modernë që  
të gjithë!) duket se kanë zgjedhur rrugën më të lehtë e më të  
shkurtër: e kanë hequr nga vetja e tyre dinjitetin, sikur ai të  
ishte zorrë qorrë a diç tjetër e panevojshme.

*-Kujt i është shitur dinjiteti?*

**F.Bruqi:** Së pari, pikërisht asaj për të cilën kanë nevojë më  
shumë. Asaj që të bën të njohur e “person publik” edhe pse  
mund të kesh botuar vetëm dy-tre tekste të dyshimtë. Asaj që  
të bën të famshëm e delirant, deri edhe në ëndrra me Nobel.  
Asaj “lubie” që për ta shuar urinë e vet të përditshme, “gëlltit  
çorbën” e gatuar prej lloj-lloj grafomanësh e sharlatanësh.  
Domethënë medias.

Argumente? Kam parasyshë një thenje të Balzakut se ai që i kërkon dekoratat nuk i meriton dhe ai që i meriton nuk i duhen gjë!

Shikojeni paraqitjen e shkrimtarëve nëpër gazeta ditore, ekranet televizivë: herë fodullë e herë kinse shpërfillës, teksa për hir të pranisë mediatike dëshmohen të gatshëm të debatojnë e diskutojnë për lloj-lloj argumentesh e problematikash jashtë fushës së dijeve të tyre, domethënë jo letrare. (Para disa ditëve, një poet i lakuar bashkëkohor fliste plot kompetencë për avantazhet e centraleve atomikë).

Lexuesi i pasionuar i lexon intervistat apo auto-intervistat e tyre nëpër faqet kulturore të përditshmeve tona: megalomani e neveritshme, vetëmburrje e vetëvlerësime foshnjara, mungesë e plotë etike, modestie e qytetarie.

(“Kur flet libri, autori duhet të heshtë”, përsëriste para pak kohësh postulatit e njohur të filozofit gjerman me origjinë polake Friedrich Eilhem Nietzsche:” Merrni pjesë në promovimet për çdo libër të botuar: seanca të bezdisshme hipokrizie mes “miqsh të gotave dhe të femrave” e që fill të nesërmen media e unshme i bën publike. - Shfletoni librat e botuar: foto autorësh delirantë e me pamje profetike (kujtesë: post-modernizmi nuk e pranon autorin-profet), shënime entuziaste në kapakët e pasmë, që do ta skuqnin nga turpi edhe vetë Xhejms Xhojsit (James Joyce) për shembull etj. Shkrimtari bashkëkohor shqiptar (përsëri u kërkoj ndjesë përjashtimeve) duket i etur për njohje e famë, qoftë edhe për një “filxhan lavdi”.

Dhe këtë lavdi (i yshtur, si duket, edhe nga ndonjë rast pararendës) kërkon ta arrijë sa më shpejt e më lehtë, duke e

konsideruar punën e tij kryesore, domethënë punën e mundimshme me tekstin letrar, si punë të dorës së dytë. Kurse parësore për të bëhen: Paraqitjet e vazhdueshme mediatike në gazeta dhe televizionet tona ;

Pjesëmarrjet nëpër lloj-lloj mitingjesh e festivalesh letrarë anë e kënd Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Globit; Radhitja e sa më shumë çmimeve të fituara (jo pak të dyshimtë e fiktivë) etj.

Këtë situatë sipas Ridvan Dibrës “ në thelb tragji-komike - të letrave tona pas viteve 1990, e “favorizojnë” edhe dy mungesa extra, tipike shqiptare:

Mungesa thujtë e plotë (uluritëse kjo mungesë!) e kritikës letrare, e cila, kuptohet nëse do të ekzistonte, mund t'ia dilte (ndoshta?) t'i “ulte gjelat që këndojnë majë togut të tyre plehut” dhe të nxirrte në pah vlerat e mirëfillta letrare-estetike.

Mungesa e plotë e organeve të specializuara letrare, estetike e kritike (me siguri, duhet të jemi i vetmi vend në botë me një mungesë të tillë!), ku shkrimtarët mund të botonin, diskutonin e debatonin mes vedi dhe jo të silleshin si futuristët e para 100 viteve, duke i mbajtur mëri njëri-tjetrit e duke u zënë me grushte klubeve”, thotë Dibra.

E megjithatë, humbjen e dinjitetit ndër shkrimtarë nuk e justifikon asnjë mungesë apo situatë, sado të pafavorshme qofshin ato. Sepse pasojat kanë filluar të duken. Gjithnjë e më shumë po shtohen zërat (dashakeqë e nostalgjikë), që rreken t'ia mohojnë çdo vlerë letërsisë shqipe të pas viteve 1990, duke e vendosur bile në rrafshet krahasuese me realizmin socialist.

Gjithashtu, të gjitha sjelljet që përmenda më sipër e që dëshmojnë mungesë dinjiteti nga vetë shkrimtarët shqiptarë, ftohën dhe largojnë edhe më lexuesit seriozë. Dhe besoj që një dukuri e tillë bëhet e dhimbshme sidomos për ata shkrimtarë të përkushtuar, që kanë dhënë e vazhdojnë të japin vlera të qëndrueshme e të spikatura letrare (Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Kongoli, Eshref Ymeri, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, Fatos Arapi, Zija Çela, Visar Zhiti, Fatmir Terziu, Skënder Buçpapaj, Mujë Buçpapaj, Izet Duraku, Përparim Hysi, Agron Shele, Amiko Kasarhuo, Fatime Kulli, Raimonda Moisiu, Rexhep Shahu, Albana Nexhipi, Zef Pergega, Edmond Tupja, Ema Andrea, Elona Tabaku, Rasim Bebo, Ferida Ramadani-Zmijani, Vullnet Mato, Mimoza Hysa, Ligor Shyti, Flutura Aça, Jerida Kulla, Eljan Tanini, Fran Ukcama, Linditë Ramushi Dushku, Rami Kamberi, Raimonda Maleçka, Vjollca Tiku Pasku, Riza Lahi, Andi Meçaj, Lisjana Demiraj, Kabil Bushati, Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Ibrahim Rugova, Ramiz Kelmendi, Din Mehmeti, Adem Gashi, Flora Brovina, Qerim Ujkani, Reshat Sahitaj, Naim Kelmendi, Skënder Zogaj, Shyqri Galica, Rushit Ramabaja, Migena Arllati, Kadrush Radogoshi, Dibran Fylli, Mehmet Kajtazi, Anton Pashku, Ruzhdi Baloku, Sejdi Berisha, Halil Haxhosaj, Iljaz Prokshi, Akil Koci, Adem Zaplluzha, Nebih Bunjaku, Musa Ramadani, Mehmet Kraja, Zejnullah Rrahmani, Bilall Maliqi, Bedri Zyberaj, Shefqet Dibrani, Nazmi Rrahmani, Xheladin Çitaku, Xheladin Mjeku, Begzad Baliu, Zeqir Fazliu, Agim Desku, H. Berisha, Mentor Thaqi, Musa Jupolli, Esat Loshaj, Hydajet Hyseni, Rexhep Ferri, etj.

E përsëris se dinjiteti i shkrimtarit bashkëkohor paraqitet problematik edhe ndër shoqëritë tjera më civile se e jona. Porse aty nuk mungojnë edhe aktet e qëndresës e të sfidës. Sa për ilustrim, po përmend vetëm dy shembuj. Shkrimatri i famshëm çek Milan Kundera (01.04. 1929) ka më shumë se 33 vjet (1982) që nuk jep intervista, i bindur tashmë në hipokrizinë dhe artificialitetin që ato, shpeshherë, përmbajnë në vetvete. Kurse novelisti amerikan Thomas Ruggles Pynchon (08.05.1937-), njëri prej zërave më interesantë të narratives bashkëkohore amerikane (natyrisht post-modern!), ka publike vetëm një foto të hershme në internet, kurse gazetarët që i kërkojnë intervista, i përzë me të shara. Jam i bindur se ithtarët e post-modernes mund t'i konsiderojnë si donkishoteskë këto raste, duke shtuar se statusi i shkrimtarit ka ndryshuar dhe nuk është si ai i para 100 viteve. Por nuk e besoj që ka pasur, ka dhe do të ketë ndonjë epokë, kur statusi i shkrimtarit përcaktohet nga bjerrja e dinjitetit të tij. Nga shkrimtarët e pas viteve 1990, përveç një letërsie cilësore e ndryshe, (vepra të tilla nuk mungojnë) kam pritur e besuar edhe në akte dinjiteti e qytetarie, duke iu kundërvënë kësisoj pararendësit famëkeq realizëm socialist, që u shqua pikërisht për mungesë dinjiteti e qytetarie. Nëse fillimet dukeshin premtuese e shpresëdhënëse, tashti e pohoj me dhimbje se ndihem i zhgënjyer. Thjesht ndërrim diktaturash, më duket. Nëse dje dinjiteti i shitej apo i falej diktaturës komuniste, sot i shitet apo i falet “diktaturës mediatike”. Kurse vitet 1930, ku mund të gjenim jo pak modele dinjiteti e qytetarie edhe ndër shkrimtarë, duken gjithnjë e më të largët. Mediat dhe televizionet tona ngrenë pyetjen: Sa dhe si



vlerësohen shkrimtarët dhe poetët në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Lindore, dhe a kanë ata një lloj statusi?” Hedhja e këtij “asi” në tryezë, në mos qoftë thjesht sa për të fituar një emision a një intervistë në TV tona apo gazete, më shumë, duket se është njëfarë ndihme që media jep që shoqëria të kuptojë diçka më shumë se ç’ndodh dhe ç’pretendohet në këtë kohë dhe në këtë klimë të përgjithshme “mosvëmendjeje ndaj shkrimtarit, librit dhe leximit”. Ndonëse vetë do të këshilloja që mediat tona elektronike, të shkruara etj., në vend të pyetjeve retorike, të krijojnë më shumë hapësirë, duke shtuar fletë apo kohë televizive për letërsinë, përsëri grishem t’i përgjigjem kësaj pyetjeje, që në të vërtetë edhe para përgjigjes sime ka njohur qindra përgjigje e rrugëzgjdhje të mbetura në rrafsh konstatimi dhe utopie. E formuluar në kohë, pra sa dhe si vlerësohet shkrimtari sot?!”

Kjo pyetje të bën të mendosh përmes opozicioneve dje-sot, këtu-atje, Lindje-Perëndim, si dy modelet ku shkrimtari vendoset përballë shoqërisë dhe pret që ajo të reagojë me vlerësim, shpërfillje apo thjesht të hyjë në komunikim të natyrshëm. Për të qenë të besueshëm duhet të kujtojmë edhe atë fazë të jetës krijuese ku shkrimtarët e Lindjes (përfshi këtu edhe shkrimtarët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria) u krekoseshin shkrimtarëve të Perëndimit se kishin gjithçka falas dhe të garantuar: shërbim mjekësor falas, arsimim falas, shtëpi falas, studio falas, piano, penela e bojëra, pushime dhe leje krijimtarie të garantuar një herë në vit dhe botime të sigurta, njëlloj si dhe honorarët. Njëra anë e balancës, duket haptazi, qe plot. Ana tjetër e balancës kishte vetëm një njësi, himnizimin e kësaj parajse e cila përmes letërsisë së

ideologjizuar, më shumë se përmes vetë indologjisë, bëhej jo vetëm e besueshme, por e dashur dhe e ëndërruar, duke krijuar edhe në mungesë lirie të shprehuri idiolatrinë mbi “statusin shoqëror të shkrimtarit”.

-Të gjorët shkrimtarë të Perëndimit!

Ndiheshin të dëbuar nga kjo parajsë! Atyre u mungonte, siç dhe u mungon statusi. Por modeli i shkrimtarit të Lindjes tanimë ka rënë dhe ka mbetur vetëm ai i shkrimtarit përballë një shoqërie vlerash përfshi këtu edhe ato të tregut.

Të mësuar me atë gjendje, falsiteti më shumë sesa vërtetësie, iluzioni më shumë sesa serioziteti, shkrimtarët shqiptarë, sidomos pjesa më e madhe e atyre që i kanë jetuar të dy kohët, por jo pak edhe nga ata që krijimtarinë e kanë nisur pas viteve 1990, ndihen keq dhe ankohen për mungesën e statusit shoqëror (kupto shtetëror). Këtë “nostalgji për status” ata kërkojnë ta paguajnë jo vetë, por t'ua paguajë shoqëria e cila prej tyre jo rrallë etiketohet si turmë lexuesish të padenjë, që gati-gati nuk i meriton shkrimtarët e saj të mëdhenj. Por në vend të presin që dikush të bëjë diçka për ta, shkrimtarët nuk mund të jenë të kënaqur me gjendjen mazokiste të rënies së lirë që po pëson “esnafi” i tyre. Ankesat për mungesë statusi dhe vëmendjeje tingëllojnë si një vetëlinçim publik. Kjo për faktin e thjeshtë se “esnafi” i shkrimtarëve, sipas atyre që shoh e dëgjoj çdo ditë, për mua rezulton se është më i përfaqësuari në Shqipëri e më pak në Kosovë. Shkrimtarët (ose të ngjashmit) prej vitesh i gjemë këshilltarë në Presidencë, në Kryeministri, në Ministri të Arsimit, Ministri të Kulturës, e në të tjera ministri që nuk kanë lidhje me kulturën. Ata i gjejmë drejtues institucionesh kulturore,

anëtarë bordesh ku miratohen strategji, projekte, politika e tekste për lexim. Ata janë pjesë e kryesive dhe kolegji meve të medie tona. Janë dhe kanë qenë parlamentarë, ministra, profesorë, dekanë, rektorë profesorë e gjer tek mësues të thjeshtë. Ata janë pra të kudondodhur.

Studiuesi Arian Leka thotë “Atëherë kujt ia kërkojnë shkrimtarët “statusin” dhe përse u duhet ai? Kujt i adresohen dhe a nuk e kuptojnë se ndodhen para pasqyrës sa herë që flasin për staturë shkrimtarësh dhe mungesë vëmendjeje nga shoqëria e cila pret t'i shohë ata sa më pak të rreshtuar nën modelin shkrimtarë të të gjitha llojeve bashkohuni”? Në sesionin letrar të FNP “Drini poetik”, që mbahet çdo herë më 8 e 9 qershor në Prishtinë-Prizren- ka krijuar hapësira multimediale që kanë të bëjnë me çështje të procesit letrar po aq edhe me raportet e letërsisë me realitetin ideologjik nën diktaturë dhe më vonë, me një kohë të re ku shkrimtari e humbi pozitën mbështetëse të mecenatit shtetëror i cili ishte njëfarësoj edhe “porositësi” i veprës së artit.

Letërsia shqipe nuk ka pasur fatin e letërsive të tjera. Shtrohet pyetja, po nëse shkrimtari “vdes” në momentin që libri është në duar të lexuesit”, Fatos Kongoli jep këtë përgjigje: “Unë jetoj me një libër derisa e përfundoj së shkruari. Mendoj se kur botohet, ai nuk është më imi.” Por ai e shikon të arsyeshme rishikimin e një veprë gjatë ribotimeve. Kjo është diçka që ai vetë e ka bërë.” Dhe kur bëhet fjalë për rishikimin e veprave dhe korrigjimet e asaj që ke shkruar edhe dyzet vjet përpara, një shembull për t'u komentuar është shkrimtari Ismail Kadare, i cili në një deklaratë të tij pohon se kjo lidhet me procesin letrar në kushtet e mungesës së lirisë së

shkrimtarit. Unë kam parasysh atë çka Ismail Kadare ka thënë në një intervistë se gjella e burgut paskesh dalë më e mirë për një numër arsyesh. “Nuk e kam kuptuar se çfarë ka dashur të thotë Kadare. Gjella e burgut që ha tjetri gatuhet më mirë apo gjella e burgut që ha vetë.”, shton shkrimtari Visar Zhiti.

*-Si kanë ndryshuar shijet e lexuesit?*

**F.Bruqi:** Ajo që ne quajtëm liri ka ndryshuar jo vetëm për krijuesin, por dhe për lexuesin. Tashmë shkrimtarët tanë janë një hap me lexuesin evropian. Ne Kosovë, Shqipëri etj., jemi fatlum në krahasim me mjaft vende të tjera sepse kemi më shumë lexues. Shkrimtari Zija Çela thotë “Nuk besoj se do të kem shpëtuar pa ndonjë kompromis të këtij lloji, për një fragment apo një fjalë të shkruar. Një shembull: si vjen letërsia. Në vitin '84 kam qenë në Kukës dhe kam shkruar një roman, “Burrat nuk dalin nga lufta”. Po të botohen sot katër recesionet e saj kohe, është krejt ndryshe. Përfundimi i recesioneve dhe i redaksisë ishte “Sipas Zija Çelës burrat kanë dalë nga lufta”, nuk quhej më një roman dekadent. Në vitin '90 ka qenë një kohë e ethshme për të botuar shkrime të cilat nuk ishin botuar, aq më tepër të dokumentuara me recesione.

Kuptova se ai që ishte kundër këtij botimi, tani isha unë, sepse kishin kaluar vite dhe nëse ideologjia është afatshkurtër, beteja estetike është e përjetshme. Standarti gjithmonë krijon më shumë hapësirë për komunitetet, por e ngushton hapësirën e individit. Thelbi i një shkrimtari është individualiteti i tij, që të jetë i ndryshëm nga të tjetër. Nëse censura në vendin tonë tashmë është lënë mbrapa, ajo që nuk lihet mbas është autocensura. Gara me veten është preferenca ime. Por mund

të them se e kemi ende të mangët kulturën e leximit, kuptohet se faktorët mund të jenë të natyrshëm. Ruajtja e kulturës së leximit është e domosdoshme. Natyrisht që ndryshimi është shumë i madh. Por ka dhe një ndryshim tjetër që e sfumon këtë ndryshim, pasi njeriu e krijon lirinë brenda vetes. Mund të jesh i burgosur dhe mund të jesh i lirë në mendime. Mund të jesh i lirë, por je i burgosur pasi nuk mendon ashtu siç duhet. Në këtë kuptim dhe para dhe pas nëntëdhjetës shkrimtarët kanë pasur privacionet e tyre. Madje mund t'u ketë kushtuar shumë shtrenjtë. Kjo situata paradoksale në sistemet diktatoriale ku ndodh që të lindë letërsi më e madhe se në sistemet e lira. Letërsia nuk është thjesht produkt shoqëror, produkt i një sistemi, por është produkt i një grupi individual. Pra vepra e një shkrimtari mbetet pavarësisht sistemit, thotë Çela dhe shton: "Këtu janë dy gjëra krejt të ndryshme. Nuk mund të bëhet krahasimi sepse tirazhet e atëhershme i botonte shteti dhe shteti i blinte. Në kuptimin që vërtet mund të botoheshin librat në njëzet mijë kopje, por shumicat i blinin prapë bibliotekat. Autori nuk paguante gjë, dhe merrte vetëm një honorar simbolik. Ndërsa sot, për ata libra që shiten, kemi një shtetje reale. Kjo nënkupton faktin se i boton shtëpia botuese dhe i blen publiku. Si kanë ndryshuar shijet e lexuesit? Lexuesi është i informuar, vërtet nuk botoheshin shkrimtarë bashkëkohorë kontemporanë, por letërsia e madhe botohej dhe atëherë sepse botoheshin klasikët Homeri, Servantesi, Shekspiri, Tolstoi, etj. Janë shkrimtarët që formojnë shijet, por mungonte pjesa më e madhe e letërsisë. Këta autorë e formonin shijen atëherë, e formojnë dhe sot. Kur flasim për shije të mirëfillta, mund të themi se

dhe sot kërkohen këto botime. Kërkohet gjysma e modernistëve, ajo pjesë që mungonte. Por në rast se sot kërkohen shkrimtarë të një letërsie komerciale, atëherë kjo është një gjë tjetër sepse ndodh në të gjithë botën. Nuk është shija e vërtetë, shija e mirëfilltë. Vërtet Daniele Steel në të gjitha vendet shitet me miliona kopje, por është një letërsi e ditës, një letërsi kalimtare etj. Dhe krejt në fund theksojë se ka shkrimtarë që nuk kanë bërë kompromise. Të gjithë e kanë bërë kompromise , për pjesë të vogla të cilat duhet të hiqnin apo duhet të shtonin, por e kanë bërë. Kohë më pare në një intervistë për Radio Radicale, radio kombëtare dhe politike në Itali ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Ettore Sequi shprehet lidhur me nismën e tij në dialogun me shkrimtarë, artistë, filozofë të cilët ndajnë me ambasadorin pikëpamjet mbi integrimin evropian të Shqipërisë. Duke iu referuar bashkëbisedimit me shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, Ismail Kadare, Sequi shprehet se i ka mbetur në mendje shprehja e shkrimtarit ku thotë: “Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian.” Lidhur me personazhin e dytë që ambasadori do të ftonte në bashkëbisedim, Sequi nuk jep një emër konkret por shprehet se do të jetë “një personalitet jo shqiptar dhe shumë i njohur në botën globale.” I pyetur nga gazetari Artur Nura se a ka dialog mes palëve politike në vendin tonë, ambasadori i kujton politikanëve shqiptarë se “dialog nuk simbolizon monologë të ndryshëm të palëve.” Duke iu referuar integritet të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, diplomati thotë se

“Ballkani dhe në zë të veçantë Shqipëria është duke bërë shumë progres, megjithëse me një seri vështirësish.” Ambasadori flet edhe për raportet dhe interesat, përgjegjësinë e BE-së për zgjerimin e saj me Ballkanin dhe veçanërisht Shqipërinë.

Ismail Kadare që është një evropian i bindur i botës shqiptare, por që është edhe shkrimtari më i mirë shqiptar, ndoshta edhe në dimensione Ballkanike dhe jo vetëm. Midis të tjerësh, ka qenë së fundi edhe në listën e shkurtër të konkurrentëve të Çmimit Nobel për letërsinë. Kështu pra, më duhet të them se pata idenë e këtij dialogimi për të arritur të kuptoja se çfarë një personazh domethënës mendon në lidhje me Evropën dhe të ardhmen Europiane të Shqipërisë. Kështu kam dashur të shpjegoj dhe dua të shpjegoj, për shembull në intervistën me Kadarenë në mënyrë të kthjellët, se çfarë në fakt, presin shqiptarët nga Evropa. Një frazë nga ky bashkëbisedim më ka mbetur thellësisht në mendje, Kadare më tha: Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian. Kadare është një shqiptar evropian. Ai jeton si në Tiranë ashtu edhe në Paris, por unë besoj që na nevojitet të dimë se cili do të jetë personi i dytë që do të vazhdojë këtë dialog me ju?

Sugjeroj publikisht që politikanët tanë, nuk duhet të kenë një diplomë formale universiteti, por duhet të kenë edhe njohuri minimale në lidhje me filozofinë politike perëndimore, pra të njohin minimalisht veprat e Tomas Hobbes, John Lock, (François-Marie Arouet) Volterit dhe Jean-Jacques

Rousseau, apo Konrad Adenauer, Alice De Gasperi, Robert Schuman, Altiero Spineli, vizionarët e historisë që frymëzuan Bashkimin Evropian. Markezi thotë “s’kam dashur që librat e mi të kenë fatin e sanduiçeve. Letërsia e sanduiçeve është letërsia rozë e një gjuhe fakirfukarashë dhe të shterpët. Letërsia e madhe, ku bën pjesë edhe Hrabali, s’ka asnjë lidhje me të. Për mua ka dy lloj letërsie. Letërsia e fabulës dhe letërsia e stilit. Tek kjo e dyta fabula është thjesht një pretekst. Tek Hrabali i gjejmë të mpleksura të dyja. Duhej ruajtur kjo veçori e veprës së tij. Pastaj ç’është përkthyesi tjetër, në mos po fjalë? Volteri, Borges dhe Pamuk ftillojnë se te secili prej nesh ekzistojnë dy, ose më shumë qenie të tjera. Kësisoj unë s’kam pse të mos ta besoj që ekziston një Hrabal i hedhur nga dritarja me të shtatë macet e tij, por edhe një tjetër që mund ta ketë vrarë veten i lodhur prej vanitetit njerëzor...

Kam shfletuar dhe lexuar me interes të veçantë biografinë e aktivitetit tuaj krijues. Sinqerisht jam ngazëllyer nga mjeshtëria e kulturës profesionale që ju lëvroni në zhanre të ndryshme.

*-Cila ka qënë eksperiencia juaj e parë me poezi, prozë, publicistikë, përkthim, esse, monografi....apo....?*

**F.Bruqi:** Po nga viti 1973 datojnë publikimet e mija letrare në shtypin e kohës. Mbase këto fillime kanë qënë të suksesshme. duke fituar edhe çmime letrare në konkurset e ndryshme letrare atëbotë, por do të thosha se në publicistikë dhe eseistikë u mora nga viti 1974 e deri me 1980, duke publikuar 21 fejtone në gazetën e atëhershme të përditshme “Rilindja”, pra shkrime dhe tema të kësaj natyre. Atëbotë një përkrahje morale dhe nxitje për t’u thelluar më tutje hullive të



këtyre fushave të shkrimtarisë, kisha nga Jusuf Gërvalla, Sedat Dida, Vehap Shita, Ymer Shkreli etj. Më vonë disa “smirëzinjve” ju “pengonte” sukcesi im publicistik i theksuar, më tepër te gazetaria investigative, ku kam qenë më i guximshëm dhe më i ndërtuar, pra shkrimet e mia u pengonin edhe disa sejmënëve të devotshëm të komunizmit jugosllavë, të cilët ishin poltronë të atij sistemi, duket edhe kujdestarë për ta stigmatizuar fjalën dhe shprehjen e lirë, të cilët bukur shumë herë intervenonin për “embargot” publicistike ndaj meje dhe shkrimeve të mia. Për ta argumentuar këtë, kësaj i shkon më së miri një thënie e shkrimtarit tonë të mirënjohur, Ramiz Kelmendit se, “shqiptari të fal gjithçka, por jo dhe suksesin!”. Do të thotë se ju keni nisur aktivitetin krijues që në moshë të re. Kjo duhet të ketë qënë me të vërtetë emocionuese dhe inkurajuese.

*-Çfarë mendoni se ju ka frymëzuar për të shkruar?*

**F. Bruqi:** Libri im i parë i botuar doli në vitin 1995, dhe është ai me poezi “Zjarri i diellit”. Pas këtij libri poetik vjen i botuar romani “Vrasja e liridonëve”, me 1996, e që u kushtohet tri personaliteteve të kombëtarizmes: Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, të vrarë me 1982 në Untergruppenbach të Gjermanisë nga sigurimi i atëhershëm jugosllav, sepse ata ishin veprimtarë të kauzës sonë kombëtare. Më vonë, në këtë vazhdë të botimeve pasojnë veprat tjera, pra romanet si: “Dorëzeza”, “Gjarprinjtë e pallatit”, “Tokë e djegur”, “Pallati i Akeronit” dhe vepra tjera poetike dhe publicistike dhe të zhanreve të ndryshme. Të gjitha veprat e mia kanë si lajtmotiv çështjen shqiptare si dhe çlirimin definitiv nga cerberët e Serbisë, por të shtjelluara në temën

romanciere. E them tash,pas kaq vjetëve se, sinqerisht jam dhe i kënaqur për shkak të vlerësimeve nga kritika letrare e kohës, ngase këto vepra janë vlerësuar dhe cilësuar për tematikën dhe për nivelin artistik të tyre, janë vlerësuar sigurisht nga profesionistët e kësaj fushe.Mbase këto vlerësime janë të botuara dhe në shtypin e kohës dhe përmbajnë gjithmonë të vërtetën e thënë mbi vlerat e këtyre veprave,pa kozmetikë pa elozhe,por të vlerësuara saktësisht dhe objektivisht. Si keni arritur ju të procedoni “në udhëtimin tuaj krijues ”, të jeni kaq kreativ, ku ka një shtrirje të gjerë të kombinimit të fakteve historike, kujtesës, miteve, marrëdhënieve ndëretnike, kombëtare, evropiane, veçmas asaj ballkanike, që perceptojnë vlerën e madhe të edukimit kuptimplotë të vetëdijes njerëzore, në marrëdhënie me të shkuarën, të tashmen e të ardhmen. A mund të na jepni disa mendime rreth tyre?

Duke u bazuar në historinë e bujshme shqiptare dhe duke i njohur rrjedhat tona historike dhe të popujve tjerë përreth nesh,në shumë vepra të mia janë shtjelluar faktet historike, etnike, antropologjike, kulturore etj,si dhe raportet në mes të këtyre popujve dhe historisë së tyre. Nga kjo del dhe vërtetohet lashtësia jonë dhe prejardhja në hapësirat ballkanike, që në shumë nga këto vepra të mia kjo temë zë vend qëndror dhe është shtjelluar nga shumë aspekte.

*-Zoti Bruqi, keni shkruar qindra artikuj shkencorë dhe studimorë, për historinë ballkanike e botërore, të botuar në organe shtypi në Shqipëri, Kosovë agjensioni Floart press, e gjetiu. Mund të na tregoni diçka në lidhje me strategjinë tuaj për këto vepra, dhe a ka ndonjë gjë tërheqëse që ju shprehni*

*nëpërmjet tyre apo ka diçka tjetër më tej se kjo...?*

**F.Bruqi:** Puna publicistiko-shkencore edhe përkundër vështirësive të saj,ka arritur të më stimulojë në thellimin e këtyre studimeve,duke shfrytëzuar burimet arkivore në vend dhe jashtë tij.Qëllimi im i gjithmonshëm ka qenë që ta nxjerrë të vërtetën për tematikën në fjalë,prandaj edhe këto tema të këtyre zhanreve janë mbetur një kontribut imi mbase po shprehem “modest”,duke dashur që ta vlerësojnë të tjerët në të ardhmen.Ndërsa sa i përket agjencionit “Floart press”, mund të them lirisht se është një ndër gazetat elektronike ndër më të lexuarat,më e hapura dhe më e debatuara,më e pavarura në trevat shqiptare.Aty ka shkrime të duarta nga shkrimtarët e afirmuar dhe ata fillestarë pa dallime. Agjensioni “Floripress” ka rreth 200 bashkëpunëtorë anë e kënd globit,ku me shkrimet e tyre kontribuan që të ketë sa më shumë lexues. Këtë e vërtetojnë rreth 3.600'000 klikime... që do të thotë se shënimet tuaja nënkuptojnë bashkëpunimin tuaj të ngushtë me një sërë burime dhe arkiva të ndryshme, si brenda dhe jashtë Shqipërisë, Kosovës , veçmas në Ballkan. A keni hasur në vështirësi nga këndvështrimi i një protagonistit në gjetjen e tyre? Nuk them se nuk ka pasur vështirësi, sepse është në natyrën e punës,por ato i kam kapërcyer gjithmonë,ngase në rend të parë si synim parësor njeriu ka qëllimin e arritjes së rezultateve në akëcilën fushë, në rend të parë me interes për opinionin.Tek unë kjo ka qenë cytje dhe më ka motivuar që të mos ndalem pavarësisht se sa dikujt kjo dhe mund t'i ketë “pënguar”.-Duke pasur parasysh faktin se ju jeni të njohur në nivel kombëtar e ballkanik, madje edhe në SHBA dhe këtë e tregon kontributi tuaj, përveç sa përmendëm më sipër, keni

vëllime poetike, në prozë reportazhe, përshkrime, artikuj kritikë dhe ese etj! Mund të them se leximi i veprave të bënë të njohur dhe pikërisht këto kontribute të miat letrare, publicistike, mbase ma kanë krijuar emrin tek opinioni ynë lexues, kjo tregon për suksesin e veprës sime letrare dhe asaj publicistike. S'do të shtoja më shumë por them se jam respektues ndaj lexuesve të mi. Secili nga lexuesit e veprave të mia, qofshin ato poetike, romanet apo publicistike dhe të tjera, kudo qoftë ata, u jam mirënjohës, i vlerësoj dhe e çmoj vlerësimin e tyre.

*-Me sa di unë keni shkruar shumë lirika dashurie. Çfarë ju ka shtyrë të shkruani poezi të tilla? Ç'është dashuria për ju? Kur një burrë e ndjen se është i dashuruar dhe cili është sekretin që fuqishëm ka influencuar në poezinë tuaj?*

**F.Bruqi:** Kam shumë miq shkrimtarë e shkencëtarë nga Shqipëria e Kosova. Disa edhe nuk janë në mesin tonë si Mehmet Kajtazi, Iljaz Prokshi, Rifat Kukaj, etj e që me siguri se kanë pasur ndikimet e tyre pozitive në krijimtarinë time letrare, poetike e publicistike... Ndër të gjallët do të veçoja Akademik Prof.dr.Fatmir Terziun, Akademik Namik Shehu, Prof.dr.Eshref Ymerin, Prof, Naim Kelmendin, Vullnet Maton, Raimonda Moisiun, Faik Xhanin, Kolec Traboinin, Zef Pergega, Izet Durakun, Rexhep Shahun, Vasil Qesarin, Përparim Hysin, Prof.dr.Shyqri Galicën, Rushit Ramabajën

*-Cilat janë disa nga idetë apo temat që ju shtjelloni në poezitë tuaja? A janë ato autobiografike? Çfarë është idealja përreth poetëve në mënyrë që të dalin poezi të arrira?*

**F.Bruqi:** Të gjithë personazhet, qoftë në poezi apo në prozë, romane etj, janë personazhe reale të kohës dhe

hapësirës sonë etnike. Vlenë të veçoj se në të tre romanet e mija, sikur janë “Dorëzeza”, “Pallati i Akeronit” dhe “Pallati i gjaraprinjve” personazhet janë realë, por të shkruar me emra artistik. Figurativisht ata janë në mesin tonë. Një numër personazhesh edhe janë gazetarë, shkrimtarë, politikanë dhe luftëtarë të tri luftërave çlirimtare, ata janë të prekshëm. Romanet e mia kanë stigmatizuar dukuritë negative në shoqëri si dhe bartësit e tyre në kohën e monizmit. Pothuaj të gjitha romanet e mi kanë bazë të mirë edhe për t'u bërë skenar filmash, dramatizime etj, ndoshta dhe mund të bëhen në një të ardhme, sepse tematika e këtyre veprave del nga jeta jonë nga ambienti ynë nga koha jonë e jetuar si shoqëri dhe si individ, por e cila kohë ka lënë gjurmet e veta, jo vetëm historike, por edhe psikologjike në njeriun e këtij nënqielli, gjithmonë i tragjizuar nga pushtuesit, në përkjejet e tij për liri dhe pavarësi kombëtare.

*-Nga poet në prozator, studues, publicist, kritik letrar dhe esseist? A i shihni këto zhanre si sfidë?*

**F.Bruqi:** Jo, përkundrazi do të thosha se e përplotësojnë njëra-tjetrën. Në rrugën time krijuese këto mbase e kanë pasuruar krijimtarinë duke e theksuar po ashtu gamën e preokupimeve të mija krijuese. Qenësorja është që të gjitha këto zhanre të krijimtarisë sime kanë ecur sukseshëm.

*-Cila është sfida për të shkruar një tregim apo roman? Zhanrin e tregimit dhe romanit e “bëtë ju të vinte te ju”, apo është preferenca tuaj?*

**F.Bruqi:** Dihet se krijimi i romanit nuk është sikur p.sh është krijimi i poezisë dhe në të kundërtën. Romani merr më shumë kohë dhe ka ligjësitë e veta të krijimit, por unë them se në të

shumtën unë preferoj romanin si zhanër dhe e kam shkruar. Puna ka dalur e suksesshme, ngase kanë shkruar pozitivisht për këto romane.

*-Ju i paraqesni personazhet tuaj nga jeta reale në përshtatje me kohën e situatën, apo anasjelltas?*

**F.Bruqi:** Personazhet e romaneve të mijja janë nga jeta reale, ngase ata janë njerëz, por që në krijimtarinë artistike ata marrin emra artistikë apo të imagjinuar, duke dashur që të mos “zbulohen”, sepse tashmë janë emra fiktivë letrar dhe jo realë, por të bëmat e tyre janë reale dhe kanë ndodhur në realitetin tonë në një kohë dhe në një hapësirë. Kjo mendoj se e ka pasuruar lëndën e romaneve të mijja dhe mbase ato mbajën vulën e disa ngjarjeve me domethënie për një kohë të jetuar. Besoj se lexuesi do ta gjykojë këtë kur t'i ketë lexuar.

*-Një nga gjërat që kam vënë re në librat dhe shkrimet tuaja reportazh është përshkrimi i vendeve, natyrës dhe pozicionit gjeografik të tyre. Pra, sa e rëndësishme është kjo në krijimtarinë tuaj?*

**F.Bruqi:** Kuptohet se përshkrimet që juve keni gjetur në veprat që potenconi, përbëjnë si të thuash një bazament të ngjarjeve të shtjelluara në ato shkrime. Përshkrimet e kësaj natyre pasurojnë rrëfimin dhe krijojnë një imazh më të saktësuar për lexuesin. Ato, pra përshkrime e natyrës, vendeve, etj, i japin jetë dhe e dinamizojnë rrëfimin apo shkrimin e një vepre.

*-Sa kohë keni që shkruani? Çfarë iu ka tërhequr në artin e të shkruarit? Cila është eksperiencia më e mirë që keni përjetuar kur shkruani? Po më zhgënjyesja? Cilat janë emocionet tuaj, kur shkruani?*

**F.Bruqi:** Mund të them se secila vepër shkruhet me emocion, pavarësisht se krijuesi që në fillimet e shkrimit të një vepre letrare, të një tregimi, të një poezie etj, i vë si të themi ato spirancat e krijimit të ngjarjes, apo të pikave ideore kah do të ecën ngjarja. Është e vërtetë se kam ndjerë në të shumtën emocionin e një magjie që të jep shkrimi kur krijon. Ndjenjën e zhgënjimit nuk e kam përjetuar, jo për tjetër, por mbase kur krijuesi krijon veprën ai ka një qëllim parësor që e shtynë atë ta krijojë atë vepër. Unë ndjehem mirë me atë që kam arritur ta krijojë dhe tua transmetojë lexuesve.

*-Ju keni një karrierë gjithashtu në publicistikë. Me këtë dëshiroj të di, se si ju harmonizoni aktualen mbizotëruese historike, sociale e politike, në kurriz të pavarësisë tuaj intelektuale. A mund të na përshkruani momente nga eksperiencia tuaj në librat, essetë dhe artikujt publicistikë?*

**F.Bruqi:** Nuk do të ndalesha tek momentet, por në tërësinë e veprës së krijuar janë mbarsur temat e shtjelluara, ato në publicistikë janë të kohës sonë, të hapësirës sonë, të mendësisë sonë, dhe të psikologjisë sonë jetësore. Ka dhe tema nga historia, mbase për t'i ndrikuar disa aspekte ngjarjesh apo personalitetesh etj, që janë e gjurmës sonë si komb në kohë, në data, në ngjarje të mëdha apo të vogla qofshin ato. Ato sikur më grishin kujtesën për t'i shtjelluar ngarendas në shkrimet e këtij zhanri të shkrimtarisë.

*-Si ka ardhur ndryshimi juaj më herët, nga poet, prozator në suksesin tuaj si publicist?*

**F.Bruqi:** Thënë të drejtën veten e shoh më të sendërtuar në zhanrin e romanit. Sikur më ka dhënë më shumë mundësi të të shprehurit, të të rrëfyerit, por gjithmonë me nivelin e gjuhës

artistike të rrëfimit. Ndoshta, them sipas përshtypjes sime, jo larg këtij suksesi qëndron edhe poezia dhe publicistika.

*-Si ndjeheni kur jepni intervista?*

**F.Bruqi:** Them sinqerisht fare mirë sepse intervista është dhe një rast tjetër i komunikimit më lexuesin, mbase nxjerrë për lexuesin në të shumtën dhe aspekte tjera, të panjohura ato që i interesojnë lexuesit për akëcilin person krijues.

*-Mesazhi juaj për inteligjencën shqiptare, kosovare dhe talentet e reja.*

**F.Bruqi:** Më e rëndësishmja është vlerësimi i drejtë i vlerave krijuese të kudoqoftë dhe vlerësimi i sinqertë i punës së njëri tjetrit kudo në hapësirën shqiptare dhe pastaj njohja e këtyre vlerave edhe nga jashtë. Ne kemi çka t'i prezentojmë edhe botës nga vlerat tona krijuese por duhet që ta kundrojmë drejtë vlerën e secilit dhe pa grupe dhe paragjykime klanesh e interesash të ngushta. Për herë të parë emrin tuaj e kam ndeshur ne “Albdreams.net” që botohet nga Rush Dragu ne Detroit, ku ju keni lidhje te ngushta me shkrimtarët e krijuesit diaspores shqiptare në Amerike! Është e vërtetë se krijimtarinë e tyre e kam publikuar për lexuesin e etur kosovar. Diaspora ka kontribuar jo vetëm materialisht, por është një vlerë gjithnjë në zbulim përse i përket thesarit të madh, të çmuar dhe të “fshehur” të saj. Kemi shkëmbyer mendime e shkrime sa ka qenë e mundur dhe këtë do ta vazhdojmë edhe ne të ardhmen. Njihemi nga larg po misioni na bashkon!

*-Çfarë dëshironi të shtoni?*

**F.Bruqi:** Asgjë më shumë vetëm të ju falenderoj për misionin tuaj në prezentimin e vlerave artistike për lexuesin, diçka me shumë për Kosovën, suksese në punën tuaj...



## PERSONALITETI I SHQUAR I KULTURËS SHQIPTARE

**Nga Akademik Prof.Dr. Eshref Ymeri**

Libri i autorit Flori Bruqi, me titull “Nëse kam ditur të guxojë”, është një tjetër dhuratë e çmuar që ai i bën masës së gjerë të lexuesve, në kuadrin e korpusit të veprave të tij të begata, duke filluar që nga ato artistike, deri te veprat shkencore, kritike dhe publicistike. Libri hapet me një shënim kritik të poetit, shkrimtarit dhe publicistit të talentuar Naim Kelmendi, i cili është edhe redaktor i tij. Paskëtaj vazhdon një cikël poetik i autorit që shërben si “tahta mbi kadife”, apo, thënë ndryshe, “si qershia mbi bakllava”.

Krijimtaria poetike e Flori Bruqit, sipas këndvështrimit tim, përfaqëson gulshet e shpirtit të një krijuesi thellësisht lirik që për asnjë çast nuk gjen qetësi. Është bota e një krijuesi me frymëzim të hyjnishtë, i cili, në qendër të universit të vet poetik, ka vendosur njeriun shqiptar. Përmes plazmimit të karakterit shqiptar, del në pah individualiteti i tij i papërsëritshëm. Krijimtaria e Florit është edhe rezultat, edhe proces. Rezultati duket në çdo sekondë të shfaqjes së tij në vargun poetik, kurse procesi vihet re në shpalosjen e botës së tij të brendshme, si shëmbëllesë fort e virtutshme. Pikërisht kështu vjen e ravijëzohet para lexuesit teknologjia e plazmimit të shpirtit poetik të Florit, madje edhe kur trajton një problem të karakterit shkencor apo publicistik. Ky plazmim ka kaluar përmes mohimit të gjithçkaje të dëmshme që mund ta infektonte në kushtet e një mjedisi amtar, por që ligjin në të e bënte një pushtues i huaj. Në një mjedis të tillë madje rreziku i infektimit shpirtëror bëhej më kërcënues prej bashkatdhetarit

që qe vënë në shërbim të të huajit. Pikërisht në këto kushte Flori i është kthyer vetvetes, për të dëgjuar tërë sy e vesh mendimet, ndjenjat dhe dëshirat e veta.

Me një çiltërsi befasuese, Flori krijon në vargjet e veta një botë psikologjike dhe intelektuale të njeriun në të përpjetat dhe në tatëpjetat e jetës së përditshme. Në poezinë me titull “Ç'rëndësi kishte e ka gjithçka?!” lexojme këto vargje:

*Është tre pasdite, gjithçka kundërmon vdekje...  
E di, është e kotë të kthehem në shtëpi, të shkruaj  
dhjetë apo tridhjetë e pesë rreshta,  
Ç'rëndësi ka?!*

Nga këto vargje, herë-herë të krijohet përshtypja se Florin e ka kapluar një ndjenjë pesimizmi të pashpresë, a thua se ai po e kundron botën përmes një lenteje erratake. Por kjo është një përshtypje e rreme. E vërteta nuk është kështu.

Filozofi gjerman Schopenhauer (Arthur Schopenhauer - 1788-1860), në veprën e tij me titull “Aforizma të urtësisë jetësore”, thotë: “...kush e shikon gjithçka në një dritë të errët dhe është i përgatitur për më të keqen, ai gabon më rrallë në parashikimet e veta, sesa njeriu që e shikon jetën si fushë me lule në ngjyrë trëndafili”...

#### **“Potpuria” letrare e Flori Bruqit**

Para pak ditësh, Shtëpia Botuese “Klubi i poezisë”, Tiranë, nxori nga shtypi dhe hodhi në qarkullim librin me titull “Moderniteti në letrat shqipe”, të autorit Flori Bruqi, poet, shkrimtar, historian, hulumtues dhe kritik i talentuar, një libër ky, i tridhjetenënti në serinë e veprave të tij, të botuara deri tani. Recenzent i librit është Rexhep Shahu, kurse redaktor - Izet Duraku.

Libri përshkohet tejandanë nga interesimet, emocionet, joshat, dyshimet e autorit që e lidhin artin e fjalës me realitetet shumëngjyrëshe të jetës së përditshme. Analizat kritikoletrare i adresohen një spektri të gjerë çështjesh etikomorale dhe lidhen drejtpërsëdrejti me kërkesat e përditshme të organizmit shoqëror. Si një kritik letrar i kompletuar, Flori Bruqi ka shpërfaqur aftësitë e tij për të zbuluar para lexuesit tablonë e të kuptuarit të plazmimeve artistike në indin e veprave të analizuara. Kësisoj ai ka marrë përsipër rolin e ndërmjetësit në shtegtimin e veprës letrare nga autori te lexuesi. Brenda penës së tij vjen e ravijëzohet edhe “reparti i punës” së shkrimtarit, edhe bota e larmishme e lexuesit. Shkrimtari, poeti, kritiku dhe gjuhëtari gjerman Frederik Shlegel (Friedrich Schlegel - 1772-1829) thotë:

“Kritiku është një lexues, i cili merret me “tretjen” e gjërave që ka lexuar. Prandaj ai duhet të ketë disa stomakë”. Funksionin e kritikës letrare Flori e shikon të lidhur ngushtë me ndikimin që ajo duhet të ushtrojë mbi opinionin shoqëror, mbi vetë autorët e veprave artistike dhe mbi zhvillimin e përgjithshëm të letërsisë dhe të artit. Në mundin e tij kritikoletrar, ndihet prania e heshtur e frymës polemike, dialogu i heshtur me autorin, me lexuesit e hamendësuar, me kolegët-oponentë.

Në këtë vepër të re, Flori Bruqi i drejtohet analizës së krijimeve letrare, të kahershme për nga prejardhja e tyre, por që vazhdojnë të ndikojnë me autoritet mbi botën shpirtërore të lexuesve edhe në ditët tona. Të tilla janë krijimet letrare të Homerit shqiptar Gjegj Fishta. Vepra e Fishtës, e këtij korifeu të kulturës shqiptare, përherë do të jetë objekt studimi dhe

analizash nga ana e kritikëve dhe e studiuesve të letërsisë shqipe. Ajo ka qenë, është dhe do të mbetet përjetësisht burim frymëzimi për brezat e sotëm dhe pasardhës për farkëtimin e vetëdijes kombëtare, në kundërshtim me vlerësimin armiqësor që i pati bërë Enver Hoxha Fishtës dhe vepërs së tij, simbol i nacionalizmit shqiptar. Lexuesi me vetëdije të lartë kombëtare, vë duart në kokë për mjerimin e palakmueshëm të figurës së Enver Hoxhës, kur sulmin e këtij të fundit kundër Fishtës, e krahason me vlerësimet që kanë bërë për të mjaft personalitete të shquara kombëtare dhe të huaja, të cilat Flori i ka cituar në faqet e këtij libri. Është e turpshme për Enver Hoxhën, i cili, si argat i regjur i Beogradit, nacionalizmin e pastër të Fishtës, e vë në një peshore me shovinizmin tribal të Vlladan Gjeorgjeviçit, kur deklaron:

“Fishta dhe Vlladan Gjeorgjeviçi janë njerëz të po një shkollë dhe shërbëtorë të një ideje skllavëruese” (Citohet sipas: Enver Hoxha për miqësinë me sllavët, sulmon Fishtën”. Marrë nga faqja e internetit “Peshku pa ujë”. 06 dhjetor 2012).

Këtu po ndalem vetëm në vlerësimin e Prof. dr. Norbert Joklit, të cilin Flori e citon në veprën në fjalë: “...me At Gjergj Fishtën gjuha shqipe u rrit, u madhnue, u ba zojë. Me At Gjergjin, kryetar në Kongresin e Manastirit, u caktue njëherë e përgjithmonë një alfabet i vetëm për mbarë Shqipërinë, vendim ky me dobi që nuk numrohen. Me At Gjergjin zuni fill shkolla me shqipen gjuhë mësimi...”

Këtë shkrim e titullova “Potpuria” letrare e Flori Bruqit”, sepse Flori, nga vargjet gjëmimtare të Fishtës, kalon te vargjet dhe përgjithësisht te vepra bubulluese e Arshi Pipës. Mandej “e mban vrapin” te joshja magjiplote e krijimtarisë së Mira

Meksit, në endjen e saj lirike mes Tiranës dhe Parisit, vazhdon me shtresëzimet e letërsisë shqiptare, duke analizuar zhvillimet e saj jo vetëm brenda trojeve etnike, por edhe në diasporë, si në Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi e deri në Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për mendimin tim, Flori Bruqi, si një kritik erudit, është i pari në historinë e letërsisë shqipe, i cili ka nxjerrë si në një “parakalim festiv” të gjithë shkrimtarët dhe poetët e trojeve etnike shqiptare. Nga radhët e tyre në Perëndimin evropian dhe amerikan, ai përmend 54 syresh. Mes krijuesve të diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dëshiroj të shtoj edhe emrin e eseistes dhe të shkrimtares sa të talentuar, aq edhe fjalëpakë, Nimfa Hakani, e cila, në nëntor të vitit 2015, botoi në Shqipëri tre libra: përmbledhjen me tregime me titull “Pacientja 101”, një përmbledhje fabulash dhe rrëfenjash për të rritur, të titulluar “Luani i fjetur”, dhe një përrallë për fëmijë, me protagonist Gjeto Basho Mujin. Flori vijon me Rexhep Hoxhën, me këtë krijues të heshtur hijerëndë, që të mahnit me ca vargje plot aromë ëndërrimtare:

*As vetë s'e dij pse kot rrugëvet po sillem*

*Pa kurrfarë qëllimi - pa drejtim askund!*

*Nër rrugë t' qytetit m' duket se po hidhem*

*Sikurse Kolombi n' oqean t' pafund.*

Paskëtaj Flori ndalet te Kadrush Radogoshi dhe analizon veprën e tij “Semantika e bregut tjetër”, ku del në pah talenti i tij si eseist, studiues dhe shkrimtar. Prej këtej, hidhet te Prenk Jakova, themeluesi i artit operistik shqiptar, autor i sa e sa këngëve dhe romancave plot lirizëm marramendës, i cili e mbylli jetën në një mënyrë tragjike, me vetëvrasje, për shkak

se diktatura komuniste enveriane jetën ia pati lënduar rëndë me pushkatimin mizor të të vëllait, për shkak të bindjeve të tij nacionaliste, çka ai e mbajti peng në zemër sa qe gjallë.

Prekëse janë faqet që Flori i kushton krijimtarisë së Ali Podrimjes që të rrëmben me vargjet e tij plot afsh lirik, aq të pasur me një figuracion emocionues. Me vdekjen e tij enigmatike dhe të parakohshme në Francë, Kosova dhe mbarë trojet etnike shqiptare sikur humbën një rën nga arteriet e tyre me gjak gurgullues.

Martim Camaj zë një vend nderi në historinë e kulturës sonë kombëtare, i njohur si studiues i gjuhës shqipe dhe i dialekteve të saj, si njohës i shquar i botës arbëreshe, të cilin autori ia prezanton lexuesit si një poet dhe prozator të talentuar, të respektuar për thjeshtësinë e madhështisë së tij, për pasurinë e pamatë të leksikut të tij.

“Potpuria” floriane vjen e bëhet edhe më emocionues kur ai e ndal “fluturimin” e shënimeve kritike të njëra nga krenaritë e kulturës shqiptare me prejardhje shkodrane, të Ndre Mjeda, të autori i poezive aq të dhembshura që ta ngrenë zemrën peshë me notat e tyre elegjiake.

“Potpuria” në fjalë vjen e pasurohet edhe më shumë me elementet e folklorit dhe të etnografisë. Flori, me përshkrimin e qeleshes së bardhë që sfidon popujt në shekuj, ka folur për historinë e saj. Kjo qeleshe, e quajtur ndryshe plisi shqiptar, si një simbol karakteristik i etnisë shqiptare, është përcjellë nga thellësitë e shekujve, plis ky, i papërsëritshëm në asnjë etni tjetër, jo vetëm në kontinentin tonë, por edhe në mbarë botën. Prandaj kjo është edhe arsyeja që, siç thotë Flori, plisi shqiptar (qeleshja) ndodhet i ekspozuar në muzeun Luvrit në Paris.

Në kreun e librit me titull “Moderniteti në letrat shqipe”, që shërben edhe si titull i kësaj vepre, kritiku Flori Bruqi është ndalur në tre momente kryesore:

Së pari, në zhvillimin e letërsisë në Kosovë, e cila zë fill që në vitet '30 të shekullit të kaluar, kur dalin në skenë penat emblematike të Esat Mekulit dhe të Hivzi Sulejmanit. Më tej autori vazhdon me krijimtarinë e poetëve dhe të shkrimtarëve të tjerë, të cilët, edhe në kushtet e terrorit serb, asnjëherë nuk hoqën dorë nga krijimtaria letrare, duke e vlerësuar atë si një armë të fuqishme të identitetit kombëtar.

Së dyti, në zhvillimin e letërsisë arbëreshe, e cila përbën një faqe të ndritur në historinë e kulturës së kombit shqiptar. Domosdo që nuk mund të mos shpërthenin “sythet” e letërsisë artistike arbëreshe, qoftë në prozë, qoftë në poezi, përderisa atje jeton një popullsi prej 90 mijë frymësh që vazhdojnë të flasin gjuhën shqipe.

Së treti, në lindjen në diasporë të një letërsie në gjuhë të huaj, por me tema shqiptare.

Në faqen e internetit “Agjencioni Floripress” të datës 03 shkurt 2014, Flori kishte botur një shkrim me titull “Shkrimtaret e ekzilit” dhe përmendte konkretisht shkrimtaret Anilda Ibrahim, Elvira Dones dhe Ornela Vorpsi, të cilat, siç thekson në këtë libër, përbëjnë treshen shqiptare të mërgimit në Itali, që i boton librat e veta në italisht, në shtëpitë botuese “Feltrinelli” dhe “Einaudi”. Ai përmend edhe zonjën Besa Myftiu që jeton në Zvicër dhe librat e veta i boton në Francë, në shtëpinë botuese “Fayard”. Asokohe, po më 03 shkurt 2014, unë pata botuar në internet një shënim me titull “Katër burbuqet e magjisë shqiptare”. Me këtë rast, dëshiroj të shtoj

edhe një tjetër “burbuqe” të talentuar. Kjo është zonja Nimfa Hakani, e cila, siç e përmenda më lart, jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Karolinën e Veriut. Këtë vit, dhe konkretisht më 25 prill, ajo botoi një përmbledhje me tri novela, me titull “Under The Orange Tree” (Nën hijen e portokallit), me një vëllim prej 362 faqesh. Tematika e tri novelave ka për objekt fshatin shqiptar në jug të vendit, në periudhën midis dy luftërave botërore.

Flori i rikthehet kritikës letrare me analizën e krijimtarisë së Gani Xhafollit, një krijues ky me një individualitet mjaft të spikatur në lëmin e poezisë për fëmijë, i cili u nda nga jeta më 15 qershor 2015, në moshën 73-vjeçare.

Studimi kritik i Flori Bruçit pasurohet me një analizë të dialekteve të gjuhës shqipe, ku theksohet se dallimet mes tyre nuk janë të mëdha, me përjashtim të disa ndryshimeve në sistemin fonetik, në strukturën grammatikore dhe në leksik. Mandej ai e vazhdon analizën për shqipen e njësuar, duke u ndalur në parahistorinë e saj që prej shek. XVI-XVIII, në hartimin e fjalorëve të parë, në kontributin që dhanë shumë figura të shquara të Rilindjes Kombëtare para dhe pas shpalljes së pavarësisë, derisa u arrit në Konsultën Gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968, e cila u mbështet në parimin “Një komb, një gjuhë, një flamur”, çka krijoi parakushtet për thirrjen e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972, që hodhi themelet e shqipes së njësuar në mbarë trojet tona etnike. Në këtë pjesë të librit u është lënë hapësirë edhe studimeve shkencore për gjuhën shqipe që janë kryer nga shkencëtarë të huaj dhe shqiptarë, edhe në kuadrin e lindjes së gjuhësisë historike-krahasuese.



Disa faqe të librit të vet, Flori ia ka kushtuar Nënë Terezës, e cila përfaqëson simbolin e ngrohtësisë shpirtërore dhe të humanizmit botëror. Prandaj figura e saj ka shërbyer si objekt frymëzimi për shumë personalitete të njohura të kulturës sonë kombëtare dhe të kulturës botërore.

Pas një paraqitjeje panoramike të krijimtarisë së poeteshës, dramaturges dhe prozatores Shqipe Hasani, Flori zbret përsëri në truallin e folklorit dhe konkretisht në atë të artit rapsodik të Dervish Shaqa Kosovës, të cilin, me shumë të drejtë, ai e quan “gjeneral të folklorit shqiptar”. Aq përcëllues ishte mesazhi i këngëve rapsodike të Dervish Shaqas për kolonizatorët serbë, sa që ata filluan përndjekjen e tij. Prandaj ai, në vitin 1956, u detyrua të zhvendosej në Shqipëri, në Rashbull, ku pati themeluar grupin e famshëm rapsodik që ka lënë gjurmë të thella në traditën e folklorit shqiptar.

Emocionuese janë faqet e librit, kushtuar njërit nga personalitetet më të shquara të kulturës shqiptare, Mitrush Kutelit, ekonomistit mendjendritur dhe shkrimtarit erudit, poetit dhe përkthyesit me shije të hollë, të cilin diktatura komuniste e trajtoi si njerka fëmijën e gjetur. Dhe s'mund ta trajtonte ndryshe, sepse intelektualët me dije enciklopedike përbënin rrezik për përmbysjen e saj. Prekëse, deri në lëndim të shpirtit, është letra e fundit e Mitrush Kutelit. Përmbajtja e saj është tronditëse. Me atë letër, Kuteli, tërthorazi, zbulon një realitet tragjik të kohës së diktaturës, kur ai intelektual i madh ishte katandisur në një gjendje aq të rënduar shpirtërore.

Në “potpurinë letrare” Flori nuk mund të linte mënjanë artet e bukura. Prandaj ai i kushton disa faqe jetës dhe krijimtarisë së skulptorit mjaft të talentuar Agim Çavdarbasha, i cili

është i njohur për hapjen e shumë ekspozitave jo vetëm në trojet amtare, por edhe në disa vende evropiane.

Me analizën e veprës së Odise Grillos, të simbolit të letërsisë shqipe për fëmijë, me vlerësimin e krijimtarisë së Esat Mekulit, si shkencëtar në fushën e veterinarisë, si poet me një talent origjinal, si përkthyes me një prodhimtari të jashtëzakonshme, si publicist dhe si një aktivist politiko-shoqëror, i cili zë një vend të veçantë në historinë e kulturës sonë mbarëkombëtare, me pasqyrimin e veprimtarisë së Enver Gjerqekut, poet, studiues, përkthyes dhe historian i letërsisë, profesor i letërsisë shqipe në fakultetin filologjik të Universitetit të Prishtinës prej vitit 1962 deri në vitin 1995, mbyllet vepra në fjalë e Flori Bruqit.

Në parathënien e librit, autori ka bërë një analizë kritike të botës letrare shqiptare, me të mirat dhe me dobësitë e saj. Ai ka cituar shkëndijëza të fjalës së çmuar të figurave të tilla, si Ismail Kadare, Ridvan Dibra, Arian Leka, Fatos Kongoli, Visar Zhiti dhe Zija Çela, si edhe të personaliteteve të huaja të lëmit të kritikës letrare. Në këtë parathënie shpërfaqet krtitika letrare profesionale brenda këndvështrimit edhe të krijuesit, edhe të lexuesit. Si një kritik-profesionist, Flori Bruqi bie në sy për thellësinë e kujtesës letrare dhe për trajtimin estetik të artit të fjalës së shkruar, çka buron nga përgatitja e tij si një intelektual erudit, i papërsëritshëm në lëmin e shkencës së kritikës letrare. Prandaj sa herë që lexoj shënime kritike të Flori Bruqit, menjëherë më vjen ndër mend një thënie e bukur e Oskar Uajldit (Oscar Wilde - 1854-1900) “Kritika kërkon shumë më tepër kulturë sesa krijimtaria”.

### **Një enciklopedi e mendimit shqiptar**

Libri më titull “Triumfi shqiptar”, i tridhjeti në serinë e botimeve të zotit Flori Bruqi, nxjerr në spikamë natyrën shumëdimensionale të krijimtarisë së këtij personaliteti të shquar të kulturës shqiptare.

Në universin e kulturës shqiptare është i rrallë fakti që një krijues të dalë para lexuesve me autoritetin e admirueshëm të një shkrimtari, poeti, përkthyesi, publicisti, historiani, gjeografi, analisti dhe kritiku të talentuar.

Tek lexon këtë vepër kaq interesante, që të rrëmben me tematikën e vet bukur të larmishme, nuk mund të mos ndiesh njëherazi kënaqësi dhe krenari për faktin që krijimtarinë e zotit Flori e përshkon tejdanë një frymë mahnitëse objektiviteti, humanizmi dhe optimizmi të pakundshoq.

Mes rreshtave të kësaj vepre nuk është vështirë të kapësh tiparin më themelor të formimit intelektual të zotit Flori - dashurinë e tij të pastër për tokën amtare, respektin e lakmueshëm për këdo që është atdhetar dhe që e do me shpirt punën, si burim mirëqenieje dhe begatie për të gjithë.

Albert Kamy (Camus -1913-1960) thotë: “Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzojë kaq shumë njeriun, sesa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë”.

Duke pasur parasysh këto fjalë të qëlluara të Kamysë, mendoj se të gjithë ata shqiptarë që popullojnë mbarë trojet tona etnike në Evropën Juglindore dhe që janë të kapluar nga pak nga ndjenja meskiniteti, smire, xhelozie, inferioriteti dhe zvetërimi të shpirtit njerëzor, pra, nga “vetëdijësimi për gjendjen e tyre të pashpresë”, është mirë ta lexojnë, me durim, veprën e zotit Flori, se nuk do të mbeten të zhgënjyer, nëse do

të jenë në gjendje të zbulojnë brenda qenies së tyre një çikëz frymë objektiviteti.

Kam bindjen se do të dalin të fituar, se vepra e zotit Flori shërben si melhem për qetësimin e shpirtave që janë të infektuar nga mikrobi djallëzor i përçarjes njerëzore.

Ne, shqiptarët, kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim prova boll të dhimbshme të përçarjes kombëtare, çka e kemi paguar shtrenjtë - me copëtimin e trojeve tona etnike. Evropa na e ka njohur mirë dhe na e ka “yshtur” po aq mirë këtë mikrob të mallkuar, prandaj edhe trojet etnike na i bëri çarçaf.

Vepra e zotit Flori duhet të lexohet me shumë vëmendje sidomos në Kosovë, në mënyrë që njerëzit e infektuar nga mikrobi i përçarjes t'i thërrasin mendjes dhe të heqin dorë një herë e mirë nga sulmet që ndërmarrin kundër njëri-tjetrit nëpër faqet e internetit, ca sulme publike këto, me një fjalor të padenjë për stilin e komunikimit njerëzor, por edhe më shumë të padenjë për një komunikim intelektual.

Më gëzon shpirti dhe ndiej një kënaqësi të jashtëzakonshme kur lexoj këtë vepër të zotit Flori, që të mëson dhe të frymëzon që ta duash dhe ta respektosh njeriun, pra, ta duash dhe ta respektosh shqiptarin. Sepse në analizat e veta shkencore zoti Flori, tërthorazi, zbulon anët më humane të shpirtit njerëzor, ndikimin e tyre në plazmimin e vlerave krijuese dhe rolin që ato duhet të luajnë në shëndoshjen e shpirtit shqiptar me dashurinë e njeriut për njeriun.

Në gjykimin tim, mbarë krijimtaria e zotit Flori, për tematikën e gjërë që trajton dhe për objektivitetin e analizave shkencore që shpalosen në të, mund të vlerësohet pa drojë si modeli i një enciklopedie të mendimit shqiptar.

FLORI BRUQI, ENCIKLOPEDIST DHE AUTOR I  
PËRMASAVE LETRARE TË KOHËS

**Nga Bajame Hoxha-Çeliku**

Emocionuese janë faqet e librit të tij, kushtuar personazheve të njohur që ai i përmbledh dhe që hidhet sa te njëri te tjetri, duke u pasqyruar vlerat e të duket se ato vlera letrare të pa tjetërsuara, i fut brenda zemrës për t'i mbrojtur e për t'ju zgjatur sa më shumë jetën.

Ajo që të bënë përshtypje është se: Flori hedh dritë me dashamirësi mbi veprat e personaliteteve më të shquara të kulturës shqiptare, pa mos harruar ata të shumtë të goditurit nga diktaturat.

Enciklopedist do ta quaja me mendim të kthjellë Flori Bruqin, sepse, Flori është ai që shpalos e shpërndan, jep njohuri të gjithanshme nga të gjitha sferat si askush tjetër. Dua të theksoj se kemi përballë një njeri titan e s'jemi te mitologjia greke, por te njeriu i shquar, që ka çarë jetën si vigan me shpatë në dorë. Ka çarë rrugë të reja në fushë të veprimtarisë shoqërore, të kulturës, të shkencës etj. Duke i sjellë shërbime të mëdha literaturës shqiptare, njeri që dallohet për dhuntitë e tij të jashtëzakonshme; titan me penë në dorë e me mendje të ndritur të mendimit njerëzor.

E me sa kam vënë re gjatë leximeve, Flori ka karakterin dhe fuqinë e një enciklopedisti këmbëngulës, që nuk i shpëton asgjë pa kapur, pa studiuar qoftë edhe një presje. ka njohuri e dije të paskajshme, një kulturë shumë të gjerë, është i gjithanshëm ndaj meriton të zërë vendin e ta ngremë lart aty ku e ka vendin dhe ku meriton.

Pra, është mendjendritur dhe shkrimtar erudit, me shije të hollë artistike, se ai di t'i rrok me ndijimin e së bukurës në art në veprimtari dhe në jetë.

Në veprimtarin e këtij gjeniu çdo vepër e tij është e bukur dhe e harmonishme, gjë që të bie në sy menjëherë, ku pasqyron artistikisht gjithçka që përfshinë brenda krijimtarisë aq të pasur dhe të mrekullueshme. Prandaj puna dhe krijimtaria e tij është shumë e larmishme, zotëron dije të thella. Florin e gjen kudo; pranë të bukurës, pranë dhimbjes, pranë lotit. Kudo gjen shpirtin e tij të palodhur bujar. Pra, për ta përmbledhur e rrethuar në një fjalë të vetme që ka erudicion.

Në shpirtin e ndjeshëm si prej artisti dhe në veprimtarinë e tij jetojnë të gjitha. Të gjitha ato që ka brenda tërësia e përjetimeve të thjeshta e të paqëndrueshme herë, herë psikike të njeriu siç janë: gëzimi, zemërimi, mallëngjimi, ngashërimi, shqetësimi, turbullimi etj.

Të gjitha këto emocione që shkaktohen e shfaqen nën ndikimin e mjedisit të jashtëm a të faktorëve të brendshëm, Flori të duket se i ka përjetuar, pastaj i ka kaluar te personazhet e tij. Apo, apo ka veshur aq bukur shpirtin bujar e të pavdekshëm të krijuesve shqiptar që nuk u heq një presje nga vlerat e tyre.

Vlera shpirtërore letrare, e forcës së mendimit, është vlerë absolute tek heroi ynë, sepse ka mbi të gjitha; pasuri të çmueshme një popull të tërë, një popull trim, të një gjuhe të një gjaku.

Kjo madhështi qëndron mbi çdo krenari dhe ka një rëndësi të veçantë për njeriun e penës, mbi njeriun e punës. Ndaj ai qëndron i fortë si shkëmb edhe përballë furtunave që; hera,

herës i zënë këmbët dhe në kohë me diell. Që ka veti shumë të shquara dhe të mahnit me veprat e tij, kjo është e evidente, sidomos punët shkencore etj. Kështu të imponon respekt, të bën ta admirosh e ta nderosh, që pa ndrojtje më bën të besoj në fjalët e mia dhe, besoj se shquhet ndër më të mirët.

Vetia e cilësia e të quajturës; poet, shkrimtar, apo arritjeve për të qenë i tillë, i merituar është dhe qëndron midis njerëzve me zemër të madhe dhe dukurive të shoqërisë, që u përgjigjen në mënyrën më të plotë, në shkallën më të lartë me përmasa e me forcë të jashtëzakonshme idealeve tona shoqërore e estetike; kësaj i thonë të quhesh i madhërishëm.

Këtu ndahen më së miri; e madhërishmja dhe e bukura apo dhe heroikja.

Prandaj Flori mbetet krijues i vlerave të mëdha.

## AKADEMIK FLORI BRUQI-LUFTËTARI I PAEPUR NË MBROJTJE TË IDENTITETIT TONË KOMBËTAR

**Nga Akademik Kujtim Mateli**

Krijimtaria e Flori Bruqit ka si gur themeli vlerat e identitetit tonë kombëtar, vlera të krijuara në breza nga paraardhësit tanë, nga lashtësia deri në ditët e sotme. Identiteti kombëtar shpaloset natyrshëm përgjatë gjithë veprës së tij, duke i mëshuar fort idesë për t'i njohur mirë këto vlera dhe për t'i ruajtur ato. Identiteti kombëtar formohet nga ato vlera që lidhen me qëndrueshmërinë në rrjedhë të shekujve për të mos humbur gjuhën dhe kulturën, traditat dhe zakonet që e kanë ruajtur atë nga asimilimi agresiv i fqinjve. Të zbulosh vlerat e qëndresës së popullit tonë në mijëvjeçarë, do të thotë ta ndërtosh të sotmen dhe të ardhmen mbi baza të sigurta.

Duke filluar me vëllimin e parë poetik “Zjarri i diellit” në vitin 1995 e deri më sot, krijimtaria letrare e Flori Bruqit ka frymëzuar brezat e rinj me dashurinë për Atdheun, të qenit krenar për të parët tanë, që kanë ruajtur tradita dhe zakone, të cilat ruajnë vlerat e krijuara në shekuj. Jeta e shqiptarit deri më sot ka qenë e mbushura me përpjekje dhe luftra të pandërprera, të cilat përcaktojnë dhe identitetin e tij liridashës e paqësor. Vepra letrare dhe sidomos romanet e tij të shumtë si “Vrasja e liridonëve”, ”Dorëzeza”, “Gjarprinjtë e pallatit”, “Tokë e djegur”, ”Pallati i Akeronit” dhe të tjera vepra të spikatura, karakterizohen nga niveli i lartë artistik dhe mesazhet e rëndësishme që i përcillen lexuesit të çdo kohe. Puna e tij kërkimore-shkencore, duke shfrytëzuar burimet



arkivore në Kosovë dhe jashtë saj, ka bërë që ta njohë më mirë historinë e vendit tonë dhe të nxjerrë nga realiteti historik dhe ai aktual, personazhet e veprave që janë dhe do të mbeten dëshmi e krenarisë sonë kombëtare. Vepra letrare e Flori Bruqit është e gjithanshme dhe kontributi i tij është i çmuar si: poet e prozator, kritik letrar e eseist, publicist i dimensioneve të larta kombëtare, i ndjekur nga shqiptarët kudo trojeve shqiptare dhe jashtë tyre në diasporë.

Gurët kilometrikë, që shenjojnë identitetin e kombit tonë në rrugëtimin e tij historik, janë ngjarjet më të rëndësishme kulmore që populli ynë ka shenjuar me gjak e sakrifica. Një nga këto pika kulmore është edhe Shpallja e Pavarësisë së trojeve shqiptare më 1912. Kjo ngjarje, e cila u kurorëzua nga një seri betejash të ashpra me pushtuesit osmanë, e ka vulosur përfundimisht marrëdhënien e shqiptarëve me perandorinë osmane, duke e konsideruar atë si një forcë pushtuese.

Flori Bruqi në krijimtarinë e tij artistike, por dhe në atë publicistike dhe shkencore i ka mëshur fort idesë që vlerat e identitetit tonë kombëtar nuk duhet të dalin në pazar. Asnjë presje nuk duhet t`u hiqet vlerave tona kombëtare. Si shembuj sillen përpjekjet e Turqisë së sotme për rishikimin e historisë së periudhës osmane, por dhe ato të Greqisë që kërkojnë të zhdukin vlerat e popullit shqiptar në krahinën e Çamërisë, e cila deri para Konferencës së Londrës 1913 ishte pjesë e Shqipërisë së Poshtme, me histori dhe kulturë shqiptare dhe e banuar nga shqiptarët.

Këto përpjekje të fqinjve tanë për ta tjetërsuar historinë e popullit tonë kanë ndeshur në penën e fortë të akademikut Flori Bruqi.

Në krijimtarinë e tij ndjehet mirënjohja dhe respekti për aktorët që sollën lirinë e Kosovës nga shtypja dhe barbaritë serbe. Heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës janë pikat orientuese se si duhet të ecet më tej. Janë këta luftëtarë, dëshmorë dhe heronj, që për sot dhe shekujt që vijnë, i kanë përcaktuar marrëdhëniet e shekullit XIX midis shqiptarëve dhe serbëve, ose më saktë ato të para vitit 1999, si marrëdhënie midis shqiptarëve, që luftonin për liri dhe pavarësi dhe pushtesve serbë. Gjaku dhe heroizmi i UÇK-së, e ka vulosur këtë marrëdhënie dhe askush, as sot dhe as në të ardhmen, nuk mund t'ia zbusë fytyrën çnjerëzore që tregoi ushtria e Milosheviçit.

Fqinjët tanë në veri dhe në jug të tokave shqiptare, aq sa kanë synuar të pushtojnë trojet shqiptare, po aq kanë bërë përpjekje të tjetërsojnë dhe historinë tonë, duke u përpjekur të rrafshojnë pikat kulmore të historisë së popullit tonë, deri tek ngjarja më e fundit kulmore siç është Lufta e Kosovës për liri e Pavarësi e vitit 1999. Ka përpjekje për të ulur vlerat e kësaj lufte si luftë çlirimtare, për të denigruar figurat e saj madhore. Përpjekje ka patur edhe për ngjarje të tjera kulmore, siç është shpallja e pavarësisë, duke mbivlerësuar kontributin e ndonjë fuqie të huaj dhe nënvlerësuar kontributin e atyre qindra mijëra shqiptarëve të organizuar në formacione luftarake në mbarë trojet shqiptare, dhe delegatët që nxorën këto treva për ngritjen e flamurit kombëtar në Vlorën heroike. Përpjekje ka patur edhe për Skënderbeun dhe luftën e tij heroike në mbrojtje të trojeve shqiptare dhe të vetë kontinentit tonë. Autorët e këtyre shtrembërimeve janë përballur me penën e akademikut Flori Bruqi, duke u dhënë qartësi këtyre shtrembërimeve dhe mjegullimeve të bëra nga autorë dashakeqës.

Fqinjët tanë në veri dhe në jug të trojeve shqiptare (serbët dhe grekët), janë përpjekur në këta dy shekujt e fundit ta shkurtojnë me sa të mundin ekzistencën e shqiptarëve në këto troje. Akademiku Flori Bruqi, si njohës i mirë i historisë, i ka demaskuar këta autorë dashakeqës dhe gjithë krijimtaria e tij letrare, publicistike dhe shkencore, tregon për autoktoninë ilire të trojeve tona, që nga kohët më të vjetra me kufij veriorë rrjedhën e lumit Danub, ashtu siç dokumentohet edhe nga gjeografi Strabon.

Po akademik Flori Bruqi, ndryshe nga institucionet shkencore në Kosovë dhe në Shqipëri, i shikon trojet shqiptare si një e tërë, si një histori e pandashme ashtu siç kanë qenë në rrjedhë të historisë. Institucionet shkencore në Shqipëri dhe në Kosovë, përfshi dhe institucionin e vetëm shkencor në Maqedoni, i kanë parë trojet shqiptare si parcela të pavarura dhe gjithë puna kërkimore-shkencore ushtrohet brenda parcelës së shtetit ku ndodhen. Ndryshe ndodh me akademikun Flori Bruqi. Ai i vështron trojet shqiptare në tërësinë e tyre dhe nga kjo fushëpamje artistike dhe shkencore jep atë realitet shqiptar të pandarë, të mishëruara në vepra artistike, por dhe në studime shkencore.

Një nga veprat madhore të akademik Flori Bruqit është “Leksikoni enciklopedik”, Prishtinë 2020, botim i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve, një vepër që rrezaton arritjet shkencore dhe ato artistike më të realizuara brenda hapësirës së trojeve shqiptare dhe në diasporë. Vetëm fakti që kjo Enciklopedi nuk është e ngjashme me ato që kanë dalë deri më sot në Prishtinë, të cilat përfshijnë personazhe dhe ngjarje brenda territorit të shtetit të Kosovës, me

ato të Tiranës, që kufizohen me personazhe dhe ngjarje brenda Shqipërisë londineze, kjo Enciklopi i thyen këto kufizime të deritanishme dhe përcjell dritë dhe dije në çdo skaj të trojeve shqiptare, deri në diasporën më të largët. Ajo përcjell idenë e përbashkimit të trojeve shqiptare brenda historisë së përbashkët, që ato kanë dhe kanë patur në mijëvjeçarë, nga ku gjallon një letërsi dhe art i përmasave botërore, sepse fryma që ato përcjellin i drejtohen çdo individit të planetit tokë, pavarësisht kombësive dhe racave që ata i përkasin.

Enciklopedia e akademik Flori Bruqit, duke u lidhur natyrshëm me zinxhirin e artë të enciklopedive botërore, u përcjell popujve dhe institucioneve shkencore vlera të rëndësishme, që janë krijuar në këto troje shqiptare përgjatë gjithë historisë së tyre.

Akademik Flori Bruqi aq sa ëshë i interesuar për fatin e trojeve shqiptare në veri, po me kaq vëmendje ka ndjekur dhe fatin e trojeve shqiptare në jug të tyre. Ka një përpjekje të pandërprerë të Akademisë së Athinës për t'i parë trojet në jug të Shqipërisë si pjesë të Helladës, duke e provokuar rëndë Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me librin shovinist të botuar në anglisht në vitin 1977. Kundër këtij libri në trojet shqiptare ka patur vetëm një zë kundërshtues dhe ky ka qenë akademiku Kristo Frashëri. Për ta patur të qartë se sa i rëndë është ky libër provokues, po e citojmë kundërshtimin e akademik Kristo Frashërit në artikullin “Shtrembërime të historisë së Epirit nga Akademia e Athinës”, botuar tek “Gazeta Shqiptare” datë 07.08.2011, i cili vë në dukje se disa botime gjoja shkencore, nuk janë gjë tjetër veçse lakmi nacionaliste të fqinjit tonë jugor ndaj viseve shqiptare.

**Kristo Frashëri:** *“Prej tyre meriton të veçohet botimi me pretendime shkencore që ka dalë nga shtypi në Athinë kohët e fundit. Fjala është për trajtesën që Akademia e Athinës botoi kohët e vona në anglisht në format të madh prej 480 faqesh, nën drejtimin e përgjithshëm (general editor) të M. B. Sake-llariut, me titull “Epirus 4000 years of greek histori and civilization” (Epiri 4000 vjet histori dhe qytetërim grek), Athinë 1997. Botimi i përmendur, që tani kemi në tryezë, ndryshon nga moria e botimeve të mëparshme nga tri pikëpamje - trajton nga pikëpamja kohore në mënyrë integrale historinë e Epirit gjatë 4000 vjetëve; e dyta, në të kanë marrë pjesë autorë ndoshta më të shquarit e historiografisë greke të ditëve tona; e treta, nga pikëpamja e përgjegjësisë shkencore, politike e morale mban vulën e Akademisë së Athinës, e cila pavarësisht nga emri që mban, është Akademia e Shkencave jo e Athinës, por e Greqisë”.*

Dhe më tej profesor Kristo Frashëri vazhdon: *“Ne kemi pritur që me dobësitë e kësaj periudhe të merren historianët shqiptarë të specializuar në problemet e historisë së lashtë të Epirit. Arsyerja përse ata heshtin është puna e tyre”.*

Po çfarë përmban në thelb ky libër? Ka tjetërsuar përkatësinë etnike të Epirit nga pellazgo-iliro-shqiptare, sipas autorëve të antikitetit, në helene, në kundërshtim me të gjithë autorët antikë që kufirin verior të Helladës e vendosnin në jug të Gjirit të Artës (Ambraqisë), kurse deri në fillim të shekullit XX, në të gjitha hartat dhe dokumentet evropiane, përfshi dhe disa autorë helenë quhej Shqipëria e Poshtme.

Gjithashtu edhe Dodona pellazge është tjetërsuar në helene, madje duke e vendosur dhe në vendin e gabuar. Në këtë hapësirë Akademia e Athinës pretendon kulturë dhe qytetërim helen që prej 4 mijë vjetësh, duke i hapur rrugën qeverisë së Athinës ta pretendojë këtë hapësirë si territor të saj, pretendim të cilit nuk i është larguar as në ditët e sotme, duke mbajtur në fuqi “Ligjin e Luftës” me Shqipërinë. Përballë këtij provokimi kaq të rëndë kanë heshtur institucionet shkencore të trojeve shqiptare. Kanë heshtur dy institucionet shkencore të Tiranës: Akademia e Shkencave dhe Akademia e Studimeve Albanologjike; dy institucionet shkencore të Prishtinës: Akademia e Shkencave dhe Instituti Albanologjik, si dhe në Shkup Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Po nëse heshtin institucionet shkencore të këtyre vendeve, që paguhen nga shtetet përkatëse për të folur, nuk ka heshtur, akademiku Flori Bruqi, si anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve, i cili në shkrimin studimor: “Vendndodhja e Dodonës pellazge” që është një përgjigje shkencore kundër Akademisë së Athinës, ka argumentuar qartësisht se Dodona në dimensionin e saj historik ka kaluar nga pellazge në ilire dhe nuk mund të tjetërsohet nga pellazge në helene, kur kufiri midis Helladës dhe Epirit ka qenë i pandryshur me Gjirin e Artës (Ambra-qisë) përgjatë gjithë historisë dhe që më vonë ky vend është quajtur Shqipëria e Poshtme. Akademiku Flori Bruqi me krijimtarinë e tij të gjithanshme, në disa fusha, ka mbetur një luftëtar i vijës së parë në mbrojtje të identitetit tonë kombëtar, ka përballuar me guxim lakmitë shoviniste të fqinjëve tanë, duke sjellë një letërsi cilësore dhe një mendim shkencor...

## NJË PLAGË E HAPUR QË S'PO GJEN DOT SHËRIM

(Referim rreth librit “*Dëshmi të krimit të pandëshkuar*” të autorit *Flori Bruqi*)

**Nga Akademik Prof.dr. Eshref Ymeri**

Libri i akademikut Prof.dr. Flori Bruqi, me titull “Dëshmi të krimit të pandëshkuar”, që doli nga shtypi këto ditë dhe që po vihet në dorën e lexuesve, shërben si një “ekranizim” i fateve të popullit shqiptar të Kosovës në veçanti dhe të mbarë kombit shqiptar në tërësi. Ai është dëshmi e gjallë e tragjizmit të fqinjësisë së kombit shqiptar me kombin serb, i cili, gjatë një harku kohor prej më shumë se një shekull e gjysmë dhe deri në ditët tona, në qëndrimin ndaj kombit shqiptar, ka nxjerrë nga gjiri i vet tufa të tëra egërsirash politike, me nxitjen dhe me mbështetjen e fuqishme të akademikëve të krimit dhe të kishës kriminale serbe. Këta akademikë të krimit, autori i ka nxjerrë lakuriq në faqet e këtij libri. Këto egërsira politike serbe me prejardhje ruse, Perëndimi evropian i ka pasë trajtuar gjithmonë me tërë përkujdesjen e vet, çka solli si pasojë që edhe në fundin e shek. XX, t'i lejojë të organizojnë atë kasaphanë të tmerrshme kundër popullit boshnjak dhe kundër popullit shqiptar të Kosovës.

As në kohët e largëta të inkuizicionit mesjetar nuk kanë pasë qenë organizuar masakra të atilla, si ato që egërsirat politike serbe organizuan në Bosnjë dhe në Kosovë.

Nëse Perëndimi evropian do të jetë në gjendje që, në shekujt pasardhës, të nxjerrë ndonjëherë nga radhët e veta mendje të ndritura, që do të kenë si yll karvani vetëm të vërtetën, kam bindjen se banjat e tmerrshme të gjakut që egërsirat politike serbe organizuan në Evropën Juglindore në

fundin e shek.XX, ato do t'i vlerësojnë si një damkë turpi në ballin e qytetërit evropian.

Skenat e masakrave të tmerrshme që përshkruhen në faqet e këtij libri, janë tej përfytyrimit të mendjes njerëzore: njerëz të pafajshëm të të gjitha moshave, deri te fëmijët e vegjël, të masakruar, të përçudnuar, të vrarë dhe të groposur në varre masive, të djegur me benzinë, të karbonizuar nëpër kontejnerë fabrikash, të mbyllur nëpër kamionë frigoriferikë dhe të flakur në lumin e Danubit, nuk do t'i trajtonin në këtë mënyrë as tigrat e egër që enden pyjeve dhe brigjeve të Amurit siberian në kulmin e urisë së tyre shtazore në piskun e dimrit. Kur u njoha me ato skena të tmerrshme krimesh në përshkrimin e akademikut Flori Bruçi, kujtesa me çoi larg.

Së pari, më erdhi ndër mend një artikull i Mihal Grame-nos, me titull “Gjakpirësit, katilët dhe vandalët”, i botuar në gazetën “Koha” më 17 prill 1914. Autori shkruante:

“Vetëm prej një kombi barbar, i cili jeton për turp në shekullin e 20-të në Evropë, mund t'i tregojë botës së qytetëruar barbarizmin e tij të pashembullt dhe të veprojë vandalizmat që ngjanë në Korçë dhe ngjasin në Shqipëri të jugës! Dhe ky komb s`mund të jetë veçse kombi grek. Një komb, i cili është gatuar nga llojish lëngërash nuk mund të kuptojë ç`domethënë turp dhe njerëzim, se ay është bërë për gjakpirësi, për katillëqe dhe për vandalizma! Kurrë nuk besojmë të gjendet njeri, i cili të shkruajë historinë e ngjarjeve të fundit në Korçë e të tregojë hollësisht shkaktarët e kësaj lëvizjeje, meqenëse shkaktare e vërtetë e kësaj lëvizjeje është qeveria greke, e cila deshte që t'i përvëlonte e t'i shuante vendet e Toskërisë nga faqe e dheut dhe programin e saj e tregoi fort bukur se ka afër



një mot që kur konferenca e Londrës vendosi kufinj të e Shqipërisë, por qeveria greke vendosi të shpërndajë armë...

Gjithë lufta që u bë në Korçë ishte organizuar nga Greqia me oficerë dhe ushtarë grekë... që të mbushnin qëllimin e poshtër dhe barbar e të rrëzojnë themelimin e Shqipërisë...” (Citohet sipas: Kastriot Dervishi. “Të mos harrojmë atë që na kanë bërë dhe atë që po na bëjnë grekët”. Faqja e internetit “Forumi shqiptar”. 07 maj 2007).

Së dyti, m'u kujtuan krimet e bishave fashiste greke në Çamëri dhe m'u fanit testamenti i egërsirës me fytyrë njeriu Napoleon Zerva: “Vdes i qetë se bëra atë që doja. Pas lashë rrëke gjaku, tym, blözë, gërmadha, ulërima fëmijësh, nuse dhe gra të zhveshura, që futeshin në furrat e ndezura, që të mos pillnin më shqiptarë, burra të varur, shpuar me bajonetë, gjuha shqipe nuk do të flitet më në tokën helene. Kjo më kënaq mua, ashtu siç kënaq tërë shpirtrat helenë!”. (Citohet sipas: “Ja amaneti që la Napoleon Zerva, gjenerali famëkeq që masakroi qindra shqiptarë”.

Akademiku Flori Bruqi nxjerr në pah rolin e pazëvendësueshëm që luajtën Shtetet e Bashkuara të Amerikës për shpëtimin e popullit shqiptar të Kosovës nga shfarosja masive që kishin planifikuar egërsirat politike serbe, duke zbatuar planin e tyre barbar me emrin “Patkoi”, sipas të cilit duhet të kryhej spastrimi tërësor etnik i territorit, kurse banorët që mbeteshin të fshehur nëpër male, duhej të shfaroseshin krejtësisht.

Jo vetëm populli shqiptar i Kosovës, por mbarë kombi shqiptar, duhet t'i jetë mirënjohës në jetë të jetëve Presidentit Klinton (Bill Clinton- 1946), Kryeministrit Britanik Toni

Bler (Tony Balir - 1953), Sekretares së Shtetit Medlin Ollbrajt (Madeleine Albright – 1937) dhe Kryekomandantit të forcave të NATO-s Uesli Klark (Wesley Clark -1944), nderimi ndaj të cilëve e meriton të përjetësohet me shtatore hijerënda që duhet të ngrihen në kryeqendrat e trojeve tona etnike.

Roli parësor i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në përgatitjen e bombardimeve kundër Serbisë, ishte i padiskutueshëm. Ndërkohë, ka pasur një kundërshtim të heshtur të Perëndimit evropian, sidomos të Francës, por edhe një stepje të ministrit të jashtëm anglez kundër fillimit të bombardimeve, çka dëshmohet fare qartë në një intervistë të gjeneralit rus Leonid Ivashov (1943), ish-këshilltar ushtarak i Kryeministrit Çernomëjrdin (1938-2010), dhënë revistës “Itogi” dhe botuar në faqen e internetit “[rusmir.info](http://rusmir.info)” të datës 27 gusht 2010.

Ndërhyrja e NATO-s, përmes bombardimeve të Serbisë për çlirimin e Kosovës, ishte një leksion me një prapavijë tepër domethënëse për shovinizmin rusomadh, armikun e betuar të kombit shqiptar, mbështetësin e paturpshëm të pjellës së vet të përbindshme serbe, shovinizmit serbokriminal.

Në këtë libër, akademik Bruqi hedh dritë edhe mbi qëndrimin e theksuar antishqiptar të Prokurores së Tribunalit të Hagës Karla del Ponte (Carla Del Ponte - 1947), për të cilën avokati anglez i Ramush Haradinajt Ben Emerson (Ben Emmerson - 1963) ka ngulur këmbë që ajo t'i kërkojë falje Haradinajt për akuzat e rreme që pati ngritur kundër tij. Ishte pikërisht po kjo Karla Del Ponte, e cila, armiqësinë e vet kundër popullit shqiptar të Kosovës dhe veçanërisht kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e pati shpalosur paturpësisht

me gënjeshtër të pafundme në faqet e librit të vet me titull “The Hunt: Me and the War Criminals” (Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës), në italisht “La caccia: Io e i criminali di guerra”, të botuar në vitin 2008.

Libri i Karla Del Pontes ishte rezultat i vizitave të saj të shpeshta në Beograd dhe i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Kremlinit, përmes Kryetarit të Komitetit të Këshillit të Federatës Ruse për Marrëdhënie Ndërkombëtare Konstantin Kosaçov (1962). Ishte pikërisht ky Kosaçovi që vuri në lëvizje edhe anëtarin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Dik Marti (Dick Marty - 1945), i cili e çoi edhe më tej shpifografinë e Karla Del Pontes, me akuzën kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për gjoja trafikim organesh të serbëve të vrarë. Pra, në Perëndimin evropian po synohej që kriminelët serbë të shndërroheshin paradoksalisht në viktima.

Në faqet e librit jepet një listë e tërë krimesh dhe kriminelësh, e cila është siguruar pas një pune të pandërprerë hulumtuese, gjatë së cilës autori ka shfrytëzuar më shumë se 200 burime të mediave vendase dhe ndërkombëtare. Kjo është një punë me të vërtetë heroike që ka kryer autori i këtij libri, të cilën jo dokushdo mund ta përballojë për të nxjerrë në dritën e diellit kaq shumë të vërteta tragjike.

Në të njëjtën kohë, të bëjnë përshtypje dhe të tronditin thellë faktet që sjell akademiku Flori Bruqi për përpjekjet e gjithanshme që bëri regjimi kriminal i Millosheviçit (1941-2006) për fshehjen e gjurmëve të kimit. Por fshehja e atyre gjurmëve vazhdoi po në atë mënyrë edhe kur Millosheviçi u rrëzua nga pushteti, përfundoi i prangosur në Tribunalin e Hagës dhe deri sa iku në botën e përtejme. Nuk mund të

ndodhë ndryshe që kjo fshehje e atyre krimeve vazhdon edhe në ditët tona, sepse pushtetin politik në Beograd e trashëguan bashkëpunëtorët e ngushtë të Millosheviçit që janë në krye edhe sot e gjithë ditën. Prandaj krimet e egërsirave politike serbe ndaj popullit shqiptar të Kosovës, vazhdojnë të mbeten ende të pandëshkuara. Dhe Perëndimi evropian vazhdon të heshtë. Madje po përgatitet ta pranojë Serbinë në radhët e Bashkimit Evropian. Këtë qëndrim shpërfillës ndaj krimeve të bishës fashiste serbe në Kosovë, Perëndimi evropian e manifeston në qëndrimin e tij jo vetëm ndaj popullit shqiptar të Kosovës, por edhe ndaj kombit shqiptar në tërësi. Ky qëndrim shpërfillës doli më shumë në pah edhe gjatë krizës së fundit në Maqedoni dhe në Shqipëri, kur Bashkimi Evropian u tërhoq përfundimisht nga zgjidhja e saj. Madje ambasadorja gjermane, e shtetit më me peshë në Bashkimin Evropian, Susanne Schütz, deklaroi para do kohësh pa iu dridhur qerpi-ku: *“Edhe nëse PD nuk hyn në zgjedhje ne do t'i njohim”* (Citohet sipas: *Ambasadorja gjermane: Do t'i njohim zgjedhjet edhe pa PD*). Nga faqja e internetit e gazetës “Shqiptarja.com”. 02 maj 2017).

Kjo ishte një deklaratë jo vetëm absurde, por edhe skandaloze, e cila, po të mos kishte ndërhyrë Departamenti i Shtetit me përfaqësuesin e vet që dërgoi në Tiranë dhe në Shkup, do të kishte bërë që situata të përcillej me pasoja të rënda, që mund të shoqëroheshin edhe me shpërthimin e luftës civile, si në Shqipëri, ashtu edhe në Maqedoni. Ja, ky është Perëndimi evropian në qëndrimin ndaj kombit shqiptar. Ky është pikërisht po ai Perëndim evropian që soditi me aq shpërfillje vrasjen dhe groposjen në një varr masiv të 8 000

njerëzve të pafajshmën në Srebrenicë në verën e vitit 1995, një gjenocid i tmerrshëm ky në fundin e shek. XX, në kryerjen e të cilit, përveç bishave fashiste serbe, morën pjesë edhe kriminelë me damkë, të ardhur si vullnetarë nga Rusia dhe nga Greqia.

Tepër prekëse janë faqet e librit që autori ia kushton figurës emblematike të popullit shqiptar të Kosovës, intelektualit të shquar të mbarë kombit shqiptar, Ukshin Hotit, i cili në themel të filozofisë së tij politike kishte ribashkimin e trojeve tona etnike. Të tmerruar nga një filozofi e tillë politike e këtij Prometeu shqiptar, egërsirat politike serbe bënë çmos që Ukshin Hotin ta zhdukim pa lënë asnjë gjurmë. Për këtë hero të kombit shqiptar, akademiku Flori Bruqi ka përfshirë në faqet e këtij libri mbresa të personaliteteve të shquara të kulturës shqiptare, si Ismail Kadare, akademik Esat Stavileci, Prof.dr. Agim Vinca, Dritëro Agolli, akademik Bedri Dedja, Adem Demaçi, akademik Rexhep Qosja dhe dr. Moikom Zeqo.

Më kanë bërë përshtypje të jashtëzonshme ca mbresa mjaft të goditura të Ismail Kadaresë për Ukshin Hotin. Siç thekson autori i librit, në një intervistë që Kadarea ka dhënë në vitin 1996, ka deklaruar: *“... e vetmja gjë që për mua ka qenë e qartë sapo kam lexuar fragmentet e para ngamendimet e tij, ka qenë përgatitja e lartë profesionale. Kam frikë se pikërisht ky nivel i lartë ka qenë edhe burimi i fatkeqësisë që e ka ndjekur hap pas hapi këtë martir. Ka qenë tragjedi e vjetër... e shqiptarëve, përpjekja për të mënjanuar nga udhëheqja e një lëvizjeje, e një populli apo shteti, njerëzit më të zotë. Kur mungon tigri, majmuni bëhet mbret, - thotë një proverb kinez.*

*Kjo logjikë e mbrapshtë, logjika e triumfit të mediokritetit, i ka shkaktuar, e, me sa duket, do t'i shkaktojë ende dëme të ndjeshme çështjes shqiptare... Më fort se kurrë kombi shqiptar ka nevoj për njerëz të aftë e me nivel të lartë.. Njerëzit e zotë janë princat e vërtetë të një kombi. Për fat të keq, princat goditen shpesh në mënyrë të vdekshme”.*

Këto fjalë e detyrojnë lexuesin të përsiatë paksa për atë që ka ndodhur dhe po vazhdon të ndodhë me fatet e kombit shqiptar, në radhët e të cilit nuk vlerësohen dhe nuk nderohen njerëzit e aftë dhe me nivel të lartë, sipas logjikës së triumfit të mediokritetit, siç flet dhe qëllon në shenjë Kadarea. Sepse mediokriteti është një tokë pjellore për lulëzimin e djallëzisë, e gënjeshtërsë, e hajdutërisë, e hilesë, e hipokrizisë, e imoralitetit, e karrierizmit, e mashtrimit, e mercenarizmit, e pabesisë, e pasurimit pa djersën e ballit, e përçarjes, e smirës, e spiunllëkut, e tradhtisë etj.

Sundimi gati katërshekullor otoman figuron si një njollë e errët në ekranin e historisë sonë kombëtare. Vetëm aty nga fundi i viteve '40 të shek. XIX patën shpërthyer ca kryengritje në jug kundër Reformave të Tanzimatit, pra, kundër taksave të reja që pati vendosur asokohe Porta e Lartë, dhe asgjë më tepër. Ndërkohë, fqinji ynë jugor kishte gati njëzet vjet që kishte fituar pavarësinë, kurse në katër vilajetet shqiptare s'kujtohej kush për çlirimin nga zgjedha otomane. Vetëm në gjysmën e dytë të shek. XIX, disa pena të shquara dhe figura politike hodhën themelet e Rilindjes Kombëtare që çuan në krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Por edhe gjatë zhvillimit të punimeve të saj, shqiptarët nuk folën me një zë, ishin të përçarë: disa ishin për autonomi, disa ishin për

pavarësi nga perandoria otomane. Në ato kushte, Lidhja e Prizrenit nuk qe në gjendje të merrte në dorë fatet e vendit dhe të jepte kushtimin, sidomos pas vendimeve kriminale të Kongresit famëkeq të Berlinit për fillimin e copëtimit të trojeve tona etnike, të krijonte forcat e armatosura dhe të nxirrte në krye një prijës me autoritet mbarëkombëtar, siç ndodhi në Greqi, prandaj edhe dështoi dhe u shtyp nga perandoria otomane.

Vendi fqinj i përtejdetit nxori në skenë Garibaldin (Giuseppe Garibaldi - 1807-1882), i cili, pas betejash të shumta, arriti, më në fund, që të krijojë një shtet të bashkuar italian më 17 mars 1861. Në testamentin për brezat pasardhës, Garibaldi ka shkruar: “Unë po lë trashëgim dashurinë time për lirinë dhe për të vërtetën dhe urrejtjen time për gënjeshtrenë dhe për tiraninë”.

Viktor Hygoi (Victor Hugo 1802-1885) ka bërë këtë vlerësim për Garibaldin: “Ç’është Garibaldi? Njeri. Asgjë më shumë. Por njeri në kuptimin më të lartë të kësaj fjale. Njeri i lirisë, njeri i natyrës njerëzore. A ka ushtri? Një grusht vullnetarësh. A ka municione? Nuk ka. Vetëm disa fuçi baruti. Armët ia ka rrëmbyer armikut. Po ku qëndron forca e tij? Çfarë ia siguron fitoren? Çfarë qëndron në mbrojtje të tij? Shpirti i popujve”.

Vendi ynë asokohe, për fat të keq, nuk qe në gjendje të nxirrte në skenën e historisë një “Garibald” shqiptar.

Po ashtu, Bismarku (Otto von Bismarck - 1815-1898), të cilin e kanë quajtur “kancelar i hekurt”, pas betejash të përgjakshme, arriti të realizojë bashkimin e Gjermanisë më 18 janar 1871. Një aforizëm i tij për lirinë, e meriton të

shkruhet me shkronja të arta:“Liria është një luks, të cilin mund t'ia lejojë vetes jo dokushdo”.

Përçarja ka qenë shoqëruesja e përhershme tragjike e kombit shqiptar. Faik Konica thotë se Shqipërinë e ka shpëtuar rastësia. Nuk dihet se si do të kishin rrjedhur ngjarjet, sikur Ismail Qemali të mos kishte ngrënë atë dackën në parlamentin turk: vallë a do të kishte dalë ndokush tjetër që të ndërmernte nismën për shpalljen e pavarësisë? Në Kuvendin e Vlorës, pas shpalljes së pavarësisë nga Ismail Qemali, në praninë e përfaqësuesve nga të gjitha trojet etnike, menjëherë duhej të kalohej në krijimin e forcave të armatosura.

Vendimet kriminale të Konferencës së Londrës për copëtimin e trojeve tona etnike, duhej të kishin shërbyer si një kushtrim, si një sinjal alarmi për të ngritur më këmbë të madh e të vogël, që nga Arta e Preveza e deri në Tivar. Fatkeqësisht, nuk u lëshua kurrfarë kushtrimi, kurrfarë thirrjeje për një kryengritje mbarëshqiptare dhe punët morën drejtimin që dihet. Përçarja ndërshqiptare e bëri të vetën.

Lulëzimin më të shkëlqyer, mediokriteti që thekson Kadarea, e arriti në periudhën e diktaturës komuniste, kur u zhdukën rrënjët e nacionalizmit shqiptar dhe në vitet '80 të shek. XX vendi ynë arriti në nivelin më skandaloz të varfërisë, saqë mbarë Perëndimi evropian e tregonte me gisht. Mediokriteti ka vazhduar të lulëzojë edhe pas ndërrimit të sistemit komunist, kur në Kuvendin e Shqipërisë, kanë zënë dhe vazhdojnë të rrinë në ndenjëset e tij mediokër të të gjitha niveleve, me përjashtim të një pakice nga të dy krahët që shfaqet herë pas here në folëtoren e tij. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Kosovë, ku mediokriteti ka lulëzuar dhe vazhdon të



lulëzojë në qejfin e vet.

Murat Jashari i është drejtuar me 104 pyetje ish-Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ish-ministrit të mbrojtjes në qeverinë e përkohshme të Kosovës Azem Syla (1951). Kam shkëputur vetëm tri pyetje me një kuptim mjaft domethënës: “Pse nuk i keni dërguar në vend dy snajperë të bardhë të kalibrit 338, të cilët unë t’i dorëzoja, një për Komandant Kumanovën (Ismet Jasharin) dhe një për Flamurin (Gafurr Elshanin)? Komandant Kumanova dhe Flamuri m’i kanë kërkuar ata snajperë për të vrarë komandantë të pushtuesit serb e jo që ju, po me ata snajperë, t’i vrisnit ushtarët më të mirë të lirisë. A ishte kështu? Zotëri, detyrën dhe rolin e kujt e keni kryer kundër popullit tuaj, ju me mafien e Drejtorisë Politike dhe të Kryesisë së PDK-së? (Citohet sipas: “Vëllai i Ismet Jasharit, komandantit “Kumanova”, me 104 pyetje për Azem Sylën”. Faqja e internetit e gazetës “Bota Sot”. 20 janar 2016).

Ja, pra, çfarë bën në Kosovë mediokriteti që stigmatizon Kadarea: vret ushtarët më të mirë të lirisë, që të lulëzojë mercenarizmi, tradhtia në shërbim të Beogradit.

Disa faqe të librit, në krye të të cilave është vënë titulli “Monumenti kulturor i Millosheviçit”, akademiku Flori Bruqi ia kushton kishës serbe “Sveti Spas” (Krishti Shpëtimtari”) në oborrin e Universiteti të Prishtinës. Ajo kishë u ndërtua arbitrarisht gjatë viteve '90, kur Kosova ishte e pushtuar nga kolonizatorët serbë, me të vetmin qëllim që t’i zinte frymën Universitetit të Prishtinës, duke ndërhyrë në një mënyrë të jashtëligjshme në sistemin kadastral të atij universiteti dhe duke zaptuar një sipërfaqe të përgjithshme

prej 4.27 hektarë. Lind pyetja: si duhet vepruar me këtë ndërtim të paligjshëm? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, po përcjell paraprakisht një informacion nga Beogradi: “Një xhami shqiptare që gjendej në Beograd është rrëzuar në mëngjesin e sotëm. Kjo xhami në Zemun të Beogradit, sipas autoriteteve, u rrëzua për shkak të lejes së ndërtimit” (Citohet sipas: “Rrëzohet xhamia shqiptare në Beograd”. Faqja e internetit e gazetës “Zëri”. 26 maj 2017).

Pra, xhamia shqiptare në Beograd u rrëzua se ishte ndërtuar pa leje. Po atëherë edhe kisha serbe që është ndërtuar në një mënyrë të jashtëligjshme para Universitetit të Prishtinës, pse nuk rrëzohet nga autoritetet vendore të Prishtinës? Përgjigjja është e thjeshtë:

Xhamia shqiptare u rrëzua në Beograd se Serbia ka në krye të shtetit burra të politikës, kurse kisha e paligjshme sebe para Universitetit të Prishtinës nuk mund të rrëzohet se Kosova ka në krye të shtetit lepuj të politikës.

Me këtë rast, akademiku Flori Bruqi, me një elegancë intelektuale, pa bërë asnjë koment të vetin, e nxjerr tërësisht zbuluar presidentin Hashim Thaçi kur ishte kryeministër, lidhur me qëndrimin e tij ndaj kishës së paligjshme serbe. Ai shkruan: “Në një emision të Radio Kosovës, Kryeministri Hashim Thaçi, i pyetur për objektin e ngritur pa leje të kishës ortodokse serbe në ambientet e Universitetit të Prishtinës, e ka quajtur atë një vepër të shëmtuar. Ai ka thënë se kjo kishë, në fakt, është monument i Slllobodan Millosheviçit. Por kur është pyetur se cili duhet të jetë fati i saj, kryeministri ka dhënë një përgjigje diplomatike: *“Kemi punë më të mëdha për të bërë, por do t'i vijë radha edhe asaj”*”.

Interesante! Por autoritetet e Beogradit nuk pritën sa të bënin “*punë më të mëdha*”, por e shembën menjëherë xhaminë shqiptare që qe ngritur pa leje.

Pra, në sytë e popullit shqiptar të Kosovës, Thaçi mundohet ta reklamojë veten si “*atdhetar*”, ndërsa kur i kërkohet mendim se si duhet vepruar me atë kishë të paligjshme, ai zbulon servilizmin dhe mercenarizmin e tij ndaj Beogradit. Sepse servilizmin dhe mercenarizmin e vet ndaj Beogradit ai e ka faktuar shumë herë me lëshimet skandaloze që i ka bërë shovinizmit serb, në bashkëpunim të ngushtë me Isa Mustafën dhe me Edita Tahirin, që prej 19 prillit të vitit 2013 dhe deri tani.

Mercenarizmit dhe tradhtisë së treshes Thaçi-Mustafa-Tahiri, ia nxjerr bojën përfundimisht Aleksandër Vuçiqi, i cili para do kohësh ka deklaruar për një marrëveshje të arritur në Bruksel. Në një informacion, të botuar në faqet e internetit, thuhet: “*Aleksandër Vuçiq ka lavdëruar marrëveshjet e arritura në Bruksel, ndërmjet Qeverive të Serbisë dhe asaj të Kosovës*”.

Ai ka deklaruar: “*Ne e morëm vendimin që të gjithë punonjësit e policisë të jenë të nacionalitetit serb, dhe se asnjë polic shqiptar të mos vërë këmbë në Veri të Kosovës*” (Citohet sipas: “*Vuçiq: Marrëveshja e Brukselit është që asnjë polic shqiptar të mos shkelë në veri të Kosovës*”).

Pas kësaj ndërhyrjeje të Vuçiqit në mjetet e informimit masiv, ka reaguar Edita Tahiri, e cila ka deklaruar: “*Serbia duhet ta heqë sëmundjen e nacionalizmit*” (Citohet sipas: “*Edita Tahiri demanton Vuçiqin: zëvendës drejtori i policisë në Veri është shqiptar*”).

Ministrja e dialogut kot e akuzon Serbinë dhe Vuçiqin për nacionalizëm! Sikur Serbia dhe Vuçiqi të ishin nacionalistë, ata meritojnë nder dhe respekt, sepse nacionalizmi është mbrojtje me dinjitet e vlerave kombëtare, e gjuhës dhe e trashëgimisë kulturore. Por as Serbia, as Vuçiqi dhe as mbarë kopeja e egërsirave politike serbe, nuk kanë qenë, nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë nacionalistë në qëndrimin ndaj Kosovës. Ata kanë qenë, janë dhe do të vazhdojnë të jenë vetëm shovinistë të egër, sepse në kushtetutën serbe Kosovën e konsiderojnë pjesë të territorit të Serbisë. Se jo më kot kryepeshkopi Irinej, komisar politik i udhëheqjes serbe, ka deklaruar se Serbia do të kthehet në Kosovë, qoftë edhe pas dy mijë vjetësh. Por është për të vënë duart në kokë që treshja pa dinjitet kombëtar Thaçi-Mustafa-Tahiri, në bazë të marrëveshjeve që ka nënshkruar me Beogradin në Bruksel, në heshtje dhe në fshehtësi nga populli shqiptar i Kosovës, Mitrovicën e Veriut e konsideron territor serb. Mirë do të ishte që ministrja e dialogut të thellohej në kuptimin leksikor të fjalëve “nacionalizëm” dhe “shovinizëm”, në mënyrë që të bindej se çfarë dallimi të thellë kanë ato nga njëra-tjetra.

Mjaft interes ngjallin faqet e librit, ku autori shtron pyetjen: “*A do të bashkohen shqiptarët në një shtet?*”.

Çështja e ribashkimit të trojeve tona etnike vazhdon të mbetet e ankthshme që asokohe kur Perëndimi evropian, nën diktatin e shovinizmit rusomadh, i copëtoi në mënyrën më barbare nga trunghi amë. Kjo Çështje Madhore e kombit shqiptar kërkon zgjidhje, kërkon zhbërjen e padrejtësisë që atij iu imponua me dhunë nga fuqitë e mëdha evropiane.

Akademik Flori Bruqi ka parashtruar në faqet e këtij librit

ecurinë e kësaj Çështjeje, me një nëntekst të qartë: kombit shqiptar duhet t'i kthehet borxhi që i është marrë më shumë se një shekull më parë.. Kërkesa për kthimin e atij borxhi ushton në vargjet poetike, në këngët e artistëve të talentuar apo në intervista dhe artikuj publicistikë. Ja ç'vargje ka hedhur në letër Princi i Polifonisë Lefter Çipa: *Ne s'kemi ëndërr të madhe, / Aq sa hap krahët shqiponja, / Shqipërinë Natyrale, / Katër vilajetet tona.*

Politikanët shqiptarë, këta servilë të regjur të Beogradit, të Athinës dhe të Brukselit, politikanë pa dinjitet kombëtar, le të kërkojnë në youtube këngën me titull “Kurrë s'i ndan shqiptarët kufini”, një këngë kjo me vargje bubulluese që ekzekutohet aq mjeshtërisht nga këngëtarët e talentuar Marie Lajçaj dhe Pëllumb Vinca. Duke pasur parasysh vëllezërit tanë përtej kufirit të Shqipërisë Londineze, kënga ushton: *Na ndan zjarri e na ndan pragu, / na bashkon gjuha dhe gjaku. / Trojet thrasin me një za: / Pa u bashku s'durohet ma, / Ka ardh koha që kem dasht, / Kangë e zemra me i ba bashkë. / Kurrë përjetë s'i qajmë do halle, / Për pa i thanë Shqipni e Madhe, / Pa na kthy borxhin Evropa / Që na ndau në copa-copa.*

Për të theksuar kotësinë e përpjekjeve të politikanëve shqiptarë për pranimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pa realizimin paraprak të ribashkimit të trojeve tona etnike, akademiku Flori Bruqi ka cituar Dritëro Agollin. Duke vlerësuar lart figurën e Ukshin Hotit për vënien në jetë të idealit të tij kombëtar për ribashkimin e trojeve etnike, Dritëroi ka deklaruar: *“Ne flasim e themi se do të hyjmë në Evropë, do të evropianizojmë Shqipërinë, etj. Të gjitha këto janë fantazira, janë gjysmake. Shqipëria*

*evropianizohet kur të jetë një, e plotë, dhe jo kështu dy copësh, se kështu nuk evropianizohet kurrë. Kë do të evropianizosh ti, tre milionë banorë do të evropianizosh? Po tre milionë të tjerë? Domethënë, problemi është tepër i ngatërruar për sa i përket evropianizimit të Shqipërisë, civilizimit të saj etj. Civilizim do të thotë kur të jesh një. Po s'qe një, nuk je i civilizuar plotësisht. Dhe Ukshini e trajton këtë problem”.*

Çështja kombëtare shqiptare vazhdon të mbetet e pazgjidhur. Ajo përbën një plagë të madhe që s'po gjen dot shërim për faj të politikanëve shqiptarë, të cilët i gënjen mendja se me servilizmin e tyre para Perëndimit evropian gjoja do të fitojnë simpatin e tij. Në të vërtetë, me qëndrimin e tyre pa dinjitet kombëtar, ata janë shpërblyer me përbuzjen e tij të heshtur.

Me botimin e librit të ri me titull “Dëshmi të krimit të pandëshkuar”, akademiku Flori Bruqi ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për ndriçimin e shumë të vërtetave tragjike për popullin shqiptar të Kosovës në veçanti dhe për kombin shqiptar në tërësi. Shumë nga këto probleme të mprehta që ai ka parashtruar në këtë libër-monument, duhej ta kishin shqetësuar me kohë e me vakt Akademinë e Shkencave në Tiranë dhe në Prishtinë dhe mbarë klasën politike shqiptare në trekëndëshin Tiranë-Prishtinë Shkup. Atyre u takonte t'i grumbullonin këto fakte tronditëse, të përgatitnin dosjet përkatëse, t'i përkthenin në gjuhët kryesore dhe t'ua nisnin kryeqyteteve të Perëndimit evropian, Brukselit, Departamentit të Shtetit, Kongresit dhe Senatit Amerikan dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që të zhvlerësonin tërësisht gjithë literaturën shpifografike kundër kombit shqiptar, me të cilën Beogradi dhe Athina kanë përmblytur

bibliotekat e institucioneve të lartpërmendura ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, kryepolitikantët shqiptarë le të mundohen që, të paktën, një herë të vetme në jetën e tyre, ta kësibëjnë nga vetja servilizmin para të huajve, të bëhen burra të politikës dhe, nga folëtorët e Brukselit, e Departamenti të Shtetit, e Senatit dhe e Kongresit Amerikan, deri në folëtorin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të ngrenë zërin për ribashkimin e trojeve tona etnike

Mendoj dhe propozoj që akademiku Flori Bruqi, në perspektivë, të përgatitë dhe të botojë një tjetër libër interesant, ku, me mjeshtërinë që e karakterizon, të trajtojë kodin moral të egërsisë grekoserbe përballë kodit moral të fisnikërisë shqiptare, në mënyrë që të dalë mirë në pah e vërteta se shqiptari, tradicionalisht, as hasmin e vet, as armikun që ia ka behur si pushtues, pasi e ka vvarë, nuk e ka pasur zakon ta poshtërojë, ta përçudnojë, ta groposë në varre masive, t'ia djegë kufomën me benzinë apo t'i përdhunojë vajzat dhe gratë dhe aq më pak të vrasë fëmijë, gra, pleq dhe plaka. Dukuri të tilla barbare kanë qenë dhe mbeten të papërfytyrueshme për kodin moral të fisnikërisë shqiptare. Por duhet të theksojmë se kodin e shëndetshëm të moralit fisnik shqiptar, na e ndoti keq krimineli Enver Hoxha, sipas urdhrave që merrte nga emisarët kriminalë jugosllavë gjatë viteve të luftës. Në një radiogram që i dërgonte Korparmatës I më 21 shtator 1944, ky kriminel dhe agjent i regjur i Beogradit, urdhëronte: “Zai Fundon ta torturoni deri në vdekje dhe pastaj ta pushkatoni” (Citohet sipas: Uran Butka *“Dokumenti, si u vra Lllazar Fundo me urdhër të Enverit”*. Faqja e internetit e gazetës “Panorama”.02 tetor 2014).

Kodin e egërsisë morale serbosllave, krimineli Enver Hoxha e praktikoi gjerësisht kundër përfaqësuesve të shquar të nacionalizmit shqiptar gjatë tërë periudhës së sundimit të tij dikatorial. Ndonjë shfaqje e shëmtuar e atij kodi moral barbar u vu re edhe në ngjarjet tragjike të vitit 1997, kur me kufomën e oficerit të vrarë të SHIK-ut Lek Qoku, tallej një turmë studentësh të ndërkryer në njërin nga auditoret e Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës dhe kur një femër e përbindshme mudohej t'i pinte gjakun.

Gjithsesi, akademiku Flori Bruqi, si një figurë e shquar me përgatitje enciklopedike, si një intelektual i nderuar erudit, e ka kryer dhe do të vazhdojë ta kryejë gjithmonë me nder detyrën e shenjtëruar para kombit shqiptar.

Nderim dhe respekt të thellë për këtë punëtor të palodhur të letrave shqipe me vlera të rralla shkencore, intelektuale.



NJË VEPËR PA KUFIZIME GJEOGRAFIKE DHE  
KOHORE TË LETRAVE TONA

**Nga Reshat Sahitaj**

Autori Flori Bruqi para lexuesit shqiptar paraqitet me librin e tij më të ri "Diademë letrare II", në të cilën vepër autori bën një studim shkencor lidhur me zanafillën e kritikës botërore e kryesisht asaj shqiptare, si dhe evoluimin e saj deri në ditët e sotme. Nihilizmi i Teki Dervishit Tanimë është e kuptueshme për secilin që merret me letërsi se kritika është studim, diskutim, vlerësim dhe interpretim i literaturës, e që autori Flori Bruqi përmes veprës së tij këto i zgjeron, duke hulumtuar në vepra të autorët klasikë e deri të kritikët bashkëkohorë, që të gjejë definicionin e saktë të kritikës, si dhe të kritikut letrar. Një kritikë letrare gjithnjë është e varur nga një kritik letrar dhe më të drejt autori Flori Bruqi librin e tij e hap me një thënie të shkrimtarit tonë tanimë të ndjerë, Teki Dervishit, kur thotë: "Nuk ekziston kritika e mirëfilltë letrare për arsye se nuk ekziston as letërsia e mirëfilltë", (f. 11, "Diademë letrare II". Kjo fjali e Teki Dervisht do ta shqetësojë Flori Bruqin, i cili do përpiqet me çdo kusht që të gjejë mesin e art, ngase nëse nuk ekziston kritika e mirëfilltë nuk ekzistuaa as letërsia e mirëfilltë dhe krijuesit do të pyesin vetën pse të shkruajnë romane kur nuk ekzistuaa roman i mirëfilltë. Edhe pse autori Flori Bruqi nuk pajtohet me thënien e Teki Dervishit, në nëntekstin e veprës së tij mund të vërehet se pjesërisht pajtohet më të kur ka parasysh kritikën që shkruhen në parathënie të librave, recensionet në gazetën tona të përditshme... ku vlerësimet e kritikëve nuk janë objektive,

nuk janë profesionale e madje disa prej tyre janë mediokre, klanore dhe të paguara, me ç'rast shkruan: "Shumica e shtëpi-ve botuese përbëhen vetëm nga pronari i saj e në të shumtën e rasteve nga një staf redaktorësh që vallëzojnë sipas xhepit të pronarit e jo sipas kritereve të vlerësimit profesional" (f. 38 "Diademë letrare II").

### **Kritika mbi kritikën**

Të analizosh një vepër që ekskluzivisht ka të bëjë me kritikë letrare, është puna më e vështirë, sepse para vetes ke një autor që ka bërë hulumtime të shumta rreth kësaj teme, ke një vepër tërësisht e mbushur me kritikë dhe vlerësime për autorë të ndryshëm, të cilat vepra duhet t'i kesh lexuar, në të kundërtën nuk ke bërë asgjë. Janë dy autorë për të cilët kam hezituar të shkruaj: Flori Bruqi dhe Prend Buzhala. I pari sqaron teorinë e kritikës letrare, gjykon për disa kritikë letrarë, duke i ngritur në pedestal si Rexhep Qosjen që i pari kishte thyer kritikën realizmit socialist në trevat shqiptare, duke e themeluar "kritikën shqiptare" e deri te Ibrahim Rugova si themelues i Hermeneutikës e strukturalizmit, pastaj merret me vlerësimin e autorëve të njohur botëror dhe atyre shqiptarë, ndërsa i dyti i ka botuar recensionet e tij, parathëniet për librat të autorëve vendorë me vlerësime për veprat e zgjedhura. Flori Bruqi nuk ngurron aspak t'i kritikojë ashpër disa vepra dhe disa autorë, ndërsa Prend Buzhala në shkrimet e tij ka vetëm vlerësime pozitive për autorët dhe veprat të cilat i ka trajtuar. Andaj, duke i krahasuar këta dy autorë dhe shumë autorë të tjerë shqiptarë dhe disa specialistë botërorë në fushës së kritikës, përsëri mund t'i kthehemi qëndrimit nihilist të Teki Dervishit, por që unë do ta formuloja më lehtë duke

thënë se nuk ekziston kritikë krejtësisht objektive. Bazuar në studiues të njohur të kritikës letrare e njëri prej tyre Jean Starobinski thotë: "... kritika është kulmi që zhvillohet si një njohuri, e specializuar dhe e denjë: të figurojë në rangun e disiplinave shkencore: e vepra kritike do shndërrohet në diskurs shkencor mbi atë objekt të veçantë që quhet literaturë".

### **Vlerësimi krijuesve të margjinalizuar**

Flori Bruqi në "Diademë letrare II" kapituj të veçantë di t'u kushtojë krijuesve tanë tanimë të afirmuar, siç janë Isamil Kadare, Aleksandër Xhuvani, Mehmet Kajtazi, Ramiz Kelmendi, Sterjo Sapse, Haki Stërmilli, Jusuf Gërvalla, si dhe të autorëve më pak të njohur për opinionin tonë. Specifika e veprës "Diademë letrare II" është se autori vë theks të veçantë krijimtarisë letrare të Jusuf Gërvallës për të cilin shumë pak kritikë tanë kanë shkruar dhe kur disa kanë shkruar e kanë trajtuar vetëm si dëshmor, si aktivist i çështjes kombëtare dhe i cili u vra padrejtësisht nga shërbimi sekret i Jugosllavisë duke e lënë pas krijimtarinë artistike të tij. Flori Bruqin jo vetëm që do e lartësojë aktivitetin patriotik të Jusuf Gërvallës, por para se gjithash shpreh revoltën e tij se si është e mundur që Jusuf Gërvallës t'i harrohet vlerësimi për veprën letrare, andaj thotë: "Opinionin e respekton dhe e adhuron dëshmorin e kombit, simbolin e luftës për liri, shembullin e kurajës prej qytetari dhe intelektual, ndërsa duket se e harron shkrimtarin e rëndësishëm që ishte dhe mbetet", (faqe 141 "Diademë letrare II"). Ata që e kanë njohur Jusuf Gërvallën e dinë se ai para se t'i rrezikohet jeta nga sistemi i asaj kohës dhe të ikte në Gjermani, ishte artist, këngëtar, poet, kritik dhe publicist, gjë

që "elita" letrare e pasluftës ende ka frikë t'ia përmendë emrin dhe veprat e Jusuf Gërvallës. Ekziston mundësia që bashkëkohorët e tij nga frika se Jusuf Gërvalla mos të radhitet në piedestal të letërsisë dëshirojnë që ta lartësojnë në aspektin kombëtar për t'ia zbehur aspektin artistikoletrar, për ç'gjë e lartëson Isamil Kadare, Sabri Hamiti dhe Myrvete Dreshaj-Baliu e ndonjë tjetër. Autori i veprës "Diademë letrare II" do t'u kushtojë rëndësi të veçantë jo vetëm analizave të poezive të Jusuf Gërvallës, por edhe në aspekte të tjera si: Jusuf Gërvalla këngëtar, Jusuf Gërvalla dramaturg, Jusuf Gërvalla shkrimtar... Në pjesën ku shtjellohet Jusuf Gërvalla si këngëtar, autori shkruan më simpatinë më të madhe që ndjen për Jusufin dhe këngët e tij. Madje autori rrëfen se si gjatë sistemit të okupimit bashkë më Fatime Llugiqin, Skender Tafaj dhe Shyqeri Galicën kishin dëgjuar dhe mbajtur kasetën me këngë të interpretuar nga Jusuf Gërvalla. Ndaj nuk ishte aspak e rastësishme kur një pjesë e repertuarit të këngëve të Jusufit u gjetën në arkivin e aktore Fatime Llugiqi e që u bënë të njohura për publikun tonë, sepse në arkivin e Televizion të Kosovës ato këngë ende nuk gjenden. Jusuf Gërvalla si shkrimtar, në "Diademë letrare II", të autorit Flori Bruqi, trajtohet romani "Rrotull" që u botua pas vrasjes së tij, ndërsa si dramaturg merret drama "Procesi" po ashtu e botuar postmortum. Në anën tjetër, autori Flori Bruqi nuk do ta injorojë krijimtarinë e Mehmet Kajtazit, siç ka shumë tendenca që ky autor të mos përmendet, sepse Mehmet Kajtazi jo vetëm që shquhej si krijues i denjë, por ai ishte edhe aktivist i Lëvizjes ilegale dhe kishte kontribuar shumë në aspektin kombëtar. Në fakt që nga paslufta e deri sot ekziston një rrymë e "elitës" letrare që t'i

zhvlerësojë, t'i injorojë, dhe t'i shuajë të gjithë krijuesit që paralelisht kontributit në letërsi, kontribuuan në çlirimin e Kosovës. Flori Bruqi është i vetëdijshëm se veprimtaria letrare e Mehmet Kajtazit nuk mund të injorohet e as të zhvlerësohet si "Nata në gur", "Shote Galica", "Minatorët" "Një diell tjetër", "Shqiptarët në Goli Otok" ..., ku në qendër të veprave të këtij autori janë: luftërat, varrtarët, nënat shamizeza, heronjtë, gjëmimet e rrufeve, zinë e riteve mortore...

### **Një vepër pa kufizime gjeografike dhe kohore të letrave tona**

Autori Flori Bruqi në "Diademë letrare II" nuk u ka vu pikë krijuesve, të cilët i ka trajtuar dhe mund t'i trajtojë, nuk ka vu pikë letërsisë shqiptare për ta kufizuar vetëm në një regjion, por atë e ka zgjeruar në tërë trojet shqiptare e madje edhe në diasporë, duke mos u kufizuar as në hapësirën kohore. Për letërsinë në diasporë, në "Diademë letrare II", vlerësimi i autorit është ky: "Edhe pse e zhvilluar në kushte të një izolimi gjeografik e ideologjik, fati dhe perspektiva e letërsisë bashkëkohore shqipe duhet vështruar në një kontekst dhe më të gjerë gjeografik, dmth. dhe përtej kornizës ngushtësisht nacionale. Pavarësisht nga zhvillimet brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe brenda viseve etnike si: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, kjo letërsi pati dhe njohu zhvillime edhe në diasporë" (f 207 "Diademë letrare II"). Zhvillimeve të letërsisë në diasporë Flori Bruqi do ta tërheqë një paralele që nga gjeneratat e para të autorëve, të cilët krijuan në diasporë deri të gjeneratat e sotme, siç merren shembull: Elvira Dones, Ornella Vorpsi, Besa Myftiu, Anilda Ibrahimit etj.

Autori Flori Bruqi e ankon fatin e krijuesve të cilët në vende të huaja janë bërë të njohur më romanet e tyre, kurse në atdheun e tyre injorohen krejtësisht. Fenomeni i injorimit dhe zhvlerësimeve të krijuesve dhe krijimtarisë së tyre madje të atyre që kanë arritur të botojnë edhe në shtëpitë më prestigjioze botërore si "Fayard", duhet të zhduket në viset shqiptare, shprehet në mënyrë indirekte Flori Bruqi. Vepra "Diademë letrare II" krijuesit e diasporës autori i ndan në dy kategori: në ata që të përkthyer nga shqipja në një gjuhë tjetër dhe ata që direkt shkruajnë në gjuhë të huaj. Si e para edhe e dyta ata janë krijues shqiptarë, e të cilët duhet të gëzojnë statusin e barabartë me krijuesit që jetojnë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni Mirëpo, afirmimi i tyre edhe në vendin e origjinës shkakton xhelozitë tek krijuesit e dobët të cilët i pengojnë të afirmuarit jashtë trojeve shqiptare, ngase fama e rrejshme e tyre do të zbehet në opinionin e brendshëm. Këta krijues të dobët që kanë arritur të krijojnë një opinion brenda atdheut, janë kundër atyre që gëzojnë famë ndërkombëtare si Besa Myftiu e të tjerët. Në këtë mes të shkrimtarëve jashtë atdheut, vetëm Isamil Kadarese nuk mundë t'ia mbyllin dyert, sepse të injorosh Kadarenë ke injoruar vetën dhe tërë popullin shqiptar. Libri "Diademë letrare II", është një vepër e cila duhet të lexohet nga të gjithë krijuesit shqiptarë, sepse mund të mësohen shumë jo vetëm për kritikën letrare, por edhe për disa personalitete shqiptare të cilët lanë gjurmë në kulturë, siç janë: Isamil Kadare, Bekim Fehmi, Rexho Mulliqi, Haki Stërmilli...

## ENCIKLOPEDIA E URREJTJES SERBE

*Libri “Shtëpia e Verdhe” i Flori Bruqit, si një dëshmi e urrejtjes së tillë*

**Nga Prof.dr. Eshref Ymeri**

Në vitin 2018, Shtëpia Botuese “Klubi i Poezisë” Tiranë, nxori nga shtypi dhe hodhi në qarkullim librin e akademikut prof.dr. Flori Bruqi, me titull “Shtëpia e Verdhe”.

Është një libër mjaft interesant, me një vëllim prej 350 faqesh, në të cilin gjen një pasqyrim të hollësishëm politika agresive e shovinizmit serb kundër kombi shqiptar. Autori, duke argumentuar me fakte, zbulon thelbin e politikës së kahmotshme serbe ndaj etnisë shqiptare: “Serbia e ka ngritur në doktrinë shtetërore zhdukjen e popullit shqiptar” (f. 9).

Në libër autori trajton disa tema nga historia e politikës agresive të shovinizmit serbokriminal ndaj popullit shqiptar të Kosovës.

Këtu do të ndalem në disa prej tyre. Rezultati i imazhit për shtëpia e verdhe. Libri hapet me temën “Nobelisti Ivo Andriç si antishqiptar”, në të cilën përshkruhen “telegrafisht” pikat kulmore të strategjisë shoviniste serbe kundërkombit shqiptar, duke filluar nga dokumenti sekret - Naçertania- e vitit 1844 që mbante firmën e Ilia Garashaninit dhe duke vazhduar me elaboratin e akademikut Ivo Andriç, mandej me elaboratin e akademikut Vasa Çubrilloviç e deri te Memorandumi 1 dhe 2, hartuar nga shkrimtari shovinist Dobrica Qosiç, akademik.

Pra, njëri nga doktrinarët e zhdukjes së popullit shqiptar, ka qenë shkrimtari shovinist Ivo Andriç, i cili, fillimisht, kishte hartuar një program për ndarjen e Shqipërisë, për çka ai

u ngrit deri në postin e ministrit të jashtëm. Programi i tij titullohej “Elaborati i Ivo Andriçit për Shqipërinë i vitit 1939”.

Ky shkrimtar shovinist, çuditërisht, në vitin 1961, paska fituar Çmimin Nobel. Çdo njeri me gjykim të kthjellët, kur merr vesh se ky shkrimtar shovinist na qenka nderuar me Çmimin Nobel në letërsi, nuk mund të mos shtrojë pyetjet e mëposhtme: Po si është e mundur që t'i jepej Çmimi Nobel një shkrimtari të tërbuar shovinist, i cili, në elaboratin e vet kërkonte shfarosjen e një populli tjetër?

A thua se është e besueshme që juria e Çmimit Nobel nuk e paska pasur indormacionin e duhur për jetëshkrimin e Ivo Andriçit dhe, konkretisht, për platformën e tij shoviniste kundër popullit shqiptar?

Është e pamundur që juria e Çmimit Nobel të ketë qenë e painformuar për platformën në fjalë të Ivo Andriçit. Ajo e pati nderuar atë shkrimtar shovinist se nuk ka pasë ushqyer kurrfarë respekti për popullin shqiptar dhe shfarosja e tij prej shovinizmit serbokriminal, nuk përbënte kurrfarë shqetësimi për të. Prandaj nderimi i Ivo Andriçit me Çmimin Nobel përbën një faqe të zezë në historinë e jurive të Çmimit në fjalë

.Por një tjetër faqe e zezë në historinë e jurive të Çmimit Nobel u shënua edhe në vitin 2019, kur juria e tanishme e nderoi me këtë Çmim edhe një tjetër shkrimtar shovinist, siç është shkrimtari austriak Peter Handke, mbrojtës i flaktë i krimeve të Millosheviçit kundër popullit shqiptar të Kosovës.

Në këtë mënyrë, juria në fjalë e damkosi përfundimisht veten me damkën e turpit, si një juri shoviniste në qëndrimin ndaj kombit shqiptar.



Akademik Flori Bruqi e sqaron lexuesin se shkrimtari shovinist Ivo Andriç e pati përgatitur elaboratin me kërkesë të kryeministrit dhe ministrit të jashtëm të Jugosllavisë Milan Stojadinoviç.

Pra, elaborati në fjalë zbulonte orientimin e politikës zyrtare të shovinizmit serbokriminal, në themel të së cilës shtroheshin pikësynimet për shfarosjen e popullit shqiptar.

Për arritjen e këtyre pikësynimeve, politika shoviniste serbe ka gëzuar përkrahjen e plotë të tri fuqive kryesore evropiane të kohës, siç ishin Anglia, Franca dhe Rusia.

Akademik Flori Bruqi citon nenin shtatë të Paktit të Londrës, të lidhur më 26 prill të vitit 1915 në mes Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe Rusisë, i cili kishtesi qëllim përfundimtar fshirjen e Shqipërisë nga harta e Evropës.

Në atë nen thuhej: “Nëse do të vinte deri te formimi i një shteti të vogël autonom e neutral i Shqipërisë, Italia nuk do t’i kundërvihej dëshirës së Francës, të Britanisë së madhe dhe të Rusisë që viset veriore dhe ato jugore të Shqipërisë të ndaheshin në mes Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë” (f. 22).

Autori përmend, po ashtu, edhe fjalët e Ivo Andriçit, i cili citon një deklaratë të kryeministrit francez Klemanso në Konferencën e Paqes të vitit 1919: “Duke propozuar një zgjidhje të përgjithshme të çështjes së Adriatikut, Klemanso, në cilësinë e kryetarit të Konferencës së Paqes, në lidhje me lëshimin e Rijekës Italisë, deklaroi më sa vijon: pra, sipas kësaj, shteti i S.H.S. (serbëve, kroatëve e sllovenëve) do të ngrihet në kulmin e fuqisë së vet, pasi t’i ketë në zotërim Shkodrën, Drinin dhe Shëngjinin” (f. 27-28).

Dihet me kohë që shovinizmi serb, gjatë mësymjes drejt

territoreve shqiptare në nëntor të vitit 1912, kur trupat sebe patën pushtuar krejt Shqipërinë Veriore dhe patën arritur deri në Tiranë dhe në Durrës, kishte si objektiv të siguronte një dalje në detin adriatik, dhe pikërisht në Durrës, sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër të vitit 1913.

Ky objektiv gjente përkrahjen e plotë të shovinizmit rusomadh, armikut tradicional të kombit shqiptar.

Prandaj, më 27 tetor (9 nëntor) 1912, në një telegram sekret që i dërguari rus në Beograd, N.G. Hartvig, i përcillte Ministrisë së Jashtme Ruse në Sankt Peterburg, thuhej:

“Për shkak të zgjerimit të ardhshëm të territoreve të të katër aleatëve, një Shqipëri autonome do të dukej si një anomali, si një vatër e përhershme trazirash, të cilat do të ngjallnin shqetësime për paqen në Ballkan...”

Shqipëria do të duhet të copëtohet mes Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë” (Citohet sipas librit: “Faktori shqiptar në zhvillimin e krizës në territorin e ish-Jugosllavisë. Dokumente. Vëll. i parë (1878-1997)”.

*Shtëpia Botuese “INDRIK”. Moskë 2006, f. 57).*

Menjëherë pas këtij njoftimi, vjen edhe reagimi i ministrit të jashtëm të Rusisë Sergej Sazonov. Në kujtimet e veta, ky ministër, si armik i betuar i kombit shqiptar, shkruan:

“Kuptohet vetvetiu se nga ana e Rusisë copëtimi i Shqipërisë mes ballkanasve, në thelb, nuk mund të haste në kurrfarë kundërshtimesh...”

Lejimi i Serbisë për të pasur një dalje në Adriatik, gjatë një periudhe të gjatë kohe, u shndërrua në një problem qendror të politikës evropiane, megjithëse në vetvete ai kishte një rëndësi thjesht të karakterit lokal...” (Sergej Dmitrijeviç

Sazonov. “Kujtime”. Shtëpia Botuese “Harvest”. Minsk 2002, f.77-79).

Një temë që meriton vëmendjen e veçantë të lexuesit, është ajo që akademik Flori Bruqi ia ka kushtuar kryeministrit serb Aleksandër Vuçiq. Ai e ka titulluar “Duart e përgjakura të Aleksandër Vuçiqit”.

Në trajtimin e figurës së Vuçiqit, autori ka meritën e veçantë se ka flakur tutje “vellon e moderimit” të kryeministrit serb, e cila i është veshur prej propagandës shtetërore, duke anashkaluar natyrën e tij kriminale në gjenocidin e ushtruar kundër myslimanëve në Jugosllavi dhe veçanërisht kundër popullit shqiptar të Kosovës.

Akademik Flori Bruqi i çjerr maskën Aleksandër Vuçiqit, si bashkëpunëtor i ngushtë i kriminelit Sheshel, kryetarit të Partisë Radikale Serbe, ku Vuçiqi mbante postin e sekretarit të përgjithshëm dhe Nikoliçi postin e zëvendëskryetarit. Që të tre këta kriminelë kishin hartuar planin “për spastrimin etnik të Kosovës”, platformë kjo, e botuar në gazetën “Serbia e Madhe (Velika Serbia) më 14 tetor 1995 në Beograd” (f. 46). Por natyra çnjerëzore e Vuçiqit del më shumë në pah përmes deklaratave të tij në përkrahje të dy kriminelëve me damkë, si Ratko Mlladiçi dhe Radovan Karaxhiçi, të dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për krime kundër njerëzimit. Akademik Flori Bruqi citon deklaratat e Vuçiqit për Mlladiçin dhe Karaxhiçin, të publikuara në vitet e para të këtij shekulli.

“Radovan Karaxhiçi është simbol i luftës për liri të popullit serb. Karaxhiçi dhe Mlladiçi janë patriotë të shquar serbë dhe heronj të luftës atdhetare. Nuk do ta dorëzojmë as

Radovan Karaxhiçin dhe as Ratko Mlladiçin. Nëse i takoj diku, do të pi me ta kafe. Shtëpia ime, ashtu si edhe gjithë shtëpitë e familjes Vuçiq, do të jenë pikërisht shtëpi e sigurt e gjeneralit Ratko Mlladiç (f. 50).

Fakti që Vuçiqi është president i Serbisë, dëshmon më së miri për psikologjinë e kriminalizuar të popullit serb.

Se jo më kot populli serb, me votën e vet, nxori në krye të shtetit pikërisht Vuçiqin, ministrin e informacionit të Sllobodan Millosheviçit, të kriminelit me damkë që lau me gjak mbarë Bosnjë-Hercegovinën dhe popullin shqiptar të Kosovës.

Prandaj akademiku Flori Bruçi, në faqet e këtij libri, i ka bërë “skanerin” e duhur Aleksandër Vuçiqit, duke ia flakur tutje përfundimisht “mantelin e udhëheqësit të moderuar” të Serbisë.

Me mjaft interes në faqet e këtij libri është tema që trajtohet në kreun me titull “Kishat dhe manastiret ortodokse në Kosovë- trashëgimi shqiptare”.

Në argumentim të titullit që i ka vënë kësaj teme të librit, akademiku Flori Bruçi shkruan:

“Mbështetje për qëndrimet tona që paraqiten gjatë gjithë këtij punimi se kishat dhe manastiret ortodokse u rindërtuan ose, më mirë të themi, u adaptuan me ndërhyrje gjatë rindërtimeve për t'u transformuar nga stili katolik në atë ortodoks,.. do të gjejmë edhe te disa studiues serbë që shquhen me punimet e tyre për këto çështje” (f. 53).

Autori, me një objektivitet shkencor, ka nxjerrë në spikamë një të vërtetë historike. Sepse dihet që politeizmi ilir filloi t'ia lëshojë vendin kristianizmit, i cili, me Ediktin e Milanos, në vitin 313, u shpall fe zyrtare, institucionale, shtetërore.

Akademik Flori Bruqi i ka dhënë propagandës mashtruese serbe një përgjigje historikisht të argumentuar. Madje përgjigjja e tij vlen edhe për Vatikanin, i cili, në vitin 2013, përmes një artikulli tëkardinalit Uallter Kasper për të përditshmen katolike “Kathpress”, deklaronte se “Kosova është djepi i kishës ortodokse serbe”.

Me analizën e temës në fjalë, akademik Flori Bruqi i ka bërë një shërbim të madh jo vetëm traditës së kahershme fetare të Kosovës, por edhe mbarë kombit shqiptar.

Kjo për arsye se populli shqiptar i Kosovës e ka të vetin djepin fetar në Kosovë se është popull rrënjës dhe institucionet e veta fetare, si kisha dhe manastire, i ka ngritur ca shekuj më parë, para se tributë sllave të shpënguleshin nga stepat ruse dhe të dyndeshin drejt Gadishullit Ilirik.

Mitet dhe mashtrimet e falsifikatorëve serbë të historisë për lashtësinë e kishave dhe të manastireve në Kosovë, nuk e mbulojnë dot diellin me shoshë.

Një tjetër temë me rëndësi që akademik Flori Bruqi trajton në këtë libër, është ajo që i kushtohet të ashtuquajturës “shtëpia e verdhë”, e cila, sipas propagandës shpifëse serbe, shërbyekej si qendër për trafikimin e organeve njerëzore. Ka qenë fjala për një shtëpi fshati që ndodhet 15 km në veri të Burrelit.

Legjenda për një trafikim të organeve njerëzore që “organizohej” në një shtëpi të tillë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka pasur për qëllim të falsifikohej e vërteta historike për krimet barbare të bishës fashiste serbe kundër popullit shqiptar të Kosovës, në mënyrë që Serbia, nga një shtet agresor, të shndërrohej në një shtet-viktimë. Kjo legjendë, e

sajuar në Beogradë dhe në Moskë dhe e mbështetur paturpësisht edhe nga Perëndimi evropian, është faqja më e zezë në historinë evropiane të pasluftës.

Në faqet e këtij libri, autori ka vënë në dukje bashkëpunimin e ngushtë të Beogradit dhe të Moskës për fabrikimin e shpifjeve për ekzistencën e të ashtuquajturës “shtëpia e verdhë”.

Ky bashkëpunim del në pah më së miri përmes deklaratave të ish-ministrit të jashtëm serb Vuk Jeremiç dhe të ministrit të jashtëm rus Sergej Lavrov, të cilët, në sinkron me njëri-tjetrin, mbështetnin fuqimisht mashtrimet e Karla del Pontes dhe të Dik Martit, mashtrime trashanike këto që u hodhën në qarkullim me sponsorizimin e drejtpërdrejtë të Beogradit dhe të Moskës.

Në librin e akademikut Flori Bruqi bëhet e qartë se Beogradi dhe Moska, si dy vatrat më armiqësore të kombit shqiptar në tërësi dhe të popullit shqiptar të Kosovës në veçanti, patën bërë shumë investime për përgatitjen e dy tellallëve të Perëndimit evropian, si Karla del Ponte, ish-Kryeprokurore e Tribunalit të Hagës, dhe Dik Marti, anëtar i Dhomës së Ulët të Parlamentit të Zvicrës dhe raportues i Këshillit të Evropës, për të shpikur mitin, sipas të cilit Ushtria Çlirimtare e Kosovës paskej kryer vrasje të të burgosurve serbë, me synimin për heqjen e organeve dhe trafikimin e tyre për qëllime fitimi.

Për këtë qëllim, ish-kryeprokuroerja Karla del Ponte (tani ambasadore e Zvicrës në Argjentinë) pati botuar librin me titull “Gjahu”, në të cilin, pa iu dridhur qerpiku, ka shpifur, duke deklaruar se gjoja civilët serbë, të burgosur nga Ushtria

Çlirimtare e Kosovës, qenkeshin vrarë në Shqipëri dhe organet e tyre qenkeshin shitur në tregun e zi pas përfundimit të luftës.

Këtë mënyrë shpifjeje e ka përdorur edhe Dik Marti, si raportues i posaçëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Raporti i tij u miratua në Komitetin për Çështje Juridike dhe të Drejtat e Njeriut, çka përbën një njollë të zezë për Komitetin në fjalë, i cili i bashkohej korit të hienave serbe dhe ruse kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Është me të vërtetë e turpshme që ai Komitet i merrte për të vërteta shpifjet e ish-Kryeprokurores Karla del Ponte dhe të raportuesit Dik Mati, sipas të cilëve trafikimi i organeve njerëzore “mund të bëhej” në një shtëpi fshati në veri të Burrelit!

Me këtë rast, akademik Flori Bruqi, për të hedhur poshtë shpifjet e ulëta të dy personazheve të lartpërmendura, i drejtohet deklaratës së një specialisti të mjekësisë ligjore nga Beogradi, prof.dr. Zoran Stankoviçit i cili “thotë se në këtë punë duhet të marrin pjesë kirurgë të mirë, një ekip multidisiplinar me të paktën 50 njerëz” (f. 101).

Arsyen e shpifjeve të ish-kryeprokurores Karla del Ponte dhe të raportuesit Dik Marti, akademik Flori Bruqi e gjen te një deklaratë e Frontit Demokratik të Bashkimit Kombëtar: “Përderisa ne shqiptarët, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë, nuk ngritëm padi kundër Serbisë për gjenocid dhe krime lufte në Kosovë, tani një gjë të tillë e bëjnë serbët kundër neve shqiptarëve, edhe përmes lobit të tyre shumë të fuqishëm në Zvicër, fillimisht përmes librit të ish-Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës, Zonjës Karla del Ponte, dhe tani

edhe përmes Raportit të Zotit Dik Marti në Këshillin e Evropës” (f. 143).

Fronti Demokratik i Bashkimit Kombëtar ka shumë të drejtë, por problemi është se padinë kundër Serbisë nuk kishte kush ta ngrinte pas përfundimit të luftës. Kjo për arsye se Hashim Thaçi kishte hyrë argat në shërbim të shovinizmit serbokriminal qëgjatë luftës dhe për të Beogradi kishte bërë një investim të madh për ta nxjerrë në krye të Kosovës, fillimisht si kryeministër dhe mandej si president. Nënkup-tohet që Thaçi, në aktivitetin e vet si kryetar i partisë demokratike dhe si argat i Beogradit, do të mblidhte rreth vetes përkrahësit e bindur, me qëllim që jo vetëm të mos ngrihej kurrfarë padie kundër Serbisë për krimet, masakrat dhe shkatërrimet e rënda që i shkaktoi popullit shqiptar të Kosovës, por edhe për t'i bërë asaj lëshime pas lëshimesh, të cilat nuk mund të vlerësohen ndryshe, përveçse si tradhti komëtare.

Libri “Shtëpia e Verdhë” i akademik Flori Bruqit është një vepër historiko-publicistike me vlera të jashtëzakonshme njohëse për krimet mbinjëshekullore të shovinizmit serbo-kriminal kundër kombit shqiptar.

\* \* \*

Kur lexuesi njihet me thelbin e politikës tradicionale serbe kundë shqiptarëve, sipas së cilës “Serbia e ka ngritur në doktrinë shtetërore zhdukjen e popullit shqiptar”, ai, vetvetiu, duke pyetur vetveten, bie në përsiatje të thella: “Po si është e mundur që një popull rrënjës në Gadishullin Ilirik, siç është populli shqiptar, kërcënohej me zhdukje nga ardhacakët sllavë?”



Përgjigjja e kësaj pyetjeje duhet kërkuar në traditën tonë të lashtë pellazgoiliriane. Sepse atje është zanafilla e tragjedisë sonë kombëtare, e cila i ka rrënjët në mikpritjen karakteristike dhe nderimin e tepruar që u kemi bërë të huajve.

Madje mbi bazën e kësaj mikpritjeje, e cila, duke i kaluar caqet e lejuara, ka ardhur e ka marrë ngjyrimet servilizmi, në gjuhën shqipe, që kryeherazi, është krijuarshprehja “shtëpia e shqiptarit është e mikut dhe e shtegtarit”.

Pra, shqiptarët, që së lashti, derën e kanë pasur të hapur për miqtë dhe për shtegtarët fqinj. Por rezulton se këta të fundit, në rrjedhën e shekujve, nuk janë treguar aspak mirënjohës ndaj shqiptarëve. Përkundrazi, mikpritjen e shqiptarëve ata e kanë vlerësuar si kompleks inferioriteti dhe na e kanë shpërblyer me rrëmbimin e trojeve tona, duke na i rrëgjuar në një mënyrë tragjike.

Dhe shqiptarët, si etnia më e madhe e Gadishullit Ilirik, në vend që të bashkoheshin fort me njëri-tjetrin dhe t'i mbronin me vendosmëri trojet e veta, ata vetëm janë tërhequr para furisë së pushtimeve të fqinjve tanë “miq dhe shtegtarë”.

Kësisoj, shqiptarët, duke e zhvendosur te të huajt gravitacionin e mikpritjes dhe të nderimit deri në servilizëm, gjatë shekujve kanë pasë krijuar një boshllëk të ndjeshëm për ngjizjen e unitetit brenda vetvetes, çka ka krijuar truall për përçarjen tragjike që i ka karakterizuar brez pas brezi. Tek po hidhja në kompjuter këto radhë, menjëherë më erdhi në kujtesë një libër interesant, me autor zotërinë Sokol Braha, shqiptar nga Kosova që jeton në Zvicër. Ai, duke trajtuar natyrën e marrëdhënieve të shqiptarëve me serbët, shkruan: “Shqiptarët përshëndetin, nderojnë, urojnë, përgëzojnë,

presin e përcjellin me krenari, sepse i kanë në traditën e tyre këto dhe i ruajnë me krenari. Edhe pse këta komshinj nuk i ftuam ne, por na erdhën si miq të paftuar!

Por unë pyes veten: a na solli neve ndonjë të mirë bujaria dhe zemërgjerësia me të huajt? Asnjëherë, kurrë! (Sokol Braha. “Vjen i kodrës, nxjerr të votrës”. Shtypshkronja “Grafobeni”. Prishtinë, 2011, f. 56).

Duke i nderuar të huajt deri në atë shkallë, sa që të mos respektosh dinjitetin personal, domosdo që do të fitosh jo simpatinë, por mungesën e respektit nga ana e tyre, i cili, me kalimin e kohës, vjen e merr përmasat e shpërfilljes, duke u ngritur ca nga ca deri në nivelin e neverisë dhe të urrejtjes së hapur. Pikërisht kështu ka ndodhur me shqiptarët. Duke u treguar mikpritës me ardhacakët sllavë, me të cilët u treguan bujarë, ilirët i lejuan të bëheshin zotër në tokat e Ilirisë.

Me kalimin e shekujve, ardhacakët sllavë i zhvendosën ilirët rrënjës shekull pas shekulli, derisa trojet ua katandisën në një shoshë vend. Në këtë mënyrë, duke i respektuar tej mase ardhacakët sllavë, ilirët, siç u theksua më lart, fituan neverinë dhe urrejtjen e tyre, e thelluan përçarjen brenda vetes dhe erdhën duke u shndërruar në një popull vetëvrasës.

Skënder Sherifi, shkrimtar dhe gazetar frankofon me origjinë shqiptare, i njohur sidomos në rrethet letrare në Belgjikë dhe në Francë, në një intervistë që i ka marrë zotëria Gjovalin Kola këtu e ca vjet të shkuara, ka nxjerrë në pah “...një prirje vetëshkatërruese që manifestojnë shqiptarët, njëfarë vetëvrasjeje kolektive.

Kur i sheh me realizëm të shkuarën dhe zhvillimet e sotme, arrin në përfundimin se ky komb është armiku më i madh i

vetvetes. Këtu ka një urrejtje, xhelozia e mëri të tepruar. Nuk dimë ta vlerësojmë tjetrin. “S'të njoh, s'dua të të njoh, s'dua të di çfarë meritash ke ti”.

Kështu arsyetohet, pak a shumë, te ne” (Gjovalin Kola. “Ky komb është armiku më i madh i vetvetes”. Gazeta “Shekulli”. 03 tetor 2006).

Pikërisht vetëvrasjes kolektive, për të cilën tërheq vëmendjen shkrimtari dhe gazetari Skënder Sherifi, një personalitet politik i viteve të luftës, ish-ministri i brendshëm Kol Bib Mirakaj, i ka kushtuar një libër të tërë, me titull “Vetëvrasja e një kombi”. Botimet “Fiorentina”. Shkodër 2014.

Pak a shumë të njëjtën linjë arsyetimi ndjek edhe publicisti dhe moderatori i njohur televiziv Artur Zheji në një material që ka botuar në internet ca muaj më parë:

“Një vend që s'ka bërë asnjë luftë me të tjerët, është dreqosur nga lufta e pamëshirshme dhe pa kufi me vetveten, si një gërryerje, si një acid vrasës, si një ligësi për të parë të dërrmuar më të dobëtin, më të pafuqishmin dhe këmbërrëshqiturin në humnerë” (Artur Zheji. “Urrejtje dhe plaçkitje apo përndryshe historia jonë...”. Faqja e internetit: “VideoËap.Net”. 30 korrik 2019).

Prof.dr. Mehdi Hyseni, akademik, në një artikull të paradokohshëm, citon zotërinë Enis Shatri:

“Sikur shqiptarët të ishin treguar kaq mizorë me armiqtë shekullorë, sa ç'janë treguar me njëri-tjetrin, kufijtë tanë do të shtriheshin deri atje ku kanë qenë, deri në Pargë e në Prevezë”.

Dhe më poshtë profesori vazhdon:

“Ky paradoks sheshit provon edhe sot gjendjen tonë të mjeruar dhe të robëruar nën tutelën kolonialiste të disa

shteteve fqinje sllave të Ballkanit (Greqia, Maqedonia Veriore, Serbia dhe Mali i Zi).

Ky paradoks qartazi provon edhe aksiomën e qëlluar të Rilindësit tonë, Faik Konica, se “armiku i shqiptarit është vetë shqiptari”.

Ky paradoks historik, politik, kombëtar e atdhetar dëshmon se populli shqiptar nuk ka ngelur rastësisht dhe vetëm si pasojë e armiqve të huaj, i copëtuar, i aneksuar, i kolonizuar, i shtypur dhe i robëruar nën thundrën tiranike shekullore të sllavëve të Ballkanit, por fajtori më i madh është vetë shqiptari, që me shekuj, që nga Hamzai e deri te Adem Jashari, e tradhton, e vret dhe ia fut thikën pas shpine shqiptarit, jo armikut!” (Prof.dr. Mehdi Hyseni. “Ndryshe”. Faqja e internetit “Albaniapress”. 19 maj 2019).

Në romanin me titull “Amanti i Arbërisë”, një libër fantastiko-historik ky për fëmijë, të cilin Shtëpia Botuese “Toena” e pati hedhur në qarkullim në vitin 2003, shkrimtarja dhe publicistja e njohur Vilhelme Vranari Haxhiraj ka zbuluar me art ca të vërteta tragjike në ecurinë shumëshekullore të etnosit shqiptar në Gadishullin Ilirik:

Ilirët nuk kanë pasur perëndi të luftës. Nga bashkëbisedimi i dy heronjve të romanit - Amantit dhe Vranos - del në pah arsyeja se pse ilirët nuk kishin perëndi lufte. Amanti i jep këtë shpjegim Vranos:

“ – Nuk ka ç'na duhet Perëndia e luftës. Populli ilir ka qenë dhe është liridashës. Ne nuk e duam luftën dhe nuk i biem askujt në qafë”.

Kjo e vërtetë tragjike ilire zbulon një mendësi paradoksale: ilirët nuk kanë pasur absolutisht prirje për ekspansion.

Po si ka qenë i mundur një paradoks i tillë, përderisa rreth e qark tyre, etnoset e tjerë etjen për ekspansion e kanë pasur si yll karvani në luftën e tyre për mbijetesë? Sa ishte sipërfaqja e etnosit grek në vitin 1831?

Në vitin 1913, brenda 80 vjetëve, u trefishua pikërisht në dëm të sipërfaqes së etnosit shqiptar.

Sa ishte sipërfaqja e etnosit serb në vitin 1878 dhe ku arriti në vitin 1913, në dëm të sipërfaqes së etnosit shqiptar?

Mungesa e prirjes për ekspansion, si trashëgimi fatkeqe që nga koha e Ilirisë, ku e katandisi Shqipërinë? Në një sipërfaqe sa një “fushë tenisi”.

Një tjetër e vërtetë tragjike që zbulohet në këtë roman, është përçarja që ka mbretëruar në botën e lashtë ilire.

Pyetjes së Amantit, drejtuar Bukuroshes së Durrësit për njerëzit nëse janë ziliqarë, ajo i përgjigjet:

“ - Po, po, kanë smirë për këdo që i shkojnë punët mbarë, mundohen dhe bëjnë të pamundurën që ta shkatërrojnë tjetrin”.

Kjo smirë tragjike vazhdon traditën e vet që nga koha e Ilirisë dhe deri në ditët tona.

Në vazhdimësi, shkrimtarja nënvizon edhe një tjetër të vërtetë tragjike për kombin shqiptar, të trashëguar që nga lashtësia ilire.

Kur po bisedojnë për ngritjen e kalasë së Shkodrës, për ndërtimin e së cilës dy vëllezër prenë në besë vëllain e vogël, Hyu i Jezercës i thotë Amantit: “Ndër tre njerëz, vetëm njëri është i drejtë. Ndaj nuk bën hair ky truall, biro!”.

Për shkak të përçarjes që kanë pasë trashëguar që nga pellazgoiliria, shqiptarët, aty nga mesi i shekullit XIX, në

vend që ta kuptonin rrezikun e madh që u kanosej nga grekosllavizmi përmes “Megaliidesë” dhe “Naçertanies”, u hodhën në kryengritje kundër taksave që u vendosën me Reformat e Tanzimatit, pa pasur absolutisht si qëllim që të luftonin për pavarësinë e vendit nga perandoria otomane.

Asokohe kombi shqiptar ishte numerikisht më i madhi në Gadishullin Ilirik. Grekët numëroheshin në 1 milion e 100 mijë, serbët - në 600 mijë, kurse shqiptarët - në 1 milion e 600 mijë. Por përçarja ndërshqiptare dhe mercenarizmi i parisë së tyre ishte pengesa kryesore për forcimin e unitetit aq të dëshiruar.

Pikërisht mercenarizmin e parisë shqiptare e përmend edhe Ivo Andriçi në elaboratin e vet, çka citohet në librin e “Shtëpia e Verdhë” të akademikut Flori Bruçi: “Në territorin shqiptar është zhvilluar një luftë e ashpër ndërmjet nesh dhe Italisë. Italianët atëherë iniciuan çështjen malazeze e maqedonase, si dhe idenë e Shqipërisë së Madhe deri në Kaçanik.

Ne kundër tyre zhvilluam herë aksione të fshehta, herë të hapura, duke i bërë për vete me para fisnikët (parinë) shqiptarë dhe duke u shërbyer me idenë e “Shqipërisë së pavarur” dhe “Ballkanin popujve të Ballkanit” (f. 28).

Përçarja ndërshqiptare në ditët tona ka marrë përmasa të frikshme. Ajo është trualli më i përshtatshëm i mercenarizmit, i servilizmit ndaj të huajve dhe i vëllavrasjes. Këtë e dëshmon më së miri numri i madh i partive politike. Në trekëndëshin Tiranë-Prishtinë-Shkup figurojnë 92 parti politike, të regjistruara në gjykata. Shpërfillja dhe neveria që ushqejnë serbët për shqiptarët, mishërohet fare hapur në kërkesën skandaloze

të kryeministres serbe, drejtuar kryeministrit Rama dhjetorin e vitit të kaluar. Në faqet e internetit asokohe u bë i njohur informacioni i mëposhtëm:

“Serbia është aq e guximshme, saqë edhe Shqipërisë i kërkon tërheqje të njohjes së Kosovës, raporton KTV.

Por, këtë kërkesë të kryeministres së Serbisë Ana Brnabiç, drejtuar kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, kryeministri Ramush Haradinaj e quan të turpshme (Citohet sipas: “Serbia i kërkon Shqipërisë ta tërheqë njohjen e Kosovës, reagon ashpër Haradinaj”. (Faqja e internetit “time.al”. 25 dhjetor 2018).

Kërkesa e kryeministres serbe është me të vërtetë e turpshme, por ajo e ka një bazë ku mbështetet - pikërisht te përçarja ndërshqiptare.

Pikërisht kjo përçarje e mallkuar është arsyeja e heshtjes së Tiranës zyrtare para institucioneve ndërkombëtare, deri edhe para Tribunalit të Hagës, për krimet e rënda që Serbia kreu në Kosovë gjatë viteve të luftës.

Ato krime ishin konkretizim i urrejtjes mbinjëshekullore që shovinizmi serbokriminal ka ushqyer dhe vazhdon të ushqejë ndaj kombit shqiptar, urrejtje që përbën një enciklopedi më vete.

Shovinizmi evropinoperëndimor, në bashkëpunim të ngushtë me shovinizmin rusomadh, e njëjtte mirë psikologjinë përçarëse që karakterizonte mbarë etninë shqiptare, prandaj edhe copëtimin e trojeve tona amtare e nisi në Kongresin famëkeq të Berlinit dhe e kurorëzoi me Konferencën edhe më famëkeqe të Londrës.

Ato dy copëtime vërtetuan në praktikë se shqiptarët, megjithëse përfaqësonin etninë më të madhe në gadishullin

tonë, përçarjen vetëvrasëse e kishin në gjenin e tyre.

Kjo përçarje ka bërë që shqiptarët e Shqipërisë Londineze sot të jenë pre e lehtë e nëpërkëmbjes, e talljes së hapur nga ana e kryeministrit Rama, i cili, sipas të gjitha gjasave, ka ndërmarrë nismën pa zhurmë e pa bujë për shpërbërjen e popullsisë së vendit tonë, numri i së cilës, sipas një statistike të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 2100 do të zbresë në 500 mijë banorë.

Largimi drejt Perëndimit i gati 500 mijë shqiptarëve pas vitit 2013, është dëshmia më kuptimplote e veprimtarisë antikombëtare të kryeministrit Rama.

Në këtë mënyrë, Rama është duke vënë në jetë doktrinën shtetërore serbe, të shpалosur 80 vjet më parë në elaboratin e Ivo Andriçit për zhdukjen e popullit shqiptar. Prandaj Rama, si simbol i përçarjes ndërshqiptare, ka për zemër jo Kosovën, por Serbinë e Aleksandër Vuçiqit, me të cilin kërkon të krijojë Minishengenin ballkanik, duke hedhur themelet e një Jugosllavie të Re, çka dëshmon shkoqur fare se, në dashurinë për serbosllavizmin, ai po ecën në gjurmët e kriminelit Enver Hoxha.

Për fatkeqësinë tonë kombëtare, shqiptarët, në vend që të çohen peshë më këmbë dhe, përmes “armës së votes”, t’i tregojnë vendin politikës shkombëtarizuese të Ramës, ata, për shkak të përçarjes tragjike që i karakterizon, parapëlqejnë ose të braktisin atdheun dhe të enden nëpër vendet perëndimore, ose të shtrojnë kurrizin para tij, duke u sjellë si delet e Krishtit. Në të njëjtën kohë, kryeministri Rama, me politikën shkombëtarizuese që ka ndjekur gjatë këtyre gjashtë vjetëve, ka bërë që vendi ynë të shndërrohet edhe në objekt i



njëshpërfilljeje, deri në përbuzjetë heshtur, nga ana e Bashkimit Evropian dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Dëshmia më kuptimplote e kësaj shpërfilljeje është vizita e Sekretarit të Departamentit të Shtetit Majk Pompeo në Mal të Zi, në Maqedoni dhe në Greqi në javën e parë të muajit tetor 2019, kur ai e anashkaloi Shqipërinë dhe Kosovën.

Prandaj ka shumë të drejtë publicisti i njohur shqiptaro-amerikan, dr. Andon Dede, fjalët e të cilit kanë një tingëllim mjaft aktual:

“Duhet pranuar se aktualisht kemi marrë një nam të keq, saqë na tregojnë me gisht kudo që vemi. Dhe të ndryshosh një opinion që ka zënë vend, është shumë më vështirë sesa të krijosh një të ri” (Andon Dede. “Pa iluzione e paragjykime”. Shtëpia Botuese “Globus R”. Tiranë 2010, f. 149).

## DËSHMI TË KRIMIT TË PANDËSHKUAR

*Refleksion mbi librin e Prof.dr. Flori Bruqi: “Dëshmi të krimit të pandëshkuar”*

**Nga Sotir Athanasi**

Librin e fundit të akademikut, Prof. Dr. Flori Bruqi, “Dëshmi të krimit të pandëshkuar”, e mbajta gjatë nëpër duar duke e lexuar e shfletuar me laps në dorë. Së brëndëshmi ndjeja një siklet e trazim të ngjajshëm me ato që na bënin të na dridhej jo vetëm zemra, por çdo qelizë e trupit.

Të gjithë kemi parë dokumentarët mbi kasapanat e nazizmit ndaj hebregjeve në kampet e shfarosjes në masë.

Në furrat e djegies me emra që ngjallin llahtarë, ndonëse isha i bindur që: skenat e ngjajshme, nga kriminelë shpërndarë mbi një popullsi civile, me karakteristika të denja vetëm për dinosaur prehistorikë në parcela me njomishte, fatkeqësisht, i përjetonte populli im autokton.

Në atë krahinë me emrin Kosovë dhe që: me aq puritanti-zëm, pa asnjë anëshmëri e krah politike, si një gjykatës i veçantë i historisë, por edhe si një prokuror, bir i kombit të vet, ngrihet në lartësinë që ia kërkon koha.

Autori, Prof.dr. Flori Bruqi ( për çudinë tonë ) ka duruar ( mbase me dhëmbët shtrënguar nën okelion: Mos durofsh, o Perëndi, por të lutem paisëm me forcë të përballoj dhimbjen dhe t'u them bashkëkohësve të mi, që: të jenë vigjilent e të hapin sytë për atë që kanë kaluar bashkëkombësit e mi. Kaq.

Se Prof.Dr. Flori Bruqi, si ndonjë Apostul i dërguar nga fuqploti, hulumton në dokumentacion.

I qëmton me durimin e kirurgut neuropsiqiatër ato, përpara se t'ia paraqesë botës, e cila

( O Zot! ) e ka më të lehtë shpërfilljen dhe rehatinë, se sa të vigjëlojë se çfarë ndodh rreth saj!

Oh! Po si ka mundësi që kontinenti ynë i vjetër të jetë plakur kaq shumë (se s'dua të them është matufjepsur) kaq skajshëm, sa të mos dijë të dallojë. Çfarë?

Atë që të rinjtë e nazistizuar serbë, alla (Turma Arkan), kishin kohë që nuk u dërgonin të dashurave të tyre (në qoftëse ende egzistonte dashuria) buqeta me lule të freskëta. Jo.

Ata i zëvendësuan ato me krena njerëzish civilë të pafajshëm. Shënja këto të një barbarizmi modern.

Le t'i referohemi historisë. Hitleri hypi në fuqi më '33-shin. Më '39, sulmoi Çekosllavakinë.

Pra, vetëm gjashtë vjet iu deshën të helmonte rininë e vëndit të tij, që: për hir të një Gjermanie të madhe, të hiqtete dorë nga lulet, nga dhimbja kur sheh lotët e një nëne, nga humanizmi kur të del përpara një paraplegjik, nga... Nga ndihma mbi më të pafuqishme, nga. . .

Edhe katrani Millosheviq, këtë bëri. E filloi me paramilitarët për një Sërbi të madhe dhe solli kasapanën ndaj popullit boshnjak. Parimi i të pangopurit, është: “oreksi hapet duke ngrënë”.

Shpërfillja e Kontinentit Matuf European, solli masakrat nga më të rafinuarat e më të përgjakëshmet tashmë, edhe në Kosovë.

E dini, miqt e mi, si quhej plani për genocid e shfarosjen nga trojet e tyre mijërajeçare, nënvizoj, autoktonët, një gjakësit tanë të Kosovës?

- PATKOI, - duhet të përgjigjet çdo nxënës, jo vetëm në shkollat e Kosovës dhe të Shqipërisë, por edhe në të gjithë Kontinentin tonë ku aspirojmë të hyjmë.

Ani se ishte i budallepsur, derisa nën hundët e tij emërtohej plani më famëkeq, për turpin e saj mbi trupin e brishtë e të skllavëruar më keq se në mesjetë të Kosovës.

Vetë fjala të sjell ndërmend kafshën dhe kafshëritë. Por ky term të kujton se Patkoi është prej hekuri dhe i destinuar për thundrën e kalit.

Veçse miqt e mi, historia ka treguar jo rrallë, se ka parë në këtë botë edhe mushka me fytyrë njeriu.

Atyre, për fat të keq, ko gjithmonë, u ka mbathur patkojtë për t'i dërguar në ferr; por i ka lejuar që të hartojnë plane me emërtime djajsh për të fshehur udhëzimet e për t'i nënkuptuar ato.

Simbole që shmangin dhënien e llogarisë në një gjyq të mundshëm. Lejon çpyllëzime e hapjen e fushë-gropave të frikëshme për të mbuluar mijëra të masakruar si nga një lukuni ujqërish.

Paçka se ndër ta më shumë se gjithçka, ishin trupa njerëzish civilë ku: gratë me fëmijët e tyre, këta engjëjt të pafajshëm nuk kurseheshin.

Patkoi u adresohet individëve ekstremistë, alla Arkan. E për 'ta, nuk ka pse të përgjigjet kryexhelati, kryepërdhunusi i grave, kryekasapi i fëmijëve.

Pastaj, edhe sikur të ketë ndonjë prokuror (siç historia do të tregojë) se asnjëherë s'kanë munguar të tillë.

Siç ka patur madje me tepri lakenj në çdo oborr mbretërinjsh pa lesh në kokë e me parukë, ashtu siç kemi parë e jemi

habitur se një farë, Karla Del Ponte, për turpin e origjinës së saj, të paguhej për të mbrojtur nallbanët e Patkoit, simbas parimit: sulmi është mbrojtja më e mirë. Kësisoj, në mos t'a justifikonte, të paktën të lante duart me Patkoin si Pont Pillati.

Image result for libri i Flori Bruqit

Të më falin lexuesit por, sapo hodha emrin e këtij prokurori që gjykoi Jezu Krishtin, më ra në sy tingëllimi shqip (thuajse motamo kur “ll”-ja, zëvendësohet me “dh”-në) i prokurorës..., PONT(I) me mbiemrin Pi(II)ati, me një zëvendësim e “ll”së në kllapa me “dh”në.

Pra: PONT PI(!)ati... Dhe u shkriva së qeshuri. Çfarë ironie groteske i ka rezervuar historia kësaj fyçke.

Edhe këtu më doli predestinata që e kam trajtuar dikur në një roman timin. (Mënjanë modestinë).

Aty, midis të tjerave, them. Në orkestrën e filarmonisë së Vjenës (koncertin e së cilës e sheh gjithë bota çdo 1 Janar), është edhe shqiptari ynë nga Kosova, Shkëlzen Dolli.

Dhe ky violinist, ka mbërritur aty me talentin dhe aftësinë e tij, për të kënaqur botën e qytetëruar duke luajtur, veç së tjerash edhe..., Danubin blu.

Kurse, e ashtuquajtura (si në shqip. Mos qeshni!), prokurorja që kërkon të përlijë krimet e një kasapi me emrin sinonim alla Hitler-Millo-Sheviç, që luajti në Kosovën tonë kryexhelatin, ky hartues i planit Patkoi, orkestroi masakrën më të madhe në Europë pas Luftës së Dytë Botërore.

Danubin blu e skuqi me kufomat e shqiptarëve autoktonë të Kosovës.

Nuk them më shumë, por mushkës hartues të Patkoit, Presidenti Klinton, ia mbërtheu mirë patkojt dhe i doli në krah

një populli të tërë siç ishin shqiptarët e Kosovës.

Në këto pak rreshta, pa mëtuar të bëj analizë, po u shmangem numurimit të krimeve të ngjajshme me filmat e Hollivudit mbi shkatërrimin e Trojës, djegien me gjithçka të saj, për të mos provokuar ndonjë ulërimë mbi llahtarën. E as të ndonjë thirrje për hakmarrje. Jo. Por edhe nuk mund të mos nënvizoj UÇK-në. Luftën e pabarabartë të saj. Heronjt e saj.

Autori Prof.Dr. Flori Bruqi, është ndalur me durim e dashuri në përshkrimin e personazheve realë në këtë luftë. Sakrificat e tyre. Shifrat eksponenciale mbi barbarinë e pashoq që do të befasonte për nga rekordet edhe Inkuizicionin mesjetar.

Renditja e bëmave ende të pandëshkuara, në penën e akademikut Prof.Dr. Flori Bruqi, u përngjasin lapidarëve masivë të holokaustit ngrietur këtu e atje në Europën tonë.

Me dhimbje, por na duhet të pranojmë se është: mëkatore.

Në parathënien e këtij libri, një tjetër akademik, Prof.Dr. Eshref Ymeri, miku im, që aq profesionalisht e me kopetencë, qëmton vlerat e tij, nuk mund të mos ndalet, veç së tjerash në faktin se: (Citoj):“Me botimin e librit të ri me titull “Dëshmi të krimit të pandëshkuar”, akademiku Flori Bruqi, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për ndriçimin e shumë të vërtetave tragjike për popullin shqiptar të Kosovës në veçanti dhe kombin shqiptar në tërësi.

Shumë nga këto probleme të mprehta që ai i ka parashtruar në këtë libër-monument, duhet t'a kishin shqetësuar me kohë e me vakt Akademinë e Shkencave në Tiranë, dhe në Prishtinë dhe mbarë klasën politike shqiptare në trekëndëshin: Tiranë - Prishtinë - Shkup. Atyre u takonte t'i grumbullonin këto fakte

tronditëse, t'i pregatisnin dosjet përkatëse, t'i përkthenin në gjuhët kryesore dhe t'ua nisnin kryeqyteteve të Perëndimit europian, Brukselit, Departamentit të Shtetit, Kongresit, Senatit Amerikan dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që të zhvlerësonin tërësisht gjithë literaturën shpifografike kundër kombit shqiptar...

Në të njëjtën kohë, kryepolitikantët shqiptarë, le të mundohen që, të paktën një herë të vetme në jetën e tyre, të kësibëjnë nga vetja servilizmin para të huajve, të bëhen burra të politikës.

***Përfundimisht:***

Krahas respektit për këtë punë me vlera të pallogaritëshme nga akademiku, Prof.Dr. Flori Bruqi, mendoj dhe propozoj se ka ardhur koha që, të dy Ministrinë e Arsimit, Kosovë - Shqipëri, këtë lëndë t'a fusin në programet si një lëndë të detyrueshme, siç është historia, apo matematika.

Kjo do të që më e pakta që mund të bëhej pas kaq viteve pavarësi për Shtetin e Ri të Kosovës.

*Gjenevë, 18 Nëntor 2017*

## NJË ENCIKLOPEDI E MENDIMIT SHQIPTAR

**Nga Prof.dr. Eshref Ymeri**

Libri më i fundit, me titull “Triumfi shqiptar”, i tridhjeti në serinë e botimeve të zotit Flori Bruqi, nxjerr në spikamë natyrën shumëdimensionale të krijimtarisë së këtij personaliteti të shquar të kulturës shqiptare.

Në universin e kulturës shqiptare është i rrallë fakti që një krijues të dalë para lexuesve me autoritetin e admirueshëm të një shkrimtari, poeti, përkthyesi, publicisti, historiani, gjeografi, analisti dhe kritiku të talentuar.

Tek lexon këtë vepër kaq interesante, që të rrëmben me tematikën e vet bukur të larmishme, nuk mund të mos ndiesh njëherazi kënaqësi dhe krenari për faktin që krijimtarinë e zotit Flori e përshkon tejendanë një frymë mahnitëse objektiviteti, humanizmi dhe optimizmi të pakundshoq.

Mes rreshtave të kësaj vepre nuk është vështirë të kapësh tiparin më themelor të formimit intelektual të zotit Flori - dashurinë e tij të pastër për tokën amtare, respektin e lakmueshëm për këdo që është atdhetar dhe që e do me shpirt punën, si burim mirëqenieje dhe begatie për të gjithë.

Albert Kamy (Camus - 1913-1960) thotë: “Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzojë kaq shumë njeriun, sesa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë”.

Duke pasur parasysh këto fjalë të qëlluara të Kamysë, mendoj se të gjithë ata shqiptarë që popullojnë mbarë trojet tona etnike në Evropën Juglindore dhe që janë të kapluar nga pak nga ndjenja meskiniteti, smire, xhelozie, inferioriteti dhe zvetënimi të shpirtit njerëzor, pra, nga “vetëdijësimi për



gjendjen e tyre të pashpresë”, është mirë ta lexojnë, me durim, veprën e zotit Flori, se nuk do të mbeten të zhgënjyer, nëse do të jenë në gjendje të zbulojnë brenda qenies së tyre një çikëz frymë objektiviteti.

Kam bindjen se do të dalin të fituar, se vepra e zotit Flori shërben si melhem për qetësimin e shpirtave që janë të infektuar nga mikrobi djallëzor i përçarjes njerëzore. Ne, shqiptarët, kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim prova boll të dhimbshme të përçarjes kombëtare, çka e kemi paguar shtrenjtë - me copëtimin e trojeve tona etnike.

Evropa na e ka njohur mirë dhe na e ka “yshtur” po aq mirë këtë mikrob të mallkuar, prandaj edhe trojet etnike na i bëri çarçaf.

Vepra e zotit Flori duhet të lexohet me shumë vëmendje sidomos në Kosovë, në mënyrë që njerëzit e infektuar nga mikrobi i përçarjes t'i thërrasin mendjes dhe të heqin dorë një herë e mirë nga sulmet që ndërmarrin kundër njëri-tjetrit nëpër faqet e internetit, ca sulme publike këto, me një fjalor të padenjë për stilin e komunikimit njerëzor, por edhe më shumë të padenjë për një komunikim intelektual.

Më gëzon shpirti dhe ndiej një kënaqësi të jashtëzakonshme kur lexoj këtë vepër të zotit Flori, që të mëson dhe të frymëzon që ta duash dhe ta respektosh njeriun, pra, ta duash dhe ta respektosh shqiptarin. Sepse në analizat e veta shkencore zoti Flori, tërthorazi, zbulon anët më humane të shpirtit njerëzor, ndikimin e tyre në plazmimin e vlerave krijuese dhe rolin që ato duhet të luajnë në shëndoshjen e shpirtit shqiptar me dashurinë e njeriut për njeriun.

Në gjykimin tim, mbarë krijimtaria e zotit Flori, për tematikën e gjërë që trajton dhe për objektivitetin e analizave shkencore që shpalosen në të, mund të vlerësohet pa drojë si modeli i një enciklopedie të mendimit shqiptar.

*Santa Barbara, Kaliforni, 19 qershor 2010*

VEPËR VËSHTRIMESH KRITIKE DHE  
SHUMËSHITESIMESH LETRARE

*Flori Bruqi: "Nëse kam ditur të guxoj", Prishtinë, 2012*

**Nga Akademik Prof.Dr. Naim Kelmendi**

Libri më i ri publicistik i shkrimtarit, tashmë të mirënjohur, Flori Bruqit, na vjen si një sihariç i mirë letrar. Libri me titull shumë sinjifikativ "Nëse kam ditur të guxoj", përmbanë një lëndë të pasur në shumë aspekte letrare. Meqë kapitulli i parë përmbanë një cikël poezish të autorit, kapitulli i dytë hap një faqe interesante me shkrimet kritike nga autorë të ndryshëm e të mirënjohur shqiptarë, pra vlerësime kritike e vështrime për disa nga veprat letrare të Bruqit, por të publikuara më parë në shtypin shqiptar të kohës. Autori Bruqi i ka sistemuar këto shkrime, që përbëjnë një sërë vlerësimesh të çmueshme letrare për krijimtarinë e tij letrare, poetike, e publicistike, por edhe për ato botime të fushës profesionale të Flori Bruqit, nga emra tashmë të ndjerë, por mjaft të shquar, si Mehmet Kajtazi, Rifat Kukaj, Zejnullah Halili, Iljaz Prokshi e ndonjë tjetër. Por, edhe nga emra po aq të mirënjohur të letërsisë sonë, të gjallë, janë përmbledhur këtu mjaft vështrime që cilësojnë e vlerësojnë veprën e Flori Bruqit, sikur janë: Fatmir Terziu, Bedri Halimi, Lumturie Haxhiaj, Shyqri Galica, Namik Shehu, Izet Çuli, Zef Pergega, Kristaq Shabani, Naim Kelmendi, Rajmonda Maleçka, Eshref Ymeri, Rushit Ramabaja, Abdullah Konushevci, Rrustem Geci, Nehat S.Hoxha, Ajshe Qorraj, Arlinda Meksi, Shpend Ruci, Arian Blushi, Nikollë Frangaj, Faik Xhani e ndonjë tjetër.

Do theksuar se në të gjitha shkrimet dhe vështrimet kritike mbi veprat letrare të Bruqit, qofshin ato vështrime të mëdha apo të vogla, ndonjëherë si njoftime mbi librat e publikuar nëpër kohë, të Bruqit, qoftë si vështrime më të gjata, cilësohet e vlerësohet krijimtari letrare e Flori Bruqit, dhënë lëtërsisë sonë më të re, duke bërë kështu emër në lëtërsinë moderne.

Ja si do të shprehej atëbotë shkrimtari i mirënjohur yni, Mehmet Kajtazi, në një vështrim të tijin për poezinë e Floriut: “Temat që ngërthehen në këto vargje nuk burojnë nga inspirimet, që i marrin disa poetë nga librat që i lexojnë, por Flori Bruqi inspirimet i merr nga jeta. Ato nuk mbesin vetëm inspirime, por dalin nga kornizat e një gjirme të thellë dhe si valëzat e detit të shqetësuar afrohen drejt brigjeve, por edhe kthehen në suprinën e largët të detit me emrin nënë, me emrin martirizim, me emrin LIRI”. Apo në një rast tjetër njëri nga shkrimtarët tanë të shquar, Zejnullah Hallili, shprehet kaq reflektueshëm: “Flori Bruqi po hyn nëpër një shteg të ndritshëm në poezinë shqipe. Figura e tij në fillim të kësaj poeme na sjell shqetësime të shumta që lidhen me Tokën, me Nënë, me Gjakun, me Vallen e Shkrepave, me Baladën e Yjve, me Lotin që ka Ogur, me Zërin me Frushullimën e Krahëve, me Akuarelin e Diellit, me Lumin e Bardhë. Secili varg vendoset në patosin e kësaj Luleje. Secila poezi ka gjethin e Vet, Dritën, shqetësimin dhe besimin, andeja, matanë errësirës, pra, ai këto frymëzime i zë nga jeta, sepse e nxit Bardhësia e katër vargjeve, figura e saj, shpirti shqetësues, Fjala”.

Në kapitullin e tretë mbarështrihet një lëndë po aq e pasur dhe e thekur letrare e autorit mbi veprat dhe mbi jetën e shumë

autorëve botërorë e shqiptarë, sipas këndvështrimit dhe shijes dhe dioptrisë krijuese të studiuesit Bruqi. Flori Bruqi këtu spikat me vështrimet e tij të thukta dhe përmbajtësore, me një metodologji klasike të vështrimit: ai shkruan mbi veprën e autorit, jep mjaft shënime biografike dhe shtjellon motivet e veprës së tyre, por edhe klasifikon ndonjë nga poezitë apo prozën apo shkrimin e akëcilit që merr në theks të vështrimit.

Në të gjitha këto vështrime kritike vërehet përkushtimi dhe niveli studimor i autorit me një bagazh të mirë studimor mbi veprat dhe autorët. Poashtu autori, në secilin vështrim jep edhe të dhëna të shumta mbi veprat e autorëve, që përbëjnë opusin krijues të tyre, si informacion të plotë për lexuesin.

Janë një sërë artikujsh kritikë e publicistikë edhe për figurat e jetës sonë letrare, por edhe politike e publicistike, sikur artikulli për dr.Ibrahim Rugovën, ku Bruqi qëmton me këndvështrimet e tija, duke na sjellë përshkrime dhe vlerësimet për figurën madhore e komplekse të presidentit historik Ibrahim Rugova, por edhe për veprën e tij letrare dhe kritike që është mjaft e bujshme. Gjithashtu me interes janë edhe mjaft shkrime të kësaj natyre, siç janë p.sh shkrimet për Nënë Terezën-nderin e kombit shqiptar, pastaj vështrimet kritike për figurat letrare si për Eqrem Çabejn, Ernest Koliqin, Martin Camajn, Azem Shkrelin, Ismail Kadarenë, Prend Buzhala, Naim Kelmendin, Bardh Frangun,dhe poetë të gjeneratës më të re të postmodernes, sikur Irena Gjoni, Lediana Kapaj, Alma Papamihali, Keidi Sejдини, Thani Naqo, Jorgo Sofokli Telo, Valdete Berisha e ndonjë tjetër.

Ato që përbëjnë gamën e gjerë të vështrimeve dhe temave sintetizuese, por edhe tematike, janë disa nga shkrimet që

zënë vend në këtë vepër, si “Shkrimtari idealist shqiptar gjatë shekullit XX”, “Kritika tani ngjanë në një digë të shpartalluar, që i varen llamarinat nga erërat e fitimit”, ”Spastrimi etnik në Kosovë”, ”Shqiptarët në shtypin arab”, ”Historik i shkurtër i gjuhës shqipe” etj.

Me një fjalë, vepra letrare e Flori Bruqit: “Nëse kam ditur të guxoj”, përbën një aureolë pikëvështrimesh të qëmtuara letrare mbi veprat e shumë autorëve të shquar, vendas e ndërkombëtarë, por edhe ato mbi veprën autoriale të këtij shkrimtari, tashmë të njohur në letrat tona, me kontributin e shumë veprave cilësore letrare, poetike e publicistike, që zënë vend të merituar në “Panteonin” e letërsisë shqiptare.

## ZBARDHJE E ÇËSHTJES KOMBËTARE

**Nga Nehat S. Hoxha**

Pas një periudhe të gjatë kohore dhe pas luftës në Kosovë, si një sihariq i rrallë na vjen një vëllim i përmbledhur me shije të hollë dhe me një gamë të gjerë temash e disiplinash me larushi të begatë nga fushat e publicistikës, histories e historiografisë, diskursionit, shkencës, figurash krijuesish me rëndësi madhore nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore; nga psikologjia, mjekësia, seksologjia; nga fusha e polemikave, artikuj të inteligjencës, të cilët do të frymëzojnë dhe pajisin lexuesin tonë me informacion të kamur, vështirë se do të mund të gjente lehtë një vëllim të vetëm, siç është ky.

Poeti i frymëzimeve të “Zjarrit të Diellit” Flori Bruqi (1995), me një guxim dhe përpjekje të ngulmët flak dashurinë për poezinë dhe i rreket zbardhjes së çështjes kombëtare në Kosovë nëpërmjet diturish të nduarnduarshme, të spikatura për ndodhjet e situatat aq të ndërlikuara të shekullit të tretur dhe të këtij qindvjeçari, për të shfletuar një sasi njohurish dhe për t'i ofruar njeriut një sofër ushqimesh të sojit të vet. Është fare vetjake kjo përpjekje.

Dhe kaq e devotshme: lexuesi mund të endet nga rrafshi në rrafsh të parapëlqyer sipas shijes që ka, dhe sipas kërkesës. Temat që janë shtruar kanë aq shumë të dhëna, sa nuk ka ndodhur ndonjëherë gjëkund në një libër të mëparshëm. Urojmë shëndet e sukses për një disiplinë kaq të pëlqyeshme dhe dobiprurëse për lexuesit tanë.

## NGA FORMA ELEKTRONIKE TE FORMA E SHTYPUR

### **Nga Abdullah Konushevci**

Libri “Guxim Shqiptar” i Flori Bruqit është një përzgjedhje, një seleksionim i punimeve më të mira elektronike, botuar në faqet e rrjetit (ëeb sites), bas i të cilave që dhe është autori dhe që tash i afrohen publikut lexues të përmbledhura në një vëllim më vete.

Me një fjalë, libri është bërë që edhe publiku lexues, i pamësuar me botimet elektronike, të njihet me tema të ndryshme, që kanë gjetur një trajtim të gjerë e të denjë pikërisht në këtë formë. Pra, kemi një kalim nga forma elektronike te forma e shtypur.

Nga temat e ndryshme historike, për seriozitetin dhe thellësinë e trajtimit, tërheq vëmendjen artikullit “Mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë”, sado që janë me interes edhe disa ide të hedhura për origjinën shqiptare të perandorit francez Napoleon Bonaparta.

Një peshë jo të vogël ka kapitulli “Për Ramushin”, në të cilin është përmbledhur intervista e z. Adem Demaçi me titull “Dora e Zezë’ e serbëve vret çlirimtarët e Kosovës”, artikulli i autorit “Hero në luftë - hero në paqe: Ramush Haradinaj”, si dhe artikulli “Ramushi, viktimë e situatës (neo)koloniale”.

Megjithatë, pjesa qendrore e librit i kushtohet antropologjisë, në të vërtetë veprës “Raca shqiptare” të Jakov Milajt, ku edhe autori, pos mospajtimeve të hapura me disa autorë, jep dhe ndihmesën e vet në ndriçimin e kësaj çështjeje shumë të ndjeshme.



Në kapitullin “Politikë” kanë gjetur vend shumë tema aktuale, sikundër është çështja e pazgjidhur çame, çështja në ka 'intifadë' në Iliridë, frika që kanë udhëheqësit tanë nga kryetarii “Vetëvendosjes”, Albin Kurti me titullin shumë domethënës “Pushtetarët e kanë frikë heroin e demokracisë”, dy artikuj për mjekun e dëgjuar shqiptar, z. Namik Shehu etj.

Një kapitull që do të zgjojë interesimin e lexuesve është pa dyshim “Spiunazhi”, ku kanë gjetur vend artikujt “Agjenturat greke dhe Sigurimi i Fshehtë i Shtetit Shqiptar”, “Kush janë agjentët me influencë në Kosovë” dhe “Aktivitetet kriminale të shtyra nga shërbimet sekrete armiqësore në Kosovë”.

Por, kapitulli më i gjerë dhe më i larmishëm është “Gjuhë & letërsi”, ku hetohet edhe karakteri i ndjeshëm hulumtues i autorit, sidomos në portretizimin e figurës së Jusuf Gërvallës dhe vlerave të veprës së tij letrare; pastaj disa anë të panjohur të shkrimtarit tashmë të ndjerë, Mehmet Kajtazi etj.

Janë me interes edhe artikujt për Kolec Traboinin, Rifat Kukajn, Kozeta Zylon, Gani Xhafollin, Nehat S. Hoxhën, si dhe një varg temash nga letërsia botërore.

Libri mbyllet me kapitullin “Psikanalizë, astronomi dhe erotikë”, ku trajtohen tema nga këta lëmenj interesantë të jetës njerëzore.

## FATI I GAZETARËVE NË SISTEMIN MONIST

*Romani “Ndërgjegjia”, një kronikë e viteve të autonomisë së Kosovës*

**Nga Mehmet Kajtazi**

Romani “Ndërgjegjia” është një pasqyrim real i lidhshmërisë së prozës artistike me shkencën e mjekësisë. Derisa në prozë artistike shpaloset biografia e vetë autorit, në pjesën e librit shkencor dhe informativ shprehet respekti i tij ndaj tërë asaj që është njerëzore dhe hapërim për ti shëruar njerzëit. Autori në këtë vepër është në cilësinë e gazetarit në sistemin komunsit, kohë kjo kur për një të vërtetë jetike të shkonte edhe koka. Pavarësisht nga kjo mynxyrë, gazetari më shumë e do të vërtetën se edhe vetë jetën, andaj shpesh atij i vihen prangat. Në shërbim të atyre që i kishin prangat dhe çelësat e burgjeve ishin edhe disa gazetarë servilë, të cilët të vërtetën e mbulonin me gënjeshtër dhe vinin xëc para syve të lexuesve. Autori i “Ndërgjegjes” ua di emrat atyre, ua njeh edhe biografitë, por nuk bie në ujëra të tyre të turbullta, nuk është hakmarrës.

Mjafton që ata, shkruan autori, do të jenë njerëz që i bren ndërgjegjia, ndërsa po patën punë me shëndetin, do ti shërojnë, edhe gangrenën do t'ua heq, thotë autori.

Fati i gazetarëve të sistemit titist ishte përherë tragjik: kur u vinte vdekja nuk meritonin tjetër, pos t'u vihet mbi varr një kurorë e bërë jo nga lulet, por nga artikujt gazetaresk që i kanë shkruaar. Gazetarët e tillë e kanë penguar vazhdimisht Flori Bruqin, por ky kishte një besim të patundur, në rradhë të parë, vetveten andaj trokiste edhe në redaksitë e shteteve të largëta,

deri në “Le Monde” të Parisit dhe shkruante në këtë gazetë për njerëzit që ishin në burgjë, e ishin të pafajshëm. Këtë mund ta bënte vetëm gazetari militant.

Duke lexuar “Ndërgjegjen” e tij, her-herë, ke përshtypejn se po e sheh Markesin që ka hyrë në zonat që i ka prekur murtaja, por forca dhe vullneti për të shkruar bënë që me përbuzje të shikojë murtajën dhe të shpëtojë nga vdekja.

*Prishtinë, 28 prill 1995*

## SHQIPFOLËSIT E BARBARIZUAR

### **Nga Rushit Ramabaja**

Romani “Ndërgjegja” i Flori Bruqit, para së gjithash është një kronikë e sublimuar me gjuhë specifike të viteve të hidhura të së ashtuquajturës kohë e autonomisë, kur shkelësi shtypte Kosovën me ndihmën e shqipfolësve të barbarizuar, të cilët emrin dhe identitetin e vet e bartnin vetëm sa për t’i ndihmuar Beogradit që në sy të botës ta fshihte okupimin e këtij krahu të dhimbshëm të Shqipërisë.

Pothuaj, në çdo faqe të tij ndihet pesha e mallit të autorit (rrëfimtari) për t’u kthyer në vendlindje dhe lufta e pandërprerë e të barbarizuarve që me anë të shpifjeve, shantazheve e kërcënimeve t’ia mbyllnin udhën përgjithmonë për në shtëpinë e vetë. Këtë dhimbje, që gjithnjë pikon helm e dashuri njëkohësisht, F.Bruqit ia del mbanë me suksese që ta fisnikërojë me shkrimet mjaft të sukseshme për fytyrat më eminente të

mjekësisë botërore, por vet-veten e identifikon më së shumti me arkitektët shqiptarë që krijuan vepra madhështore larg atdheut dhe që jo rrallë bukuria mahnitëse e artit të tyre u bë kob për ta.

Ne fejtonet për mjekësinë, për njerëzit e mëdhenj të botës dhe për arkitektët tanë, unë kam parë, veç se tjerash, përpjekjen e tërthortë të autorit që ndjekësve të vet t'ua kthejë urrejtjen në dashuri, mërinë në dhimbje dhe harresën e nëmur në rinjohje.

Kjo dëshmon shkallën më të lartë të ndërgjegjes dhe vetëdijen skjshëmërisht të sublimuar kombëtare e qytetare për pajtim edhe me të pandërgjegjshmit dhe për bashkim edhe me plangprishësit.

Duke pasur parasysh këto që thamë si dhe vlerat e tjera të këtij libri, mendoj se “Ndërgjegja” e Flori Bruqit do të ketë lexues të shumtë të të gjitha shtresave sot dhe nesër, ngaqë në të gjithnjë shquhet zëri që thërret që të mos përsëritet kurrë më e keqja e së kaluarës.

*Prishtinë, 4 maj 1995*

GJURMË QË MBESIN NË FATET E HIDHURA  
TË SHQIPTARËVE

**Nga Rifat Kukaj**

...Në këtë prozë të Flori Bruqit mpleksen fatet e hidhura të njerëzve tanë si dje, ashtu edhe sot, duke i rrahur pa mëshirë e me fishkullimë rrëqethëse shtrëngata e kohës, por që nuk ia del t'ua zbehë shpresat dhe t'ua zhdavarisë ëndrrat për një të nesërme më të mirë e më të sigurtë.

Oguri i zi ngulmon, por nuk ia arrin tërësisht t'ua fshijë gjurmët e lashta, edhe pse i fërfëllon dhe i rrah si me bisht gjarpri edhe larg truallit të tyre. Mbase mu kjo golgotë (që, për fat të keq, na përsëritet), sikur ua shton edhe më shumë dashurinë për vendlindjen e shtrenjtë.

Këta njerëz të zakonshëm, me të cilët jeta tallet, përballojnë në mënyrë dinjitoze mynxyrat që u vijnë nga urrejtja e lashtë e të huajve, por dhe nga përmbushja e mjerushëve tanë shpirtshitur e të katandisur, zhveshur nga gjithqka që është njerëzore...

*Prishtinë, 26 qershor 1996*

## GJEOGRAFIA E ATDHEUT

**Nga Iljaz Prokshi, *Prishtinë, 28 qershor 1996***

Pas vëllimit poetik me titull “Zjarri i Diellit” (1995), romanit “Ndërgjegja”(1995), “Vrasësit e Liridonëve (1996), që i botoi në Prishtinë, Flori Bruqi ditë më parë në Tiranë botoi edhe romanin “Ringjallja”. Tema e romanit “Ringjallja”qon në një kohë këtu e shumë vite më parë. Është koha e “kundër-revolucionit”, e shturjeve të sistemeve, thyerjeve e digresioneve në një ambient të caktuar, të cilat shkaktojnë dramën e individit dhe kolektivitetit, që i përket edhe prozatori.

“Ringjalljen” e karakterizon një kompozicion i thjeshtë, ku rëfimi rrjedh i qetë dhe natyrshëm. Përmes ides themelore që transmetohet këtu, dalin në spikamë edhe një varg problemesh etiko-shoqërore të cilat i shkakton një pushtues jo njerëzor. Flori Bruqi, ka përcaktuar fatin e një populli të lënë jashtë kufijve të atdheut, i cili pareshtur i nënshtrohet torturave, ndjekjeve, dënimeve dhe mynxyrave të tjera makabre. Për t'i shpëtuar kësaj dhune me shumë veta detyrohen të lëshojnë vendlindjen dhe të ikën në ekzil, siç ndodh me ikjen e çlirimit për në Shqipëri, familjet e Ligan Shpatullgjanit, Demë Ali Pozharit, Mërgim Bardhit e shumë të tjerëve në shkretëtirën e Anadollit. “Ringjallja” e Flori Bruqit është një ekuivalent i kohës: me braktisje, vetmi, trishtim, që shqetësojnë jetën e njeriut edhe në çastet më të gëzuara të tij. Asociacionet që zgjojnë dialogjet, toni që u jep ngjyrë proceseve jetësore nëpër situata të veçanta dhe rrethanat e krijuara e zgjojnë kërshërinë e lexuesit. Pa dyshim se tema është provokuese dhe jep mundësi konstruktimi artistik...

## POEZI E NËNQIELLIT DHE NJERIUT PA LIRI...

**Nga Mehmet Kajtazi**

Poezitë e Flori Bruqit (disa prej të cilave ishin më parë të botuara edhe në revista dhe në gazeta tona) i lexova me një frymë. Një cilësim i tillë i leximit të poezive bëhet atëherë kur të përvetëson si vargu i parë, ashtu edhe i fundit. Temat që ngërthehen në këto vargje nuk burojnë nga inspirimet që i marrin disa poetë nga librat që i lexojnë, por Flori Bruqi inspirimet i merr nga jeta. Ato nuk mbesin vetëm inspirime, por dalin nga kornizat e një gjirme të thellë dhe si valëzat e detit të shqetësuara afrohen drejt brigjeve, por edhe kthehen në suprinën e largët të detit me emrin nënë, me emrin martizim, me emrin LIRI. Meqë poetit i mungon kjo e fundit, siç i mungon tërë Kosovës, është plotësisht e natyrshme që në shumë vargje të ketë shqetësime. Këto shqetësime ta përkujtojnë shkrimtarin Viktor Franklin, i cili edhe pse është i rrethuar me tela në një kamp fashist në vitet e dyzeta, ai gjen shpresën që ta tejkalojë mynxyrën. Ajo shpresë është te vetë harmonia në mes Tokës dhe Qiellit, e kur kjo shtrihet edhe te njerëzit, atëherë vetë Zoti është në mes tyre dhe u ndihmon për t'u çliruar. Flori Bruqit nuk i mungon, shpresa, por nuk i mungon as harmonia. E kur harmonia prek edhe brigjet e Lumit të Bardhë të vendlindjes së tij, atëherë edhe më shumë shpaloset riti i ritmit të ujit. Uji e ka ritmin e vet, që është në përputhshmëri me hapërimin e njerëzve drejt “Zjarrit të Diellit”.

*Prishtinë, 25 janar 1995*

## POEZI E SHQETËSIMIT DHE GJAKIMIT PËR LIRINË

**Nga Zejnullah Halili**

Flori Bruqi po hyn nëpër një shteg të ndritshëm në poezinë shqipe. Figura e tij në fillim të kësaj poeme na sjell shqetësime të shumta që lidhen me Tokën, me Nënë, me Gjakun, me Vallen e Shkrepare, me Baladën e Yjve, me Lotin që ka Ogur, me Zërin me Frushullimën e Krahëve, me Akuarelin e Diellit, me Lumin e Bardhë. Secili varg vendoset në patosin e Kësaj Luleje. Secila poezi ka gjetin e Vet, Dritën, shqetësimin dhe besimin, andejza, matanë errësirës pra ai këto frymëzime i zë nga jeta, sepse e nxit Bardhësia e katër vargjeve, figura e saj, shpirti shqetësues, Fjala. E fton të hyjë nëpër thellësitë e viteve, deri te kjo Kohë, deri te krahërorët masivë, deri te Deti Tekanjoz nganjëherë. Ai sfidon Amësinë Njomëzake të Teutës, fashaton plagët me fjalët figura dhe rend andej nga Përrenjtë e Ëndrrave për të shtypur lehtë e me ndjeshmëri Butonët e Dritës, për të fituar Bardhësitë e për të kërkuar shëmbëllimin me Hermesin, por atje janë qentë, jo larg, e a do ta shqyejnë si Akteonin e Penteun e a do ta martirizojnë si Ismetin, Agimin, Mujën e Salihun.

Me tutje jep Figurë për kohën që me nxitje të Eridës, perëndeshës së Grindjes, u bë një luftë e gjatë në muret e Trojës Drapri i Sinagogës është edhe këtu në baladën e Floriut, që është e yjve, e shkrepare, e bulëzave, e syrit të mprehtë, e zërit të ëmbël, të cilit Hiçi i vjen përballë mu para viteve të liga. Por, poeti në këtë hije të çastit vëren Dritën, një xixëllonjë që lufton me errësirën, së cilës do t'ia shohë sytë,



sepse aty është puthja, aty pasioni i erës, simbol i bukur i një përqaftimi jetësor aty pasioni mëtues për Fjalën, që është njëra nga vjershat më të realizuara artistikisht. Në ishullzën më të madhe të detit figurative të Floriut është edhe Nëna si Baladë, si Qëndresë e si Ëndërr Ilire, Lumi i Bardhë e ndonjë poezi tjetër, janë kthim imagjnativ i poetit nga njomësia e Euridikës, pra, Vendlindjes.

*Prishtinë, 25 janar 1995*

## **PËRGJIGJE KRASISTËVE TË HISTORISË SHQIPTARE**

**Nga Dr.sc. Fatmir Terziu**

Dhe aty ku kjo xhelozë ndeshet me modestinë dihet rezultati. Ai kurrë nuk është barazimi. Nuk është barazimi, se jo më kot e thotë populli: “Hapja, bre burrë rrugën pimësit!” e që t'ja hapësh rrugën të 'dehurit' historik apo më së shumti atij të kudondodhurit elektronik sot, atij që e ka atë në vend të shpatës, pra të nderuarit 'mik' duhet “Guximi Shqiptar”. Ai ka armën e Flori Bruqit dhe është botuar në Prishtinë.

Është ndarë në disa kapituj dhe flet për historinë, Ramushin, Antropologjinë, Politikën, spiunazhin, gjuhën dhe letërsinë, psikoanalizën, astrologjinë dhe erotikën, por ka edhe fjalën e redaktorit dhe fjalën reçensuese. Pra në më shumë se 400 faqe flet me gjuhën e thjeshtë e modeste shqipe, për modestinë e termit “Guximi Shqiptar”. Që në titull duket kapërcimi i modestisë. Vetë modestia që “buron” nga cikloni letrar i shkrimtarit Flori Bruqi, kandidat i shkencave.

Një modesti që shënon plot 30 libra. Një modesti që nuk tejkalohet, dhe as që nuk para-prezantohet. Një modesti që

shtrydh fletushkat dhe ndrydh parcelizmat e digitalit dhe elektronikës në një sipërfaqe që as vet njeriu që e krijoi s'e kupton sa xhelozi prodhon.

Ja se si shprehet vet Bruqi “Nacionalizmin neurotik serb e karakterizon resan-timani, ose ndjenja e dinjitetit të nëpërkëmbur, bindja për humbje të padrejtë, mëria për tjetrin si pasojë e përbuzjes, apeli për hakmarrje, për qërim hesapesh, për riinterpretim të historisë, por edhe si xhelozi kundër të tjerëve që janë më të suksesshëm.”

Libri më i ri i Flori Bruqit tenton të paraqesë një dritare në këtë valëzim mjegullor, që ndeshet edhe në ditët me diell. Ai në fakt nuk është në rolin e pastruesit të xhamave të kësaj mjegulle, edhe pse fjala e tij e kreh atë mjegullnajë në heshtje dhe pa shumë bujë, teksa ka librat makrometrik të parametrave leksikorë e sfumojnë paralizën kohore dhe detajojnë të sotmen, të shkuarën me të sotmen në alteracion dhe presupozojnë të ardhmen. Prania shtjelluese e disa penave shqiptare tek “Guximi Shqiptar” e bën veprën e Bruqit t'i buzëqeshë të gjithë potencialit lexues.

Aty gjendet përgjigja për “A është Rifat Kukaj një thesar shqiptar?”, “Në vend të përkujtimit: Mehmet Kajtazi”, “Kush është Kolec Traboini?”, “Keze (Kozeta) Zylo”, “Kush është Gani Xhafolli?”, “Kush është Nehat S. Hoxha”, “Muxhahe-dinët si «Gold-en Boys»”, “Persekutimi komunist mbi vajzat e Bajram Currit”, “Polemikë pa dorashka”, “Gërmime në llagëme të pista”, “Letër e hapur organizatorëve dhe spektatorëve të koncertit të Goran Bregoviqit” e mjaft të tjera shkrime të kësaj kategorie. Më tutje Bruqi thekson: “Çuditërisht, askush nga deputetët nuk parashtroi pyetjen sesi ata do

ta arrinin të menaxhonin, të dilnin në krye me një Kosovë forcërisht të aneksuar, me dy milionë shqiptarë të mllëfosur dhe të armiqësuar me shtetin?

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, së pari duhet të analizojmë natyrën e nacionalizmit serb, e cila prodhon aberracione ciklike të politikës serbe nga rrjedhat normale historike.” Duke iu rikthyer xhelozisë ai shton: “Mëria zakonisht ka prodhuar konflikte serbe me fqinjët, ndërkaq xhelozia ka prodhuar antievropianizmin fanatik. Kur filloi e gjitha kjo? Kur dhe kush e zbuloi mitin e Kosovës?”

Duke lexuar “Guximi Shqiptar” natyrshëm sqaron edhe detaje të tilla: “Kur nisi ky ortek i irracionalizmit? Zakonisht mendohet se etnologu serb, Vuk Karaxhiq, është prodhuesi i këtij miti, por misionin hulumtues atij ia besoi etnologu dhe linguisti i njohur slloven J. Kopitar, i cili bashkëpunonte ngushtë me Gëten. Shkrimtari gjerman kishte obsesion periudhën antike greke, kohëngjë sipas tij, në qenien e njeriut ka ekzistuar harmonia mes elementit apolonik (racional) dhe atij dioniziak (irracional, emotiv). Gëte mendonte se qytetërimi perëndimor lëngon nga ngadhënjimi i plotë i racionalizmit, që e vlerësonte sinjë shkarje të rrezikshme. Ai kishte shpresë të madhe se harmonia e dikurshme antike mund të gjendej ende në baladat e popujve të Ballkanit”.

Po a mundet të shkruhet ndryshe historia? A mund të ndriçohet realiteti i saj? Përgjigja e Bruqit ndodhet në “Guximi Shqiptar...”

## SFIDA SHKENCORE TË NJË LIBRI TË GUXIMSHËM

**Nga Akademik Prof.dr. Namik M. Shehu**

Libri a përmbledhja e studimeve “Guxim shqiptar“, e intelektualit, studiuesit dhe shkencëtarit Flori Bruqi, konceptohet si një punim kompleks historiko-letraro-shkencor me vlera, përmasa dhe hapësira shumëdimensionale, të përfshira në tetë kapituj, me 45 tematika, dhe me 382 faqe; me materiale mjaft të zgjedhura dhe me interes, të studiuara dhe të përpunuara me kujdes të veçantë dhe të shkruara me vërtetësi reale, historike dhe kombëtare; në të cilën përmbledhet një game e gjerë dhe mjaft e larmishme e shumë fushave të jetës të së kaluarës dhe të së përditshmes, që kërkohen dhe janë të nevojshme të njihen, të mësohen dhe të përvetësohen nga gjithësecili, për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të tyre në punë dhe në veprimtari.

Titulli i librit “Guxim shqiptar” përbën në vetvete një vlerësim special dhe një gjetje shumë të goditur të autorit, shprehur në mënyrë simbolike, që i lejon çdo patrioti shqiptar, me ndjenjë atdhedashurie, të zgjojë dhe të ringjallë tek ai: kombin (etnik) shqiptar, popullin e lashtë pellazgjiko-Iliro-shqiptar, legjendat e kahershme martire edhe të Mujës dhe Halilit, traditat zakonore, besën shqiptare, trimëritë heroike, të koduara në kanune dhe të trashëguara brez pas brezi si të shenjta dhe të paprekshme, duke u bërë simbol i vëllazërimit ballkanik, si është treguar gjatë historisë shekullore dhe të propoganduar nga të huajt.

Konsiderata më e veçantë e librit duhet të jetë përfundimi që do të nxjerrë lexuesi nga leximi i librit, i cili mendoj dhe

konkludoj se do të përmbliidhet në qëllimin që i ka përkushtuar vetes autori: në kontributin, mbështetjen dhe dashurinë që manifeston ai për Mëmëdheun, duke Ju përkushtuar në gjithçka dhe për çdo gjë, që qartazi shprehet dhe duket gati në çdo artikull që lexohet në libër, ku ndihet dhe konceptohet patriotizmi, ndjenja atdhetare, emri ilir, epirotas, arbëresh, shqiptar, që kudo e ndesh. Shkurt, nënkuptohet boshti ideor atdhetar, i pushtuar me brezin e kuq shqiptar mbarëkombëtar.

Ndërsa, vlera e vetë autorit Flori Bruqi duhet çmuar dhe admiruar me korrektësi dhe me modesti, përpara këtij punimi vëllimor, me tematikë të shumëllojshme, të profileve të ndryshme dhe me materiale të bollshme dhe me vështirësi interpretuese; të cilat janë paraqitur me mjeshtëri, me një mori njohjesh teknike, profesionale dhe artistike, të cilat i kanë dashur autorit kohë, mund, sakrifica dhe mjaft durim për t'i përballuar dhe për të arritur suksesin e merituar. Ato duhet ta gjejnë shpjegimin e vet të vlerësimit në përgatitjen e tij të lart profesionale, në njohjen mjaft të mirë të gjuhës shqipe, të pastërtisë dhe rrjedhshmërisë së saj, si dhe të shumë gjuhëve të huaja, të profesionit të vet; të vullnetit dhe durimit të një intelektualit të aftë, mjaft aktive dhe konsekuent për t'ia arritur qëllimit. Bindje për këtë mund të formosh nëse u referohesh punimeve dhe veprimtarisë letrare, artistike dhe shkencore që ka realizuar dhe kryer autori, në një kohë të shkurtër, ku brenda 11 vjetëve ka shkruar 24 vepra madhore të gjinive të ndryshme si dhe mjaft shkrime shkencore, që e kanë detyruar të bëjë “haram“ edhe gjumin.

Zbërthimi analitik që mund dhe duhet t'i bëhet librit “Guxim shqiptar” është shpërblimi më adekuat, më i pranueshëm

dhe më i zakonshëm që kërkon dhe që duhet t'i jepet me të drejtë autorit, siç e meriton, me gjithë vështirësitë objective dhe subjektive që hasen. Në kapitullin e parë mbi “Lashtësinë e historisë“ autori ka meritë se ka ditur të zgjedhë dhe të na përfaqësojë historinë tone në periudha kohe të ndryshme, duke përfshirë tërë territorin iliro-arbëror me tema të denja, historikisht dinjitoze, me mburrje kombëtare dhe me të kaluar heroike.

Shkrimi “Pirrua i Epirit”, kontibut i z. Sitky Jahjaj, i qëmtuar me vërtetësi nga autori Bruqi, është mjaft i qëlluar në këtë libër; se na njeh me sundimtarin më të shquar të Epirit, pasardhës i Akilit, i biri i Aiakidit dhe përfaqësues i denjë iliro-epirot dhe strateg i zoti, që diti të fitonte mbretërinë e humbur më 296 p.e.s. dhe që epirotët për trimërinë e tij e thërritnin 'shqiponjë'dhe ushtarët ai i quante 'bij të shqipes', duke krijuar më pas traditën shqiptare. Pirrua e rriti autoritetin e tij dhe të epirotasve, pellazgjiko-ilir me aftësi, trimëri dhe zgjuarsis, sa maqedonasit e shëmbëllyen me Aleksandrin e Madh dhe e ftuan për ta udhëhequr. Pirrua ëndërronte perandori në perëndim. Ai i shkoi në ndihmë Tarantos kundër romakëve, që vërtet fitoi, por në histori ka hyrë me shprehjen “fitore si e Pirros “. Ai, në Sicili, më 278 p.e.s. mundi kartagjenasit; por karriera e tij aq e lavdishme u shemb në muret e Argosit nga goditja e një gruaje.

Artikulli “ Beteja e Kosovës 1389 dhe kontributi i shqiptarëve “është një meritë tjetër e autorit, sepse evidencon rëndësinë e betejës së Kosovës si bashkim-unitet i ballkanasve kundër Perandorisë Osmane, si vendi i betejës së Fushë-Kosovës, të pjesëmarrjes së popullsisë masive të krahinës së

Kosovës dhe vlerëson Milosh Kopiliqin si trim kosovar, i quajtur edhe princ arbëror, që Car Llazari, mbreti i Serbisë dhe komandanti i betejës së Kosovës, pranoi të zhvillonte një bisedë “kokë më kokë” me të si një komandant ushtrie, me historinë e një trimi që vrau sulltan Muratin II dhe ra si dëshmor, kurse popullsia kosovare e përjetësoi në këngë dhe e ktheu në legjendë të vërtetën e tij.

Në këtë betejë të koalicionit ballkanik, autori ka meritë se e pësjtjellon ngjarjen me korrektësi. Faktin bashkëpunimin e dhëndurëve të Car Llazarit, Gjergj Ballshajt dhe Vuk Brankoviçit me takimin e tij në 1388 për koalicion, se përmend luftëtarët e shquar shqiptarë, si: Gjergj Ballshaj, Theodor II Muzakaj i Beratit, i cili u vra në betejë, për të cilët flasin edhe kronikat turke; se Beteja e Kosovës u mbështet nga një koalicion i gjerë, ku morën pjesë serbët, Vuk Brankoviç që drejtonte popullatën e Kosovës, shqiptarët dhe boshnjakët, duke iu kundërvënë historiografisë falsifikuese serbe, që mohon forcat e koalicionit, injoron historinë, ul vlerën e pjesëmarrjes së shqiptarëve dhe të boshnjakëve dhe akoma më keq, Milosh Kopiliqin e bëjnë serb dhe i shtrembërojnë mbiemrin. Këto konfirmohen nga vetë serbët, që u “zgjuan” vonë për ta njohur, besuar dhe për ta propaganduar betejën e Kosovës si mit në favor të tyre, kur etnologu Vuk Karaxhiç u kujtua dhe mblodhi disa rapsodi nga një i verbër rreth betejës së Kosovës, që më pas i besuan dhe ata vetë. Çudia vazhdoi edhe në ditët tona, shpjegon autori, kur Slobodan Millosheviç, për interesat e veta, të forcimit të pushtetit politik dhe moral, mitin e betejës së Kosovës e ktheu në thirrje për unitet, ku gjente edhe shkakun e humbjes së betejës dhe për jehonë organizoi 600-

vjetorin e saj me pretekst për të rindërtuar apo dëbuar shqiptarët dhe për të luftuar kundër pavarësisë së Kosovës me terma të irredentizmit islamik, të terrorizmit, apo krimit të organizuar, të fabrikuar po nga ata vetë.

Mbrojta e Plavës dhe e Gucisë e viteve 1879-1880 është një dukuri tjetër e autorit, që dëshmon për atdhetarizëm, duke dokumentuar heroizmin dhe patriotizmin e pashoq të krahinës së Plavës dhe të Gucisë, të heroit të krahinës, Ali Pash Gucisë me shokë, të Kosovës, të Lidhjes së Prizërenit, të gjithë Shqipërisë, në mbrojtje të së drejtës dhe të tokave shqiptare, me vendosmëri, me luftë të pandërprerë, me gjakderdhje të pashoqe dhe me diplomaci kundër malazezëve, që sulmuan dy here në mënyrë të organizuar dhe me egërsi për të pushtuar Plavën dhe Gucinë në dhjetor 1879 dhe në janar 1880, por u sprapsën me trimëri, me guxim nga forcat e organizuara shqiptare, edhe pse u përdor dredhia dhe përkrahja e Fuqive të Mëdha. Evropa e kuptoj më në fund se vendi atje ka zot shqiptarët.

Dëshmitë dhe faktet angleze mbi konfliktin shqiptaromalazez rreth Plavës dhe Gucisë të viteve 1879-1880 të përmbledhura në librin e studiuesit Idris Lamaj botuar në Nju-Jork në 1999; konfirmojnë pa ekuivokë shkrimin e autorit Bruqi. Në vazhdim përmendim artikullin” Skënderbeu dhe rëndësia e infrastrukturës logjistike për të udhëhequr luftën “që autori me të drejtë e paraqet si një aspekt të rëndësishëm dhe tepër të veçantë të epokës luftarake të Gjergj Kastriotit, që historiografia dhe Sesioni Shkencor i Akademisë tonë, kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut e kishin mënjanuar atë, duke e kthyer në legjendë strategjinë dhe



betejat e tij luftarake, të cilat mbeten si të fundit. Ky shkrim shfaq interes dhe ka vlerë se për herë të parë evidentohet një koncept i ri, një ekspozim i një faze përgatitore dhe një moment vendimtar që duhet t'i jepet rëndësi në arritjen e suksesit të fitores së betejave, të vlerësuara me të drejtë edhe nga vetë Skënderbeu, që del më se qartas në artikull. Sekretit i Gjergj Kastrioti –Skënderbeut, që i rezistoi Perandorisë Osman dhe fitoi, i dedikohet jo vetëm se ishte vërtet i zoti si strateg, por më tepër se ai iu kushtua dhe kuptoi rëndësinë e infrastrukturës logjistike për të udhëhequr luftën, duke u mbështetur nga suita e tij jofisnike, përbërë nga klerikë, e nga grupi i tij laik, që kryenin punën e diplomacisë, të legatave në qytetet e Italisë, të tregtisë, të lidhjes e bashkëpunimit me shtetet fqinje të Evropës Juglindore dhe Perëndimore nga ku siguronte paranë, armatimet, pagesën e mirë të ushtarëve, bazën financiare dhe organizimin. Në këtë shkrim del se si strategji të tij, Skënderbeu kishte Rodonin si kështjellën kryesore dhe se Lezha për të ishte udhë-lidhëse midis detit dhe malësisë.

Shkrim tjetër kurioz, origjinal dhe me interes mbetet “Napoleon Bonaparti dhe shqiptarët”, ku autori jep informacione, njoftime historiko-premtuese mbi origjinën autentike edhe të mbiemrit të Napoleonit, perandorit të Francës .Studimet e autorit hapin fushë veprimi, sjellin burime të besueshme, mendime dhe citime optimiste të mjaft autorëve autoritarë të huaj, që na konfirmojnë bindjen dhe konsideratën që kanë të huajt të pranojnë se heronjtë e tyre kanë origjinë shqiptare dhe që meritojnë përgëzime. Shkrimi sjell citimin e R. Anzhelit, qëi kujtonte botës se Napoleoni

është po aq shqiptar sa edhe Aleksandri i Madh dhe Skënderbeu, ku folklori popullor e ka rrënjësuar në këngë: Ti shqipe ishe e Aleksandrit, zaptove botën dhe vajte deri në Indi.

Me Pirron vojte kundra romakëve me Skënderbeun pëmbi osmanllinj. Na kujton dëshminë e Xhozefinës për prejardhjen nga Mali i Peloponezit të Napoleonit, thënien e vëllait të Napoleonit se kemi orgjinë arbëreshe, afrimi i Napoleonit me Ali pashë Tepelenën, dënimi nga ana e Napoleonit e gjeneralit të tij, që i theu në besë shqiptarët, si dhe supozimet se a dinte shqip Napoleoni, a i njihte zakonet shqiptare, na mbushin me krenari të ligjshme se trualli iliro-shqiptar ka rritur brezni trimash dhe burra të mëdhenj shteti, duke sjellë plot shembuj edhe nga historia.

PAS LEXIMIT TË ROMANIT TË FLORI BRUQIT  
“PALLATI I AKERONIT”

**Nga Mr. Sci. Prof. Selim Krasniqi**

Krijuesi Flori Bruqi, është autori i 41 veprave letrare dhe shkencore, të botuara në Prishtinë dhe Tiranë. Ka botuar një numër të madh shkrimesh në Kosovë, Shqipëri, Amerikë, Angli, Francë, Itali, Gjermani, Kroaci etj., dhe merret edhe me publicistikë. Është drejtor për marrëdhënie me medie pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane Nev York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Në vitin 2000, autori në fjalë botoi romanin, me titull simbo-lik “Pallati i Akeronit”, në të cilin krijuesi me mjeshtri artistike e përshkruan periudhën më të dhimbshme të popullit tone, atë të luftës. Në këtë roman, autori i prekë pikat më të qenësishme të veprimit të disa skribomaneve, gazetarëve, historianëve, politikanëve, apo siç thotë autori, kukudhëve, njerëzve të UDB-ës. Romani është i ndarë në 18 kapituj të lidhur në mënyrë kontinuele me një mesazh të qartë, që të flakën dukuritë e shëmtuara, si: thashethemet, përgoimet, klanet, linçimet, sepse krijuesi duhet të merret vetëm me anën letrare dhe figurative. Kryeprotogonisti i këtij romani është uran Dugagjini, i cili njësohet me vetë autorin, i cili ndiqet hap pas hapi nga kukudhët dhe cerberët e shumtë.

Vetë titulli i romanit tregon se “Pallati” është i mbushur me mjaft kukudhë e cerberë të nëntokës, sepse vetë Akeroni, sipas mitologjisë greke, është emir i lumit të mbretërisë së nëntokës. Krahas persiatjeve të shumta të Uranit, autori, me mjaft mjeshtri e përshkruan luftën e UÇK-së në tërë Kosovën.

## VEPËR ME INTERES TË GJERË LETRAR

*(Rreth opusit letrar të autorit Flori Bruqi)*

**Nga Dr. Lumturie H. Haxhij**

Shkrimtari Flori Bruqi, nga Prishtina, që në periudhën e kaluar kishte bërë emër më tepër si gazetar dhe atë prej kronisti, iu rrek edhe fushës së letërsisë, duke botuar kështu poezi, tregime, novela, romane, dhe libra shkencor. Vepra e tij kap një volum prej 10 librash “Zjarri i Diellit”(poezi,1995), “Ndërgjegjja”(roman, 1995), “Vrasësit e liridonëve”(roman, 1996), “Ringjallja”(roman, 1996), “Gjarpërinjtë e pallatit”(roman, 1996),”Dorezëza”(roman, 1997), “Tokë e djegur”(roman,1998), “Burri dhe gruaja” (libër-publicistikoshkencor,2000), “Pallati i Akreonit” (roman,2000), “Vademecum DDD”(libër shkencor,2002).

Duke lexuar këto vepra, siç shprehet edhe kritika që e ka përcjellë botimin e tyre, shprehja e autorit është mjaft e lirshme, kemi të bëjmë me ngjarje të vërteta, të përjetuara, gjithmonë bazuar në realitetin objektiv, veçanërisht gjatë periudhave të ndryshme, që nga shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi, e cila jepet në romanin “Ringjallja” e gjer te temat politike, që e kanë shtyer njeriun të demostrojë, të rebelohet dhe më në fund të bëjë sfidë kundër regjimit, spiunëve dhe kukudhëve të ndryshëm çfarë kanë vepruar në Kosovë dhe në shtetin amë Shqipëri (veprat: Ndërgjegjja, Gjarpërinjtë e pallatit, Pallati i Akreonit).

Vepër me motive të ndryshme Romani “Ndërgjegjja”(1996) është më tepër një kronikë e sublimuar, thotë shkrimtari Rushit Ramabaja, dhe vazhdon: Ajo ka një gjuhë

specifike të viteve të hidhura, kur Beogardi në sy të botës proklamonte ndryshe dhe mabnte nën okupim popullin shiptar, ndërsa këndeje shtypte lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve, në mënyrë më barbare. Ndërkaq, romansieri Mehmet Kajtazi për këtë roman shprehet se “disa gazetarë sevilë, të cilët të vërtetën e mbulonin me gënjeshtër, emrat e të cilëve diheshin-atëbotë, mirëpo, autori Flori Bruqi nuk bie në ujëra të turbullta dhe nuk është hakmarrës”.

Dy autorë, kritikë dhe mbase njëri botues apo redaktor, kurse tjetri recensent për romanin “Gjarërinjtë e Pallatit” (1996) shprehen mjaft pozitivisht. Z.Nikolë Frangaj, nga Shkodra, shkruan kështu: “Autori për më tepër në këtë roman i bën një kritikë të hapur atyre gazetarëve qyqarë, që i përshtaten regjimit, shënon për më tepër aktet absurde të tyre, del Flori Bruqi 54 përballë tyre dhe sfidon”. Ndërkaq, Prof. Arian Blushi, nga Tirana, thotë se “Ligji i fortë”, anathema dhe censura që u bëhet shkrimtarëve dhe njerëzve të penës nga regjimi komunist është temë e romanit “Gjarpërinjtë e pallatit”, të Flori Bruqit”. “Uran Dukagjini, një intelektual i pavarur, një shkrimtar bie ndesh në regjimin komunist jugosllav dhe argatët e tij, i cili vrojton pjesën më të shëmtuar të një shteti të çoroditur”, shkruan Blushi.

Romani “Pallati i Ankreonit” (2000) është i ndarë në 18 kapituj të lidhur në mënyrë kontinuele me një mesazh të qartë, që të flakën dukuritë e shëmtuara, si thashëthemet, përgojimet, klanet, sepse krijuesi duhet të merret vetëm me anën letrare dhe figurative. Prof. Selim Krasniqi për këtë roman thotë: “Vetë titulli i romanit tregon se “Pallati” është i mbushur me mjaft kukudhë e cerberë të nëntokës, sepse vet

Akeroni, sipas mitilogjisë greke, është emri i lumit dhe mbretërisë së nëntokës. Krahas persiatjeve të shumta të Uranit, autori me mjaft mjeshtri, e përshkruan luftën e UÇK-së në tërë Kosovën, si në Drenicë, Dukagji, Llap, Shalë, shkruan për “Kosova-press”-in (2000), Prof.Krasniqi. “Romani që ka zgjuar interesin më së shumti të lexuesit është pa dyshim romani “Vrasësit e liridonëve”(1996), roman ky që pas botimit të tij në Prishtinë, u ribotua edhe në Tiranë e Nju-Jork. Autori Bruqi, që e shkroi një roman të tillë, në radhë të parë shpreh jo vetëm talentin e tij, por edhe guximin, që t'u rreket temave të tilla”...shkroi shkrimtari Bedri Halimi.

Romani”Vrasësit e liridonëve” është një lloj apologjie kushtuar Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekës, si dhe disa patriotëve të tjerë si Enver Hadri e ndonjë tjetri. Vetë tema e romanit ”Vrasësit e liridonëve” thotë shkrimtari dhe shkencëtari dr.Shyqri Galica (“Zëri i Kosovës”,1996) është sugjestive, e kapshme për lexuesin.

Aktet barbare mbi popullin shqiptar nga regjimi serbian nuk pushonin, u desh të ngihet një gjeneratë e re intelektualësh, mërgimtarësh që të sfidonin mbi këtë katrahurë të së keqës. Kush tjetër pos një Jusufi, Bardhoshi, Kadriu dhe Enveri, si dhe shumë të tjerë.

Vrasësit e Liridonëve apo synimet baladeske Autori Flori Bruqi,thotë shkrimtari Gani Xhafolli, (“Fjala e jonë”, 1996) nuk kufizohet shumë vetëm në jetën e tyre,por bën një paralelizëm midis të keqes, barbararisë dhe aktit të vetëflijimit, një synim ky baladesk, plot guxim , një ndjenjë e mosnënshtrimit çfarë është veprimi i vëllezërve Gërvalla e Kadri Zekës, Enver Hadrit e shumë e shumë të tjerëve, të cilët i vrau UDB-

“Romani “Vrasësit e liridonëve” është një roman më tepër politik dhe pikërisht Nëse kam ditur të guxoj 55 trajton një periudhë shumë të ndieshme, shumë tragjike, atë të viteve 80-ta, kur regjimi i Beogradit shtypte demonstruesit shqipëtarë, i ndiqte, i burgoste dhe i vriste më në fund.

Për të shtruar duke zgjedhur një temë të tillë, autorit Flori Bruqi, iu ka dashur të njohë më mirë shpirtin revolucionar të Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës, natyrisht, nëse nuk ia ka arritur gjer në pikën më të ndieshme, mjafton që i ka hyrë kësaj teme dhe mendoj se është vepra e parë që iu kushtohet këtyre patriotëve të lëvizjes kombëtare”, shkroi për këtë roman (“Rilindja”,1996) poeti Esat Loshi.

LEKSIKONI ENCIKLOPEDIK I AKADEMISË SHQIPTARE  
AMERIKANE TË SHKENCAVE DHE ARTEVE  
NJU JORK-PRISHTINË

**Nga Akademik Dibran Fylli**

Botimi i parë i “Leksikonit enciklopedik ” për akademikët e Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane etj, shpresojmë që do të plotësojë zbrastësirat në zhvillimin e shkencës, kultures dhe letërsisë shqiptare, ngase një doracak të tillë nuk ka ekzistuar.

Pas tranzicioneve demokratiuke në trojet shqiptare dhe diasporë zhvillimi i shkencës, letërsisë, artit etj., mori hov si kurrë më parë. 28 Nëntori i vitit 1995 shënonoi këthesë historike për themelimin e Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në New York. Themelues të Akademisë janë: Prof. Dr. Skendër Kodra, Dr. Ulvi Vehbiu, Dr. Adem Harxhi, Dr. Namik Shehu, Mentor Mata, Sanie Selita etj. Akademia në fakt është një institucion mbarë kombëtar ngase ka anëtar nga Prishtina dhe Tetova e Presheva, nga Tirana, Shkodra e Gjrokastra..., dhe Diaspora. Bashkarisht në këtë Akademi organizuam një sër aktivitetesh shkencore dhe kombëtare si fjala vjenë Konferenca kushtuar 600-vjetorit të lindjës së Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skenderbeut, 70 vjetorit të lindjës së shkrimtarit të shquar Ismail Kadare. Konferenca për gjuhën e njësuar shqipe, ku senator i gjuhës dhe kulturës kombëtare Prof. Peter Prifti mbrojti me argumente origjinale rëndësinë historike të Kongresit të Drejtëshkrimit në Tiranë 1972, kundër qëndrimeve subjective, politike dhe antishkencore të profesor Arshi Pipës.



Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork punimet e tyre shkencore i kanë botuar në revistën shkencore të Akademisë AAAS “Dituria”.

Ndërsa në vitin 2019 kjo Akademi i botoi dhe përuroi në Prishtinë dy libra të autorëve nga Kosova: Dibran Fylli “Tokë e mbjellë në Varre”(Krimet Serbe në Kosovë 1998-1999) si dhe libri i Jahja Llukës “Përmbledhje shkrimesh”.

Është përgatitur për botim libri i parë “Leksikon enciklopedik”, i cili sadopak do ti plotësojë zbrazëtësitrat që janë hetuar në zhvillimin e shkencës, letërsisë, artit, kultures etj. ngase një doracak i tillë biografik dhe bibliografikë deri me tash nuk ka ekzistuar.

Shkencëtarët dhe shkrimtarë tanë etj., edhe pse jetuan dhe krijuan në rrethana të caktuara, ata identitetin e tyre kombëtar e dëshmuuan me veprat e tyre, me përmbajtjet e veprave, me personazhet, me ambientin, e madje edhe me deklaratat e tyre së janë shqiptarë.

Gjatë shkrimit të këtij doracaku për 4 vjet pandërprerë na kanë përcjellë edhe probleme të ndryshme në grumbullimin, verifikimin dhe sistemimin e të dhënave.

Rritja në numër e anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Arteve me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup, ka sjellë prej kohësh nevojën e një enciklopedie ku të pasqyrohet kontributi i anëtarëve të kësaj Akademie që jetojnë në trojet shqiptare dhe në Diasporë. Libri “Leksikon enciklopedik” vjen si një kontribut i çmuar i kësaj akademie që nga themelimi i saj në vitin 1995 e deri më sot.

Pas një pune të mundishme dhe të suksesshme autori më bashkëpunëtorët e tij ka arritur që t`i japë lexuesit edhe këtë

Enciklopedi biografike dhe bibliografike të akademikëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit si dhe disa intelektualëve tjerë që kanë lënë gjurmë në shkencë, letërsi dhe art.

Në këtë mënyrë kemi një tablo të plotë të këtyre autorëve dhe veprave të tyre në Shqipëri dhe Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, në Luginën e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, Çamerisë dhe në Diasporë.

Autori së bashku me Stafin redaksional ka punuar me dashuri dhe përkushtim në mbledhjen e këtyre biografive dhe bibliografive të këtyre njerëzve të shquar të trojeve shqiptare dhe gjithashtu të Diasporës shqiptare.

Shumë prej tyre nuk rrojnë më, ndaj dhe marrja e informacionit ka paraqitur vështirësi. Mirëpo këmbëngulja e tyre ka bërë që asnjë prej këtyre anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve të mos mungojë, madje të mos mungojë asnjë vepër e tyre.

Kjo tregon seriozitet dhe përgjegjësi, kur merr përsipër të shkruash vepra të përmasave të tilla madhore.

Nuk kanë hyrë në “Leksikon enciklopedik” ata që nuk kanë vepra shkencore, letrare etj., të botuara si dhe ata që nuk i kanë dërguar më kohë biografitë dhe bibliografitë e tyre.

Njerëzit e interesuar do të kenë mundësinë të njihen jo vetëm me shtrirjen gjeografike ku veprojnë këta autorë, por dhe prurjet shkencore që ata kanë sjellë në të gjitha fushat e dijës njerëzore. Ky libër enciklopedik do t`u vijë në ndihmë mësuesve dhe nxënësve, pedagogëve dhe studentëve, kërkuesve të rinj shkencor dhe gjithë atyre që janë të interesuar të thellojnë dijet e tyre.

Bashkëveprimi dhe shtrirja gjeografike ku veprojnë këta autorë ka sjellë një përbashkim të vlerave të krijuara, kanë nxitur njëri-tjetrin për t'u thelluar më tej në fushat ku ata krijojnë, studiojnë apo hulumtojnë.

Rezultatet kanë qenë të kënaqshme dhe lexuesi do të shohë prurjet e secilit autor në fushën përkatëse, sidomos në mjekësi, inxhinieri, shkenca ekzakte, letërsi dhe albanologji, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me identitetin e kombit tonë i cili në rrjedhë të mijëvjeçarëve ka lënë gjurmët e tij.

Ka qenë dhe është detyrë e anëtarëve të kësaj Akademie të thellojnë punën kërkimore shkencore në fushë të Shkencave ekzakte, mjekësisë, teknologjisë, albanologjisë duke shkuar në thellësi të mijëvjeçarëve.

Kjo Enciklopedi është hartuar në mënyrë të tillë që nga lexuesi i zakonshëm e deri te studiuesit e fushave të ndryshme të kenë mundësinë që të njihen me arritjet e secilit autor dhe të përzgjedhin prej tyre atë që ata kërkojnë.

Ajo duke patur biografinë dhe bibliografinë e një numri të konsiderueshëm autorësh ka përfshirë të gjitha fushat e dijes duke filluar me arritjet në shkencat natyrore dhe veçanërisht në fushën e mjekësisë, në albanologji dhe gjuhësi, në histori dhe filozofi, në art dhe letërsi, në ekonomi dhe në çdo sferë tjetër të dijes njerëzore.

Artikujt dhe studimet e këtyre autorëve përfshijnë figurat më të rëndësishme historike që u kanë dhënë emrin e tyre ngjarjeve më kulmore të historisë sonë.

Kjo enciklopedi përfaqëson një vepër shkencore. Në kumtesat dhe studimet e këtyre autorëve do të gjesh botën shqiptare në të gjithë dimensionin e saj historik nga lashtësia

deri në ditët e sotme. Kjo vepër ka identitet të spikatur kombëtar. Autorët që përfshihen në këtë botim enciklopedik kanë sjellë kontribute të rëndësishme në shkencë dhe arte, sidomos arritjet në fushë të mjekësisë, teknologjisë, jurispondencës, ekonomisë, albanologjisë etj.

Një nga figurat qendrore të kësaj akademie ka qenë kryetari i saj Prof. dr. Skëndet Kodra, i cili munda të përba-shkojë dijen shqiptare dhe më gjerë, të shtrirë në pesë shtetet ballkanike ku shqiptarët janë pjesë e rëndësishme e tyre dhe në Diasporë dhe që ky kontribut shqiptar po ngrihet vazhdimisht drejt nivelit botëror.

Tashmë Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe e Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup është bërë epiqendra e mendimit akademik që prodhohet në trojet shqiptare duke sjellë gjallëri dhe freski në fushë të artit dhe shkencave.

Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve është mbështetur fort mbi arritjet e deri tanishme të dijetarëve shqiptarë, i ka parë kontributet e tyre akademike si arritje të çmuara dhe i ka vlerësuar vazhdimisht.

Por çdo arritje është njëkohësisht pikënisje nga ku fillon e ngrihet një arritje tjetër. Në këtë kuptim, duke ruajtur vlerën e arritur, janë bërë përpjekje për arritje të reja dhe që këto kontribute akademike janë të rëndësishme sidomos në fushë të mjekësisë, albanologjisë etj.

Albanologjia ende nuk e ka thënë fjalën e saj përfundimtare, sepse kërkohen studime të thelluara në gjuhësi dhe antropologji, në histori dhe arkeologji, në besimet pagane që emërtohen pellazgjike dhe që kanë bashkëjetuar me

shqiptarët deri në ditët e sotme. Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve, si akademi e trojeve shqiptare dhe e Diasporës u ka dhënë një ndihmesë të çmuar shkencave ekzakte dhe atyre shoqërore, veçanërisht në fushë të Albanologjisë, ku gjithnjë e më shumë, anëtarët e kësaj akademie kërkojnë të depërtojnë në atë histori që nga historianët quhet parailire.

Nëse për grekët historia para helene apo pellazgjike është e dokumentuar prej autorëve të antikitetit dhe helenët nuk kanë patur asnjë lidhje gjenetike me pellazgët; shqiptarët e sotëm ruajnë tradita dhe zakone që e kanë zanafillën nga ajo periudhë që autorët e antikitetit i emërtojnë pellazgjike siç është adhurimi për lisin e shenjtë apo adhurimi për malin e Tomorit që kanë qenë rite që kanë përcaktuar identitetin e asaj popullsie që quhej pellazgjike.

Disa nga studimet që janë marrë me periudhat para ilire janë të nivelit akademik dhe përbëjnë arritje të këtij institucioni në botën akademike shqiptare.

Disa nga arritjet e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, kanë prekur në thellësi sferat e dijes njerëzore, aty pasqyrohet qartë identiteti ynë kombëtar, autoktonia e shqiptarëve në trojet e veta, marrëdhëniet me popujt e tjerë prej të cilëve ka dhënë dhe ka marrë çfarë shoqëria njerëzore ka arritur në shkencë dhe arte dhe që kanë shërbyer për një ecje të sigurt të njerëzimit drejt progresit dhe përparimit shoqëror.

Aty do të gjesh të pasqyruara marrëdhëniet e popullit tonë nga qytetërimet e lashta mesdhetare deri në ditët e sotme. Në studimet e autorëve që janë marrë me historinë e shqiptarëve

dhe të trojeve të tyre del në dukje se uniteti i shqiptarëve ka patur në themel tolerancën dhe harmoninë midis tyre, tipare që janë manifestuar në të gjitha fushat e jetës.

Në këtë enciklopedi do të gjesh autorë me veprimtari të gjerë dhe me vlera të spikatura në fushën e mjekësisë, teknologjisë, biznesit, gjuhësisë të cilat konsiderohen studime të mirëfillta shkencore duke i dhënë një shtysë të mëtejshme shkencës shqiptare në veçanti .

Raportet e gjuhës shqipe me gjuhët e popujve fqinj, që nga antikiteti deri në ditët e sotme janë dëshmi e sigurt e ekzistencës së shqiptarëve në trojet ku jetojmë sot që nga kohët parahistorike. Këto studime gjuhësore janë shoqëruar me një dokumentacion të pasur dhe me burime të drejtpërdrejta nga autorë shqiptarë dhe të huaj që janë marrë me origjinën e shqiptarëve dhe gjuhës shqipe.

Letërsia shqipe është gjetur në këto vitet e fundit në kuota të lartësuar që qëndrojnë denjësisht përkrah letërsisë botërore. Ajo shkruhet brenda trojeve shqiptare, por dhe jashtë tyre në Diasporë. Pavarësisht se ku shkruhet dimensionin e saj artistik ka rrokur gjithë dimensionin e hapësirës botërore. Ajo troket në çdo portë ku brenda saj ka një qenie njerëzore që lufton për ta bërë botën më të bukur dhe më të mirë. Letërsia shqipe i ka kapërcyer kufijtë e trojeve të saj, çmohet e vlerësohet ngado, në çdo veprimtari që ka brenda saj përmasën botërore.

Personazhet e letërsisë shqipe aq sa individualizojnë njeriun e shtrirjes gjeografike ku ata veprojnë, po aq lehtësisht u përgjigjen vlerave universale që mbart njeriu i kohëve moderne.

Veprat e artit, sidomos piktura, kanë shtegtuar anë e kënd botës dhe kanë përcjellë botën e pasur shpirtërore të shqiptarit, model nëpër kohra i shpirtit paqësor dhe liridashës.

Në këtë leksikon enciklopedik ku përfshihen më shumë se 300 autorë të trojeve shqiptare dhe Diaspora janë përfshirë të gjitha fushat e dijes njerëzore.

Do të gjesh personalitete të spikatura me kontribute shkencore dhe artistike që janë ngritur vazhdimisht drejt nivelit evropian dhe botëror.

Duke lexuar bibliografitë e këtyre autorëve lexuesi do të gjejë fushën e interesit të tij, do t'u drejtohet lehtësisht bibliotekave dhe librarive.

Ky botim do ta bëjë më të lehtë punën e studentëve dhe pedagogëve, të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë. Duke lexuar këtë libër enciklopedik do të vijë më e plotë pamja e gjithë arritjeve shkencore dhe artistike të deritanishme të realizuara nga Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe e Arteve dhe të gjithë atyre shkrimtarëve dhe studiuesve që kanë bashkëpunuar me këtë institucion prestigjioz të trojeve shqiptare dhe në Diasporë.

VËSHTRIM ESEISTIK PER VEPRËN LETRARE  
“DIADEMË LETRARE” TË AUTORIT FLORI BRUQI

**Nga Prof.dr. Eshref Ymeri**

*“Një kirurg i mirë e di se kur thika e tij është duke prekur nervin. Edhe një kritik i mirë e ndien po ashtu lëvizjen e penës së vet”-Bernard Shou.*

Me librin e ri “Diademë letrare”, autori Flori Bruqi, i mirënjohur për krijimtarinë e tij të begatë në shumë fusha të dijes, vë në dorën e lexuesve një tjetër vepër interesante, në të cilën pasqyrohen ngjarje të vragshme në jetën e kombit shqiptar, probleme të gjuhës shqipe, përsiatje në fushën e kritikës letrare, vlerësime mjaft të gjetura për veprimtarinë krijuese të autorëve të ndryshëm, nisur gjithmonë nga objektiviteti shkencor që është produkt i formimit të tij të admirueshëm intelektual.

Ai bën interpretime dhe shpreh këndvështrime për vepra letrare nga pikëpamja e aktualitetit, duke i lidhur ato me problemet e mprehta të jetës shoqërore dhe shpirtërore të popullit shqiptar dhe duke nxjerrë në pah tërthorazi edhe bindjet e veta si kritik, të mbështetura mbi një truall të shëndoshë kombëtar.

Tek po e lexoja me kureshti çdo faqe të këtij libri mjaft tërheqës, më erdhi ndër mend një shprehje e bukur e Oskar Uajldit (Oscar Fingal O'Flahertie Wills Wilde - 1854-1900), filozof, estet, shkrimtar dhe poet anglez me origjinë irlandeze, njëri nga dramaturgët më të njohur të periudhës së vonë viktoriane, i cili thoshte: “Kritika kërkon më shumë kulturë sesa krijimtaria”.



Dhe me të vërtetë: vlerësimi kritik i krijimtarisë artistike kërkon formim të gjerë kulturor, i cili përfaqëson në vetvete një “fletëhyrje”, një “lejekalim” për çdo vepër letrare, që kjo të çajë drejt zemrës së lexuesve.

Prandaj Flori Bruqi, me formimin e tij, si një intelektual erudit, nxjerr në pah dhe konfirmon parimet krijuese që përvijohen në veprat e shumë autorëve në botën e letrave shqipe, ushtron ndikim të ndjeshëm mbi procesin letrar, si edhe mbi kristalizimin e drejtpërdrejtë të vetëdijes shoqërore. Vlerësimet e tij herë-herë mbartin një karakter publicistik, duke u pleksur me gazetarinë, si edhe një natyrë të mprehtë nga sfera politikës së ditës. Por ato, në të njëjtën kohë, janë të lidhura ngushtë edhe me shkenca të pranëndodhura (fqinjësore), si historia, gjuhësia dhe politologjia.

Shumë interesante janë përsiatjet e autorit për letërsinë dhe për psikologjinë. Aty ai ndalet në figurën e Frojdit, i cili njeriun e vë në qendër të psikanalizës. Në qendër të doktrinës psikanalistike frojdiane për njeriun, qëndron fakti se njeriu përfaqëson në vetvete një sistem energjetik.

Sipas Frojdit, njeriu, në këmbënguljen e tij të padiskutueshme për kënaqësi, hyn në konflikt me shoqërinë dhe me qytetërimin. Njerëzit, sipas tij, veprojnë në përputhje me parimin e kënaqësisë, me pikësynimin për t'i përmbushur dëshirat e veta pa kurrfarë kufizimi.

Duke ballafaquar Frojdin me Marksën në vlerësimin e individit, autori ndalet në atë që mund të quhet antropologjia filozofike e Marksit. Të mirën dhe të keqen në natyrën e njeriut, dashurinë apo egoizmin, në dallim nga Frojdi, Marksit e shpjegon jo me vetë natyrën në fjalë, jo me ndonjë sistem

energjetik, por me rrethanat shoqërore. Këtë ai e shpjegon me faktin se njeriu apo individët i krijojnë vetë rrethanat shoqërore në ecurinë e zëvendësimit të brezrave.

Mjaft interes ngjallin ballafaqimet që bën autori për gjuhën shqipe dhe sidomos për lashtësinë e saj, duke sjellë brenda thurimës së lëndës pikëpamjet e mjaft shkencëtarëve të shquar të albanologjisë, nga hapësirat evropiane dhe nga trojet amtare.

Atë e dëshpëron fakti që historianët, përgjithësisht, i trajtojnë kulturat që kanë krijuar popuj të ndryshëm të periudhave parahistorike apo historike, por kur është fjala për etni konkrete, ata ose flasin pak ose heshtin fare për popujt që i kanë krijuar qytetërimet përkatëse.

Duhet pranuar se historianët e huaj kanë heshtur qëllimisht për etninë shqiptare se lashtësia e saj ka ngjallur xhelozinë e tyre, veçanërisht lashtësia e gjuhës shqipe.

Fakti që Plini Plaku (Gaius Plinius Secundus (23-79 e.r.), nartyralist i shquar romak, në veprën me titull “Naturalis Historiae” (Historia e Natyrës), në vëllimin VII, shkruan: “Ilirët (arbërit) kanë krijuar të parin alfabet dhe romakët shkrimin e tyre e morën nga ilirët”, fakti që, pas Plini Prakit, historiani i lashtë romak Apiani (Аппианос Александрѳус - 95-170), me prejardhje greke dhe që ka shkruar në greqishten e vjetër, autor i veprës “Historia e Romës”, ka përsëritur të njëjtën gjë, fakti që profesori hungarez Imre Toth, specialist i sllavistikës, në librin e vet kushtuar Kirilit dhe Metodit, dy krijuesve të alfabetit të sllavishtes së vjetër, thotë se, ndër burimet që ata shfrytëzuan për krijimin e alfabetit në fjalë, ishte edhe shkrimi i vjetër shqip, janë dëshmi të pastra se

gjuha shqipe qëndron në themelin e të gjitha gjuhëve evropiane. Madje Engelsi, për Apianin, në veprën “Ludvig Fojerbahu dhe fundit i filozofisë klasike gjermane”, shkruan: “Nga historianët e lashtë, të cilët kanë përshkruar luftën që është zhvilluar në gjirin e Republikës Romake, vetëm Apiani është ai që na flet qartë dhe shkoqur...”.

Një hapësirë boll të mjaftueshme në librin në fjalë autori ia ka kushtuar shkrimtarit racist serb Dobrica Qosiç, filozofisë së urrejtjes të të cilit ndaj kombit shqiptar ai ia ka çjerrë maskën me vet fjalët e këtij shovinisti të regjur, sipas të cilit, në raport me etninë shqiptare, populli serb na qenka, demek, populli më demokratik, më i civilizuar dhe më i arsimuar i Ballkanit!

Me ditarin e vet me titull “Koha e gjarpërinjve”, të cilin e pati shkruar në periudhën 21 mars 1999 - 1 janar 2000, Dobrica Qosiç, në qëndrimin racist ndaj etnisë shqiptare, zë kryet e vendit, përkrah kryeministrit serb të vitit 1913 Vladan Gjorgjeviç, shkrimtarit Ivo Andriç, akademikut Çubrilloviç, kryepeshkopit Pavle që prehet në atë botë dhe kryepeshkopit të tanishëm Irinej, si edhe të shumë ...viçëve të tjerë antishqiptarë.

Por Flori Bruqi, me elegancën intelektuale që e karakterizon, është sqimatar në leksikun që përdor për të nxjerrë në pah mllefet e Qosiçit kundër popullit shqiptar të Kosovës, mllefe këto që, në të vërtetë, zbulojnë antivlerat e tij intelektuale. “Ekranizimi” që Flori i bën në këtë vepër racizmit të Qosiçit, më kujton një letër shumë interesante që shkrimtari i shquar francez Romen Rolan (1866-1944), laureat i Çmimit Nobel në vitin 1915 për veprën me titull “Për idealizmin e

lartë të veprave letrare, për simpatinë dhe për dashurinë për të vërtetën”, ia dërgonte një kolegu të tij gjerman në vitin 1914, edhe ky laureat i Çmimit Nobel për vitin 1912. Shkak për atë letër ishte bërë sulmi i trupave gjermane kundër Belgjikës. Letra në fjalë i drejtohej dramaturgut të njohur Gerhart Hauptman (1862-1946) më 29 gusht 1914 dhe qe botuar më 2 shtator 1914 në “Journal de Geneve”. Në të ai shkruante: “Lufta është fryt i dobësisë së popujve dhe i budallallëkut të tyre... Unë... e pashë se si trupat tuaja po shkelin neutralitetin e Belgjikës fisnike. Ky është një veprim i pandershëm që ngjall përbuzje në çdo vetëdije të ndershme dhe është pjesë e traditës politike të mbretërve tuaj prusianë”.

Pra, Flori Bruqi, në analizën e kthjellët që i bën racizmit të Dobrica Qosiçit, hedh dritë mbi një traditë tashmë të konsoliduar gjatë një periudhe mbinjëshekullore të një racizmi mbarëkombëtar serb, të cilin vargani i mbretërve, njerëzit e letrave, bota akademike dhe politika e ushqyer prej tyre, ia kanë kultivuar mbarë kombit serb në çdo pore të tij.

Kësisoj Flori Bruqi, me një qetësi “patriciane”, e zhvlerëson tërësisht deklaratën butaforike të Qosiçit për popullin serb, si më “demokratiku”, më “i civilizuari” dhe më i “arsimuari” i gadishullit tonë!

Me taktin e një kritiku gjakftohtë, Flori i lë të kuptojë lexuesit se kombi serb dhe mbarë intelektualët që e përfaqësojnë, pa qenë nevoja të hyjë në mendësinë e kampeve politike që nuk ia vlen të hetohet, vuajnë nga një sëmundje mbarëkombëtare, siç është mungesa e së vërtetës, e cila, që në zanafillë të zbritjes së tribuve sllave drejt Ballkanit, u përzu dhunshëm për gjetiu, meqenëse vendin e saj e zunë mitet dhe

legjendat që u sajuan pa pasur kurrfarë trualli konkret. Dhe subvensionimi për krijimin e tyre nuk ka njohur kurrfarë kufijsh. Madje ky subvensionim, që para nje shekulli, arriti deri aty, saqë kryeministri Vladan Gjorgjeviçi, në vitin 1913, botoi librin me titull “Shqipëria dhe Fuqitë e Mëdha”, në të cilin shqiptarët i paraqit si njerëz me bisht që i kujtuakeshin pararendësit gjysmë të egër të lashtësisë. Pikërisht ky libër, i mbushur me mite dhe me shpifje serbe, u qe servirur në tryezë përfaqësuesve të gjashtë Fuqive të Mëdha në Konferencën famëkeqe të Londrës të vitit 1913 që kishin mprehur thikat për copëtimin e trojeve etnike shqiptare.

Me analizën e vet intelektuale, Flori Bruqi argumenton tërthorazi se e vërteta mbetet një e mërguar e përjetshme e Serbisë, sepse mitologjia dhe shpifografia janë shndërruar për të në “shpendë grabitqarë” që nuk e lënë t’u afrohet absolutisht hapësirave serbe.

Madje kulti i mitologjisë dhe i shpifografisë serbe ka arritur deri në atë pikë, saqë kohët e fundit edhe Kardinali Vallter Kasper, për të përditshmen katolike Kathpress, deklaroi se Vatikani nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës se Kosova na qenka “djepi” i kishës ortodokse serbe! Kjo deklaratë e këtij përfaqësuesi të lartë të Vatikanit të bën të hamendësosh se ai ose është një klerik me formim të mangët intelektual, ose ka marrë përsipër rolin e tellallit të Serbisë. Sepse siç dihet tashmë, politeizmi ilir filloi t’ia lëshonte vendin me kohë krishterimit, i cili, që me Ediktin e Milanos, në vitin 313, u shpall fe zyrtare, institucionale, shtetërore. Për më tepër, kisha katolike shqiptare në Dardani është përhapur që në shekullin e parë pas Krishtit, ndërkohë që sllavët zbritën

në gadishullin tonë në shek. VII. Kur cek problemin e së vërtetës, Dekarti thotë: “Pë të gjetur të vërtetën, gjithsekush duhet që, të paktën, një herë në jetën e tij, të çlirohet nga paragjykimet e grumbulluara me kohë dhe ta ndërtojë krejtësisht nga fillimi sitemin e bindjeve të veta”. Me sa duket, kjo thënie e artë nuk gjen kurrfarë trualli në hapësirat serbe.

Në librin e vet Flori Bruqi është ndalur posaçërisht në krijimtarinë e mjaft autorëve shqiptarë, në veprat e të cilëve, në njëerën ose tjetrën mënyrë, gjen pasqyrim çështja kombëtare shqiptare, një çështje që vazhdon të përcjellë rënkatën e një shekulli të tërë për një padrejtësi të rëndë që i është bërë etnisë shqiptare, në pritje për të gjetur zgjidhjen e vet përfundimtare.

Në analizat e tij del në pah Flori kritik dhe Flori artist, krijues. Por në rastin konkret, forca gjykuese, forca analizuese merr sipërinë mbi forcën krijuese. Çështjet me rëndësi jetësore, jeta me të fshehtat e saj, plagët e saj të hapura janë më afër organizimit mbresëlënës të botës së kritikut që mbështetet mbi truallin e shëndetshëm të organizimit krijues të artistit.

Në analizat e Florit që burojnë nga honet një shpirti të ngrohtë mes shkulumash dashamirësie për kolegët e tij krijues, qoftë caqet e një kritike thjesht estetike që përmbliidhen në kërkesën për një interpretim dhe takt poetik, qoftë caqet e kritikës historike, vijnë e përcaktohen nga ndjenja e fuqishme e atdhedashurisë. Në vlerësimet e tij kritike kapen lehtë zërat e gjallë të jetës shqiptare në një përthyerje artistike, zbulohen të fshehtat e mëdha të shpirtit shqiptar dhe të organizimit të tij të brendshëm.

Në këtë mënyrë, në analizat kritike të Florit, vetë jeta shqiptare përvijohet para lexuesit si një përndritje hyjnore.

Në penën e Florit, arti dhe kritika përbëjnë një tërësi organike në të kuptuarit e ideale.

Me këtë vepër, Flori ka ngritur një panteon amfiteatror në nderim të shumë figurave të nderuara të letrave shqipe, mes të cilave nuk mund të rri pa përmendur disidentin e shquar, poetin martir Havzi Nela, gurrës poetike të të cilit ia mbylli grykën litari i kriminelëve komunistë, pikërisht atëherë kur sistemi i tyre ishte në grahmat e fundit.

AGU E FRESKON BALLIN NË KROJET POETIKE  
TË FLORI BRUQI

*(Referuar tek vepra letrare "Diademë Letrare")*

**Nga Akademik Prof.dr. Zef Pergega**

Kohë më parë një mik i imi në Tiranë, fisnik deri në thelb të shpirtit, penë e zgjuar dhe e talentuar e fjalës shqipe, më shkruante: “Të lutem falënderoje mikun tënd Flori Bruqi, për shkrimet që më dërgon. Nëpërmjet tij i them çdo ditë mirë-mengjes Kosovës, i them poezisë së tij, më fladitë dhe më çelë sytë, i them përkushtimit të tij, se ku e merr këtë vullnet kaq të fortë...!” Sa më tepër kalojnë vitet mbi rrudhat e ballit të njeriut, krojet e shpirtit gurrojnë dhe e ndezin motivin për të parë gurët e trojeve të të parëve.

E mbi të gjitha, për t'i rënë në gjunjë lotit të gurit, që vajton pa britma. Kështu më ndodhi në vitin 1998, ku pashë muret e rrënuara të kalasë. “Bassania” të stërgjyshit të lisit të fshatit tim. Ishte koha kur të rinjtë e fshatit luanin me simite të bardha të demokracisë e shkullonin coca cola e mua më duhej me detyrim të dhunshëm të largohesha për në Amerikë. Lumi i fshatit nënqeshi dhe guri heshti, kur ia ktheva shpinën Kodrës “Pleshe”, ku i ka themelet kalaja e njëhershme me Lissusit e lashtë. Prej olimpkit të një guri të madh me mbishkrime të quditshme u ngrit një fjalë e moçme e më lëshoj zë, kur po freskohesha në ujin e kthjellët të lumit Mat. “Në rrënojat e thella të gurëve, kërkto se aty ka kroje të bardha dhe kyçen me shekujt e ndryshkur pavionet e lashta të historisë tonë!”



Më tingëlloi kjo fjalë, sikur donte të thoshte se nuk duhej t'ua ktheja shpinën. Thonë se edhe pisha e ka shtatin e drejtë se me rrënjët e thella të saj në nëndheun e tokës kërkon burime, por Maxhun Bruqi, i cili në pëllëmbën e Shqipërisë Etnike dhe në folenë e gurëve të rëndë e shqiti dritën, që venitej nën pushtetin e territ të thundrave të shkelësit. Ai, kur rëndi gjeografisë së vendit të tij me kalin e bardhë të zanave, mbollti kudo filiza të njomë dhe i vishte me shajakun e kostumit tonë kombëtar, që t'i mbronte nga baroti djegës. Ata janë shenjat e tokës së vet në vend të piramidave. Poeti i lirisë së tokës martire të Kosovës, Naim Kelmendi në prag të 101 vjetorit të pavarësisë më dërgon një kartolinë. Në pasqyrën e saj janë disa njerëz që mbajnë mbiemrin e një trungu. Të duket një legjendë e kohës së re, që dritën e të vjetrës e përcjellë mes gjetheve të gjelbërimit, e Maxhuni i ka rrethur me dejet e pemës, anëtarët e familjes Bruqi. Në rrënjët e tyre ka një buzëqeshje familjare, por ka edhe kroje vargjesh, të cilat Flori Bruqi i ka mbledhur në kuvendin e madh të shekullit të shqiptarëve me shaminë e një ore mali, që e takoi për herë të parë në një krua të fshatit, kur vashat e tjera ishin larguar, e ajo e kishte pritur... ndaj familja e tij është e nderuar në gurin e fisit shqiptar. Flori Bruqi vjen në letërsinë tonë kombëtare me krojet e kulluara të flirtit të shpirtit të tij. Kam vënë re se ai nuk bën kompromis me askënd që ka vënë firmën në balada, në mite, në legjenda, për t'u dukur baloz mbi detin e fjalës shqipe të valës tonë të kripur ëmbëlsisht, as me heronjtë e shpallur rrejshëm nëpër podiume, por ai si misionari i fjalës së lotit të qiririt, i pashuar dhe i patretur e ka projeksionin lart në qiellin e lirë në vlerën e të vërtetës.

Aty poeti Bruqi frymëzohet, për njeriun, për nderimin, si dorë e besës së bashkimit, e në penën e tij, rrjedh krijimi me një shporte dhuratash me metafora. E lexova me ëndje, si çdo krijim tjetër, librin e ri në botim të Flori Bruqit “Diademë Letrare”,-(kritikë, gjuhësi, pikëpamje, poezi...) e shumë më shumë se kaq. Në krojet poetike të Flori Bruqit agu i parë e freskon ballin, për t'ia gëzuar ditën njeriut. Në këtë libër autori Bruqi shfaqet si vreshtar me shumëllojshmëri drurësh frurorë, që i krasit në mënyrë tradicionale, që shëndeti t'u kalojë mesazheve poetike. Flori është një aristokrat i kulturuar në kancelarinë e tij të studimeve, të denja për referenca shkencore, në krahasime e analiza të ndryshme. Shpirti i guximit të Flori Bruqit i shtron rrugët e së resë, duke rritur krenarisht gjeneratat që vijnë pas, për t'u përfshirë pa hezitim në maratonën krijuese.

Një libër që na vjen në dorë e të mahnit me logjikën dhe argumentin shkencor, që e zbukuron kurorën e festës së letrave shqipe. Shembull pozitiv, bre bac, i lëmë për llogore mbrojtëse të kombit të tij dhe njëherësh i gatshëm dhe me zë të fortë të jetë tribun në katedrën e kulturës...e bash të afërt i ka Naimët aty ku këmba e ditës së re prek shqimet. S' ka më bukur, kur librin Flori ia kushton babait, kopshtarit të gjeografisë, duke na kujtuar se bota e vargut rrotullohet rreth vetes dhe kurorës së shenjtë të kombit.

*Detroit, 20 nëntor 2013*

## NJË PIKË LOTI QË NË OLIMP LIND!

Tani mbi tavolinën time të vogël kam një dhuratë të madhe. Shpesh fjala “*dhuratë*” kuptohet si vlerë materiale, pas së cilës ne shqiptarët jemi të dhënë me mish e shpirt. Vlera materiale nuk ka as zemër, as shpirt dhe as konvertim njerëzor. Megjithëse, për dhuratën ka një mijë e një fjalë edhe unë bashkohem me të tjerët që të mos fshihet nga dialogu reciprocitetet.

Po unë në këtë rast e kam fjalën për një dhuratë tjetër, të veçantë që më erdhi nga Prishtina. “*Zëri im Prishtinë*” kishte mbrtur tani në kryeqytetin e lirë, në adresën e një fisniku në ballin e derës ku lexohet Flori Bruqi. E ai me solli dhuratën më të këndeshme të vitit 2012, dy librat që mbajnë firmën e tij “*Olimpi Shqiptar*” dhe “*Nëse kam ditur të guxoi*”

Gjithë mozaiku i krijimtarisë së tij është një akademi elitare në themelin e krejt amfiteatrit letrar dhe historik të olimpit shqiptar. Kësaj dhurate iu bashkangjiti edhe një urim me rastin e festës së Pashkëve.

Këtë muaj marsi i shkrova Florit ende pa shkrirë dëborë: “*Me shëndet festën e Pashkëve. Qofshin të bardha ditët për Ju familjen dhe nje rilindje për Kosovën. Po ashtu si një shenj i dallur dhe i veçantë i krijimtarisë tuje në Enciklopedinë shqiptare!*” E ai pa vonesë ma ktheu: “*...Ç' do festë fetare është kambanë zgjimi për bashkimin tonë kombëtar nëpërmjet artit dhe kulturës!*”

Duke lexuar këtë urimin e Florit, i cili kurrë nuk vonon dhe kurrë nuk paragjykon më bën të mendoj se gjumin më të rëndë dhe zgjimin më të vontë e bëjnë akademikët tane. Ata më së

shumti i ngjajne murgjërve të pergamenteve që janë mësuar me dhomat e errëta. Po Flori Bruqi ka zgjedhur një rrugë tjetër. Ta pastrojë fytyrën e gurëve të harruar nga myku i mohimit. Të ia kthejë tiparet fisnike olimpik shqiptar. Të ia kthejë lavdinë e vjedhur duke u ndalur në çdo hap, në çdo frëngji, në çdo shesh gladiatorësh, në çdo poltron sundimtari e perandori. Madje me një sy te veçante shikon edhe njerëzit që luajnë kumar me vlerat. Ai nuk ka bërë as më shumë dhe as më pak, por ate që nuk e ka bërë askush në këtë gjysëm shekulli të fundit: Ti kthejë zërin e kthjelltë Olimpik Shqiptar.

Flori Bruqi, si argjendar i kualifikuar i penës dhe i fjalës po i lidh zërat e vjetër me zërat e rinj, duke themeluar për të parën herë Orkestrën kombëtare të Olimpik shqiptar. Ai vetë si dirigjent dhe si violinë e parë shkon zbathur, për ti ndeshur me mirë shputat me dheun e vet në unison me orën e mirë të kombit tonë dhe ky është guximi, të cilin mund ta lexojmë në pllakën e vendosur në hyrje të kodikëve të olimpik tonë. S'ka dhuratë më të bukur në fytyrën e gurit të latuar me daltën e tij dhe të mendimit shqip dhe pa mëdyshje mund të themi bashkë me një zë se Flori Bruqi është një fenomen enciklopedik, i cili jo vetëm ka krijuar sfondin dhe këndin, por ai na jep edhe këndin e olimpik, të cilin për çudi nuk e mban sekret.

Ai dhuron për të gjithë shporta me bekime dhe ashtu si amerikanët nuk punon duke pritur kthimin e tyre.

### **Të lëvizesh gurët e rëndë për t'iu dhënë rëndësinë**

Flori Bruqi është një nga miqtë e mirë të miqëve të fjalës së lirë dhe besnik i qëndron kurajos civile dhe qytetare. Ai bashkëbisedon me njerëzit në menyrën më të shpejtë. Gjatë këtyre viteve që bashkëpunoi me revistën e tij “*Floripress*”

nuk e pashë njëherë që ti kërkoje ndihmë justifikimit. Ko fjalë mbart mikrobe anti-njerëzore, ndaj ai e ka braktisur nga kulla e genit të tij dhe nga brazdat e arës së florinjte.

Ai është një urim i fjalës lashtë dhe një bekim i fjalës së re. Një mekanizëm i çuditshëm që i lëviz gurët e rëndë, të kohrave për t'iu dhënë rëndësinë e duhur. Një medalje e artë që ai ia kthen historisë në pavionin e munguar. Flori me sa e kuptoj unë është një pikë loti që lind lirinë, një dhimbje poetike për çdo martir, një lis i fisit të kombit që kujdeset për rrënjët e tokës së vet. Nuk është pak të kujdesesh për rrënjët se aty e ngrënë çerdhen krimbat e armikut.

Nuk e kam vënë re Florin të turfullojë nëpër mikrofonta e tribuna karrikesh dhe të thotë se kjo është prona ime e lavdit, por në këtë muzeum veprash janë në të gjithë princat e fjalës, janë kumbarët e pajtimit, janë ata që shkuan, janë heronjtë e lirisë, janë dhe ata që në duar mbajnë hostenin, për ti qëlluar ciklopët mohues në syrin e verbërisë.

Mbi të gjithë këta kodikë të letërisë dhe kulturës që kanë brenda palcën dhe mjaltin e identitetit shqiptar ka edhe një mistike të shpirtit të Flori Bruqit që i thërret personazhet në darkën e universit të mendimit, për të vazhduar misionin e pavdeksisë së fjalës shqipe. Për ta bërë këtë ai ka zgjedhur tryezën e gurtë të Olimpiti Shqiptar. S'ka më bukur dhe me pastër!

Flori nuk e ka resektin për njerëzit formal, sikur njerit ti ndezës një cigare në kalim apo si një përshëndetje ditore rutinore. Ky autor që të mahnit me sjelljet e tij prej qytetari e prej oborrtari sarajash kosovare është ndoshta i vetmi që i ka nderuar aq shume krijuesit shqiptar, këtë gjerdan brezash të

lidhur me gojtana vargjes, duke ua nxjerrë në dritë veprën e tyre në shërbim të shoqërisë. Ky det i madh i zhytur i thesareve vjen e del në suprinë me spirancën e kapitenit të parë Flori Bruqi dhe anija e ngarkuar me botën e mistershme që përmban xhevahire, lundron drejt bregut, për tu ancoruan në limanin e olimpit të vet. Në këtë kontekst figurativ, por edhe realist Flori Bruqi shfaqet si një Robinson Kryzo që duhet “shtrydhur” të flasë akoma për historitë dhe sakrificat që e lartësuan shqiptarin në shtegtimin e bukës si një dëshmitar i zërit të veçantë të kombit të tij.

Flori Bruqi i vret ankthet, për tu dhënë jetë ëndrrave plot prille. Ai është një sy vështrimi mbi strehë të bregut, duke u ngritur mbi pikën më të lartë të olimpit, të mësojë se ç'fare fshihet mes zotave. Dhe zbret përsëri bregut me durim e pasion të madh në shpirt, të cilit i jep guximin dhe forcën e e gjunjëve, për të mbledhur margaritarët e hedhur. Ky njeri ka gjithmonë një temë në mendje, siç e ka bujku farën në trastën e mbjelljeve, ai ka një mesazh në zemër, siç ka bilbili këngën e pranverës, ai ka një shpërthim në letrën e bardhë, siç e ka sythi nën lëkurë të lëngut të trungut. Ai është punëtor pa bujë, siç është bleta në hoje nektari.

E fjala shqipe duhet të ketë më shumë mjeshtra popullor të fjalës dhe ekselence elitare, që spikasin në gjeometrinë e syrit të Flori Bruqit, i cili vallon gjurmët e hartës ilirike.

### **Ne qytetin pa reklama**

Kur dëgjojmë fjalën “*Olimp*” i gjithë përfytyrimi ynë ndesh mbi muret e lartë, mbi kollona të lashta, ku kalojnë princa me shpata, mbi kulla vrojtimi, ku zjarri i lëshon flakë zjarrit të malit përballë, mbi dritare që varen legjenda e mirë si

vela të shqyera nga furtunat e kohës, dhe ai ndalet në dhomat e torturave të burgut ne kala...

Me etjen e mendimit tim u mundova të çapis pakës në “Olimpin Shqiptar” të Flori Bruqit, për të përjetuar sado pak këtë magji të vlerave njerëzore, në fakt në atë vend ku realisht u takon burrave të kombit. Në ecjen time kishte shumë njerëz dëshmitarë. Të parin “*takova*” Naim Kelmendin, i cili më pyeti:

*“Kah po shkon o mërgimtar?!”*

*“Të marr vesh pak për Olimpin Shqiptar?!”*

“Kalo djathtas dhe ngjitu në atë kodër. Aty është një tabelë e madhe e shkruar nga qielli. Dera është hapur dhe s'ke nevojë të trokasësh. Flori Bruqi të pret. Ai me zellin dhe sensin e tij prej intelektualit i ka vënë shenjën më pikante mendimit shqiptar dhe analizës letrare!”

E hedh vështrimin dhe kureshtjen time mbi këtë qytet pa reklama, që të lën pa gjumë. Mijra mrekulli të një bote që flet herë me zë të fortë e herë me zë të brishtë. Pak me tutje “*takoj*” një mërgimtar shqiptar me emrin Eshref Ymeri, që kishte udhëtuar nga Santa Barbara e Kalifornisë, i cili me përshëndet në gjuhën angleze, si për të më ngacmuar kujtesën, kur në Detroit shkëmbyem disa fjalë për letërsinë...

E ai më thote:

*“...Me një çiltërsi befasuese Flori Bruqi krijon me vargjet e veta një botë psikologjike e intelektuale të njeriut në të përpjetat dhe tatëpjetat e jetës së përditshme. Ai nuk e shikon jetën si fushë me ngjyre trëndafili!”*

*“-Po ai trëndafil dhe zambak e ka fjalën!”* - ia ktheva, duke rruftur një kafe malli

*“-Ngjyra e trëndafililit është ngjyra e romantikës dhe e optimizmit, por Flori Bruqi në lirikën e tij ka si synim të ia heqë jetës njerëzore petkun e së keqes që e shëmton.*

*Përgatitja e tij erudite, analizat shumë përmasore, formimi i tij nacionalist e radhisin këtë autor në plejadën e njerëzve më të shquar të kombit shqiptar...!”*

Fryma e Olimpmit më mbush që të mos ndalem. Ec dhe mendoj nga të gjitha drejtimet, sepse ne çdo stacion që ndaloj ka një të veçantë që të tërheq.

Krijimtaria e sotme ka më tepër tonë lavdi se mesazhe artistike dhe analizë letrare. Ne ishim mësuar në monizëm të dëgjonin vetëm sirenën e partisë dhe treni ideologjik na e hidhte mazutin e zi fytyrës sa të gjithë ishim të zinj.

Kritika në letërsi e në art i ngjan një dige të shpartalluar që ka marrë përpara me lumin e baltës edhe gjeneratorët e drites. Librat po shkruhen me pare dhe per pare me vjedhje te tmerrshme.

Veprat artistike janë te pakta. Karroca e ndryshkur e politikës e ka zvetnuar shpirtin e kulturës të popullit dhe të intelektualit.

Flori Bruqi vozit me rremat e krahëve të tij. Ai ka një busull në frymezimet e ngjarjeve me kulmore të kombit tonë, me një shenjtëri mbrenda qënies shqiptare.

*“... Vete modestia që buron nga cikloni letrar i shkrimtarit Flori Bruqi është pjesë e fletëve në 30 libra. Një modesti që nuk tejkalohe dhe as para prezantohet. Libri i Flori Bruqit synon të paraqesë një dritare në këtë valëzim mjegullor që ndeshet edhe në ditët me diell!”*- shkruan shkrimtari Fatmir Terziu.



Si përfundim i këtij udhëtimi të shkurtër në *Olimpin Shqiptar* mund të them se Flori Bruqi me veprën e tij madhore nuk është plagjaturë servile e politikave dhe kukullave të fryra mbi karrike pushteti, por ai shëron si misionar tokën e djegur të kombit të tij ashtu si Nana Terezë që shëroi plagët e të varfërve të botës nëpërmjet shpirtit të humanizmit.

Guximi, nderimi dhe talenti janë bërë një në fuqinë mendore të Flori Bruqit dhe ai është një arkitekt i ngritjes së qytetit të kulturës kombëtare shqiptare.

*Detroit, 31 mars 2013*

**FLORI BRUQI, INTELEKTUAL I SHQUAR I  
KOMBIT SHQIPTAR**

**Nga Kozeta Nushi**

Nëse mer në dorë librin publicistiko - shkencor “Polemika Shqip”, botuar në Prishtinë, në vitin 2009, librin e intelektualit të shquar të kombit shqiptar, Z.Flori Bruqi, i njohur nga mediet si shkrimtar dhe publicist, po nga unë, Kozeta Nushi, i njohur si shpirti, pasqyra e kombit, zbulon shumë të vërteta rrënjëthënëse mbi masakrën e Reçakut, aty ku më 1999 u krye krim kundër njerëzimit.

Sipas Z.Flori: Krimi e ka emrin krim.

Shpifja e ka emrin shpifje.

Masakra e ka emrin masakër, e kështu me radhë.

Në këtë libër jepet gjithashtu një listë e gjatë emrash të të vrarëve shqiptar, me ditëlindje dhe vende ku janë masakruar, apo vrarë, në luftën e fundit më 1998-1999 në Kosovë, ngs ish ushtria, policia apo paramilitarët serb.

Në librin: “Guximi Shqiptar” - botuar në vitin 2008, në Prishtinë, Z.Flori Bruqi ringjall kombin etnik shqiptar, popullin e lashtë pellazgjiko-iliriko-shqiptar.

Shumë interesant është shkrimi: ”Napoleon Bonaparti dhe Shqiptarët”

Një mbresë të veçant të lënë shkrimet: ”Hero në luftë, Hero në paqe, Ramush Haradinaj”; “Ramushi - viktimë e situatës (neo) koloniale”; “Çamëria, Epiri i veriut dhe gjendja sot”- është një tjetër tem e fortë që Z.Flori Bruqi prek me penën e tij të fuqishme, duke bërë që t’ju erren sytë, t’ju merret goja dhe të skërmisin dhëmbët shumë shpifës e falsifikator të

vërtetash historike. Z.Flori Bruqi është shumë i drejtpërdrejt, sepse e thellë dhe e fortë është dashuria e tij për kombin. Me duart dhe penën e tij të fortë, Z. Flori Bruqi çan terrin dhe sjell diellin.

“Olimpi shqiptar” (pikëpamje, kritikë, vlerësime, poetikë)- është një tjetër libër i nxjerrë në dritë.Përmendja e z.Fatos Arapi në këtë libër, më sjell në mendje një kujtim të fshehur në sirtarin e mendjes sime:

Isha në një panair libri, në Tiranë, ku fatmirësisht merrnin pjesë shkrimtar shqiptar dhe kosovar. Para se të hyja tek porta e panairit të librit, z.Fatmir Toçi, drejtor i shtëpis botuese “Toena” më fton të ulem së bashku me të dhe me z.Fatos Arapi, në një tavolinë.

Në momentin që z.Fatmir Toçi paguan për ne të tre, z.Fatos Arapi me thjeshtësi më pyet se ku punoj aktualisht. Unë i përgjigjem se punoj si mësuese në Fitore.

- Të pëlqen të vazhdosh të shkruash? - më pyet sërish.

- Po, - i them. - Është një pasion i lindur tek unë dhe më i fortë se unë.

- Si je nga gjendja ekonomike? - më pyet pa më vënë në siklet.

- Jam shumë mirë, po jo aq sa për të paguar publikimin e librave të mi, - i përgjigjem me sinqeritet.

- Atëherë duhet t'i bësh nervat çelik,- vazhdon ai, po me sinqeritet. - Vetëm kështu, talenti yt, në atë mjedis ku jeton, nuk do të shuhet.”

Këtu mbaron edhe ky dialog, që mua më kujtohet, ndërkohë që lexoj librin: “Olimpi Shqiptar” të z.Flori Bruqi. “Nëse kam ditur të guxoj” - është një tjetër libër shkronjë art, i

këtij gjeniu të letrave shqipe.

Ndër kritikët e shumtë që përmend, gjej dy kritik të drejt e të rrept: -Z. Fatmir Terziu dhe Prof.Dr. Eshref Ymerin, të cilët i njoh më shumë se të tjerët. Ndjem mirë nga ky fakt. Shumë kumbon përshkrimi që Z.Flori Bruqi i bën figurës madhore të presidentit historik, Dr. Ibrahim Rugovës. Nënë Tereza, - nderi i kombit shqiptar, - ringjallet sërish në shkrimet e tij.

Z.Flori gjithashtu shkruan për Z. Naim Kelmendi, i cili më 25 Shkurt, 2014, në orën 2:27 të mbasdites më shkruan:

-“Përshëndetje, e nderuara Kozeta! Lexova poezinë tuaj: ”Ku t’i gjej rrënjët e tua Kosovë?” Të lumtë për një poezi të arrirë artistikisht. Të përshëndes me përzemërsi Naimi, botues i Rugova Art, Prishtinë, duke ju uruar gjithë të mirat.

Më mbas mar një tjetër urim:

-“Suksese në të tjera poezi”, - nga Z.Vladimir Rama. Midis të tjerash ai shkruan: - poezia juaj ka një kuptim të gjerë, atë të një kombi dhe të një flamuri të përbashkët. Dhe kështu ai më përshëndet fort, sepse sipas tij, është një kontribut i veçantë në realizimin e kësaj dëshire të përbashkët.

Urimet për këtë poezi, që Albania Press e publikoi me flamurin e shtrenjt shqiptar, duke ngazëllyer shumë shpirtin tim të brishtë, janë të shumta.

Në një kohë që Z.Ferhat Ymeri më dhuron një urim shumë fisnik: - “Fluturim të mbarë në udhëtimin tënd artistik dhe atdhetar!”, - unë ndjem keq, si një fëmijë i zënë në faj për këtë shkrim të padërguar tek Tribuna Shqiptare, - ku pashë të publikuara për herë të parë në faqet e internetit dy tregimet e mia të para.

Mirëpo duke qenë se si tip, kam nevojë për mbështetje, për një urim, për një fjalë të ngrohtë, nga këto urime ndjem me të vërtet shumë mirë. Lotët e dhimbjes për padrejtësitë këmbehen me lotë gëzimi, nga përkujdesi i fjalëve të zgjedhura nga mirësia e shpirtit në lidhje me personin tim.

Dhe meqenëse mendoj se në jetë është shumë e rëndësishme, ta ndash si bukën ashtu edhe gëzimin me ata që kanë nevojë, po pa e tepruar, se gjella me kripe e kripa me karar- thotë populli ynë i mençur.

Unë kam dëshir të ndaj me ju, që do të keni mirësinë të lexoni këtë shkrimin tim edhe një mesazh të dërguar nga vëllai im Z.Lirio Nushi: -“ E shtrenjta motërza ime e vogël! Më krenon çdo moment, kur shoh që zemra jote fluturon me shqipet, edhe pse je kaq larg atdheut tënd. E di shumë mirë se lutjet e shkrimeve të tua të fundit, janë një forcë universale që bekojnë Shqipërinë tonë të “mizëruar” nga “errësira e padijes” mbi të vërtetat e mëdha të kombit tonë. Dhe krahët e shqipes tënde në Fluturim, janë të vogla të mbështjellin brengat e mëdha të një kombi të tërë që “rënkon i heshtur”. Sepse shqipet e vërteta janë të vetmuara...! Po jam i sigurt se forca e zemrës tënde, do të marrë fuqi kur t'i bashkohen miliona të tjera në ajri. Të përqafoj me mall dhe e di sa pak kohë të ngelet për t'i shkruar këto rrjeshta, sepse vogëlushët e tu Uilliam e Cesare (Uiliami dhe Çezare) të shpejtojnë frymëmarrjen nga përkujdesja e madhe që duhet t'ju japësh. Ti je kranaria më e madhe e jetës sime...

Duke dashur të shkëputem nga fjalët e vëllait tim, tre vjeç më të madh se unë, po vazhdoj të shkruaj me pak fjalë për një tjetër libër të Z.Florig Bruqit. Për librin “Triumfi Shqiptar” .- të

botuar në Rugova Art, i cili sjell mjaft të dhëna për krimet dhe tmerret serbe ndaj shqiptarëve autoktonë që nga Sanxhaku i Nishit, deri ku shtriheshin shqiptarët në trojet e tyre etnike. Shumë i fuqishëm është shkrimi: “Ardhacakët sllavë, armiq të përbetuar të kombit tonë”, apo “Përprjekjet sllave për shfarosjen e shqiptarëve”

Mirëpo Z.Flori shkruan: “Puthja për femrat, më e rëndësishme se seksi”. - Për këtë, si femër, i jap të drejtë.

Me një interes të jashtëzakonshëm për çdo lexues është shkrimi: ”Kuvendi i Isniqit, një shekull më parë, solli Besëlidhjen Shqiptare”.

Ja, kjo është një përmbledhje shumë - shumë e vogël për krijimtarinë Z.Flori Bruqi.

Po unë e respektoj më tepër, për respektin njerëzor që tregon ai ndaj kujtdo, që për një arsye ose tjetër, lidhet me të.

Pasi, nëse në jetën e përditshme nuk di të sillesh me fisnikëri ndaj personave që të rrethojnë, gjithë ato që shkruan, sado vlerë që të kenë, shumëzohen me zero.

*Brescia - Italy, 27 shkurt 2014*

TRIUMFI SHQIPTAR, VEPËR SHUMËDIMENSIONALE  
PREZENTIMESH E TEMATIKASH HISTORIKE E  
LETRARE

**Nga Prof.dr. Naim Kelmendi**

Blogu virtual, tashmë i njohur për mijëra lexues të tij, Floart Press, iformuar dhe i drejtuar tash e sa vite nga poeti dhe shkrimtari, autori i shumëromaneve e veprave poetike, Flori Bruqi, po luan rolin e tij, e të një rëndësietë veçantë, në shumë fusha të krijimtarisë dhe ato infomimi, por jo vetëm kaq. Në këtë vebfaqe mund të lexohen shumë e më shumë tema, shkrime e prezente fushash dhe autorësh të ndryshëm, por që në këtë drejtim kanë një interes, jo vetëm për lexuesin e kategorisë më të thjeshtë, që aty “hyn” për “vizitë” informative. Pikërisht në këtë blog, janë botuar mjaft shkrime, jo vetëm letrare e poetike, por edhe mjaft shkrime me tematikë nga historiografia shqiptare, me tematikë nga gjuhësia shqiptare, me tematikë nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore, janë prezentuar mjaft personalitete të jetës sonë publicistike letrare, janë botuar shumë poetë të zgjedhur nga hapësira gjithëshqiptare, prej nga vijnë akëcilët prej autorëve që veprojnë e krijojnë në ato hapësira jetësore gjithëkombëtare. Por, në këtë Blog virtual, ka pasur edhe mjaft tema me natyrëdebat, reagime, shumëherë polemika të natyrave të ndryshme e për çështje tëndryshme etj, që pikërisht me këtë polarizim dhe me këtë natyrë paraqitjeje, këtë blog virtual, e ka bërë më të vizitueshëm dhe më të lexueshëm nga mijëra lexues në ditë. Nisur nga ky diversitet temash e preokupimesh krijuese të paraqitjeve, në të shumtën është paraqitur

mendimi, sipas drejtuesit të saj, qetë akumulohet një lëndë, kuptohet e zgjedhur dhe e sistemuar, që të botohet silibër, duke pasur kështu një rëndësi tjetër për një lexues tjetër, duke i dhënë kështu kënaqësinë estetike dhe mundësinë edhe një tjetër kategorie lexuesish, që të kenë mundësi t'iu qasen këtyre shkrimeve dhe temave, interesante dhe të nevojshme për lexim edhe për lexuesin e librit. Nga kjo doli libri i parë i këtij lloji, i shkrimtarit dhe publicistit të mirënjohur, Flori Bruqit, vepra me titull: "Guxim shqiptar", që zgjoi interesimin e duhur tek lexuesi ynë, jo vetëm në Ko-sovë, ku u botua dhe u promovua kjo vepër e autorit, por edhe më gjerë. Poashtu pas një pune të kujdesshme dhe sistematike të Bruqit, vjen edhe vepra e dytë, me titull: "Olimpi shqiptar", gjithashtu një vepër me interes, për lëndën e saj të pasur, jo vetëm poetike e letrare, por edhe publicistike dhe për shumë tema dhe shkrime të një tematike fushash të ndryshme.

Kështu pason edhe libri i tretë, e që tashmë e kemi në dorë, me titull "Triumf shqiptar". Mbase kjo sintagmë e emrit shqiptar, është një simbiozë, që i lidhë të tri këto vepra, por duke i krijuar jo vetëm si një ndër lidhje të brendshme përkah tematika dhe gama e natyrës së shkrimeve në mes vete, por edhe si një trilogji, do të thoshim, të një tërësie të nivelit shkrimor, sipas shijes, vrojtimit dhe sistemimit të autorit Bruqi. Libri më i ri, "Triumf shqiptar", i autorit Bruqi, sjell gjithashtu një konglomerat temash e shkrimesh, sikur janë edhe të ndara në disa kapituj programatik, do të thoshim, që nga temat me përmbajtje historike, e ku zënë vend ato me temë nga historiografia shqiptare, e që ndër këto shquhen edhe ato për autoktoninë tonë, sikur janë p.sh "Shqiptarët dhe



Ballkani”, apo “Ardhacakët sllavë, armiq të përбетuar të kombit tonë” apo “Përpjekjet sllave për shfarosjen e shqiptarëve”, pastaj ato për prejadhjen e shqiptarëve në këto hapësira, si “Etnogjeneza e shqiptarëve ngailirët”, pra me përmbajtje shkencore, dhe të autorëve të mirënjohur botëror, apo edhe mjaft tema të tjera të kësaj natyre, si p.sh

“Pashallaku i Beogradit gjatë sundimit osman”, që sjell mjaft të dhëna dhe fakte historiografike për krijimin e shtetit serb që në viti 1800 e tutje, duke argumentuar se serbët kanë ndjekur një politikë tejet agresive dhe ekspansioniste ndaj racave tjera në Ballkan, për t’iasimiluar, sidomos ndaj shqiptarëve, e që janë në hapësirat e veta autoktone prej shekujsh.

Ky shkrim të kthen të historia jonë e hershme, sa tragjike por edhe a dhimbshme, duke mbetur në kujtesë për atë hapësirë të etnisë shqiptare, pra Sanxhaku i Nishit, vetëm toponimet e vendbanimeve shqiptare. Sidomosky shkrim me karakter studimor sjell mjaft të dhëna për krimet dhe tmerretserbe ndaj shqiptarëve autoktonë që nga Sanxhaku i Nishit, deri ku shtriheshinshqiptarët në trojet e tyre etnike.

Disa shkrime në këtë kapitull shkojnë edhe më larg, që në lashtësinë ilire, duke sjellë fakte të tjera nga shtrirja dhe jeta e ilirëvenë hapësirat ballkanike, siç është shkrimi me titull, ”Emrat ilirë të vendeve e të lumenjve në Serbi”.

Janë edhe mjaft shkrime të tjera, që përbëjnë lëndën e pasur të kësaj vepre publicistike të Bruqit, siç është ta zëmë, ”Helena e Trojës, legjendat dhe të vërteta 2500 vjeçare”, që flet për lashtësinë e miteve greke,apo “Ataturku dhe rilindja e një kombi”, që flet për një pjesë të historisë së Turqisë dhe për reformatorin e saj Kemal Ataturkun, e që ky, siç e vërtetojnë

edhe faktet historike ishte me prejardhje shqiptare. Lënda e kësaj vepre sjell edhe mjaft shkrime të fushës letrare, siç janë ato nga letërsia botërore, me theks të veçantë tek disa autorë tashmë klasikë të kësaj letërsie dhe nga ajo shqiptare, duke veçuar kështu autorë dhe nivele të mirëfillta shkrimore të letërsisë sonë të re, kësaj të modernes dhe post modernes.

Kur jemi tek letërsia shqiptare, në kapitullin me titull: "Letrare", zënë vend shkrimet si: "Albanologët austriakë zbulojnë një libër shqip, para Buzukut, nisin verifikimet", pastaj shkrimi: "Jeta e emigrantëve shqiptarë në SHBA në shek.XX", apo shkrimi tjetër: "Ç'shkruante Agolli, Çabej, Shuteriqi, Çaçi, Spasse, Buda, Paço, Gjata, kur vdiç Fan S.Noli", apo: "Grekët, Viliam Mayer, Ali Pasha dhe Bajroni", e që kështu përbëjnë gjerësinë dhe thellësinë e veprës përkah tematika e shtjelluar në këto shkrime e artikuj të natyrave historike, letrare, gjuhësore, poetike etj.

Në një kapitull tjetër zgjojnë interesin shkrimet tjera të natyrës psikologjike, ku në to shtjellohen mjaft tema edhe nga seksologjia, etj, të elaboruara dhe të shtjelluara me profesionalizëm. Shkrime të kësaj natyre veçojmë, sikur janë:

"A është stimulimi seksual i njëjtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat", "Puthja për femrat, më erëndësishme se seksi", "Tradhtia e ka emrin burrë apo grua?!...", e ndonjë tjetër.

Edhe te kapitulli me titull: "Tematike", mjaft shkrime zgjojnë interes për shkak të natyrës së tyre dhe për tematikën që rrahin. Do të veçonim këtu shkrimet, sikur janë ato: "Bota ka 15 milionë shqiptarë", "CIA për republikën e Kosovës", "Carla Del Ponde dhe shqiptarët", "Kur'ani në letërsinë shqiptare", "Kuvendi i Isniqit, i një shekulli më parë, solli

besëlidhjen shqiptare”, ” Vizioni nacional i Dr.Ibrahim Rugovës”, “Lideri historik i shqiptarëve, Ibrahim Rugova”.

Edhe në kapitullin “Poetike”, prezentohen në këtë pjesë të librit, disa nga poetët tanë dhe krijimet e tyre, sikur janë disa emra të shquar, gjithandej gjeografisë sonë etnike, ku veprojnë e krijojnë, si: Ramiz Kelmendi, Xhevahir Spahiu, Ramadan Musliu, Naim Kelmendi, Luljeta Lleshanaku, Mimoza Ahmeti, Basri Çapriqi, Kozeta Zavalani, Julia Gjika, Aleksandër Gera, Prend Buzhala, Adem Zaplluzha, Lekë Gjoka, Nexhat Çoçaj, Ilir Borova, etj.

Në fund libri “Triumf shqiptar” jep gjithashtu një pasqyrë të disa nga veprat e botuara nga autorët tanë, apo disa zhvillime letrare të ne, promovime veprash, botime etj, nën titullin “Ciceroni letrar”.

Kështu, libri “Triumf shqiptar” i shkrimtarit, publicistit, dhe poetit, Flori Bruqi, përbën, me një fjalë, tërë atë gamë temash e shkrimesh që veprës i japin peshën e veçantë, jo vetëm për kah gjerësia e karakterit shtjellues tematik, por edhe për kah cilësia strukturore, përmbajtësore, si dhe për kah kuptimi metaforik...

## LUFTA E OPINIONEVE

*Ese letrar për librin „Guxim shqiptar“ të shkrimtarit Flori Bruqi*

**Nga Rrustem Geci**

Libri „Guxim shqiptar“ i shkrimtarit dhe studiusit Flori Bruqi është një libër i arrirë, një libër që lexuesin e tërheq ta lexoj. Temat, motivet, trajtimi, rrjedhshmëria, mesazhi e të tjera kudo janë brenda librit.

Gjithë natën era mbrëmë theu qelqe, porta, pullaze,.. e nata s'kishte të sosur. Në këtë art poetik të poetit Bruqi, libri shpalon shtresat e errësirës,urrejtjen e “bujtësve” këtej, veprimet e tyre prej armiku.

Nuk ishte dëshirë e këtij populli që Kosova të ngjy fjalën në qypin e gjakut. Asnjë betejë në Kosovë nuk ishte pa një pike gjaku, pa një të rënë në rrënjë të fjalës. Alfabeti i lirisë është ai i moçmi, me pushkë, me dije, me guxim.

Pa pushkën majekrahu të trimave shprehet Bruqi, liria jonë do të ishte vetëm një dëshirë dhe asgjë më shumë. Libri “Guxim shqiptar” është një dëshmi esesh dhe polemikash se gjakderdhja e madhe, ikja e madhe, dhe kthimi i madh, detyruan bashkësinë ndërkombëtare ta njohin vullnetin e popullit të Kosovës.

Në këtë libër të arrirë autori Bruqi, ka shtruar me kujdes rreth 73 ese dhe polemika e vështrime kritike nga gjuhësia, historia, antropologjia, politika, spiunazhi, psikoanaliza, astrologjia dhe letersia.

Libri „Guxim shqiptar“ ka një leksik të pasur, të rrjedhshëm e me figura të kohës sonë.

Temat në këtë libër janë nga „ish përditshmëria“ jonë e luftës dhe e opinioneve.

Lufta e Kosovës në këtë libër është me plot guximtarë dhe kryengritës të devotshëm. Asnjë fjalë e asaj kohe tregon Bruqi nuk ishte pa beteja, pa një guxim në vete. Nevoja për liri krijoka vullnetin për liri.

Nuk ishte i lehtë rebelimi nën atë pushtues. Çdo njeri që nku pajtohej me gjenocidistët serb, ai duhet të ishte trim dhe trim shkuar trimave. Mirëpo, fuqia e popullit është fuqia e pareshtur e betejave të tij.

Në atë kohë të „Guximit shqiptar“ çdo njeri i etnikumit tonë ishte në luftë, në betejën e tij për të mbijetuar. Pak janë ata që janë fshehur hijeve. në këtë temë kujtoj se kam shkruar mjaft.

Çlirimi i Kosovës nuk ishte i lehtë, për këtë dëshmojnë të rënët. Flori Bruqi deri më tash ka botuar 24 libra. Libri „Guxim shqiptar“ është libri i 25 me radhë.

Krijimtaria e Floriut është e gjerë dhe e thellë.

Veprat e Floriut janë të vlerësuara nga kritika. Bruqi është një figurë e madhe në letërsinë tonë...

## OLIMPI SHQIPTAR

*(Pikëpamje, kritikë, vlerësime, poetikë...)*

**Nga Prof.dr. Naim Kelmendi**

Vepra "Olimp shqiptar" është edhe një kontribut tjetër i mendimit intelektual dhe vështrimit, pikëpamjes dhe mendimit kritik, të shkrimtarit dhe publicistit, Flori Bruqi. Autor i shumë veprave, ai na del para lexuesit edhe me këtë vepër në publicistikë, si çdoherë me veprat e tij në këtë fushë, i arrirë, përmbledhës, i veçuar dhe i shenjuar. Pas veprës paraprake, "Guxim shqiptar", që tek lexuesi shqiptar, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, nuk mbeti pa jehonën e vet, tash Flori Bruqi vjen para lexuesit tonë me një tjetër vepër hiç më pak të rëndësishme se kjo që e theksuam. Madje, kjo e tashmja: "Olimp shqiptar", në dukje të parë, mbase nënkuptohet si vazhdimësi e "Guximit shqiptar", por kjo na del disi më e veçuar përnga kuantiteti dhe kualiteti, përnga seleksionimi dhe vizioni conceptual i librit, poashtu dhe përnga tematika dhe përnga seleksionimi i lëndës së këtij libri. Nisur nga botimet elektronike, si tek libri "Guxim shqiptar", në vebfaqen "Floart Press", Flori Bruqi ka ditur të veçojë në këtë vebfaqe letërsi të mirëfillët, polemika të nivelit intelektual e shkencor, shkrime e veçime të tjera nga shumë fusha letrare dhe të publicistikës.

Me sajimin e librit "Olimp shqiptar" autori sinjifikon një pikë kulmore të asaj lënde që përfshinë brenda kjo vepër dhe, pikërisht këtë synon autori t'ia ofrojë lexuesit. E tërë lënda, kuptohet, më parë e botuar në vebfaqen e njohur "Floart Press", është lëndë e zgjedhur dhe e përzgjedhur nga kritere të mirëfillta letrare, që përbëjnë një prezentim zhanresh të

ndryshme, duke u nisur nga poezia, me autorë të zgjedhur shqiptarë, polemika për çështje të veçanta, çështje me tematikë psikologjike, analiza dhe veçime nga letërsia botërore, kuptohet sipas përzgjedhjes së autorit, por edhe autorë e figura të letërsisë, publicistikës dhe jetës buplike shqiptare, që në një formë o në një tjetër, kanë shënuar pika kulmore në jetën dhe dijen shqiptare. Të tilla figura në këtë vepër i gjejmë, nga bota letrare: Esad Mekulin, Azem Shkrelin, Din Mehmetin, Fatos Arapin, Arshi Pipën, Martin Camajn, Anton Pashkun, Agim Vincën, Sabri Hamitin, Besnik Mustafajn, Naim Kelmendin, Abdullah Konushevcin, Fahredin Shehu, Iljaz Prokshin, Albana Lifschin, Rajmonda Moisiu etj, nga ajo studimore si Rexhep Qosjen, Idriz Ajetin, Jup Kastratin, gjithashtu për jetën dhe veprën e nobelistes shqiptare Nënë Terezën, pastaj për figurat madhore të kohës sonë, legjendën e luftës, rezistencës dhe trimërisë shqiptare Adem Jasharin, atë të presidentit historik të Kosovës, Ibrahim Rugovën, atë të shkrimtarit tashmë me famë botërore Ismail Kadare, si dhe mjaftë tema të tjera me interes të veçantë...

Edhe me këtë vepër diktohet mëtimi i autorit Flori Bruqi që të seleksionojë kategori, vlera dhe çështje që shenjojnë nivele të arrira në botën e kulturës shqiptare, dhe këtë ai arrinë ta bëjë me sukses, me një shije të hollë dhe të zgjedhur. Me zellin dhe sensin e tij prej intelektualit të kujdesshëm, ai pothuajse i vë shenjën pikante mendimit të analizës letrare, prezentimit, vështrimit, krijimit, debatit, recensionit dhe shtjellimeve tematike, që ngrit brenda këtyre vështrimeve dhe tematikës në këtë vepër...

## REAGIME DHE POLEMIKA QË SFIDOJNË TË PAVËRTETAT SERBE TË KOHËS

Në librin “Polemika shqip”(Prishtinë, 2009), shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Flori Bruqi, spikat me sensin për të polemizuar, në të shumtën për të reaguuar në shumë çështje, që për temë kishin atë, çështjen e të vërtetës historike shqiptare, por të shkruara dhe të thëna në kohë dhe hapësirë të caktuar nga emra akademikësh serbë dhe shkruesish serbë.

Polemisti Mr.sci. Flori Bruqi, në blogun e tij virtual: ”Flor Press” dhe në shumë web faqe tjera shqiptare dhe në gjuhë tjera botërore polemizon dhe reagon shpejtë kundrejtë të pavërtetave të thëna nga akëcilët akademikë serbë, që me “të vërtetën” e tyre publike, ushqenin opinionin vendor e ndërkombëtar për akëcilën çështje a problematikë kundër çështjes shqiptare, qoftë politike, historike, etnike etj.

Flori Bruqi polemizon intelektualisht dhe me kundërargumente kundrejtë shpifjes publike serbe, më mirë të thuhet, kundër rrenës serbe, që sipas thënies së njohur të akademikut serb Dobrica Qosiçit, është moral serb, për ta mendësuar opinionin me pseudoinformim, me pseudoshkencë, me pseudopolitikë etj, por që këtyre, polemisti i mirënjohur shqiptar Flori Bruqi ua heq maskën me kundërargumente.

Pra, në këtë libër, që përmbledhë, në të shumtën polemikat e kohës së pasluftës për shumë çështje, sa të ndieshme, siç është e vërteta mbi masakrën e Reçakut, aty ku më 1999 ishte kryer krim kundër njerëzimit, apo shumë çështje të tjera, që nga pseudoshkruesit, pseudoakademikët, pseudointelektualët serbë të Beogradit, interpretoheshin ndryshe nga ajo që ishte e



vërtetë e përmnjëmendët, Flori Bruqi i problematizon çështjet, kuptohet reagon pas shkrimit të atyre, për t'i ndriqar dhe për t'i vënë në vend të vet të vërtetat, apo për t'ua thënë secilës emrin e vet ashtu siç e kanë në të vërtetë.

Sepse, krimi e ka emrin krim, shpifja e ka emrin shpifje, masakra e ka emrin masakër, e kështu me radhë.

Ky libër ofron mjaft material të polemikës, një zhanër ky, jo fort i lëruar në letrat tona të kohës moderne, por ja që, Flori Bruqi, reagon dhe polemizon në nivelin më të mirë me pseudoshkencën serbe...

Në të vërtetë, ky libër ofron për lexuesin edhe mjaft reagime të tjera nga shkruer të ndryshëm në Blogun virtual "Floart Press" etj.

Në këtë libër, jipet gjithashtu një listë e gjatë emrash të të vrarëve shqiptarë, me datëlindje dhe vende ku janë masakruar apo vrarë, në luftën e fundit më 1998-1999 në Kosovë, nga ish ushtria, policia apo paramilitarët serbë.

Kështu që edhe ky kapitull plotëson një anë tjetër të vërtetash, mbi krimet serbe në Kosovë, e që plotësojnë atë kriterin e polemikës argumentuese në raport me polemizuesin, shkruerit shpifës e falsifikator të vërtetash historike, politike etj.

Shkencëtari dhe polemisti Flori Bruqi, reagon dhe polemizon duke mos dashur që t'i lë të heshtura çështjet, në të shumtën, atëherë kur ata, nga tabori i "intelektualizimit" serb, pa argumente, shkruajnë e gënjejnë, për çështjet, tashmë të njohura edhe nga opinioni botëror.

## LETËRSITË SI VAZHDIMËSI HISTORIKE

*“Letërsia si 'aksion' komunikimi” -Një libër kritik për krijimtarinë e shkrimtarit Flori Bruqi*

**Nga Rajmonda Maleçka**

Flori Bruqi është njëri nga shkrimtarët që ka shkruar njërën nga letërsitë më interesante në Kosovë, veçanërisht në prerjen kohore të viteve 90-të e në vazhdim, me çfarë është bërë prezent një nga zhvillimet më të rëndësishme jo vetëm për Kosovën, por të gjithë Ballkanin. Në problematikën historike, etnologjike, diplomatike e emblemuar nga të gjithë analistët historik dhe ato të kohëve të vona si “nyja gordiane e Ballkanit”, letërsia e Flori Bruqit është interesante dhe e elementuar si letërsi bashkëkohore me të gjithë problematikën e saj qoftë ajo brenda letrare dhe ajo jashtë letrare.

Një korpus romanesh, të cilët në librin kritik që pritet të botohet në Tiranë së shpejti, vlerësohen si detaje të realitetit shqiptar, në kushtet e një klime kolonialiste, hedhin dritë të mjaftueshme në prerjet historike të një populli të sakrifikuar dhe të kryqëzuar për një çështje të hershme dhe hyjnore. Të gjithë konfliktet hyjnore kanë në themelin e vet raportet me lirinë. Flori Bruqi ndihmon në “paradigmën” për ta kuptuar “legjendën e mbijetesës”, gjithashtu dhe atë temën biblike të dhimbjes.

Raportet që letërsitë kanë me popujt dhe tokën në të cilën ato kanë gjetur rrënjët e fjalëve dhe të mendimeve, të kujtesës dhe të nevojës për të ditur se kush është atdheu, liria, njerëzit e lashtë dhe njerëzit e lirisë, kanë prodhuar gjithmonë letërsi që

ju kanë rezistuar kohërave. Një letërsi është e mirë, është nënprodukt i një realiteti të madh njerëzorë, kryesisht nga ky raport dhe nga jetëgjatësia që ajo i ka programuar vetes.

Pjesa më e madhe e letërsisë së shkruar në Kosovë, veçmas nga gjysmë e dytë e shekullit që sapo lamë pas, është ndërtuar përmes një raporti ekzistencial i elementuar në subjekte, ngjarje, personazhe dhe struktura të shkëlqyera vertikale dhe horizontale me çfarë krijuesit e Kosovës i kanë bërë shërbimin kulturës shpirtërore dhe asaj të kujtesës kolektive, duke qenë e orientuar shpirtërisht.

Ekzistencializmi është një konsekuencë e njohur për të jetuar, i cili është shfaqur dhe e ka pjesëtuar veten në letërsinë artistike më shumë se sa në shumë fusha të tjera të dijes dhe të filozofisë. Tek shqiptarët ky lloj raporti ka qenë shumë më herët se sa Hajdegeri të shpallte doktrinën e ekzistencializmit. Nëpër prerjet e këtij ekzistencializmi, shkrimtari Flori Bruqi ka arritur t'i "shkulë" kohës shumë personazh të tipizuar mrekullisht, shumë ngjarje me të cilat i bëjnë prezent epokën, protagonizmin historik, të cilat janë elementë të dukshëm të procesit letrarë.

Studimi kritik për krijimtarinë artistike të Flori Bruqit e karakterizon autorin si një krijues unik në kushtet e një letërsie të re dhe specifike, e cila u shkrua në Kosovë në rrethanat e një kompleksi totalitaro-kolonial, e cila ishte e kushtëzuar të ishte me një simbolikë të qëndrueshme, por të realizonte një komunikim real. Në kohët totalitare dhe ato që inspirohen prej tij, apo janë nënprodukt i tij, komunikimi ka një rëndësi të madhe, i cili lidhet me strategjinë e mbijetesës. Kosova, të paktën për një shekull është kushtëzuar për

mbijetesën e saj, pasi mbi të njëri nga kundërshtarët e saj të vjetër praktikoi mbi të gjenocidin, etnocidin dhe shfarosjen e zhdukjes në masë.

***a. Letërsitë si prerje të kohërave***

Studimi kritik për krijimtarinë e Flori Bruqit si shkrimtarë merr në konsideratë romanet e tij të cilët nyjëtojnë kohët më emblematike të Kosovës. Bruqi ka arritur të sjellë personazhe, realitete njerëzore, situata, ambiente dhe klimë shpirtërore autoktone, të cilat bëhen të kapshme nga të gjithë kategoritë e lexuesit. Letërsia ka një qëllim të njohur, ajo synon të realizojë një komunikim sa më të gjerësishëm dhe sa më selektiv. Marrëdhënia që letërsia krijon me lexuesin është më e shtrirë dhe më e gjerësishme se sa njoftimi që përcjellin llojet e tjera të komunikimit, dhe të letërsisë dokumentare apo dhe asaj historike.

Bruqi arrin të krijojë një raport kompleks të të gjithë llojeve të komunikimit me kohën, njerëzit, relacionet e nevojshme të shoqërisë në saj të tipave, karaktereve, ngjarjeve dhe të lëndës letrare, aq më tepër të gjinisë së romanit, duke e shndërruar të në “aksion”. “Aksioni” i komunikimit, kryesisht përmes një letërsie të ngjarjeve të hapura dhe të përjetuara, ka përmbushur njërin nga kushtet më sendërtare të letërsisë artistike, duke qenë njëra nga pasqyra më besnike ku njerëzit kanë parë fytyrën e vet dhe historia ka shtuar faqet e librit të saj të madh të etnisë, kombit dhe të autoktonitetit të tij. Romanet dhe krijimtaria artistike e Flori Bruqit, sjell prerjet kohore të zhvillimeve të fund-shekullit të kaluar kryesisht, në një realitet të kushtëzuar njerëzore, ku duken hapur marrëdhëniet koloniale të kolonizatorit si sundues i egër dhe i

papërmbjatshëm në egërsinë e vet dhe të një realiteti njerëzorë, i cili i referohet thelbit të tij që nga lashtësia deri në ditët tona. Drama dhe personazhet, aksioni i ngjarjeve dhe definicionet psikologjike, të cilët tipizojnë zhvillimet sociale dhe historike të asaj ku merren dhe autori e gjen lëndën letrare, janë si dukuria e formimit të ortekëve që zmadhohet dhe marrin fuqi në rrugëtimin e vet. Bruqi kujdeset t'i ruajë konvencionet e kohës së tij dhe të personazheve të tij.

***b. Letërsitë si vazhdimësi historike***

Çështjet kombëtare kanë rrënjë të thella në problematikën e tyre për t'u bërë letërsi për arsyen e njohur të tyre. Letërsia artistike i ruan ngjarjet historike ndryshe arkivave, ndryshe dokumenteve historike, ndryshe historisë, ndryshe kronikave dhe ndryshe gjithë llojeve të tjera të kujtesës. Letërsia artistike i mbush me gjak dhe shpirt ngjarjet historike, i mban ashtu dhe i ruan po ashtu. Letërsia artistike i ka kodet komunikative më të gjerësishme dhe më shpirtërore se sa të gjithë zejet e tjera të kujtesës dhe të revokimit njerëzor. Letërsia artistike nuk i konservon as ngjarjet historike, as ato njerëzore, as dhe personazhet e tyre, përkundrazi ajo arrin t'i bëjë pjesë të konvergjençave të zhvillimeve.

Personazhet e njohur dhe real të Shekspirit të madh, historia i ka fosilizuar, i ka konservuar deri në gjendje bazike, ndërsa shkrimtari i madh përmes letërsisë i ka sjellë ato në marrëdhënie me të gjithë kohët, pavarësisht sa të zhvilluara dhe të avancuara ata kanë qenë krahasimisht me kohën e personazheve real, prej të cilëve Shekspiri e mori “tharmin” e tyre. Thuajse 10 romanet e Flori Bruqit dhe libri më i mirë i tij, “Guxim shqiptar”, i cili është ndërtuar si një organizëm unik,

me marrëdhënie dhe kumte vertikale, horizontale dhe diagonale, dhe që është një libër për të gjithë, përbëjnë një realitet të veçantë letrarë, qoftë për tematikën po ashtu dhe për profilin letrarë që autori ka paraqitur. Dhe kjo është kaq e vërtetë, sa të zë shumë pak kohë fizike ta absorbosh në leximin e parë këtë lloj krijimtarie, por është ndryshe kur atë kërkon ta zotërosh.

Shkrimtari Flori Bruqi përmbush parimin themelorë të letërsisë si krijim, pasi ajo (letërsia artistike) nuk e përkufizon kohën që zë brenda vetes, por e pasqyron atë përmes zgjedhjes dhe seleksionimit të ngjarjeve, personazheve tipik dhe e bën të komunikueshme me të gjithë kohët. Kjo sjellje elitare dhe e zgjedhur i bashkëngjitet dhe përvetësohet

### *c. Metafora ekzistenciale e jetës*

Duket se Flori Bruqi është një shkrimtar, i cili arrin ta gjejë letërsinë dhe gjendjen e tij krijuese, qoftë në një realitet në të cilin flitet për vdekjen, pritet vdekja, dhe, ku të gjithë lajmet që shkojnë e vijnë kanë të bëjnë po me vdekjen. Baladat e vjetra dhe ato të reja qoftë dhe për ta mundur vdekjen, kanë qenë dhe do të jenë më tragjiket në historinë e njerëzimit. Epi i Gilgameshit duket se i ka thënë të gjitha që nga koha kur ai u krijua dhe deri sot.

Ka kërkuar dhe ka gjetur personazhe, të cilët kanë plotësuar kapacitetin real dhe atë përtej vetës, që shkrimtari i ka bërë pjesë të një pune, frytet e të cilës jetojnë gjatë. Jetojnë më shumë se një shtëpi, më shumë se një mundim, më shumë se të gjithë gjërat e tjera më të sofistikuara, që njerëzimi është përpjekur dhe ka luftuar ta “mbajë” kohën, ta sundojë atë.

Koha nuk mund të sundohet kurrë, ajo zotërohet dhe të gjithë këtë e kanë bërë shkrimtari me letërsinë, që nga kohët antike deri sot. Letërsia e mirë e “mban” kohën, ajo e merr atë mbi shpinë, siç mund të marrësh mbi shpinën e devesë dhe një shtëpi, e përcjell nga koha në kohë. Asnjë teknologji tjetër sado e sofistikuar të ketë qenë ajo nuk ka arritur ta bëjë këtë, përveçse letërsia dhe shkrimtari.

Shkrimtari Flori Bruqi ka kërkuar ngjarje dhe ato i ka gjetur në jetën e njerëzve të tij, në jetën e armiqve të historisë dhe të popullit të tij. Ka qenë një ngjarje që ka shëtitur nëpër të gjithë rrugët e vendit të tij, nëpër rrugët e fisit të tij, prag më prag shtëpie. Ai, shkrimtari është nxënë me atë ngjarje, është rritur dhe pjekur me të. Një pjesë të saj e ka marrë në shpinë si ajo deveja nëpër shkretëtirë, një pjesë tjetër e ka “bërë” burrëri për ta përballuar jetën.

E gjithë krijimtaria e Flori Bruqit është një mega-metaforë e ndërtuar “metonimikisht” në raportet e njeriut me njerëzit dhe e qëndresës me ekzistencën. Studimi kritik mbi krijimtarinë e Flori Bruqit arrin ta elementojë të gjithë strukturën artistike të cilës i “perimetrohet” dukshëm ç’ka motivuar atë dhe pse ka qenë e tillë. Krijimtaritë universale vijnë përmes thjeshtësisë së vet, por e mbajnë të tillë temat universale, për të cilat njerëzimi ka pasur, ka dhe sot do të ketë përjetësisht nevojë. Studimi kritik për krijimtarinë e Flori Bruqit prek dhe çështjet e tjera të letërsisë që është shkruar dhe po shkruhet në Kosovë.

## SHKRIMTARI QË SHTROI “SHINAT” E “ OLIMPIT” SHQIPTAR

**Nga Prof. Faik Xhani**

Flori Bruqi me impenjimin e tij shumëvjeçar, me punën e tij prej intelektual, me obligim atdhetar, me përgjegjësinë e një studiuesi dhe hulumtuesi serioz, me peshore farmaceutike, ka ditur të zgjedh, të shkruaj e të përmbush pjesën lëndore të “Olimpit” Shqiptar.

Rrjedha kohore ecën me ritmin e saj, duke ruajtur në memorien e nderit njerëz e personalitete të nderuar. Në epokën e sotme një nga këta është edhe intelektual, publicisti dhe shkrimtari kosovar Flori Bruqi.

Ai, prej kohësh, krahas aftësive profesionale si studiues ka shpalosur talent e mjeshtëri artistike edhe në lëmin e botimeve. Krijimtaria e tij është e larmishme , në prozë dhe poezi, por veçanërisht ka spikatur në prozë, duke botuar 8 romane, 11 libra shkencor, 21 fejtone publicistiko-shkencorë, shumë ueb, faqe interneti me punime socio-psiko-kineozio-logjik, të fshehtat e të vërtetat e virusit avian etj.

Flori Bruqi, shkrimtari që shtroi “shinat” e “ Olimpit” Shqiptar. Ky shkrimtar me një humanizëm e mirënjohje të thellë dhe me një hulumtim serioz disa vjeçar ka mundur të ngrejë një “Olimp Shqiptar” me xhevahiret e krijimtarisë të krijuesve shqiptarë duke gjetur, zbuluar, studiuar, vlerësuar e bashkuar në një libër voluminoz prej 665 faqesh, i cili titullohet “Olimpi Shqiptar”.

Ashtu është titulluar dhe ashtu qëndron, jo si lartësi copë-zash të ngurtësuar, por si lartësi vlerash ideo-artistike e



mjeshtrove të letrave shqiptarë, pavarësisht se ku kanë punuar e jetuar.

Autori Flori Bruqi projektoi dhe hapi “trazenë” e “Olimpit Shqiptar” të krijimtarisë. Ky libër përmbledh 12 poetë shqiptarë, 12 shkrimtarë botërorë, 22 recensione për krijimet më të mira shqiptare dhe botërore, 7 tema psikologjike, 6 historike, 19 shkrimtarë e personalitete nga bota shqiptare, 14 poezi dhe si një epitaf i argjend jetëshkrimi i tij. Ky libër shpërfaq jonizimin e shpirtit të autorit, si më i miri pjalm që bulëzon shpirta, gjallon zemra, flladit mëndje, ndriçon “maratonën” e krijimtarisë shqiptare dhe e ngre atë në lartësinë e një “Olimpi Shqiptar”, si pjesë integrale e artit dhe kulturës Evropiane.

### **Ferri i Flori Bruqit**

Në se Dante Aligeri na solli Ferrin e fantazuar me të gjitha labirintet e tij deri tek rrethi i 12-të të perëndisë, në ditët tona doli një Dante i Ri. Ai është shkrimtari kosovar Flori Bruqi. Ky autor na ka sjellë ferrin e vërtetë njerëzor, jo si dënësë e perëndisë për të këqijat dhe mëkatet e botës njerëzore, por ferrin e shtetarëve e gjeneralëve të Serbisë, të strukturave të ushtrisë e policisë Serbe. Në këtë libër, nga faqja në faqe njihesh me skena të llahtarshme jo të sajuara, por reale, ku artistët që luajnë, janë: plaka, pleq, gra, burra, mandej dhe fëmijë, femra e meshkuj, është një popull i tërë i vënë në kalvarin e vuajtjes e të torturës, një popull i destinuar për t'u përzënë nga trojet etnike e për t'u qitur fare me gjithçka. Është një vend i cili u bë shkumb e hi jo vetëm nga zjarri i predhave e bombardimeve, por edhe nga zjarri i vendosur me benzinë nga dora e shkjaut.

Kur lexon këto faqe të këtij libri nuk ka mëndje që nuk luan, nuk ka sy që nuk loton, nuk ka trup që nuk rënqethet, nuk ka qenie që nuk revoltohet, nuk ka njeri që nuk reagon dhe nuk besoj të ketë qenie njerëzore që të mos jetë e gatshme për t'u radhitur në skalionet e luftëtarëve për t'u thënë ndal, këtyre kriminelëve të njerëzimit, arqitekëve të gjenocidit serb në Kosovë apo atij çam në Greqi.

Duke lexuar librin lexuesi futet në botën e krimit, nuk është më njeri, por duket si një profet që vëzhgon çfarë ndodh në atë labirint krimesh dhe i raporton zotit të tij. Lexuesi xhiron me kamerën e ndjesive, përjetimeve, fantazive dhe riprodhimeve të realiteteve monstruoze që Flori Bruqi, falë aftësive të tij psikologjike, por edhe atyre artistike i sjellë mjeshtërisht në memorien tonë.

Përshfaqet aty Shën Bortolemeu i Gjakovës, objektet fetare qindra vjeçare që digjen, nëna që dhunohen para fëmijëve, mure të përgjakura, bajoneta që presin kopsa, çjerrin gjokse, trupa që digjen me benzinë, makina që mbushen me kufoma dhe nuk dihet ku përfundojnë, prindër që çmenden para torturave të fëmijëve e dhunimeve të nuseve të djemve, gjurmë dhëmbësh nëpër trupësa, shenja plagësh e djegiesh nëpër trupësat e femrave kosovare, sisa të prera, sy të dal, gishta të prerë etj. Shëmbëlltyrat më të këqija të Europës të sotme.

Është shumë tragjike, e paprecedentë dhe nuk mund të kapërdihet pa lënë gjurmë të çdo lexues e të çdo njeri që i thotë vetes njeri, vrasja e 22 fëmijëve të familjes Vejsa, të familjes Cana, Ramadani etj, masakrimi i kirurgut gjakovar Dr. Izet Himës, 2019 femrave të dhunuara që trajtohen nga shoqata “Jeta në Kastriot” nga të cilat, 124 prej tyre janë me gji të prerë e

gishtërinj të këputur, 9 me sy të nxjerr, 16 me plagë në fytyrë që kanë lënë 4327 fëmijë jetimë, të cilët presin me padurim të shohin e të shijojnë kujdesin amësorë. Krime këta që as mendohen, në realitet, kanë ndodhur dhe dëshmojnë çdo ditë para Europës e botës. Ja sepse s'ka kohë për pritshmëri, s'ka asnjë mëdyshje dhe s'ka pse të ketë asnjë hezitim nga Tribunali i Hagës për të hetuar dhe vënë para përgjegjësisë autorët e këtyre krimeve. Nuk ka arsye të heshtte të anashkalohen qoftë edhe ata që i kanë kryer, pavarësisht nga ata që i kanë urdhëruar.

S'ka asnjë arsye që të heshtte e të anashkalohen veprime e qëndrime vandaliste e shoviniste që shfaqen hera-herës nga serbët në Kosovë dhe grekët me shqiptarët. Qoftë edhe raste të shkëputura duhen vlerësuar me rigorozitet, hetuar dhe parandaluar në kohë.

Pikërisht libri i autorit Flori Bruqi “Olimpi Shqiptar” është sinteza më e mirë e dëshmisë së krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit serb në Kosovë.

Ai është një apel i hapur për EULEX, BE dhe për Kombet e Bashkuara për të nxjerrë mësimet e duhura e për të vënë para përgjegjësisë çdo shtetar e shtet që kryen krime e gjenocid, për të prerë e parandaluar një herë e mirë dorën gjakatare të masakrimit, terrorizmit e shfarosjes së njerëzve të pafajshëm e të pambrojtur.

Autori i mizoskenave psikologjike të qenieve njerëzore nën presion dhe kanosje për jetë a vdekje.

Në librin “Olimpi Shqiptar” nga faqja 309-400 janë trajtuar me realizëm temat psikologjike. Në këtë sprovë prej 100 faqesh, autori Flori Bruqi jo vetëm paraqitet si njohës i

thellë i psikologjisë, por paraqitet i veçantë edhe si prozator. Është veçori dalluese e këtij autori pasqyrimi i proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të tij artistikisht. Ky autor falë kompetencës në lëmin e psikologjisë, ka harmonizuar bukur me anë të fjalës artistike rrjedhën e përjetimeve dhe tablotë e mizoskenave psikologjike të qenieve njerëzore, veçanërisht kur ata janë nën presion e shantazhim, nën trysni të kanosjes me vdekje dhe shuarje jete.

Autori në këtë plan mund të jetë ndër lauerantët e paktë edhe në botë të këtyre mizoskenave e të këtij aereali psikologjik. Flori Bruqi me këtë libër ka sjellë një kinoditar me metrazh të gjatë të traumës psikologjike të njerëzve nën dhunim e torturë. Autori me mjeshtëri artistike dhe profesionale ka sjellë në faqet e librit traumën psikologjike të një populli martir siç është populli kosovar, ka realizuar më së miri edhe një model të rrjedhës së proceseve e gjendjeve psikologjike në kushte të veçanta specifike, në kushtet e traumës e të shantazhimit, kur luhet me jetën e vdekjen. Ai nuk mbetet, thjeshtë një vëzhgues i këtyre proceseve e gjendjeve psikologjike të personazheve të të gjitha moshave, por i zhbiron thellë ata, i ndjek hap pas hapi, i analizon me detaje, përgjithësisht jep dhe mesazhe profilaktike për kapërcimin e rehabilitimin e tyre. Pikërisht në këtë anë fokusohet shumë, pasi ajo çka ndodhi, nuk mund të ndalohet më as në Kosovë, as në Çamëri, por e rëndësishme është parandalimi i situatave të tilla kudo në botë dhe rehabilitimi i këtyre viktimave nga qeveria e Kosovës, Greqisë, Avganistanit, Libisë e gjetkë.

Autori Flori Bruqi si specialist i fushës së psikologjisë profilaktike fokusohet në mënyrë të veçantë në një dukuri që

është shtuar shumë në Kosovë dhe në shumë vende të botës, SUICIDIN (vetëvrasjen). Jep dinamikën e këtij procesi, analizon në thellësi faktorët që i çojnë njerëzit në këtë përfundim si dhe jep mesazhe shumë profilaktik për kujdesin dhe parandalimin e Suicidit duke deduktuar: “ *Edhe një i vetëm të shpëtohet është e rëndësishme sepse është jetë njeriu e pakompesueshme me asnjë lloj vlere...* ” ( faqe 391). Më tej duke analizuar këtë akt thekson: “ *Suicidi është një moment kur dhimbja shpirtërore është e masës sa megjullon vetëdijen dhe akti si akt, vjen si pasojë e dëshpërimit të madh, ndjenjës së pavlerës e pashpresës për jetën* ”.

Analizat dhe mesazhet që jep autori janë shumë kuptim-plote për çdo shtetar e qeveri. Trajtesa e këtij akti nga autori si dhe mesazhi që jep janë sa humanë aq edhe të domosdoshëm për çdo qeveri e për çdo shtetarë për ta kthyer fytyrën më mirë nga shtetasit e vet dhe për ta patur prioritet mirëqenien dhe lumturinë e tyre.

Autori Flori Bruqi është njëkohësisht edhe një analist dinjitoz i situatave e proceseve rajonale e globale dhe duke qenë i tillë, me vizionin e tij shkencor e largpamës apelon përpara organizmave ndërkombëtare për parandalimin e gjenocidit e të traumatizimit psikologjik kudo në botë. Ai i fton partnerët ndërkombëtar për të mos i anashkaluar këto trauma njerëzore, përkundrazi për t'i zbuluar, vlerësuar, hetuar, parandaluar dhe duke dënuar cilin do që shkel të drejtat universale të njeriut, qofshin individë apo shtete.

“Olimpi shqiptar” i Flori Bruqit një libër dëshmi e terrorizmit, masakrimit, traumatizimit dhe shfarosjes të popullit kosovar.

Me shqetësimin e një atdhetari të vërtetë, me përkushtimin e një hulumtuesi serioz dhe me vendosmëri të rrallë autori Flori Bruqi ka mundur të zhbirojë thellësisht strategjinë e spastrimit etnik të Kosovës dhe të zbulojë të vërtetën e funksionimit e të veprimit të strukturave policeske të sigurimit serb. Autori ka arritur të zbulojë pseudonimet, ndërtimin, funksionimin, përbërjen, drejtuesit e tyre, aksionet terroriste, masakruese e shfarosëse të civilëve të pafajshëm e të pambrojtur në Kosovë.

Ky autor nëpërmjet hulumtimit, investigimit, intervistimit nga ai vetë apo të tjerë nga Europa e bota jep të qartë tablonë e krimeve, por edhe të strukturave e autorëve të tyre. Ai ka mundur të japë një tablo të qartë për atë çka ndodhur në Kosovë para dhe gjatë ndërhyrjes së NATO-s, me synim të mirëpërcaktuar nga Millosheviçi dhe krerët e tjerë drejtues të shtetit Jugosllav.

Autori i librit zbulon lakuriq të vërtetën mbi masakrat në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq. Midis tjerash shkruan: “Të premtën, ditën e ngrohtë me diell, më 14 maj, të vitit 199 në një kënd të Europës dhe nën bombat e NATO-s, 41 meshkuj nga fshati Qyshk, ishin vrarë nga forcat kombinuara militare serbe. Moshë nga 19 deri në 69 vjeç. Në mëngjesin e së njëjtës datë, forcat serbe të sigurimit kishin sulmuar dhe dy fshatra të tjerë fqinj, Pavlan dhe Zahaq, ku kishin dëbuar nga shtëpitë gratë, fëmijët dhe pleqtë dhe kishin vrarë në tërësi 72 njerëz.

Një nga personazhet e librit Lulja e rrënuar tregon: *“Me këto dy duar unë kam mbledhur eshtrat e dajave të mi, kushërinjve dhe të babait tim. Atë që kishte mbetur nga babai im, e gjeta fare në fund, por jo tërë kufomën. Vetëm disa pjesë*

*nga trupi i tij. Nuk kam gjetur këmbët as kokën. Vetëm brinjët kam gjetur. Dhe me këto duar e kam kallur në dhe kurse, këta-serbët, këta që e kanë vrarë, ata i kanë duart e zhytura me gjak . Ata e kanë vendin në Hagë” (f.353).*

Duke lexuar librin “Olimpi Shqiptar” lexuesi takon pseudonime të till si : “Frenki”, “OPG”, “Mogla”, “Munja”, “Brigada Cara Dushana” etj . Ata janë struktura të policisë, sigurimit e të Armatës Jugosllave që kanë kryer krimet më makabre që ka njohur njerëzimi, të cilët urdhrat i kanë marrë nga njerëzit e gjeneralët më të besuar të Millosheviqit. Gjithashtu emra të tillë si Dragani, Njebosha Miniq (Mrtvi), Vedamir Shalipuri, Miqo Martinoviq, Gjuro Kastratoviq, Milan Kaljeviq, Obrad Rajiqeviq etj. Kanë qenë pjesëtarë të “Munja” që kanë marrë pjesë në disa përleshje të mëdha me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës “(366). Më represivët e më të dhunshëm në terrorizimin, dhunimin, djegiet dhe vrasjet e civilëve të pafajshëm në Kosovë, veçanërisht në Pejë, Qyshk, Pavlan, Zahaq etj.

Pjesët me titujt: “Kush duhet të sjellë drejtësi në vend”, “Na duhet drejtësia sikurse plagës ilaçi”, “Spastrimi etnik dhe ndërgjegjësimi”, “Spastrimi etnik-gjenezë e një ideologjie”, “Përvoja e re, një përvojë e hidhur” etj. Tregojnë vizionin e këtij autori, i cili e lejon atë të nxjerrë përfundime me vlerë si dhe të japë mesazhe paqe e lirie jo vetëm për Kosovën e kosovarët, por për të gjithë popujt e vendet e botës. Përvoja e fituar dhe ndërgjegjësimi i plotë për krimet dhe gjenocidin serb në Kosovë e atë Çam në Greqi përbëjnë pika kyçe orientimi, por edhe bazamente të forta përvoja për parandalimin e këtyre krimeve e gjenocidi kudo në botë.

Për nga larmia e tematikës, galeria e personazheve, mënyra e pasqyimit, analizat e holla e të thella, hulumtimi serioz, të dhënat e njohuritë si dhe deduktimet e mesazhet që jep libri i autorit Flori Bruqi “Olimpi Shqiptar”, përbën një nga librat më të arrirë e shumë interesant nga i cili, kushdo mëson. Ai mbetet një thesar krijimtarie. Ja sepse meriton të zë një vend nderi në bibliotekat e gjithë shqiptarëve kudo që punojnë e jetojnë e më gjerë. Ky libër shtroi “trasenë” e krijimtarisë të “Olimpit Shqiptar”, e cila nevojitet, të pasurohet gjithnjë e më shumë, me krijimet e autorëve shqiptarë nga të gjitha trevat e viset, ku banojnë e jetojnë.

Ashtu është titulluar dhe ashtu qëndron, jo si lartësi copë-zash të ngurtësuar, por si lartësi vlerash ideo-artistike e mjeshtrave të letrave shqiptarë, pavarësisht se ku kanë punuar e jetuar.

Autori Flori Bruqi projektoi dhe hapi “trasenë” e “Olimpit Shqiptar” të krijimtarisë. Ky libër përmbledh 12 poetë shqiptarë, 12 shkrimtarë botërorë, 22 recensione për krijimet më të mira shqiptare dhe botërore, 7 tema psikologjike, 6 historike, 19 shkrimtarë e personalitete nga bota shqiptare, 14 poezi dhe si një epitaf i argjend jetëshkrimi i tij. Ky libër shpërfaq jonizimin e shpirtit të autorit, si më i miri pjalm që bulëzon shpirtra, gjallon zemra, flladit mëndje, ndriçon “maratonën” e krijimtarisë shqiptare dhe e ngre atë në lartësinë e një “Olimpi Shqiptar”, si pjesë integrale e artit dhe kulturës Evropiane.

Nëse Dante Aligeri na solli Ferrin e fantazuar me të gjitha labirintet e tij deri tek rrethi i 12-të të perëndisë, në ditët tona doli një Dante i Ri. Ai është shkrimtari kosovar Flori Bruqi...



PUBLIKIMI I VLERËSUESHËM NË FUSHËN E DIJES  
SHQIPTARE, “OLIMPI SHQIPTAR” I FLORI BRUQIT

Nga Kristaq F. Shabani

*Prologim dritësor*

Kohët e sotme janë kohë të lulëzimit modernist dhe të daljes nga “prangimi” dhe “ganxhimi”, i të cunguarve me emër pronor, që dolën nga “Lëvozhga mit” dhe elegjuan “vargjet vrara” tregojnë për përçapje studimore jashtë “kuadraturës kriteriale“ e normativave moralizuese...

Ende në studimet apo mendimet kritike thuren lavde të pameritueshme për krijues, që shkuan apo që janë aktualisht, pa i këndvështruar ata me sensin e origjinalitetit dhe të prezencës “autoritare“ të kreaturës së tyre..., por shpesh ndiqet përvijimi i rrugëtimit të tyre, nëpërmjet asaj ç'kanë thënë të dikurshmit, të cilët kanë humbur logjikën” e mendimit kritik, në këtë kohë të ndryshimeve të gjithanshme dhe atyre emotive, duke mos kapur fillin e najlonizuar...

Krijimi është produkt i një të talentuari me forcë të madhe meditative, me një këndvështrim ndryshe nga të tjerët, i cili dritësohet nga një diell tjetër dhe është i aftë të krijojë lidhësinë shpirtërore në një formë e trajtë çudibërëse dhe në një klimë polarizuese me stina të kthyeshme, të ndërthurura dhe të ndërvarura nga njëra - tjetra. Sot me studime dhe mendim kritik merren dhe ata, që s'kanë minimumin e njohurisë për këtë shkencë të madhe, duke krijuar precedentin e rrezikshëm të vulgarizimit dhe të skeptricizmit të mediokritetit.

Ndërmarrja e veprave të studimit analitik në këtë vullshmëri dhe stad krijimi me një temperament e stil më të lirshëm, më të pushtetshëm kreativ është një veprimtari, e cila kërkon nivel të lartë kulturor. Shtëlljesë:

Libri “Olimpi Shqiptar”, i Flori Bruqit, është një libër voluminoz, i cili edhe nga aktitektura si dhe nga kapitullizimet e tij tregon katërcipërisht erudicionin, nivelin e njohurive të autorit, lëvrues dhe studiues në shumë fusha, duke bërë analitika dhe paraqitje profesionale. Në këtë libër, duke u nisur nga shijet e tij artistike, që duhen respektuar, ai ka rrokur disa nga poetët shqiptarë si: Azem Shkreli, Agim Vinça, Fatos Arapi, Arshi Pipa, Avdulla Konushevci, Esat Mekuli, Agim Bacelli, Besnik Mustafaj, Arif Molliqi, Din Mehmeti, Naim Kelmendi, Sabri Hamiti, Fahredin Shehu, Rajmonda Moisiu, Mardena Kelmendi, Pal Sokoli, Albana M. Litschin, Raif Gashi dhe Iljaz Prokshin...

### ***Përzgjedhje autoriale***

Kjo është një përzgjedhje autoriale, duke u nisur nga këndvështrimi i tij i pavarur dhe i lirë poetik, nga pëlqesat personale kritike, apo nga mendimet kritike të dhëna për këta poetë.

Azem Shkreli trajtohet në këtë vepër të Flori Bruqit si poeti, që zë vend në krye të poezisë moderne shqiptare si dhe e evidenton si impulsues të një sensi dinamik, të një spektri zgjerues tematik, të një risie lirike si dhe të një pasurimi ngjyror të fjalësit në sensin figurativ të ndjesisë. Jep një panoramë dinamike të Azem Shkrelit, duke paraqitur veprat e tij të botuara në disa gjini si poezi, prozë, drama e tjerë. Azem Shkreli cilësohet si kthesuesi i parë drejt modernitetit

në letërsinë shqiptare. Edhe në lëmimin prozaik autori evidenton Shkrelin si thyerës i tabusë dhe marrës i kthesës së mirëfilltë në letërsinë kosovare dhe atë shqiptare me romanin “Karvani i Bardhë” si dhe me tregimet në librin “Sytë e Evës”. I shquar në lirikat e para (vendlindja dhe njeriu në epiqendër të krijimit), të pasuara me lirikat e dashurisë, lirikat atdhetare, lirikat refleksive.

Një nga karakteristikat më madhore të këtij produkti lirik dhe poetik është se, Shkreli në kreaturën e tij ishte i prirë drejt meditatimeve filozofike. Për të argumentuar përfundimin e tij logjik studiuesi, shkrimtari Bruqi, ilustron me poezi të Shkrelit me tituj intrigues si: “Bregu i Mollës”, “Këngë e Vrugët”, “Motivet e verdha”, “Para elegjisë”, “Liqeni”, “Kënga e turpshme” e tjerë.

Duhet theksuar se periudha, kur jetoi dhe shkroi Azem Shkreli ishte një periudhë tensionare, e indokrinuar, e trajtesave ditirambore dhe e produktit kënaqësor, një periudhë, ku shembëlltyra poetike devijojë me urdhëresa në “korsi” të njëjta, apo starte të njëjta dhe precipitimi vetiak ndëshkohej, ndaj rrugëtimi në “rrugë të pashkelura” duhet të ishte i studiuar me mjaft vëmendje nga krijuesi, por përmasat figurative duhet të ishin të një lartësie e përzgjedhje, por të buruara nga një spontanitet i nevojshëm, për të shmangur rakitizmin (proliksitetin), i cili ishte kryefjala e krijimtarisë së poezisë dobësore inervore e kohës, ku ditirambi dhe natyra krijuese stimulonte pa nerv “ecuritë” këmbërrënë dhe ecjet në urat lëkundëse...

Nëse sot analizon poezitë shkreliane me një këndvështrim tjetër të ecurisë poetike në kontekstin e shkëmbimit universal

të vlerave do të diktosh që, paçka nga mospërkthimet në gjuhë të huaja të kësaj kreature, ruhet supermacia dhe dinamika e krijimit, nga shkathësia frazore dhe figurative, nga fjala e përkorë, nga vrullimi e gjallesa e përcjellshmërisë së idesë, nga arkitektura poetike.

Por duhet theksuar se bukuria lirike e Shkrelit të befason, por në disa raste kalon edhe në momente moralizuese, tonaliteti, paçka nga figurimi si psh. te “Para elegjisë” poezia fillon mjaft bukur dhe precipiton po bukur me natyrshmëri dhe ndjesi, por: ... Një ditë do t'i hash buzët e tua, gjurmët e tua do t'i pështysh... (ka rënie të diagramës poetike dhe duhet të kishte gjetje figurative), pastaj poezia përsëri uniformohet dhe del në udhën që kërkohet, deri sa arrin te “epilogu”, i cili merr “krahë moralizues”.

Ruaju, moj se vashat më të bukura i vret bukuria e vet, ... paçka nga filozofia mbartëse, pasi poezia e modernitetit i ruhet moralitetit të hapët, pasi humb melodicitetin, e shpreh moralitetin me aftësinë e ndritshme të vargut. Kjo mund të thuhet edhe për “Katër këshilla vetes” (janë vetëm tri këshilla në fakt dhe jo katër, pasi një është e ripërsëritur dhe nuk ka vlerë të katërt), të cilat me me shenjën pikësore pikëçuditëse, janë kthyer në tone urdhërore për veten dhe krijuesit e tjerë. Konteksti përmbajtësor i kësaj poezie është kontradiktor...

Këshillën e parë të Shkrelit, që ia ka vënë vetes e mbartin poetët e rinj si lajtmotiv! Një bukurim poetik është poezia “Nënat”, e cila ka një rrjedhë gjallësore, të ndritshme, të figurshme, të buruar nga një shpirt poetik analitik dhe tepër i aftë për të diktuar bukuritë e nënës. Bruqi ka evidentuar në përfaqësuesit më me zë të letërsisë shqipe, poezinë shqipe, poetin

dhe studiuesin Agim Vinca. Kam mendimin se Vinca ka kontribute dhe shërbesa të mëdha në letërisë shqipe, sidomos në studimet e saj, dhe drejt thuhet në librin “Olimpi Shqiptar” se është një studiues i dalluar dhe ka meritë edhe në guximin e tij intelektual.

Një vlerë e tij është: i përkthyer në disa gjuhë si hebraike, vietnameze, maqedonase, kroate, sllovene, polake, ruse, frënge, italiane, gjermane, angleze, turke, arabe e tjerë. Në këtë kontekst është ndër të parët dhe vlen të përmendet për kontribut. Vetëm një studim analitik i poezive të paraqitura në librin e Flori Bruqit dhe me një krahasim logjik me krijimtarinë shkreliane, Vinca paraqitet i zbehtë në poezinë e tij.

Dua të veçoj poezinë “Paradoks”, e cila është në pëlqesën time, por me një heqje të që -së në vargun e tretë... “Glosë për Çamërinë”, një poezi tërësisht e dobësuar, me pak vargje poetikë, paçka çfarë kërkon të thotë... Më saktike dhe më e precipituar nisma e poemës për Familjen Jashari...

Duhet theksuar se poezia e mendimit konciz kërkon “mbrujtje të madhe “. Po kështu mendoj se poezia “Mora Rrugën për në Qafë Thanë”, mendimi i poetit ka mbetur në vargje proliksë...

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për “Psalm për Shën Naumin” ai mbetet në pozicion konstatues dhe precipitimi i vargut të fundit tregon një pasthirmim i dalë jo vetëm nga shpirti i ndjerë poetik, por edhe nga shpirti i çdo njeriu... Pra nuk ka lulim poetik...

Kështu mund të flitet edhe për “Betimin” (Anno Domini 1999), i cili ndoshta ka nëpër të ca vargje imponantë. Doja të theksoja se studiuesi duhet të jetë dhe poet i nivelit,

edhe i shkolluar, për të realizuar një zbërthim analitik të krijimit.

I nderuar Bruqi, me këtë substrakt poetik të përsjellë për Vincën, nuk justifikohet, sa duhet dhe si duhet prezenca e tij poetike si i “spikatur “, që motivohet prej jush në këtë libër voluminoz, kur mund të përzgjidheshin nga krijimet e tij poezi të tharmit.

Vendosja e Arapit në këtë libër është e përlligjur. Arapi e meriton vendi e tij në këtë “kolanë” të letërsisë e të poezisë shqipe. Duhet theksuar se Arapi ka patur aftësinë të poetizojë me shumë patos dhe lirizëm.

Po kështu duhet evidentuar se, “rrudhimi kohor” nuk ka vepruar vetëm në Shqipëri dhe s'ka ndikuar vetëm këtu në krijimtarinë letrare të krijuesve shqiptarë, por shumë edhe në Kosovë, ku, përveç të tjerash ka pasur edhe “flirtime” poetike të detyruara, ashtu sikundër ka pasur edhe represione, reprezalje ndaj krijuesve...

Për poetin Fatos Arapi është folur shpesh dhe zoti Bruqi bën një analitikë të kujdeshme për diagramën poetike të këtij poeti. E magjishme poezia e tij për Atdheun...

Atdheu yt i vogli, i vogli./ Ai hyjnor i pavdekshi - loti, duke mos mohuar kreaturën e Fatos Arapit, doja të theksoja se dhe poezia e tij nuk i ka shpëtuar rrëfimit, aftësisë rrëfyese dhe, hera – herës, në disa krijime të tij ka rënie, s'ka figurim, paçka se do të shprehë gjendje, ka tepëri dhe zgjatje të panevojshme, të cilat me një përqëndrim më të madh Arapi mund t'i kishte krasitur vetë, duke mos luftuar për një koincizitet poetik dhe të latuar mirë. Kjo poezi ka trajtë afër modernes, por ka dhe tonalitete deklarative.

Kjo që theksova më lart nuk e zbeh aspak kreaturën e Fatos Arapit... Nuk dua të zgjatem me këtë poet, pasi të them të drejtën nuk kam parapëlqesë për rimëzimet të formës apo trajtës të puthur, apo përdorimet e rimimeve foljore më nervozojnë së tepërmi, pasi humbasin bukurinë... Kur analizojmë kështu dhe kemi mendime kritike për Fatos Arapin ç'mund të thuhet për disa krijues të tjerë, që janë vendosur në librinn "Olimpi shqiptar", të cilët kanë dobësi të theksuara në poezi dhe që s'kam ndërmend t'i paraqes në këtë mendim kritik për këtë libër voluminoz.

Motivet nga është nisur autori unë i kam parasysh për efekte gjeopoetike, duke u nisur edhe nga mosnjohja si duhet e krijuesve të mirëfilltë shqiptarë modernë, të cilët sot japin kontribut dhe konkurrojnë në poezinë botërore moderne. Me vend e shoh dhe me të drejtë pjesëmarrjen në këtë libër të figurave poetike të tilla kosovare si Esad Mekuli, Din Mehmeti, Naim Kelmendi, Sabri Hamiti, Fahredin Shehu e tjerë. Më gëzon fakti që tre poetët e fundit janë konkurrues, duke përfshirë dhe Avdullah Konushevcin e Besnik Mustafaj (por me një selektim me të mirë të krijimeve të tyre) i mëshojnë fort një poezie moderne dhe kanë mundësi shumë të mëdha për të pasqyruar kreaturën e tyre në rang ndërkom-bëtar.

Që të jem i saktë mund të kem të njëjtin mendim edhe për ndonjë recensë, apo mendim të fryrë për ndonjë krijues, i cili nuk është i atij stadi që është personifikuar. E shoh të arsyeshme të them se, disa e heqin veten, sikur janë në majë të Olimpikut, kur nuk janë tillë dhe një qëndrim i tillë, natyrisht, e dëmton vetë "Olimpin". Poezia nuk kërkon lavdërime, por të

thënur troç dhe troçësia është e bukur dhe jo përkëdhelëse.

Heshtje përkufizohet: “HIÇ...”

Heshtje do të thotë: “MOSJETIM...”

Heshtje do të thotë: “PIKË”...

### ***“Pulsi i Dhimbjes”***

*Elegancë përzgjedhjeje e Bruqit në korifenjtë e letërsisë botërore*

Një përzgjedhje elegante është bërë në kapitullin e dytë të librit. Bruqi ka përzgjedhur korifenj të letërsisë botërore, që kanë dafinizuar dhe kanë arritur maja olimpiane në letërsi, pasi vepra e tyre e spikatur edhe sot lulon dhe “jep” mend, pra përzgjedhje të letërsisë që s'vdes...

Në pararojë të hyrësisë së këtij kapitulli është Albert Kamy, ky klasik modern, Borges, ky fenomen letrar, siç e motivon Bruqi, Heinrich Heines, poeti i madh gjerman, Gabriel G. Markuez, Hemingueji, shkrimtari brilant, i cili të befason ende me librin e tij të pavdekur kurrë “Plaku dhe Deti”, një mistikë fenomenale letrare, Anton Çehovin, shkrimtar - majë i letërsisë ruse, Fjodor Dostojevski, shkrimtar i trurit intelektual dhe i përsiatjeve të mendimit letrar të përkorë; Vladimir Majakovski, i veçantë në krijimin dhe stilin e tij të motivuar, Viktor Hugo, shkrimtari madhor francez epokal, Jean Paul Sarte (të çuditshmin mendimor dhe rrëfyes ”ndryshe”), Orhan Pambuk, nobelistin turk dhe në epilogim të këtij kapitulli vendos Robert Shvarc, albanologun, shkrimtarin dhe përkthyesin e talentuar të gjermanishtes të Erih Maria Remarkut, Lion Fojtvanger, Leon Uris, Bertold Breht, Hajnrih Hajne, Gëte e Shiler...



Kapitulli i tretë duhet motivuar kapitulli i recensioneve për vepra të Ali Asllanit, homazhim për veprën e Fan Nolit, për Anton Pashkun, për Martin Camaj, Vedat Kokona, Azem Shkrelit e për Fatos Kongolin, Ben Blushin, Flutura Açka, Sadik Përvetica, Zymer Elshanin, Myrvete Dreshaj – Baliu, Ibrahim Skënderi e tjerë...

Ndërsa, kapitulli i katërt motivohet si kapitulli i temës psikologjike.

Në këtë kapitull autori ka hedhur dritë, që duhen mbajtur mend dhe të mos pësojnë ndryshime rrjedhat historike, si një nga temat kryesore: dhunimet gjatë luftës së Kosovës, ku predominon eliminimi fizik dhe mendor, del në pah lufta e moderuar e Vesli Klark për të mposhtur arkitektin mizor, diktatorin serb Milosheviç, jepet një panorama analitike e Masakrës së Çyshkut si dhe një panoramë tjetër e tej thelluar e spastrimit etnik; po kështu bëhet një analitikë e shkaqeve të vetëvrasjes dhe jepen rekomadime për të eliminuar këtë akt antinjerëzor nëpërmjet parandalimeve dhe kujdesit, që duhet treguar për uljen në minimum të tyre...

Evidentimi i faktorëve të rrezikshmërisë që të shpien në suicid është një zbuluesë kontributi i Flori Bruqit për parandalesë..

I mëshohet në këtë kapitull edhe psikologjisë andragogjike dhe zbatimi të saj në ushtrinë shqiptare dhe në TMK/FSK.

Konceptet dhe përvojat e të mësuarit, proceset volitive, orientimi për të mësuar, motivimi i të mësuarit.

Ky konceptim ka objekt dhe zhvillimin e mëtejshme të përgatitjes ushtarake, duke u nisur dhe nga klimat: klima e hapët, klima e kënaqësisë, klima humaniste...

Trajtesa më kapitullin e pestë është trajtesa historike dhe rrok disa tema të rëndësishme si Kosova, të pathënat pas luftës, nacionalizmi dhe ndikimet e huaja, Milan Von Sufflay dhe shqiptarët, preket Jeta e Ali Pashë Tepelenës, Ahmet Zogut dhe ky kapitull mbyllet me Adem Jashari, simbol i rezistencës shqiptare.

Zbërthim analitik historic në këtë kapitullizim bëhet për Kosovën, shtypjen etnike, arkitektët e kësaj shtypjeje, misonet si dhe ndihmesa e organizuar dhe e detajuar e ndërkombëtarëve me rol parësor SHBA.

Jepet dhe një panoramë e pushtimeve të Romës, Bizantit, Turqisë e tjerë, duke nxjerrë në pah dhe fetë e tyre sjellëse në këto troje shqiptare (katolicizmin, ortodoksizmin dhe islamizmin)...

Tërheq vëmendjen studimi apo paraqitja që bëhet në vepër të studiuesit, albanologur kroat Milan Shufflai, ku jepen të dhëna historike të panjohura si dhe po kështu paraqiten me koincizitet rrethanat e vrasjes së këtij gjeniu të letrave, (objekti i vrasjes i lidhur drejtpërdrejt me çështjen shqiptare, angazhimin e tij në zbulimin e historisë shqiptare, nëpërmejt një punimi disavolumësh), që iu përkushtua dhe studimit të historisë shqiptare, anëve esenciale të pazbuluara të saj, i shkolluar në shkollën austro-gjermane.

E rëndësishme dhe shumë dukurore dhe dritësore është se për albanologun jepen të dhëna, veprimtaria e tij si dhe letërkëmbimet me personalitete, po kështu dhe fjalënderuese për veprimtarinë e tij të shumanshme shkencore e historike. Në pjesën tjetër të përshkrimit të Ali Pashë Tepelenës në librin “Olimpi Shqiptar” jepet dhe korelacioni në trajtesë të figurës

si dhe përshkrimi në veprën e Dumasit dhe të Zavalanit për Ali Pashë Tepelenën. Bruqi hedh dritë në figurën e Aliut në lidhje me krijimin e shërbimit sekret të Pashallëkut të Janinës, një trajtesë interesante si pashai pati aftësi të organizonte një shërbim sekret të aftë, përballues dhe justifikues për objeksionet e tij me largpamje.

Pa dyshim i rëndësishëm është dhe një pasqyrim i jetës së Ahmet Zogut, po kështu dhe e figurës kalendarike, burrërore dhe heroike të Adem Jasharit, duke e trajtuar si simbol të rezistenës kombëtare.

I nevojshëm, ky kapitull, tërheqës vëmendjeje... Kapitulli i parafundit i “Olimpi Shqiptar” rrok dhe trajton personalitete të mëdha me kontribut nga Bota e Dijes shqiptare si: Gonxhe Bojaxhiu në letërsinë shqipe, (konfigurimi i kësaj figure në shkrimet e autorëve dhe krijuesve shqiptarë), poetin, prozatorin dhe dramaturgun Jusuf Gërvalla (dalin në pah dhe evidentohen panjohësitë për veprën e tij dhe publikimi i veprave të tij, të kësaj figure poliedrike të këtij shkrimtari martir, cilësuar prej autorit), dr. Mirela Bogdani “Dritësim i botës shqiptare” (shqiptarja e Oxfordit, nën lajtmotivin “Elita e dijes duhet riangazhuar); evidentohet Akademik Idriz Ajeti (pesë veprat e tij, kontribut madhor në fushën e dijes shqiptare), Ledri Kurti – Kraja, eseiste dhe poete shkodrane (tërheq vëmendjen “Skicë e mendimit estetik shqiptar në fillim të shekullit të XX) (Konica, Prozë dhe kritikë); trajtohet Ismail Kadare pak më ndryshe, pas dhënies së një fragmentimi jetësor nga jetëshkrimi kadarean, bëhet një zbrëthim i poezisë së Kadaresë, duke e cilësuar poezinë e tij si një prej zhvillimeve më novatore në vjershërimin shqip, gjatë

një gjysmë shekulli) si dhe jepet një pasqyrim i qartë i produktit letrar të Ismail Kadaresë, gjatë gjithë jetës së tij shkrimore.

Bëhen zbërthime analitike të romaneve dhe veprave të Kadaresë si dhe jepen fragmente nga veprat e tij si “Kronikë në gur, “Përbindëshi”, “Kështjella” ,”Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur”, “Qyteti pa reklama”; Jup Kastrati (Jeta dhe vepra e tij), Ibrahim Rugova (bëhet zbërthim njohës për veprat e tij, jepen çmimet dhe titujt Ndërkombëtarë të Ibrahim Rugovës, trajtohet si kultivues i modernitetit në letërsi, si studiues; Rexhep Qosja (jepet një panoramë për jetën dhe veprat e Qoses) si dhe kontributi i tij akademik në ngritjen e kuadrove shkencore në fushën e folkloristikës, fushat studimore në folkloristikë, studimet e tij teorike për figuracionin dhe stilin, studimet krahasimtare.

Pastaj kapitulli vijon me: Ukshin Hotin (është një përkujtim memorial i veprës së tij si dhe mendimet e dhëna për Ukshin Hotin nga personalitete të kulturës dhe të letërsisë si Kadare dhe Rexhep Qosja.

Një vend të veçantë në “Olimpi Shqipar” zë dhe vepra e jeta e poetit, fabulistit Izet Çulli, që është dhe në kryesinë e LNPSHA “Pegasi” Albania, ku pasqyrohet vepra e tij dhe tre shkrime të tij për Kosovën; Adem Demaçi, një plotësi për të njohur këtë shkrimtar me veprat e tij), Zymer Neziri, studiues i mirëfilltë dhe kontribues në Institutin Albanologjik të Prishtinës, Adnan Abrashi, Nimon Muçaj, intelektuali Namik Shehu, Begzad Baliu dhe në fund në këtë kapitull i lihet vend pjesës opinionare.

*Pjesa e fundit e “Olimpi shqiptar”*

Ky kapitull sjell opinione për librin “Guxim Shqiptar” Shkrime nga Fatmir Terziu, Rustem Geci, Naim Kelmendi, Nehas S. Hoxha, Avdullah Konushevski, Izet Çulli dhe përfundon me poezi të vetë autorit Flori Bruqi dhe mbyllet me biografinë (jetëshkrimin) e autorit të “Olimpi Shqiptar”.

*Si përfundesë:*

Këshillim i LNPSHA “Pegasi” Albania për librin “Olimp shqiptar”, të Flori Bruqit, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Arsimit e Shkencës të Kosovës

Me një arkitekturë të tillë ky libër duhet të jetë një ogur i mirë për pedagogët, studentët, shqiptarë, mësuesit dhe nxënësit e të gjitha kategorive për të mundësuar zgjerimin e tyre të njohurive në disa fusha si: atë letrare, psikologjike, fushën e madhe të dijes, njohjen e personaliteteve të letërsisë botërore si dhe disa prej përfaqësuesve tipikë të letërsisë së Kombit shqiptar.

Komisioni i specializuar për hyrjen e teksteve dhe librave të autorëve të ndryshëm si libra të kontributit në fushën e dijes elitare duhet të evidentojë edhe këtë libër dhe jo të vendosë në programet shkollore libra, që s'meritojnë e s'thonë gjë për letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Studentët, tashmë, janë të prirur që t'i marrin tekstet, apo të kryejnë detyrat e kursit, duke kopjuar nga materialet në internet, duke ndryshuar paksa përmbajtjen dhe pedagogët e tyre paqetohen me këtë “vjedhje” dijesh dhe errësim dijesh..., ku nuk duket inteligjenca e studentit, por krijohet premise e shabllonizimit dhe kopjimit narrativ...

Kjo tashmë është bërë modë dhe sfiluese edhe me nxënësit e shkollave 9 vjeçare e të mesme. Kjo bën që të hiqet dorë nga leximi i librit...

Ky mendim i LNPSHA “Pegasi” Albania të vlejë edhe për përzgjedhje të librave të ndryshëm letrarë, që kanë vlerë të padiskutueshme në fushën letrare e gjuhësore dhe që mund të futen në programet shkollore e të mos vijohet vetëm me letërsitë e dikurshme, por me me letërsitë ndryshe të mirëfilltë, që i nevojitet aktualitetit dhe zhvillimit të mendimit progresiv të shoqërisë.

Po kështu Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë duhet të ngrejë një komision të veçantë për të qëmtuar, hulumtuar veprat e krijuesve shqiptarë, që sjellin pasurimin e gjuhës shqipe me neologjizma letrare, të cilat të studiohen nga studiues niveli, jot ë mefshtë si deri më tani hezitues, dhe të pasurohet fjalori i gjuhës shqipe në një kongres të veçantë për këtë akt madhor gjuhësor.

## NJË SYTH SHPIRTI NË AKUARELIN E NJË KOSOVARI

Nga Akademik Prof.dr. Zef Pergega

Nanat janë krijesa e krijesave njerëzore. Asnjë hije muzgu me fluturim korbash nuk zë vend në shpirtin e tyre. Stoicizmi human dhe krenar është sfida e natës. Ata linden prej dhimbjës dhe dhimbjës së rritjës i kënduan gjithë jetën. Me këngë e thurin djepin e dashurisë dhe me shallin e ylberit i shërojnë ethet e forta. Asnjë art nuk mund ta shëmbë tempullin e shënjtë të tyre. Nanat janë bota e qiellit dhe e tokës dhe krah u japin foshnjave të bëhen ëngjëjt e jetës. Sa herë ngjitësja shkallëve të drunjta të kullës së vjetër, nana ime që thurte bukur çorape me luledele apo me degë ulliri, pa më parë me therriste me emër. Me njihte nga hapat e ngjitjës...Ndërkohë që arti i sotëm e ka shpërfillur fytyrën dhe visarët e shpirtit të nanës dhe është mbërthyer si rriqën në kërthizën e vibrimeve nudo, ngrihet një bir kosovari i lindur në vatren e lisit të tamlit dhe lisit të zjarrit, një flori-florë poetike mbi kurorë të gurrës së parë me emrin njerëzor Flori që me pathosin e tij të vllgut e ngre simbolikën e nanës mbi rrezët e dritës asaj drite që ajo i përket.

Rastësisht e me saktë në mënyrë periodike e lëxoi krijimtarinë e këtij poeti dhe si anija që e hedh spirancën në molon e ankorimit ma mbajti vështtrimin një cikël poetik e këtij fisniku të fjalës së lirë. Duke lëxuar poezinë “Rreze drite” njeriu dhe në mënyrë të veçantë emigranti s'ka sesi të mos ngrohet nga këto rreze dhe të na kujtojë që sado që jemi larg shpinë kthyer, nana kurrë s'e harron birin apo bijen e saj.

Që ajo të mos rrijë duke pritur mbas dere nga këto mbrapështi, Flori Bruqi si një thurës vargjesh me mbjellje zambaku e tredofilesh në ballkonin dhe kopështit të mevehtësisë së Kosovës, shkëput nga trangu i shpirtit një petale meraku prej vazos së kujdesit të nanës drejt adresës tonë, si pëllumbi që këkon bregun...

*“...Natën e mirë bir  
Çelësin mos ia vë derës  
Se do të vijë nana  
Gjumin e paprishur  
Me hapat e pranverës  
Mos je shpluar  
Kur ike...!”*

Poeti Flori Bruqi e ka thënë me një ndjenjë të thellë atë që shumëkush e ka harruar madje e ka mbraktisur nga shpirti këtë kumt njerëzor. Këtë thesar që rrjedh në lumin e turbulluar të jetës, Flori e nxjerr nga fundi si varken e mbytur. Shumë i kanë kënduar nanës që ngjajnë me tinguj nostalgjie, por motivi i autorit në fjalë ka atë rreze drite që nuk shterr në shpirtin e nanës pavarësisht se koha po i josh brezat me harresën dhe përzierjen e gjakut. Bash kur hollohet e ndryshohet gjaku aty nana loton me sytë nga qielli për pak shpresë dhe respekt për prinderit.

Lajmotivi i poetit Flori Bruqi ka eren e theut të parmëndës dhe e lëron vargun në ngohtësinë e qiellit pa patur nevojë të marrë miell hua, por gruri i arës së tij piqet me afsh trualli. Shpirti poetik me të cilin ka rrethuar tokën e mushtit të vargjeve bashkë me fantazinë dhe dhuntinë rri në dritaret e një kalaje, si zogu që sjell lajmin e begatisë, lidhur guret me



metafora dhe ushqyer me qumështin e zanave të kthyerë përseri pas shumë motësh ikjesh ndër valë. Poeti kosovar u këndon atyre që nënçmohet, atyre që shkelen me të padrejtë, atyre që u flet puna dhe dikush ua mohon me guna, i këndon urtisë, mençurisë së popullit të tij, bekimit të ballit dhe nderit të nëpërkëmbur. Ai i thërret nanat, vashat të vijnë në këngë se me këngë janë rritur djepat e trimërisë se pa ata djepa Kosova do të ishte përseri e shtypur ndaj dhe poezia e tij “Lajtmotiv e sinqerte” është një zgjim dhe një kurajo, një hov dhe një tingull i ri në piskamë se prej tyre ne morëm këmbë...

*“...Ejani në këngë  
Nana dhe motra  
Ne lindëm nga këngët tuaja  
Nga zëri juaj  
Morëm këmbë...!”*

Para vargut të Flori Bruqit të ndizet një qerpik ngadhënjimi. Ai të fton qetësiht pa tamburante në vargun e rrëzeve të perëndimit për ta përjetuar poezinë nga vitrina e pastër e dritës që ndizet në pishtar. Edhe pse politikisht ka ardhur liria ne Kosovë, shpirti i vashës e përjeton atë me trishtim. Të lehurat e natës nëpër zgavrra përgojimesh të paragjykuara me kurtha e gracka dashurie dhe poeti i vemëndshëm e shkoqit këtë ndjesi, mbasi ai nuk i duron njollat e zeza në bluzën e bardhë të transparences së virtytit njerëzor dhe pyet në poezinë “Liri fjale”

*“...Mos vallë  
në qytetin tënd ilirik  
të ndjekin qentë e tërbuar  
Ndonjë hije nate...?!”*

Flori Bruqi, si në jetë dhe në krijimtari nuk thyhet nga pushteti i prangave të pritjës dhe as nuk e kapin ethet e padurimit edhe kur e ndjen vetvlimin në damarë. Me krah dallendyshe ngjit muret e heshtura, ku jeta merr serume të hidhura e ai ulet në karriken e sallonit të pallatit të ëndërrave rinore pasi shiu e ka bërë qull fletoren e vargjeve pa e ndërjerë shterren kur shkruan poezinë “Qyteti ku tëprita”

*“...Unë jam aty ku me ke lënë*

*Vallëzoi me hijet*

*E nuk di cilën të përkedhel*

*Pres dashurinë tënde*

*Mbi buzët e tua të zë një ëndërr...!”*

Një poezi e veçantë me një gurrë me metafora dhe me një kopësht me krahasime është ajo me titullin “Akuareli i diellit”

Ajo iku në moshë të njomë, pa pasaportë e pa adresë. Ndoshta pa mësuar mirë emrat e malit, lendinës, lumit e bregorës që jetës i japin blegërime. Nxori në rrugë në atë shteg të ngushtë nga gjoksi i paprekur fletoren me vjersha dhe shkroi për mëngjesin e Prishtinës, të vetmin kujtim mori më vete nga majat e ikjës dhe ai ngushtim shpirti e tokë i kujtoi nanen. Në xhamat e retinës vizatoi portretin e baces plak dhe pastaj e fshiu me dorë dhe dorën e puthi me bekimin e vetvetës. Është gjaku që ndjen gjakun, e kush me bukur se Flori Bruqi e përcjellë këtë penelatë, si visari me i çmuar i shqiptarit e i kosovarit. Dikur ajo vashë u kthye ne vendlindje. Autori nuk u bën thirrje dallendysheve të kthehen, por ai nga një kënd i syrit të tij vëzhgon fluturimin e tyre nga qielli që u laguan dhe e stolis tablonë kur vasha e ngjeu penelin në

akuarelin e hënës në mbrëmjen e majit dhe pikturoi rrugen. Kishte çelur pranvera e kthimit. Ky motiv është thënë nga Flori Bruçi në mënyren me mjeshtrorë. Në fshat vasha që kishte ikur, por atdheu i ishte mbledhur galuc si një gur në zemër e në shpirt, me të cilin ajo kuvendoi gjithë kohën e largimit duke gjetur në ato themele hijet e vetmisë dhe të heshtjës dhe me tej melodinë e draperit në duat e fahtarëve të tokës së saj. Flori është i dashuruar pas së bukurës, ai e ushqen atë që të mos vyshkët dhe të mos shkilet. Madje ai është një triumf rrënjësh që larton trungun e inditetit njerëzor. S'ka gjë më të bukur kur femra e ruan feminitetin e saj sa edhe pemet kërkojnë ti ngjajnë.

*“...Shpirti i saj  
Një lëndinë qërshori  
Selvitë ndanë rrugës  
Trupin e saj imitojnë...!”*

Ndesha një krahasim që e vallon se tepërmi stofen e vargun dhe e llamburit mesazhin tek poesia “Mendim e kredhur” Nuk e di nëse ky poet me një fizionomi të konturuar në brumin e farës kombëtare ta këtë provuar mërgimin. Ai me nota trishtimi e vizaton portretin e shekullit që ndau familjen duke u çirur nëpër tribuna e konferenca për liri e lëvizje të lirë. Sa nana e motra mbetën pa burra, pa fëmijë e autori thotë se nuk paten një gur ku të qajnë!

Vejusha pa fat me prehera të thatë. Djepa që nuk lidhën dhe as nuk zgjidhen. Kënga Nina-nana e ngrirë në mure të akullta dhe siç thotë Flori, në shpresat e djegura vret e qan trishtimi. Tonelata vujtjesh që mbytën mbi dallgët e mërgimt mekatar dhe poeti i dhimbshur thotë:

*“...Shikimi i nënëmadhës si shqiponjë*

*Pas e ndjek*

*Klithma djemsh*

*Mbetur ikona nëpër pragje...!”*

Në akuarelin e dritës së shpirtit të tij që rri në pëllëmbë të vargjeve, një ditë në Amerikë dallova ylberizimin e figurave letrare dhe artistike të këtij poeti që e shikoj si kurorë magjike mbi ballë të tokës kosovare për t'ia zbukuruar fytyren lirisë dhe gjithçka që është shqiptare.

## NJË MOZAIK NË LETËRSI

**Nga Prof.Dr. Rasim Bebo**

Flori Bruqi, mori rrugën dhe ndaloi te zalli i lumit gurgullues të letërsisë shqipe. Këtu ulur, filloi të zgjedh një e nga një gurë: të vegjël, të bukur, të shndritshëm, nga ata që ta reflektojnë spektrin e diellit në fytyrë dhe të verbojnë aty për aty. I radhiti një nga një në një mozaik, të ngjashëm me atë të stërgjyshit tonë pellazg, që ndërtoi të parin mozaik në botë, këtu e mbi 4000 vjet më parë në Nekropolin e Athinës, të zbukuruar më gurë të vegjël të lumit në dyshemetë dhe muret. Prej këndeje në të gjithë perandorin pellazge, që shtrihet në tre kontinente: nga Azia e vogël te Priami i madh, në Afrikën e Veriut, duke dalë në Europë te Baskët, dhe deri në veri për gjatë rrjedhjes së lumit Danub me kufi. E gjejmë kudo këtë mozaik dhe sidomos te Tempulli i famshëm i Dodonës, në Butrint, në Durrës, në Apolloni, në Trojë, në Gjenevë të Zvicrës, (si na vë në dijeni Prof. Dr. Agim shehu) dhe në shumë vende të tjera. Kur i shikojmë këta mozaikë të bukurisë së përkryer, që pasqyrojnë artin e mrekullueshëm të stërgjyshërve dhe gjyshërve tonë, ne mahnitemi që toka nënë - Demetra - i ruan për mijëra vjet. Syri ynë i përmbledh me një të parë.

Mirëpo mozaiku i të nderuarit Bruqi, është bërë në Kosove dhe në vend të gurëve të zgjedhur të lumit, ai radhit shkronjat e trashëguar të gjuhës shqipe, të konfirmuara nga Pema e 63 gjuhëve dhe nga pema, që pasqyron prof. Mr. Flori e 47 gjuhëve, që për vjetërsi i kalon të gjitha gjuhët e botës mbi 9.000 vjet përpara. Kështu kemi të bëjmë me këtë mozaik

libër, “Diadema Letrare”, që përmbledh: kritikë, gjuhësi, pikëpamje, poezi. Mozaikun libër, të Prof. Dr. Florit, nuk mund ta përmbledhim me një të parë, qoftë edhe me dy, sepse duhet kohë për ta lexuar dhe studiuar me vëmendje të përqendruar. Ky grumbullim material, i përgatitur nga autori, zëvendëson atë të Akademisë së Shkencave Shqiptare në Prishtinë, Shkup dhe Tiranë. Sot ato institucione janë në shërbim të kursit sllavo-rus-greke. Ndërsa Shqipëria është nën drejtimin e Këshilltarit, Kolonelit, Akademikut, të asfalisë (sigurimit) grek, Janullatos. Elitat e kulturës së këtyre vendeve, janë të heshtur, të korruptuar, të politizuar, të frikësuar dhe bëjnë: “Gjumin më të rëndë dhe më të gjatë, si murgjit e pergamenave, që janë mësuar me dhomat e errëta”.

Duke shfletuar “Diademn letrare” në faqen e parë lexohen rreshtat, që Flori i dedikon babës së tij: “Babajt tim Maxhun Bruqi, mësimdhënës, që tërë jetën e vet intelektuale e atdhetare ia kushtoi gjeografisë kombëtare”. Ai e gjeti shkabën dykrenëshe në themelin e shtëpisë të bërë blözë.

Bregu i detit dhe Mesapliku i këndojnë Shqiponjës. Shkab e madhe kasaba, / me dy krahë të mëdha, / nuk u dhe dhe nuk u fale. Flori Bruqi aty të zgjon historin e Dodonës. Ndër 1800 objektet e zhgroposura në Dodonë më 1875-1877, gjithçka (ndërtesa, monumente, dhurata si (ex-voto) etj. drejtpërdrejt, lidhen me mbretin e perëndive pellazge Zeusin. Këtu u gjetën shumë shkaba dykrenëshe, që janë përhapur në Perandorin Pellazge. Një ndër ato mund të jetë dhe ajo që gjeti Prof. Maxhun Bruqi. Dodona ndodhet 16 km. në J. P. të Janinës në Çamëri. Të gjithë autorët e lashtë si Homeri, Hesiodi, Hekateu, Akusilao, Hellaniko, Herodoti, Tukididi etj, siç na i

përmend eruditi Flori, na bëjnë të ditur se, para mbërritjes së grekëve në shek e VII p.e.s. vendi banohej nga Pellazgët Hyjnor. Dodona ishte vendi i kultit, apo vendi i Shenjtë parahelen, më i lashti dhe i vetmi vend i njohur. Zeusin e trajtonin jo vetëm si pellazg por e cilësonin më tepër si Dodonas. Dodona është bërë disa herë blözë. Dodona u rrafshua në vitin 219 p.e.s. nga gjenerali etolas, Dorimahu. U rindërtua nga pasardhësit e Burrit të Ledhezës Pirro. Qëndroi e tillë deri në vitin 167 p.e.s. kur vërshuan lukunitë e Paul Emilit. Dodona Pellazge pësoi edhe një rrënim tjetër vdekjeprurës në motin 88-87 p.e.s. prej trakasve aleatë të Mitridatit... Më 435 e.j. perandori i lindjes, Teodori urdhëroi “shuarjen e përhershme të Dodonës Pellazge si zjarrishte pagane dhe shndërrimin e saj në një nyje të krishtere më 475 e.j. fillimisht nga vandalët dhe më pas (551), Totila me barbarët ostrogotë, të pasuar nga saraqenët e bullgarët etj., e fshinë përjetë të jetës nga faqia e dheut Dodonën, kryeqendrën europiane të pellazgëve, - populli më i lashtë në kontinent. (Dhimiter Pilika “Pellazgët”, f. 161). Flori Bruqi të jep drejtimin dhe te hap rrugë, për t’u thelluar në “Kujtimet” e Ismail Qemali, që thotë: se, “Në vitin 1866, kur isha këshilltar politik i valiut të Janinës, gjatë një vizite tek pronat e një miku tim në fshatin Melingus, kisha dalluar disa rrënoja, që i lidha me tempullin antik të Dodonës. Dhjetë vjet më vonë ia tregova mikut tim në Vlorë Karapanos”. Ky filloi menjëherë gërmimet në Dodonë pas 1460 vjetësh, duke nxjerrë në dritë një sasi thesaresh arkeologjike me vlerë të jashtëzakonshme. (P. Xh. “Ilirira”, 6-2-2006, f. 24). Karapano, vllaho-grek, i shkathët, shumë nga këto thesare të Dodonës ua fali si dhuratë delegatëve të Anglisë dhe

të Francës, që ishin anëtarë të Kongresit Berlinit. Me qëllim, për të përkrahur kërkesat e qeveris greke në këtë Kongres. Prof. Dr. Flori Bruqi, hynë në plejadën e njerëzve më të shquar të kombit shqiptar. Ai është trim, i papolitizuar, nacionalist i pastër, me pak fjalë, të hap horizont për t'u futur thellë në ngjarjet historike. E gjeti shkabën dykrerëshe në themelin e shtëpisë të bërë blozë. Ashtu si Dodona u bë disa herë blozë, por prapë u ngjall, se, “fara shqiptare nuk është delikate dhe që të goditet lehtë, e të rrezikojë të zhduket. Është e fuqishme, e ashpër, luftarake, që nuk mund t'i nënshtrohet të tjerëve. Ajo i jep rëndësi kombit, ekzistenca e saj e mposht edhe kohën. Ajo mbizotëron aty, ku popujt e tjerë dështojnë. (A. Kola “Arvanitasit” f. 166). Një ndër plagët e mëdha, është Shqipëria Londineze, që eruditi Flori e përmend dhe analizon shpesh në librat e tij të shumta. Prof. Dr. Eshref Ymeri thotë: se Shqipëria nuk ka qenë 116.000 km<sup>2</sup> por 134.000 km<sup>2</sup>, shifër kjo e marrë nga enciklopedia Ruse.

Lexuesin e shtinë Flori për t'u thelluar në problemet kardinale të popullit tonë, i cili ka kaluar në luftra me pellgje gjaku. Pikërisht Kryengritja e madhe e vitit 1913, që kishte përfshire gjithë trojet shqiptare e ktheu vendin në shkatërrim dhe mjerim me pellgje gjaku? A. Baleta shkruan: “Kryengritjet shqiptare që u bënë në Kosovë më 1908-1910-1912, praktikisht ia shtrinë rrugën Serbisë, sepse u harxhuan, u grinë forcat me Turqinë. Sot nuk kemi të drejtë të mos i vlerësojmë ngjarjet si duhet, që të mos i bëjmë të njëjtat gabime, Është fakt i njohur tashmë, se përplasja shqiptaro-osmane e viteve 1911-1912 dobësoi ndjeshëm potencialet dypalëshe. Pikërisht, pak jave pas mbarimit të kësaj lufte, Më 18 gusht po



të vitit 1912, filloi sulmi ndaj territoreve shqiptare, nga Mali i Zi, Sërbia dhe Greqia. Nëse lufta e shqiptarëve do të përqendrohej kundër këtyre agresorëve, padyshim që dhe harta e sotme e Shqipërisë do të ishte ndryshe. Në faqen e parë të këtij “Mozaiku Letrar”, Kur Maxhuni gjeti shkabën dykrenore në themelin e shtëpisë bërë blozë të padëmtuar, e pastruan nga bloza dhe e vendosën te këndi si më parë. Shfletojmë librin më tej dhe shikojmë një fotografi familjare me tre breza dhe me 14 veta të grumbulluar si një tufë trëndafilash, që pasqyron një familje shtet brenda shtetit. Sa bukur, kur sheh gjyshërit, fëmijët e tyre dhe nipër e mbesa, të ulur dhe në këmbë me çiltërsi. Kjo është familja, Kosova sot e gjallë, dinamike, e lulëzuar, që e përshkruan biri i saj Flori Bruqi. Jo më larg se 14 vjet, Flori përshkruan: Populli i Kosovës - UÇK-ja dhe NATO = Liria e Kosovës. Të ngjethet mishtë kur dëgjon dhe shikon kasaphanën serbe. Gazeta “Iliria” shkruante në atë kohë: Kur shkova në zyrë, thotë, Magdalena Ollbrajt dhe pashe mbi tavolinë gazetën, me fotot e masakrave serbe në Kosovë, u trondita dhe mora Klintonin në telefon, NATO duhet të filloi sulmin për të ndalur këtë gjakderdhje të këtij populli trim, të përmendur në histori.

Presidenti amerikan Bill Klinton shprehej në qershor të vitit 2002 se: “Nënë Tereza ishte e para që më bëri të dua kombin shqiptar dhe tani ndihem shumë krenar që plotësova një detyre morele të saj ndaj vlerave të lirisë”. Fjala është për shpalljen e Kosovës të pavarur. (Prof. Dr. Saimir Lojla ”Bota sot” 19.10.2004)

Tani vijmë te fundi i shekullit që shkoi, te përshkrimi i luftës së Kosovës nga Prof. Dr. Flori Bruqi: Lufta filloi më 12

shkurt 1998 deri në 23 mars 1999. Më 12 qershor 1999 hyri NATO në Kosovë. Në këtë luftë u dëbuan 800.000 shqiptarë, u vranë 15.000 persona, nga këta, 2400 luftëtarë të UÇK, janë zhdukur rreth 5000 njerëz, janë përdhunuar afër 20.000 femra, janë rrëmbyer mbi 3000 shqiptarë dhe akoma nuk u dihet fati i 2087 të tjerëve, Kanë djegur 1.100 vende banimi, kanë plaçkitur djegur e shkatërruar mbi 200.000 shtëpi, banesa, objekte kulture, shkencore, fetare. Ky përrshkrim do të mbetet si pjesë e krestomacisë historike, për ta përdorur çdo person i kulturuar dhe sidomos çdo historian për referenca. Kosova fitoi Lirinë.

Me ardhjen e Titos së vogël në Shqipëri, Miladin Popoviçi si udhëheqës suprem mbi Enver Hoxhën, po ta zije në gojë Kosovën dhe Çamërinë, të jepnin karamelen e plumbit pas kokës.

Grekët Çamërinë e vranë, e therën, e dogjën, përdhunuan dhe e dëbuan, pa pasur asnjë ndihmë nga shteti amë, po vetëm sabotim dhe diskriminim. Kosovën e tradhtuan vetë udhëheqja shqiptare. Djemtë e Shaban Polluzhës, rreth 40-50 mijë frymë dorëzoheshin te vllau shqiptar dhe ky vëlla tradhtar ja dorëzonte serbëve, që i asgjësonte në masë si në masakrat e Tivarit etj. Te gjitha këto ngjarje pikëllimi i gjen te libri “Diadema Letrare” të përrshkruara në art.

Ndërsa Çamëria u tradhtua nga qeveria shqiptare dhe Akademia e Shkencave, greku e shpalli Çamërinë, si toponim që nuk ekziston, duke njoftuar institucionet ndërkombëtare për ta ligjëruar dhe u ligjërua. Arritën deri aty, sa Ministri i Jashtëm grek, deklaroi serbes, pa u trembur fare se “Çamërinë unë nuk e njoh” dhe qeveria shqiptare hesht, se është bërë

Tirana më keq se Athina për kombin shqiptar. Pikërisht për këtë, historiani sllav në Maqedoni, arriti të nxjerrë nga goja se maqedonasit e sotshëm ishin stërnipërit e Lekës së Madh dhe më tej, “Prof. Polljanski” tha se Skënderbeu nuk ishte shqiptar. Ne e pyetëm: Profesor, për cilën Maqedoni flisni, sepse për ne historianët, ne kohën e Aleksandrit të Madh, ju bridhnit ende në stepat e Rusisë, kurse në viset e Aleksandrit të madh, keni ardhur 10 shekuj më vonë. Polljanski u përgjigj... “Ne, -tha ai, -maqedonët, me të vërtetë kemi ardhur shekuj më vonë, por përderisa u vendosëm në trojet e maqedonëve të lashtë, ne jemi pasardhësit e tyre, jo vetëm pasardhësit e tyre kulturorë por edhe gjenetik. Sot akademikët sllav të Shkupit, nuk duan të dinë fare për saktësitë historike. Për ta, sllavo-maqedonët e ditëve tona, vëllezërit e bullgareve dhe të serbëve, kur e do puna, janë sllavë, kur nuk e do puna, nuk janë sllavë, por pasardhësit e maqedonëve të Aleksandrit të Madh. Ndërsa shqiptarët i quajnë disa “ashkla”, që kanë shpëtuar pa u zhdukur. (N. Muhameti “Maedonia...”, bot. 2009, f. 415).

Te “Diadema Letrare” ne shikojmë Flori Bruqin si erudit, i prozës dhe i vargut, duke i zgjedhur gurët e mozaikut dhe duke i radhitur, si nacionalist në plejaden e njerëzve më të shquar të Kombit shqiptar.

Çabej thotë: “Nuk mundet të shkëputet kërkimi gjuhësor, pa pasur parasysht faktorët historikë. Flori, me Diademën Letrare, zë vendin e Çabejt që ka vdekur, duke kritikuar “hartën e kulturës indoeuropiane, pa e ditur tani se si do të konsiderohemi, në çfarë konteksti si gjuhë e humbur, e rrëgjuar, apo etni, a popull i zhdukur. Prof. Dr. Flori Bruqi, zuri vendin e dhjetëra Profesorëve që punojnë në Akademinë e Shkencave,

për të vënë pikën mbi “i”, duke argumentuar me duzina libra dhe tema te ndryshme të tij dhe duke grumbulluar shumë shkrime nga autorë të ngjashëm me veten e tij. Ai thotë: “Të gjitha veprat e mija kanë si lajtmotiv i çështjes Shqiptare. Nuk është e rëndësishme çfarë mendon Qosiqi?!”

Flori shkruan: “Kam lexuar, po, dhe ç'nuk kam lexuar, madje ç'të lexuar se (!), nga autorë serbë, beogradas dhe jo vetëm, opinione nga më të neveritshmet dhe më përçmueset, nga më përdhosëset dhe më poshtërueset, nga më të përdalat dhe më të përçartat dhe jo vetëm, që të mos them edhe raciste – kundër shqiptarëve. Më vjen ndot edhe t'i kujtoj, e pale më t'i shkruaj a citoj, gjithçka u fol e u shpërfol, gjithçka u shkrua e u nënshkrua, gjithçka u botua e u stërbotua, “nashke”, e jo pak edhe në gjuhë të huaja, që s'i zë në gojë asnjë i çmendur. Dhe as i ka edhe fjalori më i zi me sharje e fyerje, me poshtërime e ofendime, me mallkime e stërmallkime. S'është nevoja të përbaltesh e të pisërohesh me andriqët e çubrilloviqët, sepse balta të baltëron, e pisi të pisëron. Mjafton të ndyesh gojën vetëm me një e të vetmin emër e mbiemër, me atë më “aktua-lin” dhe më të ziun nga aq të zinj, “babanë e kombit serb” - Dobrica Qosiqin”. Akoma më shumë: Kriminelët serbë “kanë bërë llamba me kafka shqiptarësh të vdekur, u kane prerë kokën, ua kanë zier në tenxhere, u hoqën katër dhëmbë ari, dhe kafkën e kane ngjyrosur, e kane bere llambe tavoline!” ka thënë S. Stojanoviç. Ata u vranë për Kosovën e lirë... Flori shkruan: “Tridhjetë e një vjet më parë, në rrethin e Shtutgartit në Gjermani, Lëvizja politike për çlirim kombëtar, mori një goditje të rëndë në atentatin kundër Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, tri figurave të rëndësishme

politike dhe organizative të lëvizjes kombëtare në emigracion. 17 janari 1982 ishte datë që tronditi zemrat e bashkombasëve të tyre si në trojet shqiptare, ashtu edhe në shtetet perëndimore, ku jetonte dhe vepronte një komunitet i tërë politik”.

Dy vjet para të quajturës demokraci dhe 17 vjet para atentatit kundër tre djemve Kosovar, dënohet me varje në litar për t'i këputur vargun politik, Havzi Nela, nga Presidenti Ramiz Alia i komunizmit, që kaloi president i demokracisë me fjalën: “Enver Hoxha ka vetëm ditëlindje”.

*Addison Chikago, nëntor, 2013*

**LIBRI I 34-t I FLORI BRUQIT - DIADEMË LETRARE II****Nga Rexhep Shahu**

Që në krye të këtyre shënimeve për librin e fundit (i 34-ti), “Diademë Letrare II”, të gazetarit, shkrimtarit, kritikut e studiuesit shkencor Flori Bruqi, po e them se nuk do ta ndjek traditën e pahijshme të shkrimeve që bëhen për autorë apo për libra të ndryshëm, ku shkruesit e shkrimeve prezantuese, promovuese apo analizuese, në vend që të flasin rreth autorit e librit që marrin në dorë, fillojnë e rrëfejnë, keq e shumë keq, për dijet e tyre të mangëta, për bëmat e tyre të bëra keq, të pabëra apo të ëndërruara e të pamundura, që shpalosin erudicionin e tyre të mangët e shterpë, që gjejnë rast të nxijnë faqe letre, në gazeta, revista a në libra të huaj, për me folë për veten e tyre e përrallat që kanë dëgjuar kafeneve dhe rrallë, fort rrallë, flasin ndonjë fjalë që s'thotë asgjë për librin e autorin e librit që marrin në dorë apo marrin përsipër ta trajtojnë, duke shpalosë një krekosje acaruese, një padije të thellë e një servilizëm të pështirë ndaj autorit për të cilin duan të flasin, nga ndonjë qëllim jashtëletrar ose për shkak të rrethanave të caktuara, të dyshimta, që shtojnë pabesueshmërinë e artikujshkruesve dhe dëmtojnë e çënojnë autoritetin e librit e të autorit të librit për të cilin nxijnë faqe kompjuteri apo letra të bardha.

Në të shumtën e rasteve, krahas padijes e servilizmit, këto lloj shkrimesh i prodhon ndonjë interes i ngushtë çasti dhe pandershmëria e atyre që shkruajnë.

Them që në krye shënime, pasi është e vështirë t'i klasifikoj këto radhë apo fjalë në ato që njihen si rregullat e

qarta të klasifikimit për shkrimet kritike që bëhen për libra të ndryshëm që botohen.

Them është e vështirë sepse ky libër i Flori Bruqit çelet pikërisht me një shkrim të gjatë profesional mbi kritikën letrare dhe kriteret që janë caktuar për të bërë një kritikë, shkrim që e trajton kritikën letrare në thellësi që në fillimet e saj, duke krahasuar e ballafaquar përvoja të ndryshme të huaja e vendase për kritikën dhe kritikën letrare.

Unë e kam të vështirë ta bëj kritikën e kritikës. Thjeshtë po e përsëndes këtë libër të 34 të Flori Bruqit, si një kontribut me vlerë në letrat shqipe, si “një libër që i shtohet mendimit kritik për letrat shqipe” siç shkruan poeti dhe shkrimtari Izet Duraku.

Në këtë libër të Flori Bruqit shfaqet gjeografia e gjërë e tematikës që ai trajton, gjeografia e gjërë e interesave të tij letrare, e autorëve dhe veprave që analizon e merr në shqyrtim. Dhe gjithmonë po flasim për atë që ai ka shkruar, për atë që është në libër dhe jo për ato gjëra, fjalë e qëndrime që mungojnë në libër dhe autori nuk i ka marrë në trajtim në këtë vëllim të dytë të librit të tij “Diademë Letrare II”, por që i gjenden të botuara në organe të ndryshme të shtypit të shkruar a të medias elektronike.

Në Diademë Letrare II, Flori Bruqi ka guxuar të merret me tema të rënda, me autorë të përmasave të mëdha, të cilët me ndikimin e tyre në letrat shqipe e më gjërë në fushën e letrave në shkallë europiane e botërore, janë rrezatues e imponues, janë “të frikshëm” për t'u marrë me to, apo për t'u afruar pranë tyre. Pas një trajtimi të gjërë e të thellë të kritikës letrare, çfarë është e pse është ajo, si është, ku është e si duhet e mund të jetë

në letrat shqipe, kur fillon e si fillon, si është lëvruar e si ka evoluar, Flori Bruqi na paraqet Frojdin me tërësinë e tij dhe të zgjidhjes së enigmave që ky shkencëtar ka bërë për njerzimin. Flori Bruqi i krijon lehtësi e komoditet lexuesit edhe jo profesionist që ta kuptojë e të bindet për ndikimin e madh që pati në botë e në fushën e letrave Frojdi si psikologu që me tezat e tij u bë i pashmangshëm dhe imponues për t'iu referuar gjithkush që merret me letrat, kritikën letrare dhe laboratorin e krijuesit apo studiuesit shkencor.

Me durim e vullnet të spikatur studiuesi Flori Bruqi analizon tërësinë e veprave kritike të Ibrahim Rugovës dhe ndikimin që ai pati në historinë e letrave shqipe, duke qenë ndër të parët që i drejtoi kamerat dhe interesat letrare e shkencore nga shkenca letrare perëndimore për ta avancuar kështu kritikën dhe studimet letrare të autorëve shqiptarë dhe për t'u shkëputë nga shkolla lindore, term ky thjeshtë konvencional, ashtu siç ishte perëndimor edhe shkrimtari i parë modern i letrave shqipe, Pjetër Bogdani, të cilin Rugova e ka studiuar dhe analizuar në tërësi e në thellësi edhe si artist edhe si filozof paraprijës i modernitetit shqiptar.

Pasi paraqet, siç e përmendëm Ibrahim Rugovën me gjithë plotninë e tij si kritik e studiues i epërm i letërsisë që shërben si model për pasuesit me po atë fuqi e lartësi si politikan i pambërritshëm e i papërsëritshëm i kombit shqiptar, Flori Bruqi sjell vështrimin e tij për Krist Malokin - dijetarin shqiptar të Gracit të Austrisë, këtë aristokrat modern të letrave shqipe, i cili me fuqinë e argumentit e të dijës së thellë u rri si kurorë letrave shqipe dhe shërben si model i vështirë e “arrogant” për pasardhësit për shkak të dijeve, fuqisë dhe



elegancës në analiza. Pak dihet për Krist Malokin për shkak edhe të nënvleftësimit a lënies mënjane me dashje nga politika dhe shkenca letrare zyrtare e udhëhequr nga politika dhe për shkak edhe të skrupulozitetit të tij e të raportit të tij të pakompromis me të vërtetën gjatë analizimit të letërsisë apo të çfarëdo fenomeni shoqëror apo letrar.

Flori Bruqi kalon nga Dante Aligeri te Ismail Kadare i shtyrë nga mesazhet e mëdha që përcjell letërsia e madhe e autorëve që kanë fuqi rrezatuese e unifikuese për letërsinë e tyre kombëtare. Ferri ferr mbetet si dje, sot e nesër. Qëndresa si vlerë kombëtare e shqiptarëve apo si ëndërr e dëshirë e përhershme e shqiptarëve në shumë vepra të Kadaresë, dimrat si stinë e dimrat si vuajtje për shqiptarët, si metaforë në letërsinë e Kadaresë, urat e kështjellat, besa e mbajtja e fjalës së dhënë, janë qëmtime, gjetje e pohime që Flori Bruqi i lehtëson për lexuesin e pangeshëm a dembel të letërsisë së Kadaresë dhe i paraqet me gjuhën e studiuesit në “Diademë Letrare II”.

“Princin shqiptar të kinemasë”, Bekim Femiun, këtë artist të përmasave botërore, këtë Uliks a Odise shqiptar, këtë patriot shqiptar që bëri për shqiptarët më shumë se divizione e taborre bashkë duke pohuar kudo skenave botërore se ishte shqiptar dhe nuk guxuan t’ia ndërrojnë asnjë germë të emrit asnjëherë, që edhe me vdekjen e vet dhe derdhjen e hirit të trupit të tij në Lumbardhin e Prizrenit i shërbeu Kosovës e shqiptarëve, Flori Bruqi e bën pjesë të librit të tij “Diademë Letrare II”, jo për shkak të librit me kujtime që ka shkruar Bekim Femiun, por për shkak se gjithë jeta e vepra e tij ishte në shërbim të artit e ishte art.

Edhe poeti, shkrimtari, këngëtari e patrioti idealist Jusuf Gërvalla është vështruar në tërësinë e tij nga Flori Bruqi me dashuri e konsiderata për artin e jetën e tij në shërbim të Kosovës e të çeshtjeve shqiptare.

Nga “Diademë Letrare II” mësova se Jakov Mile, autori i librit “Raca Shqiptare”, mik i Migjenit, patriot i thekur shqiptar, kishte qenë ministër bujqësie në Shqipëri dhe u ndjeva me turp që nuk e kam ditur kur është dashtë me e ditë për me ia vendosë portretin krahas portreteve të gjithë ministrave të tjerë të bujqësisë të Shqipërisë të ekspozuar në mjediset e Ministrisë së Bujqësisë në Tiranë. Flori Bruqi edhe për shkak të doktorimit të tij e të shkollimit në fushën e shkencore të Defektologjisë, është njohur në thellësi me veprën e Jakov Miles, me thëniet e kundërthëniet, me tezat e kundratezat dhe është përfshirë edhe vetë në debatet shkencore e jo shkencore mbi librin e bujshëm “Raca Shqiptare”. Vështrimi për këtë vepër e këtë çeshtje zë vend të rëndësishëm në këtë pjesë të dytë të Diademës Letrare. Në “Diademë Letrare II” ndërthurën të vjetrit me të rinjtë, të huajt me shqiptarët, të gjallët me të vdekurit e gjallë, shkrimtarët që jetojnë në Kosovë, në Shqipëri, në Diasporë, ata që shkruajnë shqip e ata që shkruajnë për tema shqiptare në gjuhë të huaj dhe ndërthurën mes tyre natyrshëm Aleksandër Xhuvani studiues, gjuhëtar e veprimtar i kulturës kombëtare, Naim Kelmendi poet e publicist, Shefqet Dibrani publicist e poet, Amiko Kasaruho autoritet i rrallë moral i shqiptarëve që shkroi tmerrin e diktaturës komuniste të Shqipërisë që e provoi në kurriz dhe përktheu mrekulli nga letërsia botërore në gjuhën shqipe, shkrimtari Mehmet Kajtazi me korpusin e

veprave të tij, Ramiz Kelmendi me kontributet e tij të shumta, Kadrush Radogoshi me jetën e veprën e vet, Engjëll I. Berisha me poezitë e tij, Jakov Xoxa, Sterjo Spase, Haki Stërmilli, Foqion Postoli si katër shkrimtarë të fillimeve të letërsisë së ndërprerë në Shqipëri para diktaturës dhe në fillimet e saj si dhe dhe kompozitori i njohur Rexho Mulliqi që mbetet krenari dhe emblemë në krijimtarinë muzikore shqiptare në Kosovë.

Një libër është si një godinë. Flori Bruqi kishte aq shumë material e lëndë të parë për libër sa nuk mjaftojnë tre - katër libra 300 faqësh për ta përfshi gjithë materialin e lëndën e parë në dispozicion.

Shpresojmë se autori do të “ndërtojë” libra të tjerë me shkrimet e shumta që ka të shpërndara gjithandej nëpër website e organe të ndryshme shtypi.

**RECENSIONI I “LEKSIKONIT ENCIKLOPEDIK”  
NGA AKADEMIJA SHQIPTARE-AMERIKANE E  
SHKENCAVE DHE ARTEVE NË SHBA**

**Nga Prof.dr. Nijazi Halili**

Shkrimtari, publicisti, hulumtuesi shkencor, anëtar i rregullt i Akademisë Shqiptare Amerikane për Shkencë dhe Arte, Drejtor në Marrëdhënie me Publikun, Prof.Dr. Flori Bruqi, PhD, kësaj radhe na paraqitet me një libër fjalor enciklopedik shumë interesant si rezultat i hulumtueseve shkencor të kësaj akademie në fushat e tyre të thella për shkencën dhe artin.

Në këtë libër, që mban titullin “Leksikoni Enciklopedik” i ndarë në disa kapituj. Sipas autori ky leksikon enciklopedik ka një vlerë të veçantë për kohën kur të botohet dhe t’iu epet në dorë lexuesit, të cilët kanë mundësi t’i thellojnë njohuritë e tyre në shumë aspekte për çështjen tonë kombëtare.

Leksikoni Enciklopedik i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA është një vepër kapitale që trajton artet në të gjitha hapësirat shqiptare në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi edhe në diasporë.

Bashkëpunëtorët e kësaj vepre kapitale janë nga të gjitha trevat ku në këtë leksikon enciklopedik kanë punuar studiues nga të gjitha trevat shqiptare, siç janë: Skënder Kodra, Dibran Fylli, Agron Fico, Adem Harxhi, Arjan Hamiti, Asllan Qyqalla, Bedri Tahiri, Eshref Ymeri, Flori Bruqi, Fritz Radovani, Fatos Daci, Hakif Bajrami, Isuf (Isuf) Dedushaj, Jahja Mustafë Lluka, Kujtim Mateli, Migena Arllati, Mixhait

Reçi, Namik Muhedin Shehu, Nehat Jahiu, Nijazi Halili, Naim Salih Kelmendi, Ndue Hila, Petraç Risto, Sulejman Abazi (Neshaj), Shyqiri Bytyqi, Vilhelme Vrana Haxhiraj, Gjin Kol Musa, Zef Mulaj, Isak Shema, Salih Kelmend, të cilët përbëjnë bordin që ndjek ecurinë. Pjesa dërrmuese e punimeve është hartuar nga ky bord, por janë afruar edhe shumë e shumë studiues të tjerë të njohur për zërat e ndryshme të arteve.

Sipas autorit Prof.Dr. Flori Bruqi, ky leksikon enciklopedik është i para i këtij lloji në hapësirën shqipfolëse. Ky është një projekt ambicioz në siglën e Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, ku dihet se Shqipëria ende nuk e ka fjalor enciklopedik të kësaj natyre. Kishte një fjalor të hershëm enciklopedik, e tani ka dalë në botim fjalori i ri vetëm me dy vëllime, pritet i treti, ndërsa leksikoni Enciklopedik i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA do të ketë disa vëllime.

Fjalori enciklopedik i autorit Prof.Dr. Flori Bruqi, PhD në siglën e Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, tani është dorëzuar për botim, është leksikon enciklopedik i cili përfshinë kontributin e shumë shkencëtarëve në fushat e tyre.

Leksikoni Enciklopedia ka si specifikë se mbart elementë vlerësues për çdo autor; çfarë ai përfaqëson, cilat janë tiparet, profili i tij, nga se çmohen veprat e tij.

Sipas autorit jepet një përshkrim për figurat më të shquara të shkencës dhe Artit nga Akademia e Shqiptare -Amerikane e Shkencave dhe Arteve.

Botimi është një produkt i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në SHBA, mendohet se mbart vlerësimin e mundshëm më të drejtë, nga vlerësimet që mund të jepen nga studiuesit që punojnë në mënyrë individuale. Fjalori Enciklopedik ka një bord, emrat më të shquar në fushat e tyre, e kësajsoj mendoj se ka dhe një lloj objektiviteti.

Duke qenë se janë studiues që njohin mirë lëmit e veta, vetvetiu ata do të dinë si ta vendosin e t'i japin vendin e duhur çdo zëri të veçantë. Sipas autorit të kësaj vepre madhore nuk do të jenë të përfshirë vetëm studiues e tanishëm në këtë projekt por do të përfshihen, edhe studiues post mortum të cilët kanë lënë gjurmë në shkencë dhe Art.

Studiuesit janë përfshirë nga të gjitha fushat siç janë artet figurative, shkencat ekonomike, shkencat e mjekësisë, shkencat e historisë nga të gjitha trevat shqipfolëse, nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, nga Kosova dhe Amerika. Por peshën kryesore do ta mbetet tek vetë autori.

Mendoj që në këtë fjalor enciklopedik autori ka bërë një sistemim të plotë, të ngjeshur të vlerave që ka krijuar arti shqiptar në shekuj, të emrave dhe them se do të jetë një kontribut I pakontestuar.

Si për shembull kontribuues të shquar të këtij leksikoni enciklopedik janë shumë akademikë të spikatur të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve. Ne nuk do të bëjmë plotësisht historinë. Ky fjalor enciklopedik do të jetë i përmbledhur, e konciz.

Por nuk do të lejojmë pa e përmendur dhe përfshirë në këtë vepër kapitale edhe institucionet e artit, kulturës, muzikës,

teatrit, galeritë që janë pjesë përbërëse e artit e tjera.

Sipas autorit Prof.Dr. Flori Bruqi, çdokush do të ndjekë fushën e tij me impenjim maksimal. Synimi i autorit ishte që ta plotësojmë këtë leksion enciklopedik deri ditën e fundit. Patëm një të dhënë të re, ne do ta përfshijmë në leksikoni e enciklopedisë.

Ashtu edhe ne, siç shprehet autori kemi qenë ky popull, kemi pasur këtë kulturë dhe kjo do të thuhet përfshihen në këtë vepër kapitale.

Më i vështirë ishte aspekti historik, pasi që kemi përfshirë një numër të madh të autorëve apo shkencëtarëve post mortum të cilët tani nuk gjenden në mesin tonë, e që kishin kontribuar në fushën e shkencës dhe artit për vite të tera, andaj ata do të zënë vend të merituar në këtë vepër kapitale të autorit Prof.Dr. Flori Bruqit.

Në këtë rast autori ka një lloj përgjegjësie sepse vepër është botim akademik, bëhet nga njerëz që kanë nivel të lartë akademik për këtë punë dhe çdo gjë kalohet me përgjegjësi në një sitë profesionistësh duke bërë seleksionim deri në pikën përfundimtare për secilin krijues.

Të dhënat dhe botimet, suplementet e artit, të dhënat e reja që dalin edhe në shtypin periodik do të shfrytëzohen sigurisht me një përpjekje dhe saktësi duke i përfshirë në këtë vepër.

Çfarë janë botime për artin do të kalohen të gjitha në filtër. Por kjo nuk do të thotë se nuk do të ketë gjëra të reja.

Sipas autorit fjalori enciklopedik i ka kaluar të gjitha fazat dhe atë përfundimtare dhe është dërguar për botim megjithëse behet fjale për një vepër me rendësi kombëtare. As imediat qofshin ato te shtypit qofshin radio apo tv nuk informojnë apo

nuk japin informacione të mjaftueshme për këtë dem kombëtar që i behet kulturës shqiptare, andaj kjo vepër e autorit Flori Bruqi, do të përfshijë informacione të mjaftueshme që do ti shërbejnë gjeneratave të reja si pikë reference për studime dhe hulumtime shkencore.

Në këtë fjalor enciklopedik, politika nuk do të ketë vend dhe hapësirë për të vepruar, andaj kjo vepër kapitale është e begatuar dhe do mbetet shembull për gjeneratat e ardhshme se si duhet punuar dhe vepruar gjithnjë në interes të dijes dhe shkencë, pasi që një fjalor i kësaj natyre i ka munguar trojeve shqiptare me vite.

Lexuesi dhe studiuesi shqiptar dhe ai i huaj do ta lexoni dhe studioni këtë vepër kapitale, për dhembjen tonë, të autorit dhe të gjithë atdhetarëve, për të pasur mundësi të gjykoni...

*Prishtinë, 9.12.2019*



## AI KA NJË SHTRIRJE TË GJERË KRIJIMTARIE ARTISTIKE DHE SHKENCORE

**Nga Adem Avdia**

Nëse merr në analizë veprën dhe krijimtarinë e Prof. Flori Bruqit, nuk mund të qëndrosh indiferentë dhe në distancë nga figura e këtij personaliteti të letrave shqipe. Kush ka patur rastin t'a njoh nga afër vëren se ka të bëj me një njeri human, jo vetëm të letrave. Ai është shumë i “butë” e nuk cënon kurrë dinjitetin e tjetrit. Mundohet të kaloj në harmoni e të sheshoi çdo “kapërcim” sado të vogël. Nuk ka qejf të dëgjoj e të shohë njerëz në konflikt. E kjo tregon se ka shpirt të madh. Nuk është njeri materialist e kurrë nuk ka menduar të marrë fitime nga veprat tija edhe pse është shumë normale dhe brenda moralit. Nuk është thjeshtë krijues.

Ai është dhe udhërrfyesi i krijuesve të rinj, rol që e kam provuar edhe vetë. Është drejtues jo vetëm i shoqatave shkencore e letrare, nga më seriozitet e të njohura në trojet etnike shqiptare, por është organizator i mrekullueshëm i dhjetra aktiviteteve shkencore, letrare e artistike në Kosovë e jashtë saj. Është fitues i dhjetra çmimeve në konkurset letrare dhe poetike në Shqipëri e Kosovë. Rekordmbajtës i tyre, ashtu si mbetet një personalitet i qetë dhe i ekuilibruar në juritë e shumta të vlerësimit të krijuesve, të atyre që ai i përkrah dhe inkurajon aq shumë. Këto e shumë të tjera duhet të jenë përshkrimi i veprës së tij të madhe. Është vështirë dikush të mundohet ta personifikojë. Është shumë i madh dhe shumë i gjërë. Duhet mendje të ndritura dhe pena shumë të holla që shpresoj se një ditë do të ngjyhen në bojën e dijes e diturisë.

Ai ka jetuar, por jo vetëm. Ka krijuar një fond të pasur letraro - artistik. Në fondin e tij gjen një larmi krijimesh. Ka studiuar, ka hulumtuar e ka zbuluar detajet e jetës dhe i ka pasqyruar në krijimeve letrare nëpër vite. Ka marrë si bleta nektarin e pastaj ka prodhuar produktin, “mjaltin” e tij që ne aq shumë e shijojmë. Ka botuar mbi 50 libra, mbi 50 vepra letrare, ku ndofshta një njeri “modern” nuk i ka lexuar aq në numër. Ndotshta mbi 50 të tjera ka në mendje e presin penën e dorës së tij. Të gjitha veprat e tij janë për tu ndaluar. Të gjitha të befasojnë e të japin material artistik e jetësor. Të gjitha kanë brenda historinë e krijimtarinë tonë kombëtare. Krijimtaria e tij është risi. Aty gjëndet një galeri e paparë dhe një labirinth i vërtetë në prozë e poezi. Gjëndet njeriu i zakonshëm me dhembshurinë e dashurinë e tij, gruaja e nëna të shkriurë në memoriale dashurie e krenarie, dhimbja që kaloi një popull, si nën zgjedhën pushtuese ashtu dhe barbarizmin shfarosës, por asnjëherë me kokë të ulur. I drobitur por jo i rrëzuar, i sakatosur por jo i dorëzuar. Një popull qendrestar që i mbijetoj furtunës. Vepra e tij që shtrihet nga lashtësia, është jo thjeshtë histori, por me argumente shkencore tregon se ky popull që ka vuajtur dhe ka kaluar tmerre është po aq i fortë, po aq rezistentë, është si bari që sa më shumë ta presësh, aq më i bukur del, del e lulëzon hijëshëm në tokën e tij. Krijimtaria dhe veprat e tij janë një enciklopedi shqiptare. Kur ndrron librat, nuk ndrron vetëm veprat e shkruara, por kalon nga një botë në tjetrën. Sa je tek lashtësia, tek argumentet se sa i lashtë është ky popull e ky komb, sa dhe ku mundohen ta deformatojnë historinë fqinjët dhe ta bëjnë të tyren jo vetëm baladën, tokën e gjakun, hidhesh menjëherë tek lufta çlirimtare e pavarësisimit

Kosovës me martirët e saj të letrarizuar aq bukur. Sa lexon një poezi me dashurinë e pastër njerëzore, kalon tek gurgullima e ujit në bjeshkët e Rugovës, tek natyra që aq shumë e deshi dhe aq mahnitshëm e përshkroi. Sa shfleton faqet e "Shtëpisë së verdhë" kalon befasi tek shpendi që mbizotëron në krijimet e tij, tek shqiponja që edhe në fluturim e përfytyron me dy krena. Në veprat "Diademë letrare", në disa volume, spikat kritika letrare dhe vështrimi analitik i prozës dhe poezisë së autorëve shqiptarë. Nuk ke fare nevojë të thellohesh në veprat letrare dhe krijimet artistike, po të studiosh me vëmendje vështrimin kritik të Prof. Flori Bruqit. Aty gjen që nga kolosët e mëdhenj të letërsisë shqiptare e deri tek krijuesit e rinj. Këta të dytët kur shohin se me shkrimet e tyre është marrë ky personalitet i shquar, ndjejnë një inkurajim të pamasë e shpërthejnë në botën e tyre të krijimtarisë. Krijimtaria e Prof. Flori Bruqit është krijimtaria e njeriut për njeriun. Ai duke qenë shembulli i moralit, i punës, sakrificës, vetmohimit, sprovës, guximit dhe inkurajimit, të tillë e bën dhe veprën dhe krijimin e tij. Nuk mund të ndodh ndryshe.

Ky libër interesant që pritet të jetë në duart e lexuesve dhe merr përsipër të jetë sintezë e krijimtarisë, punës shkencore e kërkimore, hulumtimeve dhe përshkrimeve artistike të mendjes dhe syrit vëzhgues dhe largpamës të Prof. Flori Bruqit mendoj se do jetë bërthama ku do të mund të lidhet fruti pemës madhështore të tij. Mendoj se sado i madhërisëm të jetë ky libër, sado personalitete të shkruajnë kritikën dhe mendimet e tyre, asnjëherë nuk mund të arrihet të përmblihdet në një botim si një vepër dhe të thuhet: "Kjo është vepra e

Prof. Flori Bruçit". Jo. Ai ka një shtrirje të gjërë krijimtarie artistike dhe shkencore si në kohë dhe në volum. Ai nuk ka thjeshtë mbi 50 vepra shkencore dhe letrare, por ka mbi 50 dritare me këndvështrime të shumta e dhjetra tematika që nuk përputhen me njëra tjetrën.

Në librin që pritet të merret në dorë nga lexuesi vërej një gamë të ngushtë nga larmia e tij, por nga ana tjetër vërej se shumë nga krijimtaria e tij e gjërë nuk janë cekur. Kjo vjen nga fakti se krijimtaria e tij shumë vite përpara nuk ndodhet në duart e lexuesit të zakonshëm.

Kjo nuk do të thotë që studiuesit, kritikët letrarë dhe dash-amirësit e tij të mos vijojejnë të merren me atë në vite. Ajo është një labirinth ku mund të futesh, por duhet të mendohesh mirë se është e vështirë të dalësh. Po të marrim të mirëqenë këtë libër, atëherë duhet të shoqërohet dhe po me aq libra sa ka dhe volumin krijimtar të tijin. Vetëm kështu do të mbeteshim disi të kënaqur.

FLORI BRUQI: "JA CILA ËSHTË FRIKA IME MË E  
MADHE SI SHKRIMTAR!"

**Prof.dr. Astrit Kastrati**

*Agjencioni prestigjioz "Floripress" ka marrë një intervistë shkrimtarit shqiptar nga Prishtina zt. Flori Bruqi. Në rubrikën për "Kulturë" të gazetarit Prof.dr. Astrit Kastrati, Bruqi ka rrëfyer për jetën e tij si shkrimtar.*

*Edhe pse intervista është e një modeli i shkurtër, Bruqi ka treguar aty më shumë se sa do të tregonte në një intervistë të gjatë. Kështu, shkrimtari ka treguar nga se ka frikë në jetë, libri që i ka ndryshuar jetën, dhe se cili është lexuesi i tij i preferuar. Në intervista e mëarshme, Bruqi thotë se nuk ka frikë nga njerëzit dhe vdekja. Të qenit shkrimtar i madh. i ka siguruar atij pavdekësinë. Por megjithatë edhe gjenitë e kanë një pikë të dobët dhe për Bruqin është vetë-censura. Pasi sipas tij kjo e vret letërsinë.*

**-Cili është lexuesi juaj i përsosur?**

**F. Bruqi:** Një lexues që pëlqen Tolstoin, por që nuk e shijon si Don Kishotin - apo si Hygon, dhe nuk merr të njëjtën ndjenjë kur lexon Dostojevskin apo Kadarenë.

**-Çfarë hani kur shkruani?**

**F. Bruqi:** Unë shkruaj çdo ditë. Punoj me shumë se 5 orë në ditë. Pi vetëm kafe dhe qajë, asgjë tjetër.

**-Cila është krenaria juaj nga të gjitha shkrimet?**

**F. Bruqi:** Vrasësit e Liridonëve. U shkrua në vitin 1990 dhe u publikua 6 vite më vonë, gjatë periudhës së monizmit në ish Jugosllavi. Ishte një libër kundër tiranisë...për vrasjen mizore të Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës.

**-Çfarë ju frikëson?**

**F.Bruqi:** Unë kam krijuar letërsi gjatë kohës se sistemeve politike diametrikisht të kundërta: një tirani që zgjati për mua 1974-1999, dhe 20 vite liri. Në të dyja rastet, vetëm diçka mund të shkatërrojë letërsinë vetë-censura.

**-Cilët libra keni mbi tavolinën tuaj para se të flini?**

**F.Bruqi:** Libra që unë aktualisht nuk i hap, por që vetë prezenca e tyre të rrezaton diçka. Shpesh kjo ndjenjë është krejt e ndryshme nga ajo që përjeton kur i lexon. Por kjo është ndjenja për të cilën unë kam nevojë.

**-Keni një rutinë të shkruari?**

**F.Bruqi:** Ndërmjet orës 11 dhe mesditës, pothuaja çdo ditë. Në Prishtinë dhe në fshatin tim të lindjës (Isniq) punoj në shtëpi.

**-Cili libër ka ndryshuar jetën tuaj?**

**F.Bruqi:** Sikur t'isha djalë. Unë e lexova atë në moshën 12 vjeçare. Megjithëse nuk kuptoja gjithçka, e doja kaq shumë sa që fillova ta kopjoja në dorë. Një vit me vonë, doja te beja të njëjtën gjë me Lulja e kujtimit, i cili megjithatë ishte me pak i kuptueshëm.

**-Si relaksoheni?**

**F.Bruqi:** Unë eci. Në Gërmi eci pothuaja çdo ditë...

**-Cilat janë influencat tuaja letrare?**

**F.Bruqi:** Të tre gadishuj e Europës: Apeninët, me Dante Alegierin; Ballkani me tragjeditë greke dhe Homerin; baladat mesjetare shqiptare; Gadishulli Iberik me Don Kishotin. Ishujt Britanik me William Shakespeare. Rusia dhe literatura e Europës Qendrorë (Tolstoji, Kafka, Dostojevski).

*-Kur e morët vesh se do të bëheshit shkrimtar?*

**F. Bruqi:** Kur isha 21 vjeç. Atëherë ishte e lehtë ta imagjinoje veten një shkrimtar të rëndësishëm...

*-Cili prej romaneve të pëlqen më së shumti që ke shkruar?*

**F. Bruqi:** Pas vëllimit poetik me titull “Zjarri i Diellit” (1995), romanit “Ndërgjegja” (1995), “Vrasësit e Liridonëve” (1996), që e botova në Prishtinë, në Tiranë botova romanin “Ringjallja”. Tema e romanit “Ringjallja” qon në një kohë këtu e shumë vite më parë. Është koha e “kundërrevolucionit”, e shturjeve të sistemeve, thyerjeve e digresioneve në një ambient të caktuar, të cilat shkaktojnë dramën e individit dhe kolektivitetit. “Ringjalljen” e karakterizon një kompozicion i thjeshtë, ku rëfimi rrjedh i qetë dhe natyrshëm. Përmes ides themelore që transmetohet këtu, dalin në spikamë edhe një varg problemesh etiko-shoqërore të cilat i shkakton një pushtues jo njerëzor.

Unë si prozator nuk e kam përcaktuar fatin e një populli të lënë jashtë kufijve të atdheut, i cili pareshtur i nënshtrohet torturave, ndjekjeve, dënimeve dhe mynxyrave të tjera makabre. Për t'i shpëtuar kësaj dhune me shumë veta detyrohen të lëshojnë vendlindjen dhe të ikën në ekzil, siç ndodh me ikjen e Çlirimit për në Shqipëri, familjet e Ligan Shpatullgjanit, Demë Ali Pozharit, Mërgim Bardhit e shumë të tjerëve në shkretëtirën e Anadollit. “Ringjallja” është një ekuivalent i kohës: me braktisje, vetmi, trishtim, që shqetësojnë jetën e njeriut edhe në çastet më të gëzuara të tij. Një formë herë e çlirët e rrëfimit e herë-herë me një organizim të dialogut krijon bagazhin e mundshëm të ambientit nën pushtim.

Asociacionet që zgjojnë dialogjet, toni i proceseve jetësore nëpër situata të veçanta dhe rrethanat e krijuara e zgjojnë kërshtërinë e lexuesit. Pa dyshim se tema është provokuese dhe jep mundësi konstruktimi artistik i situatave që e bëjnë për vete lexuesin.

Poashtu edhe libri “Guxim shqiptar“ është një libër sipas meje i arrirë, një libër që lexuesin e tërheq ta lexoj. Temat, motivet, trajtimi, rrjedhshmëria, mesazhi e të tjera kudo janë brenda librit. Gjithë natën era mbrëmë theu qelqe, porta, pullaze,.. e nata s’kishte të sosur. Në këtë art poetik libri shpallon shtresat e errësirës, urrejtjen e “bujtësve” këtej, veprimet e tyre prej armiku. Nuk ishte dëshirë e këtij populli që Kosova të ngjy fjalën në qypin e gjakut. Asnjë betejë në Kosovë nuk ishte pa një pike gjaku, pa një të rënë në rrënjë të fjalës. Alfabeti i lirisë është ai i moçmi, me pushkë, me dije, me guxim. Pa pushkën maje krahu të trimave, liria jonë do të ishte vetëm një dëshirë dhe asgjë më shumë. Libri im “Guxim shqiptar” është një dëshmi esesh dhe polemikash se gjakderdhja e madhe, ikja e madhe, dhe kthimi i madh, detyruan bashkësinë ndërkombëtare ta njohin vullnetin e popullit të Kosovës. Në këtë libër me kujdes janë shkruar rreth 73 ese dhe polemika e vështrime kritike nga gjuhësia, historia, antropologjia, politika, spiunazhi, psikoanaliza, astrologjia dhe letersia...!”

Në romanin tim “Pallati i Akeronit”, është zëri im i guximshëm që shkrova mbi një periudhë të dhembshme, të mbrapshtë, por edhe të stërkequr, që e krijoi regjimi dhe kukudhët e tij. Këtu kam prekur disa nga pikat më të qenësishme të veprimit të disa gazetarëve dhe të atyre politikanëve apo



njerëzve të UDB-së. Por në këtë libër që ka edhe elemnte të një romani kriminalistik ku kapet një periudhë e rëndë e shqiptarëve, sidomos, të atyre që punonin për çështjen shqiptare që ishte shumë tragjike. Romani është i ndarë në kapituj, një ndarje kjo formale, por në epiqendër është narratori i gjithëdijshtëm Uran Dugagjini, që përqendrohet kryesisht rreth veprimit të disa gazetarëve të pa ndërgjegjshëm, spiun të nëntoks së Beogardit, të zier me regjimin, duke përgjuar njerëzit që nuk i shkonin për shtati atij apo diçka ngjashëm me “kundërrevolucionarët”, të cilët ndiqeshin, largoheshin nga puna, dënoheshin gjer në likuidim fizik, siç ndodhi me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, Kadri Zekën, Enver Hadrin e shumë të tjerë. Në roman prekën edhe shumë çështje të tjera si ato të luftës, heroizmin e disa luftëtarëve e shumë çështje të tjera që për lexuesin do të jenë mjaft interesante. Alergjia e narratorit është e ndjeshme, sepse atij i ndalohej botimi i shkrimeve, si i shumë kolegëve të tij, ndiqet si dhe nuk i lë vend në asnjë shtresë nga veprimi i kukudhëve. Është pra, Uran Dugagjini i cili perjeton ngjarje të hidhura para dhe gjatë luftës dhe, ende e ndjen veten të “lënë në harresë”, ngase kukudhët janë vendosur në poste të ndryshme, sidomos në mjete të informimit dhe vazhdojnë t'u tekton, por tani kuptohet, kinse në emër të “demokracisë”, të cilën deri dje e shkelën apo nuk guxonin ta përmendin...”

Sa i përket librit "Triumfi shqiptar", po shkëpus atë çfarë shkruan Akademik Prof.Dr. Eshref Ymeri i cili thotë "...Flori Bruqi, nxjerr në spikamë natyrën shumëdimensionale të krijimtarisë së këtij personaliteti të shquar të kulturës shqiptare. Në universin e kulturës shqiptare është i rrallë fakti

që një krijues të dalë para lexuesve me autoritetin e admirueshëm të një shkrimtari, poeti, përkthyesi, publicisti, historiani, gjeografi, analisti dhe kritiku të talentuar. Tek lexon këtë vepër kaq interesante, që të rrëmben me tematikën e vet bukur të larmishme, nuk mund të mos ndiesh njëherazi kënaqësi dhe krenari për faktin që krijimtarinë e zotit Flori e përshkon tejdanë një frymë mahnitëse objektiviteti, humanizmi dhe optimizmi të pakundshoq. Mes rreshtave të kësaj vepre nuk është vështirë të kapësh tiparin më themelor të formimit intelektual të zotit Flori - dashurinë e tij të pastër për tokën amtare, respektin e lakmueshëm për këdo që është atdhetar dhe që e do me shpirt punën, si burim mirëqenieje dhe begatie për të gjithë.

Albert Kamy (Camus - 1913-1960) thotë: “Asgjë tjetër nuk mund ta frymëzojë kaq shumë njeriun, sesa vetëdijësimi për gjendjen e tij të pashpresë”.

Duke pasur parasysh këto fjalë të qëlluara të Kamysë, mendoj se të gjithë ata shqiptarë që popullojnë mbarë trojet tona etnike në Evropën Juglindore dhe që janë të kapluar nga pak nga ndjenja meskiniteti, smire, xhelozie, inferioriteti dhe zvetënimi të shpirtit njerëzor, pra, nga “vetëdijësimi për gjendjen e tyre të pashpresë”, është mirë ta lexojnë, me durim, veprën e zotit Flori, se nuk do të mbeten të zhgënjyer, nëse do të jenë në gjendje të zbulojnë brenda qenies së tyre një çikëz frymë objektiviteti. Kam bindjen se do të dalin të fituar, se vepra e zotit Flori shërben si melhem për qetësimin e shpirtave që janë të infektuar nga mikrobi djallëzor i përçarjes njerëzore. Ne, shqiptarët, kemi dhënë dhe vazhdojmë të japim prova boll të dhimbshme të përçarjes kombëtare, çka e

kemi paguar shtrenjtë - me copëtimin e trojeve tona etnike. Evropa na e ka njohur mirë dhe na e ka “yshtur” po aq mirë këtë mikrob të mallkuar, prandaj edhe trojet etnike na i bëri çarçaf.

Vepra e zotit Flori duhet të lexohet me shumë vëmendje sidomos në Kosovë, në mënyrë që njerëzit e infektuar nga mikrobi i përçarjes t'i thërrasin mendjes dhe të heqin dorë një herë e mirë nga sulmet që ndërmarrin kundër njëri-tjetrit nëpër faqet e internetit, ca sulme publike këto, me një fjalor të padenjë për stilin e komunikimit njerëzor, por edhe më shumë të padenjë për një komunikim intelektual.

Më gëzon shpirti dhe ndiej një kënaqësi të jashtëzakonshme kur lexoj këtë vepër të zotit Flori, që të mëson dhe të frymëzon që ta duash dhe ta respektosh njeriun, pra, ta duash dhe ta respektosh shqiptarin. Sepse në analizat e veta shkencore zoti Flori, tërthorazi, zbulon anët më humane të shpirtit njerëzor, ndikimin e tyre në plazmimin e vlerave krijuese dhe rolin që ato duhet të luajnë në shëndoshjen e shpirtit shqiptar me dashurinë e njeriut për njeriun.

Në gjykimin tim, mbarë krijimtaria e zotit Flori, për tematikën e gjërë që trajton dhe për objektivitetin e analizave shkencore që shpalosen në të, mund të vlerësohet pa drojë si modeli i një enciklopedie të mendimit shqiptar" shkruan Ymeri.

## STATUSI I SHKRIMTARIT SOT

**Nga Akademik Prof.dr. Flori Bruqi**

Jorge Francisco Isidoro Luis Borges do t'i mjaftonte vetëm një fjali për ta dhënë mrekullisht thelbin e dinjitetit: “Individ dinjitoz është ai që ia del të jetë në paqe me veten dhe me të tjerët”.

Thënia e njohur e Immanuel Kantit se “Individi pa dinjitet s'mund të prodhojë vepra dinjitoze”, duket që u përket atyre postulateve që s'vjetrohen kurrë, pavarësisht konotacioneve që mund të fitojë fjala “dinjitet” në kohërat moderne apo postmoderne.

Në Fjalorin e Gjuhës Shqipe, përmes një shprehje fare pak dinjitoze, jepen dy shpjegime të fjalës “dinjitet”: 1. Tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish (nderi, krenaria etj.); vetëdija që ka njeriu a një grup njerëzish për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi i tij për vetveten; shfaqja e jashtme e kësaj vetëdije dhe e këtij nderimi.

### ***Dinjiteti kombëtar.***

Dinjiteti i njeriut (i familjes, i ndërmarrjes, i institutit). Me (pa, plot) dinjitet. Ngre (ul, fyen, merr nëpër këmbë) dinjitetin. S'ka pikë dinjiteti. Flet (sillet) me dinjitet. 2. Cilësia e mirë a vlera e lartë e diçkaje që e bën atë të çmohet. Me dinjitet artistik. Vepër plot dinjitet.

### ***A ka dinjitet shkrimtari i sotëm shqiptar?***

Jo pa dhimbje, derisa flas edhe për veten më duhet të përgjigjem (zë-ulët): “Jo”.

Si për ta ngushëlluar veten dhe kolegët e mi, po shtoj se problematika në fjalë, domethënë “dinjiteti i humbur i shkrimtarit” duket së është një shqetësim mbarë-kombëtar çka lidhet, me siguri, me “dinjitetin e humbur” të vetë letërsisë.

Sipas studiuesit Ridvan Dibra ”Konsumizmi i shfrenuar, triumfi i imazhit, realitetet elektronikë, ekspansioni i medias etj. duket se vërtet ia kanë lëkundur letërsisë dinjitetin e dikurshëm”. (Në parantezë, gjithherë e kam fjalën për autorë dhe letërsi serioze, që rreken t'u rezistojnë kohërave dhe ndërrimit të përvitshëm të modave).

Amerikani, Joseph H Bloom njëri ndër emrat më të lavdishëm të kritikës letrare bashkëkohore, shprehet plot dhimbje: “Talentet e mëdha janë shurdhuar një herë e mirë nga realiteti i medias amerikane.

Kush mund t'i rivalizojë me parodi lajmet e televizorit, gazetës dhe fjalimet e qeveritarëve?

Realiteti amerikan është më grotesk dhe më qesharak se cilado parodi, sado e mirë qoftë...”. (Kur realiteti amerikan paraqitet i tillë, imagjinojeni tonin, të dashur miq).

Të dënuar të përballen e të jenë pjesë e një realiteti të tillë, disa prej shkrimtarëve shqiptarë bashkëkohorë (post-modernë që të gjithë!) duket se kanë zgjedhur rrugën më të lehtë e më të shkurtër: e kanë hequr nga vetja e tyre dinjitetin, sikur ai të ishte zorrë qorrë a diç tjetër e panevojshme.

### ***Kujti është shitur dinjiteti?***

Së pari, pikërisht asaj për të cilën kanë nevojë më shumë. Asaj që të bën të njohur e “person publik” edhe pse mund të kesh botuar vetëm dy-tre tekste të dyshimtë. Asaj që të bën të famshëm e delirant, deri edhe në ëndrra me Nobel.

Asaj “lubie” që për ta shuar urinë e vet të përditshme, “gëlltit çorbën” e gatuar prej lloj-lloj grafomanësh e sharlatanësh. Domethënë medias.

### *Argumente?*

-Shikojeni paraqitjen e shkrimtarëve nëpër gazeta ditore, ekranet televizivë: herë fodullë e herë kinse shpërfillës, teksa për hir të pranisë mediatike dëshmohen të gatshëm të debatojnë e diskutojnë për lloj-lloj argumentesh e problematikash jashtë fushës së dijeve të tyre, domethënë jo letrare. (Para disa ditëve , një poet i lakuar bashkëkohor fliste plot kompetencë për avantazhet e centraleve atomikë).

-Lexuesi i pasionuar i lexon intervistat apo auto-intervistat e tyre nëpër faqet kulturore të përditshmeve tona: megalomani e neveritshme, vetëmburrje e vetëvlerësime foshnjarake, mungesë e plotë etike, modestie e qytetarie.

(“Kur flet libri, autori duhet të heshtë”, përsëriste para pak kohësh postulatit e njohur të filozofit gjerman me origjinë polake Friedrich Vilhem Nietzsche.” Merrni pjesë në promovimet për çdo libër të botuar: seanca të bezdisshme hipokrizie mes “miqsh të gotave dhe të femrave” e që fill të nesërmen media e unshme i bën publike.

-Shfletoni librat e botuar: foto autorësh delirantë e me pamje profetike (kujtesë: post-modernizmi nuk e pranon autorin-profet), shënime entuziaste në kapakët e pasmë, që do ta skuqnin nga turpi edhe vetë Xhejms Xhojsit (James Joyce) për shembull etj.

Shkrimtari bashkëkohor shqiptar (përsëri u kërkoj ndjesë përjashtimeve) duket i etur për njohje e famë, qoftë edhe për një “filxhan lavdi”.

Dhe këtë lavdi (i yshtur, si duket, edhe nga ndonjë rast pararendës) kërkon ta arrijë sa më shpejt e më lehtë, duke e konsideruar punën e tij kryesore, domethënë punën e mundimshme me tekstin letrar, si punë të dorës së dytë. Kurse parësore për të bëhen:

1. paraqitjet e vazhdueshme mediatike në gazeta dhe televizionet tona ;

2. pjesëmarrjet nëpër lloj-lloj mitingjesh e festivalesh letrarë anë e kënd Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Globit;

3. radhitja e sa më shumë çmimeve të fituara (jo pak të dyshimtë e fiktivë) etj.

Këtë situatë sipas Ridvan Dibrës “ në thelb tragji-komike të letrave tona pas viteve 1990, e “favorizojnë” edhe dy mungesa extra, tipike shqiptare:

1. Mungesa thujse e plotë (uluritëse kjo mungesë!) e kritikës letrare, e cila, kuptohet nëse do të ekzistonte, mund t’ia dilte (ndoshta?) t’i “ulte gjelat që këndojnë majë togut të tyre plehut” dhe të nxirrte në pah vlerat e mirëfillta letrare-estetike.

2. Mungesa e plotë e organeve të specializuara letrare, estetike e kritike (me siguri, duhet të jemi i vetmi vend në botë me një mungesë të tillë!), ku shkrimtarët mund të botonin, diskutonin e debatonin mes vedi dhe jo të sillleshin si futuristët e para 100 viteve, duke i mbajtur mëri njëri-tjetrit e duke u zënë me grushte klubeve”, thotë Dibra.

E megjithatë, humbjen e dinjitetit ndër shkrimtarë nuk e justifikon asnjë mungesë apo situatë, sado të pafavorshme qofshin ato. Sepse pasojat kanë filluar të duken. Gjithnjë e më

shumë po shtohen zërat (dashakeqë e nostalgjikë), që rreken t'ia mohojnë çdo vlerë letërsisë shqipe të pas viteve 1990, duke e vendosur bile në rrafshë krahasuese me realizmin socialist.

Gjithashtu, të gjitha sjelljet që përmenda më sipër e që dëshmojnë mungesë dinjiteti nga vetë shkrimtarët shqiptarë, ftohën dhe largojnë edhe më lexuesit seriozë.

Dhe besoj që një dukuri e tillë bëhet e dhimbshme sidomos për ata shkrimtarë të përkushtuar, që kanë dhënë e vazhdojnë të japin vlera të qëndrueshme e të spikatura letrare (Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Kongoli, Fatos Kongoli, Eshref Ymeri, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu, Fatos Arapi, Zija Çela, Visar Zhiti, Fatmir Terziu, Skënder Buçpapaj, Mujë Buçpapaj, Izet Duraku, Përparim Hysi, Agron Shele, Amiko Kasarhuo, Fatime Kulli, Raimonda Moisiu, Rexhep Shahu, Albana Nexhipi, Zef Pergega, Edmond Tupja, Ema Andrea, Elona Tabaku, Rasim Bebo, Ferida Ramadani-Zmijani, Vullnet Mato, Mimoza Hysa, Ligor Shyti, Flutura Açka, Jerida Kulla, Eljan Tanini, Fran Ukcama, Linditë Ramushi Dushku, Rami Kamberi, Raimonda Maleçka, Vjollca Tiku Pasku, Riza Lahi, Andi Meçaj, Lisjana Demiraj, Kabil Bushati, Rexhep Qosja, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Ibrahim Rugova, Ramiz Kelmendi, Din Mehmeti, Adem Gashi, Flora Brovina, Qerim Ujkani, Reshat Sahitaj, Naim Kelmendi, Skënder Zogaj, Shyqri Galica, Rushit Ramabaja, Migena Arllati, Kadrush Radogoshi, Dibran Fylli, Mehmet Kajtazi, Anton Pashku, Ruzhdi Baloku, Sejdi Berisha, Halil Haxhosaj, Iljaz Prokshi, Akil Koci, Adem Zaplluzha, Nebih Bunjaku, Musa Ramadani, Mehmet Kraja, Zejnullah



Rrahmani, Bilall Maliqi, Bedri Zyberaj, Shefqet Dibrani, Nazmi Rrahmani, Xheladin Çitaku, Xheladin Mjeku, Begzad Baliu, Zeqir Fazliu, Agim Desku, H.Berisha, Mentor Thaqi, Musa Jupolli, Esat Loshaj, Hydajet Hyseni, Rexhep Ferri, Gëzim Ajgeraj, Makfire Maqedonci-Canolli, ... etj).

E përsëris se dinjiteti i shkrimtarit bashkëkohor paraqitet problematik edhe ndër shoqëritë tjera më civile se e jona. Porse aty nuk mungojnë edhe aktet e qëndresës e të sfidës. Sa për ilustrim, po përmend vetëm dy shembuj.

Shkrimatri i famshëm çek Milan Kundera (01.04.1929) ka më shumë se 33 vjet (1982) që nuk jep intervista, i bindur tashmë në hipokrizinë dhe artificialitetin që ato, shpeshherë, përmbajnë në vetvete.

Kurse novelisti amerikan Thomas Ruggles Pynchon (08.05.1937), njëri prej zërave më interesantë të narratives bashkëkohore amerikane (natyrisht post-modern!), ka publike vetëm një foto të hershme në internet, kurse gazetarët që i kërkojnë intervista, i përzë me të shara.

Jam i bindur se ithtarët e post-modernes mund t'i konsiderojnë si donkishoteskë këto raste, duke shtuar se statusi i shkrimtarit ka ndryshuar dhe nuk është si ai i para 100 viteve. Por nuk e besoj që ka pasur, ka dhe do të ketë ndonjë epokë, kur statusi i shkrimtarit përcaktohet nga bjerrja e dinjitetit.

Nga shkrimtarët e pas viteve 1990, përveç një letërsie cilësore e ndryshe, (vepra të tilla nuk mungojnë) kam pritur e besuar edhe në akte dinjiteti e qytetarie, duke iu kundërvënë kësaj pararendësit famëkeq realizëm socialist, që u shqua pikërisht për mungesë dinjiteti e qytetarie.

Nëse fillimet duke-shin premtuese e shpresëdhënëse, tashti e

pohoj me dhimbje se ndihem i zhgënjyer.

Thjesht ndërrim diktaturash, më duket. Nëse dje dinjiteti i shitej apo i falej diktaturës komuniste, sot i shitet apo i falet “diktaturës mediatike”. Kurse vitet 1930, ku mund të gjenim jo pak modele dinjiteti e qytetarie edhe ndër shkrimtarë, duken gjithnjë e më të largët.

Mediat dhe televizionet tona ngrenë pyetjen: Sa dhe si vlerësohen shkrimtarët dhe poetët në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë Lindore, dhe a kanë ata një lloj statusi?”

Hedhja e këtij “asi” në tryezë, në mos qoftë thjesht sa për të fituar një emision a një intervistë në TV tona apo gazete, më shumë, duket se është njëfarë ndihme që media jep që shoqëria të kuptojë diçka më shumë se ç'ndodh dhe ç'pretendohet në këtë kohë dhe në këtë klimë të përgjithshme “mosvëmendjeje ndaj shkrimtarit, librit dhe leximit”.

Ndonëse vetë do të këshilloja që mediat tona elektronike, të shkruara etj., në vend të pyetjeve retorike, të krijojnë më shumë hapësirë, duke shtuar fletë apo kohë televizive për letërsinë, përsëri grishem t'i përgjigjem kësaj pyetjeje, që në të vërtetë edhe para përgjigjes sime ka njohur qindra përgjigje e rrugëzgjdhje të mbetura në rrafsh konstatimi dhe utopie.

E formuluar në kohë, pra “sa dhe si vlerësohet shkrimtari sot” kjo pyetje të bën të mendosh përmes opozicioneve djesot, këtu-atje, Lindje-Perëndim, si dy modelet ku shkrimtari vendoset përballë shoqërisë dhe pret që ajo të reagojë me vlerësim, shpërfillje apo thjesht të hyjë në komunikim të natyrshëm.

Për të qenë të besueshëm duhet të kujtojmë edhe atë fazë të jetës krijuese ku shkrimtarët e Lindjes (përfshi këtu edhe

shkrimtarët shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria) u kreko-seshin shkrimtarëve të Perëndimit se kishin gjithçka falas dhe të garantuar: shërbim mjekësor falas, arsimim falas, shtëpi falas, studio falas, piano, penela e bojëra, pushime dhe leje krijimtarie të garantuar një herë në vit dhe botime të sigurta, njëlloj si dhe honorarët.

Njëra anë e balancës, duket haptazi, qe plot. Ana tjetër e balancës kishte vetëm një njësi, himnizimin e kësaj parajsë e cila përmes letërsisë së ideologjizuar, më shumë se përmes vetë indologjisë, bëhej jo vetëm e besueshme, por e dashur dhe e ëndërruar, duke krijuar edhe në mungesë lirie të shprehuri idiolatrinë mbi “statusin shoqëror të shkrimtarit”.

### ***Të gjorët shkrimtarë të Perëndimit!***

Ndiheshin të dëbuar nga kjo parajsë! Atyre u mungonte, siç dhe u mungon statusi. Por modeli i shkrimtarit të Lindjes tanimë ka rënë dhe ka mbetur vetëm ai i shkrimtarit përballë një shoqërie vlerash përfshi këtu edhe ato të tregut.

Të mësuar me atë gjendje, falsiteti më shumë sesa vërtetësie, iluzioni më shumë sesa serioziteti, shkrimtarët shqiptarë, sidomos pjesa më e madhe e atyre që i kanë jetuar të dy kohët, por jo pak edhe nga ata që krijimtarinë e kanë nisur pas viteve 1990, ndihen keq dhe ankohen për mungesën e statusit shoqëror (kupto shtetëror).

Këtë “nostalgji për status” ata kërkojnë ta paguajnë jo vetë, por t’ua paguajë shoqëria e cila prej tyre jo rrallë etiketohet si turmë lexuesish të padenjë, që gati-gati nuk i meriton shkrimtarët e saj të mëdhenj. Por në vend të presin që dikush të bëjë diçka, shkrimtarët nuk mund të jenë të kënaqur me gjendjen mazokiste të rënies së lirë që po pëson “esnaf” i tyre.

Ankesat për mungesë statusi dhe vëmendjeje tingëllojnë si një vetëlinçim publik. Kjo për faktin e thjeshtë se “esnafi” i shkrimtarëve, sipas atyre që shoh e dëgjoj çdo ditë, për mua rezulton se është më i përfaqësuari në Shqipëri e më pak në Kosovë. Shkrimtarët (ose të ngjashmit) prej vitesh i gjemë këshill-tarë në Presidencë, në Kryeministri, në Ministri të Arsimit, Ministri të Kulturës, e në të tjera ministri që nuk kanë lidhje me kulturën. Ata i gjejmë drejtues institucionesh kulturore, anëtarë bordesh ku miratohen strategji, projekte, politika e tekste për lexim.

Ata janë pjesë e kryesive dhe kolegjiimeve të medieeve tona. Janë dhe kanë qenë parlamentarë, ministra, profesorë, dekanë, rektorë profesorë e gjer tek mësues të thjeshtë. Ata janë pra të kudondodhur.

Studiuesi Arian Leka thotë “Atëherë kujt ia kërkojnë shkrimtarët “statusin” dhe përse u duhet ai? Kujt i adresohen dhe a nuk e kuptojnë se ndodhen para pasqyrës sa herë që flasin për staturë shkrimtarësh dhe mungesë vëmendjeje nga shoqëria e cila pret t'i shohë ata sa më pak të rreshtuar nën modelin shkrimtarë të të gjitha llojeve bashkohuni”?

Në sesionin letrar të FNP “Drini poetik”, që mbahet çdo here më 8 e 9 qershor në Prishtinë-Prizren- ka krijuar hapësira multimediale që kanë të bëjnë me çështje të procesit letrar po aq edhe me raportet e letërsisë me realitetin ideologjik nën diktaturë dhe më vonë, me një kohë të re ku shkrimtari e humbi pozitën mbështetëse të mecenatit shtetëror i cili ishte njëfarësoj edhe “porositësi” i veprës së artit.

Letërsia shqipe nuk ka pasur fatin e letërsive të tjera. Shtrohet pyetja”.

Po nëse shkrimtari “vdes” në momentin që libri është në duar të lexuesit”, Fatos Kongoli jep këtë përgjigje: “Unë jetojë me një libër derisa sa e përfundoj së shkruari. Mendoj se kur botohet, ai nuk është më imi.” Por ai e shikon të arsyeshme rishikim e një vepre gjatë ribotimeve. Kjo është diçka që ai vetë e ka bërë.”

Dhe kur bëhet fjalë për rishikimin e veprave dhe korigjimet e asaj që ke shkruar edhe dyzet vjet përpara, një shembull për t'u komentuar është shkrimtari Ismail Kadare i cili në një deklaratë të tij pohon se kjo lidhet me procesin letrar në kushtet e mungesës së lirisë së shkrimtarit.

Unë kam parasysh atë çka Ismail Kadare ka thënë në një intervistë se gjella e burgut paskesh dalë më e mirë për një numër arsyesh.

“Nuk e kam kuptuar se çfarë ka dashur të thotë Kadare. Gjella e burgut që ha tjetri gatuhet më mirë apo gjella e burgut që ha vetë.”, shton shkrimtari Visar Zhiti.

### ***Si kanë ndryshuar shijet e lexuesit?***

Ajo që ne quajmë liri ka ndryshuar jo vetëm për krijuesin, por dhe për lexuesin. Tashmë shkrimtarët tanë janë një hap me lexuesin evropian.

Ne Kosovë, Shqipëri etj., jemi fatlum në krahasim me mjaft vende të tjera sepse kemi më shumë lexues.

Shkrimtari Zija Çela thotë “Nuk besoj se do të kem shpëtuar pa ndonjë kompromis të këtij lloji, për një fragment apo një fjalë të shkruar. Një shembull: si vjen letërsia. Në vitin '84 kam qenë në Kukës dhe kam shkruar një roman, “Burrat nuk dalin nga lufta”. Po të botohen sot katër recesionet e saj kohe, është krejt ndryshe.

Përfundimi i recesioneve dhe i redaksisë ishte “Sipas Zija Çelës burrat kanë dalë nga lufta”, nuk quhej më një roman dekadent. Në vitin '90 ka qenë një kohë e ethshme për të botuar shkrime të cilat nuk ishin botuar, aq më tepër të dokumentuara me recesione.

Kuptova se ai që ishte kundër këtij botimi, tani isha unë, sepse kishin kaluar vite dhe nëse ideologjia është afatshkurtër, beteja estetike është e përjetshme. Standarti gjithmonë krijon më shumë hapësirë për komunitetet, por e ngushton hapësirën e individit.

Thelbi i një shkrimtari është individualiteti i tij, që të jetë i ndryshëm nga të tjetër. Nëse censura në vendin tonë tashmë është lënë mbrapa, ajo që nuk lihet mbas është autocensura.

Gara me veten është preferenca ime. Por mund të them se e kemi ende të mangët kulturën e leximit, kuptohet se faktorët mund të jenë të natyrshëm. Ruajtja e kulturës së leximit është e domosdoshme.

Natyrisht që ndryshimi është shumë i madh. Por ka dhe një ndryshim tjetër që e sfumon këtë ndryshim, pasi njeriu e krijon lirinë brenda vetes.

Mund të jesh i burgosur dhe mund të jesh i lirë në mendime. Mund të jesh i lirë, por je i burgosur pasi nuk mendon ashtu siç duhet. Në këtë kuptim dhe para dhe pas nëntëdhjetës shkrimtarët kanë pasur privacionet e tyre. Madje mund t'u ketë kushtuar shumë shtrenjtë.

Kjo situata paradoksale në sistemet diktatoriale ku ndodh që të lindë letërsi më e madhe se në sistemet e lira.

Letërsia nuk është thjesht produkt shoqëror, produkt i një sistemi, por është produkt i një grupi individual.

Pra vepra e një shkrimtari mbetet pavarësisht sistemit, thotë Çela dhe shton: "Këtu janë dy gjëra krejt të ndryshme.

Nuk mund të bëhet krahasimi sepse tirazhet e atëhershme i botonte shteti dhe shteti i blinte. Në kuptimin që vërtet mund të botoheshin librat në njëzet mijë kopje, por shumicat i blinin prapë bibliotekat.

Autori nuk paguante gjë, dhe merrte vetëm një honorar simbolik. Ndërsa sot, për ata libra që shiten, kemi një shtije reale. Kjo nënkupton faktin se i boton shtëpia botuese dhe i blen publiku.

Lexuesi është i informuar, vërtet nuk botoheshin shkrimtarë bashkëkohorë kontemporanë, por letërsia e madhe botohej dhe atëherë sepse botoheshin klasikët Homeri, Servantesi, Shekspiri, Tolstoi, etj. Janë shkrimtarët që formojnë shijet, por mungonte pjesa më e madhe e letërsisë.

Këta autorë e formonin shijen atëherë, e formojnë dhe sot. Kur flasim për shije të mirëfillta, mund të themi se dhe sot kërkohen këto botime. Kërkohet gjysma e modernistëve, ajo pjesë që mungonte.

Por në rast se sot kërkohen shkrimtarë të një letërsie komerciale, atëherë kjo është një gjë tjetër sepse ndodh në të gjithë botën.

Nuk është shija e vërtetë, shija e mirëfilltë. Vërtet Daniele Steel në të gjitha vendet shitet me miliona kopje, por është një letërsi e ditës, një letërsi kalimtare etj.

Dhe krejt në fund theksojë se ka shkrimtarë që nuk kanë bërë kompromise. Të gjithë e kanë bërë kompromise, për pjesë të vogla të cilat duhet të hiqnin apo duhet të shtonin, por e kanë bërë.

Kohë më pare në një intervistë për Radio Radikale, radio kombëtare dhe politike në Itali ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Ettore Sequi shprehet lidhur me nismën e tij në dialogun me shkrimtarë, artistë, filozofë të cilët ndajnë me ambasadorin pikëpamjet mbi integrimin evropian të Republikës së Shqipërisë.

Duke iu referuar bashkëbisedimit me shkrimtarin e mirënjohur shqiptar, Ismail Kadare, Sequi shprehet se i ka mbetur në mendje shprehja e shkrimtarit ku thotë: “Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian.”

Lidhur me personazhin e dytë që ambasadori do të ftonte në bashkëbisedim, Sequi nuk jep një emër konkret por shprehet se do të jetë “një personalitet jo shqiptar dhe shumë i njohur në botën globale.”

I pyetur nga gazetari Artur Nura se a ka dialog mes palëve politike në vendin tonë, ambasadori i kujton politikanëve shqiptarë se “dialog nuk simbolizon monologë të ndryshëm të palëve.”

Duke iu referuar integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, diplomati thotë se “Ballkani dhe në zë të veçantë Shqipëria është duke bërë shumë progres, megjithëse me një seri vështirësish.”

Ambasadori flet edhe për raportet dhe interesat, përgjegjësinë e BE-së për zgjerimin e saj me Ballkanin dhe veçanërisht Shqipërinë.

Ismail Kadare që është një evropian i bindur i botës shqiptare, por që është edhe shkrimtari më i mirë shqiptar, ndoshta



edhe në dimensione Ballkanike dhe jo vetëm. Midis të tjerësh, ka qenë së fundi edhe në listën e shkurtër të konkurrentëve të Çmimit Nobel për letërsinë.

Kështu pra, më duhet të them se pata idenë e këtij dialogimi për të arritur të kuptoja se çfarë një personazh domethënës mendon në lidhje me Evropën dhe të ardhmen Europiane të Shqipërisë.

Kështu kam dashur të shpjegoj dhe dua të shpjegoj, për shembull në intervistën me Kadarenë në mënyrë të kthjellët, se çfarë në fakt, presin shqiptarët nga Evropa.

Një frazë nga ky bashkëbisedim më ka mbetur thellësisht në mendje, Kadare më tha: Evropa është shteti natyral i Shqipërisë, i vetmi shtet! Kështu besoj se kjo gjë është pak a shumë perceptimi i të gjithë shqiptarëve. Shqipëria është një vend shumë filo-Evropian.

Kadare është një shqiptar evropian. Ai jeton si në Tiranë ashtu edhe në Paris, por unë besoj që na nevojitet të dimë se cili do të jetë personi i dytë që do të vazhdojë këtë dialog...

Sugjerojë publikisht që politikanët tanë, nuk duhet të kenë një diplomë formale universiteti, por duhet të kenë edhe njohuri minimale në lidhje me filozofinë politike perëndimore, pra të njohin minimalisht veprat e Tomas Hobbes, John Lock, (François-Marie Arouet) Volterit dhe Jean-Jacques Rousseau, apo Konrad Adenauer, Alice De Gasperi, Robert Schuman, Altiero Spinali, vizionarët e historisë që frymëzuan Bashkimin Evropian.

Markezi thotë “s’kam dashur që librat e mi të kenë fatin e sanduiçeve. Letërsia e sanduiçeve është letërsia rozë e një gjuhe fakirfukareshë dhe të shterpët.

Letërsia e madhe, ku bën pjesë edhe Hrabali, s'ka asnjë lidhje me të. Për mua ka dy lloj letërsie.

Letërsia e fabulës dhe letërsia e stilit. Tek kjo e dyta fabula është thjesht një pretekst. Tek Hrabali i gjejmë të mpleksura të dyja. Duhej ruajtur kjo veçori e veprës së tij. Pastaj ç'është përkthyesi tjetër, në mos po fjalë?

Volteri, Borges dhe Pamuk ftillojnë se te secili prej nesh ekzistojnë dy, ose më shumë qenie të tjera. Kësisoj unë s'kam pse të mos ta besoj që ekziston një Hrabal i hedhur nga dritarja me të shtatë macet e tij, por edhe një tjetër që mund ta ketë vrrarë veten i lodhur prej vanitetit njerëzor...

*Prishtinë, 19.05.2015*

## PSE KOSOVA E SHTYPI VETVETEN MË SHUMË SE KUR E SHKELI SERBI?!

**Nga Akademik Prof.dr. Zef Pergega**

*Fishta u pat thënë: “Këndoni në Lahutë heronjtë që të mos vdesin e shqip të frymojnë. Ky është shenjtërimi më i madh për një komb!” Martin Camaj u pat thënë: “Flisni gjuhën që nana në djep ua mësoj!” Ndërsa Arshi Pipa u coj fjalë:” Atë ditë që do të harroni Pjetër Budin atë ditë do të shtypni veten!” Po shqiptari si shqiptari marroset pas politikës dhe injorancës, kurrë nuk e pranon dijen e vet ta ketë mbi krye! Njoh disa që janë sfidë e gjallë që këta porosi i kanë si drita e diellit. Janë pak, por si shenjtëri e dheut të vet si shenjtë Agustin që të paktën e donte pak! Si thonë në Mirditë pak e sak. Me librat e tyre Flori Bruqi, Nusret Pllana Anon Nikë Berisha, Dibran Fylli, e ndonjë tjetër janë më shumë se katër akademi. Puna e tyre është me shumë se një apo 100 heronj lufte se ata shkruan për heroizmin, shkriftrimin e dheut që fara të mbijë e shëndetshme...në ATSH, Agjensinë e lajmeve shtetërore shqiptare në vitin 1998 na erdhi një serb nga Franca të na bënte organizimin e strukturave, kur fitoj pushtetin PS.*

### ***1.Sa mund të kenë dërguar të tillë në Kosovë?!***

Rrënjët e mashtrimit të Serbisë për kulturën shqiptare në Kosovë, janë nëpër hendeqe akademike, ndërsa puna e shqiptarëve për ta mbrojtur dhe dokumentuar është sa ajo e miut...Serbët kanë mbërritur që njerin e tyre ta kishin në drejtimin e gazetës “Le Mond” të Francës, e ne gërrhisnim nën lëkurën e guacës tonë të mbyllur, se jemi fanar ndriçimi në botë...sa erdhëm e fikëm sa gjithë hiri i këtij fanari fantazëm

erdhi u bë bukë e pjekur e krimit më monstruoz politik në botë. Ndërkohë Serbia e pa të domosdoshme mashtrimin e opinionit botëror, duke i dhënë vetes një armë të fortë sulmi, kur ne shullaheshim në një larë dielli përpara një filxhani kafeje apo një gote raki me gjizë osmane... Ne jemi më keq se korbi që turpin e kemi si bukën me djathë. Ne jemi vrastarë të dijës. Ne qeverisemi nga kopilizmi serb, grek dhe turk! Po dheu ynë ka njerëz të mirë që kanë kapërcyer fenë e emrit të tyre dhe e kanë bashkuar me fenë e kombit deri thellë në gjak e gur të trollit tonë. Edhe pse studiuesit tonë nuk botuan nevojshtëm libra akademik mbi gjurmët dardane, ilirike, arbërore të kristianizmit e të osmanizmit, me analiza dhe burime të sakta në arshivat e Vatikanit, Romës, Vjenës dhe Stambollit, duke marrë rrogën për të ngrohur vezët e karrikës, Kosova pati njerëz që i dolën zot situatës dhe dëshmisë, t'i tregonin botës fytyrën e genocidit serbo-sllav në Kosovë me foto dramatike e rrënjëqethëse të krimit më makabër të njerëzimit, që as lufta e Trojës nuk e ka parë...

Tre të tillë i njoh personalisht: Nusret Pllanën, Flori Bruqin dhe Dibran Fyllin. Kam marrë pjesë në promovimin e librave të tyre. Një grusht njerëzish që gjallë e mbajnë patriotizmin në fund të zemrës dhe shpirtit të tyre. As një shenj nga gaverina shqiptare dhe kosovare. Pusht-tetarët e kanë vra dheun tonë, historinë, gjakun e lirisë, kanë humbur çdo gjurmë e shenjës për t'u shenjuar ato vetë në bronx të ndryshkur... Ndonëse mundësia e përhapjes së librave, të Nusretit, të Florit, të Dibranit është e vogël me gjithë zanin e madh të shpirtit të tyre, sa duket se shteti i nënqesh për punën lapidare të tyre! Është një serb me emrin Vuçiq, i cili ia dhuroi Europës një

libër shumë interesant për Europën, duke treguar para opinionit të cilvizuar european faqen e zezë të shqiptarit e fatkeqësi për ne, nën okelion "Trashigimia e krishterë (kuptohej serbe ) në Kosovë e Metohi " Shtrohet pyetja, sa libra ia ka prezentuar Kosova Europës, ku bindshëm të ketë shkruar që objektet e kultit të krishterë në Kosovë, së pari janë shqiptare, të "vjedhura" nga serbët?!. A e ka bërë këtë Akademia e shkencave shqiptare me një batalion akademikësh apo Universiteti me një kompani profesorësh?! Pse me tre lule, si Nusreti, Flori e Dibrani e ndonjë tjetër, mund të vjen pranvera në Kosovë?! Pranvera nuk është kur mbjellë një pemë në trotuar me gjethe jeshile, por kur boton një libër që me të çelë lulja e gjakut të lirisë, që na e kanë pirë tradhtarët, së pari brenda pragut tonë. Një shtet gjakatar, pushtues e kriminal,i krijuar në vitin 1803, Serbia posedon të gjithë pasurinë kulturore kishtarë shqiptare të Kosovës.

Më kujtohet në promovimin e librave të Nusretit në Detroit dhe të Dibranit në Prishtinë, kur njerëz kërkuan që librat, filmat të botohen në anglisht, por ata që kishin në dorë, pushtetarët të lartë të Kosovës dhe liderë të diaporës u ra një hije ngjyrë metaline, kur llava e metalit ngrinë mbi kallëpe. Këta emra që përmenda: Nusretin, Florin e Dibrantin, sigurisht ka edhe individë të tjerë, duhej shoqëria t'i mbante në pëllëmbë të dorës dhe bashkë me ta të shkonin në kryeqytetet e Europës, në mediat dhe forumet e tyre për të folur..., por ato sikur thanë: "le të flasim këta që i kemi zgjedhur për pushtet" Si mund t'i besosh aq gjatë ato që i ke zgjedhë si zgjedhë që nuk të lëshon pa ta pa shkumën e fundit të shpirtit në buzë. Dalin sot e protestojnë 30-40 veta se ata i shohin në Hagë dhe nuk

marrin librat e shkrimtarëve kosovare t'i mbajnë në dorë se për momentin ato japin mesazhe më shumë se mbajtja e flamurit të patriotizmit. Akademia e Kosovës, a është ajo një pandemi në vete?! A mund të quhet institucion akademik, kur nuk ke forcën as sa një foshnje të guxosh për të vërtetën historike?!

Më tha një mik në Kosovë në promovimin e librit të Dibran Fyellit, ku vetëm dy krijues katolik merrnim pjesë, se ne kosovaret nuk jemi islamikë dhe 95% e popullit e don Gjergj Kastriotin si hero të kombit dhe Nana Terezën si shenjtoje të kombit. Po more vëlla i dashur, ju keni eliminuar nga skena politike partinë që e krijoi edhe me mbështetjen e Rugovës, shkrimtari dhe akademiku i ndjerë Mark Krasniqi!... Ju ia keni lënë shtatoren e pajtuesit të gjaqeve Anton Qeta të shtrirë për dhe për shumë vite dikun në një cep të oborrit. Ju, të dashur vëllezër, në politikë keni dërguar në misione diplomatike njerëz që është turp t'i shikosh të punojnë si kamarierë e furrtarë, kur Serbia dërgon njerëz të shkolluar në Perëndim. Ju vëllezër jeni shtet multi etnik dhe duhet ta keni një serb amasador në vendet ballkanike ato gjetkë, duhet ta keni një egjypjan në vendet që e flasin gjuhën e këtij kombi, duhet ta keni një turk në vendet arabe, duhet t'i keni pesë apo gjashtë katolikë në Uashington, Londër, Zvicër, Gjermani, Austri, Danimarkë apo dikund tjetër. Keni njerëz të tillë. Dhe, nëse nuk mundeni t'i gjeni, t'i kishit dërguar në shkollë. Por pse nuk keni dërguar Florin, Nusretin, Dibranin, se ato do të flisnin, siç mund të flas unë lirshëm nga Amerika për kulturën, historinë, për rrënjët, për tolerancë fetare, por nuk keni dashur dhe si po duket ende nuk jemi gati të dojmë...

Kjo është tradhtia që i keni bërë dheut tuaj, duke iu përshpirtur politikës si gjarpëri vezëve të breshkës! Me ato politikanë një ditë nuk është çudi të hani këmbët tuaja. Po shkrimtari më i shquar mbi veprën e Nanë Terezës dhe shumë veprave të tjera, Anton Nikë Berishaj, për disa vite profesor në Universitetin e Kozencës në derë të shtëpisë e keni! Po nuk keni dëshirë t'i thoni mirëmëngjes se është kaurr. U larguat prej krimit serb dhe ratë në gropën e krimit osman.

Nuk mbijetohet kështu! Buxheti i Serbisë për këtë propagandë mashtruese për Kosovën, është shumë më i madh se pasuria e Begjetit, që pret si struci ta zgjasë qafën në ndonjë hije karrikeje, duke e pritur Thaçin të dalë nga ajo vrimë e zezë që e kanë futur. Duke gërthitur për "vëllanë" turk, që nga paslufta i ndërtuan 800 xhami, dhe tani dalim me "kryeveprën 30 milionëshe" me xhaminë e Prishtinës. Asgjë nuk kam me veprat e kultit dhe as besimet se i kam në familje, por edhe për atë kishë u shkruan libra kundra, u ndezën kovachanat e kundërshtisë, sikur nuk i njihni rrënjët tuaja, ndaj Serbia që e stimuloi këtë marri ju çuan tani një mbeturinë turke! Në vend që të ngriheshi e t'i thoni "ndal" si dardanë! Po heronjtë i vranë dhe gjakun u pijnë për lavdi, sot njerëz që nuk kanë pikë lavdije, por bunker i madh hajnie.

### ***2.Një film për Skënderbeun....apo për Gjergjin***

...e vrafte buka njeriun e lig! -thotë një fjalë popullore Osmanët shqiptarë dhe helenëve grekë në Shqipëri u pëlqen ta quajnë: Skënderbeu. Duke punuar këta sulltanë në Akademitë tona e kanë futur këtë term që nuk ka të bëjë me emrin e djepit dhe të pagëzimit nëpër literaturë! Si do të quhej në film, Gjergj Kastrioti apo Skënderbeu?!

Në sytë e amerikanëve dhe të gjithë perëndimorëve: ne nuk kemi qenë kurrë një popull, dhe aq më pak një nacion. Ne për ata jemi thjesht turmë laramane të mbetura e të mbledhura nga ngjarjet historike, ku kusht të mundet hyn e zhvillon lojëra interesash. Nuk ka ekzistuar në mijëra vjet histori njerëzore që: një popull mysliman të ketë hero katolik, apo e kundërta, dhe në fakt shumica absolute myslimane nuk e ka njohur kurrë si hero të tij! Tani ka gjithnjë e më shumë që deklarohen hapur dhe në mënyrën më agresive kundër. Ashtu siç jemi në të vërtetë, ashtu na trajtojnë dhe respektojnë: dmth pa identitet, ose thënë turkçe: pa din e iman. Në administratën amerikane, shqiptarët që punojnë janë ose muslimanë ose ortodoksë, dhe habiten e ngrenë supet kur dëgjojnë emra katolikë.

Në Detroit katolikët janë të njohur prej malësorëve të Malësisë së Madhe, por edhe kontributi i tyre, sidomos për Kosovën e lirë, është kompromentuar nga mediat globaliste soro-komuniste, sa edhe pak do ta shuajnë emrin dhe organizimet e tyre. Këtu kanë interferuar disa jugor islamë të djallëzur deri në brirë, të cilët me misionin e tyre po shkatërrojnë çdo vlerë kombëtare që nga pas u shkon ndonjë lider fetar. Nëse Hollivudi do t'i ngrinte nga dheu e balta e mohimit vlerat qytetëruese, përbashkuese dhe europiane të Heroit tonë kombëtar, kjo do të binte ndesh me realitetin shqiptar dhe me psikologjinë e rrënjosur të perëndimorëve të sotëm, se gjithë kjo histori nuk ka si të jetë e vërtetë, sepse para syve kanë librat e mashtrimit serb, sepse etnogjeneza e saj është e kallur nga vetë shqiptarët dhe tradhtuar prej tyre. Siç thotë Konica se, shumica e shqiptarëve mund të përshkruhen si të tillë. Të gjithë filmat që janë bërë nga Hollivudi për ngjarje romake,



greke, të cilët ka prej tyre shqiptarë që janë përvetësuar nga këto dy kombe irlandeze, për heronjtë e tyre, qofshin ato lokale apo kombëtar, tregojnë se ato e kanë trashëguar mesazhin e luftës, dhe se nuk ka polemika mbi jetën dhe veprën e tyre.

Ndyshon puna në Shqipëri, minaren në mes Tiranës ia kanë ngulur heroit në sy. Shikoni me kujdes siglën e Sokol Balles apo të njonjë tjetri si ai i Zhejit, japin minaren, kishën ortodokse, ndonëse aty afër as 500 metra është Katedralja. Në asnjë vend perëndimor festat edhe ato katolike apo muslimane nuk bëhen në shesh siç bëhen në sheshin e Tiranës festat e muslimanëve, duke treguar një supermaci ndaj feve të tjera dhe duke fyer rëndë ateistët dhe intelektualët. Kjo është prekje e hapur e lirisë së tjetrit. Nëse do çdo komunitet fetar të marrë me qera stadiumin dhe të festojë atje, e shqiptarët për të realizuar këtë fe mbulojnë përmendorën e Heroit tonë kombëtar në mes të Tiranës, apo përdhosin shtatoren e nënë Terezës në Mitrovicë apo gjektë, pikërisht ato që dolën me qirinjtë e saj ndezur në mes të Prishtinës, duke kërkuar liri nga genocidi serb. Si mund të bëhet film nga amerikanët kur islamiku me pikepamje lindore, Rexhep Qosja, e llogarit diktatorin si burrin më të madh të kombit, duke e vënë në krah të Skënderbeut?!...

Kur diktatorit ia hodhën shtatoren, kush mund të japë garanci që në vend të Skënderbeut do të vihet ajo e Haxhi Qamilit, siç ka dashur në fillim Enveri. E ç'vlerë do të kishte filmi?!...

Se edukimi në Shqipëri e Kosovë, historia dhe letërsia i ka rrënjët tek partia, kështu ka thënë Ismail Kadare. Po të kishin nxjerrë islamikët apo othodoksët një njeri të përmasave të

Gjergj Kastriotit, do kishin lënë qimet e kokës dhe filmin do ta kishin realizuar. Rusët e bënë për ne një film dhe Enveri nuk ua prishi. Qëllimet e rusëve diheshin. Supermaci në Ballkan!...

Ne jemi popull i lashtë ilir nëpër fjalë e harta, por jo në vepra të shkruara që mund të përballen me botën në argumente. Ne jemi mësuar të themi: “Rroftë sulltati, rroftë beu, rroftë bajaraktari, rroftë partia, por kurrë rrofshin njerëzit e dijes, ata i kemi çuar në hell e i kemi pjekur kukurec...!”

Lexoni këta autorë të dijes që permenda më lart, të shikoni sytë e vërtetë të Kosovës drejt Perëndimit. Lexoni shkrimet e shqiptaro-amerikanit Agim Vuniçi. Lexoni veç lexoni për të gjetur vlerat e bashkimit, dhe mos i mbani sytë tek analistët e ekraneve.

Asht rrenë krejt bre!

*Detroid-SHBA, 2021*

## TESTET E KONSTRUKTUARA PËR NEVOJAT TË NJË PUNIMI SHKENCOR

**Nga Dibran Fylli**

Flori Bruqi, është njeri prej studiuesve -kineziologëve më të njohur në trojet shqiptare dhe më gjerë. Përpos artikujve të botuar në shumë revista kineziologjike, ai ka botuar edhe shumë libra nga kjo disiplinë sportive si bje fjala : ”Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut” (Prishtinë, Tiranë, 2004); "Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe josportistë, para dhe pas vrapimit 400 metra(Prishtinë, Tiranë,2004); "Psihološka istr živanja nekih aspekata umora i odmora" (Zagreb,1989); “Struktua faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjik” (Prishtinë, Tiranë, 2004); “Delikuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike” (Prishtinë, Tiranë, 2004); “Burri dhe gruaja” (Tiranë, Prishtinë, 2000); ”Ubijali sport" /Zagreb, 2008/; ”Psihologija sporta" (Beograd, 2018); "Edukimi fiziko-ushtarak në Iliri dhe në kohën e Gjergj Kastriot Skenderbeut” /Prishtinë, USA, 2008/; “Ritmičko-sportska gimnastika” /Zagreb,2009/, “Edukata dhe arsimimi tek Ilirët”/USA, 2015/; “Struktura faktoriale e dimnsioneve antropometrike dhe fiziologjik”, USA, 2004 etj.

Shoqëria e jonë është e interesuar që në Organizatat sportive të sendërtohen, para së të gjithash puna edukative, gjegjësisht puna e tillë që do të nxjerrë në shesh dhe brendësinë e formimit të q qimeve sociale. Rregullat e autorëve tjerë konfirmojnë se me ushtrimin fizik mund të arrihet dhe është i pashmangshëm ndërrimi i përmbajtjeve dhe metodave të

punës, që të ngritet në nivel më të lartë puna edukativo-profesionale...

Autori Bruqi, konstaton se “testet e konstruara për nevojat të një punimi të tillë shkencor, mund të shërbejnë në mënyrë të dobishme e edhe për kërkime të ngjashme ose identike të vlerës së influencës edukative në mjediset e tjera, që të ndërmer masa më karakter të përgjithshëm “, konkludon autori Flori Bruqi.

Gjendja në disa organizata të kulturës fizike në Republikën e Kosovës, imponon të shqyrtohen mundësitë e vlerësimit të efektit të ushtrimit fizik, asisoji sa që me rregullat teknike të vlerësohen në të ardhmen e afërt edhe arritjet e ndikimit mbi qëndrimet primare sociale në sportin Kosovar.

Është e rëndësishme të veçojmë edhe ca të dhëna socio-psikologjike dhe kineziologjike të autorit Bruqi për librin studimor socio-psiko-kineziologjik “Burri dhe gruaja”, (në Prishtinë, Tiranë, 2000), i cili konkludon:

”Marrëdhëniet dashurore para martesës si dhe jeta bashkëshortore në periudha fillestare, sidomos kur të rinjtë, dhe të rejat i verbon dashuria, parafytyrohen dhe në përgjithësi janë të lumtura. Por më vonë, kur bashkëshortlët fillojnë të ndeshen më veshësit e jetës së përditshme dhe ndodhë njëfar velje e njërit ndaj tjetrit, jo vetëm nis të shfaqët njëfarë ftohje por ndonjëherë zhvillohet dhe një luftë, herë e butë dhe herë e rreptë, për mbijetesën e familjes, natyrisht pa i përjashtuar castet e gëzuara dhe të lumtura”.

Pikërisht ky libër studimor i Flori Bruqit, më këshilla dhe shembuj që burojnë nga përvoja shumë shekullore e bashkëjetesës familjare, por edhe i ndërthurur më fjalë dhe porosi të

mençura të shkrimtarve e shqiptarë dhe shkencëtarëve botëror 1%, në studime psiko-socio-kineziologjike dhe shoqërore serioze për këto probleme, synon që të shërbejë si udhëzues me vlerë për të zgjedhur mënyrat më të përshtatshme për të zbutur dhe kapërcyer mosmarrëveshjet bashkëshortore, që e helmojnë dhe e lëkundin familjen shqiptare. Libri është i dashur për lexuesin!

Poashtu, edhe në librin e posa botuar (2020) të Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve “Leksikon enciklopedik”, studiuesi Flori Bruqi, ka shkruar edhe për disa kineziolog shqiptar duke i veçuar disa prej tyre. Ai i ka paraqitur biografitë dhe bibliografitë e këtyre autorëve dhe studiuesve shqiptarë nga; Kosova, Shqipëria, Maqedonia Veriore (Ilirida), Lugina e Preshevës, Malin e Zi , Çamëria dhe Diaspora, çka e veçon dukshëm krijuesin Bruqi prej studiuesve tjerë dhe kineziologëve vendorë, të cilë fare nuk merren më tema cilësore kineziologjike botërore...

*Prishtinë, 29 qershor 2021*

**Zef Pergega**

Pikëpamje për krijimtarinë letrare, kritikën dhe krizën e identitetit.....5

**Eshref Ymeri**

Personalitet i shquar i kulturës shqiptare.....69

Potpuria” letrare e Flori Bruçit.....70

Një enciklopedi e mendimit shqiptar.....79

**Bajame Hoxha-Çeliku**

Flori Bruçi, Enciklopedist dhe autor i përmasave letrare të kohës.....81

**Kujtim Mateli**

Akademik Flori Bruçi-luftëtari i paepur në mbrojtje të identitetit tonë kombëtar.....84

**Eshref Ymeri**

Një plagë e hapur që s'po gjen dot shërim.....91

**Reshat Sahitaj**

Një vepër pa kufizime gjeografike dhe kohore të letrave tona.....109

Kritika mbi kritikën.....110

Vlerësimi krijesve të marginalizuar.....111

**Eshref Ymeri**

Enciklopedia e urrejtjes serbe.....115

**Sotir Athanasi**

Dëshmi të krimit të pandëshkuar.....134

**Eshref Ymeri**

Një enciklopedi e mendimit shqiptar.....140

**Naim Kelmendi**

Vepër vështrimesh kritike dhe shumështrimesh letrare.....14

**Nehat S. Hoxha**

Zbardhje e çështjes kombëtare.....147

<b>Abdullah Konushevc</b>	
Nga forma elektronike te forma e shtypur.....	148
<b>Mehmet Kajtazi</b>	
Fati i gazetarëve në sistemin monist.....	150
<b>Rushit Ramabaja</b>	
Shqipfolësit e barbarizuar.....	151
<b>Rifat Kukaj</b>	
Gjurmë që mbesin në fatet e hidhura të shqiptarëve.....	153
<b>Iljaz Prokshi</b>	
Gjeografia e atdheut.....	154
<b>Mehmet Kajtazi</b>	
Poezi e nënqiellit dhe njeriut pa liri.....	155
<b>Zejnullah Halili</b>	
Poezi e shqetësimit dhe gjakimit për lirinë.....	156
<b>Fatmir Terziu</b>	
Përgjigje krasistëve të historisë shqiptare.....	157
<b>Namik Shehu</b>	
Sfida shkencore të një libri të guximshëm.....	160
<b>Selim Krasniq</b>	
Pas leximit të romanit të Flori Bruqit “Pallati i Akeronit”.....	167
<b>Lumturie Haxhiq</b>	
Vepër me interes të gjerë letrar.....	168
<b>Dibran Fylli</b>	
Leksikoni enciklopedik i Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork-Prishtinë.....	172
<b>Eshref Ymeri</b>	
Vështrim eseistik për veprën letrare “diademë letrare” të autorit Flori Bruqi.....	180
<b>Zef Pergega</b>	
Agu e freskon ballin në krojet poetike të Flori Bruqi.....	188

<b>Zef Pergega</b>	
Një pikë loti që në Olimp lind.....	191
<b>Kozeta Nushi</b>	
Flori Bruqi, intelektual i shquar i kombit shqiptar.....	198
<b>Naim Kelmendi</b>	
Triumfi shqiptar, vepër shumëdimensionale prezentimesh e tematikash historike e letrare.....	203
<b>Rrustem Geci</b>	
Lufta e opinioneve.....	208
<b>Naim Kelmendi</b>	
Olimpi shqiptar.....	210
Reagime dhe polemika që sfidojnë të pavërtetat serbe të kohës.....	212
<b>Rajmonda Maleçka</b>	
Letërsitë si vazhdimësi historike.....	214
<b>Faik Xhani</b>	
Shkrimtari që shtroi “shinat” e “Olimpit” shqiptar.....	220
<b>Kristaq F. Shabani</b>	
Publikimi i vlerësueshëm në fushën e dijes shqiptare, “Olimpi shqiptar” i Flori Bruqit.....	229
<b>Zef Pergega</b>	
Një syth shpirti në akuarelin e një kosovari.....	243
<b>Rasim Bebo</b>	
Një mozaik në letërsi.....	249
<b>Rexhep Shahu</b>	
Libri i 34-t i Flori Bruqit - “Diademë Letrare II.....	258
<b>Nijazi Halili</b>	
Recensioni i “Leksikonit Enciklopedik” nga Akademia Shqiptare-Amerikane e Shkencave dhe Arteve në SHBA.....	264
<b>Adem Avdia</b>	
Ai ka një shtrirje të gjerë krijimtarie artistike e shkencore.....	269



---

## Përmbajtja

---

### **Astrit Kastrati**

Flori Bruçi: ”Ja cila është frika ime më e madhe si shkrimtar!” .....273

### **Flori Bruçi**

Statusi i shkrimtarit sot.....280

### **Zef Pergega**

Pse Kosova e shtypi vetveten më shumë se kur e shkeli serbi?! .....295

### **Dibran Fylli**

Testet e konstruktura për nevojat të një punimi shkencor.....303



Dibran Fylli  
Naim Kelmendi  
FLORI BRUQI KONTI I LETRAVE SHQIPE  
(Intervista, vështrime, recensione)

Shtëpia botuese  
Press Liberty

Formati: 21cm

Tirazhi: 1000 copë

Shtypi “Office Printy”  
Prishtinë, 2021

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

